

**ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**57**




**PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTONET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNËS TË  
SIQIPERISE**



ENVER HOXHA



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TE PPSH

# ENVER HOXHA

VËLLIMI

57

PRILL 1976 – MAJ 1976

SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»  
TIRANË, 1987

## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 57-TË

Vëllimi i 57-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përmban materiale të periudhës prill-maj 1976, shumica e të cilave batoohen për herë të parë.

Duke filluar nga kjo periudhë, nisën të zhvillohen rregullisht takimet ditore të sekretarëve të Komitetit Qendror të PPSH. Këto takime, që u futën në stilin e punës së Sekretariatit të Komitetit Qendror me iniciativën e shokut Enver Hoxha, ishin shprehje e thellimit dhe e zbatimit të mëtejshëm të parimit të kolegjalitëtit. Nëpërmjet tyre udhëheqësi i Partisë informohej dhe mbahej në korent të gjendjes e të punëve të Partisë dhe jepte orientime e porosi shumë të vlefshme për zgjidhjen praktike të problemeve të ditës e të perspektivës. Takimet ditore, ku shpesh merrnin pjesë edhe anëtarë të Byrosë Politike, u bënë një shkollë kalitjeje për sekretarët e Komitetit Qendror, veçanërisht për kuadrot e rinj që erdhën në udhëheqje të Partisë, të cilët mësonin shumë nga përvoja e madhe e shokut Enver, nga këshillat e ndihma e tij e përditshme.

Materialet e vëllimit të 57-të i përkasin një periudhe dymujore, gjatë së cilës masat punonjëse, me komunistët në ballë, të frymëzuara nga direktivat e Partisë, kishin rritur mobilizimin në punë për realizimin e detyrave të kohës, për të pritur Kongresin e 7-të të Partisë me një bilanc sa më të pasur arritjesh.

Në vëllim theksohet domosdoshmëria e forcimit të pandërprerë të rolit udhëheqës të Partisë në të gjitha fushat. Kjo arrihet kur të gjithë komunistët janë vazhdimisht në lustë e në përpjekje për rritjen e rolit pararojë të tyre për ta mbajtur Partinë kurdoherë të pastër, për ta kalitur e për ta revolucionarizuar ideologjikisht e organizativisht atë, organet udhëheqëse dhe organizatabazë. Gjithashtu, theksohet detyra e madhe që komunistët të studiojnë gjithnjë tcorinë marksiste-leniniste dhe dokumentet e Partisë, sepse vetëm këshfu ata do të orientohen drejt në kuptimin dhe në zbatimin e direktivave të Partisë e do të mobilizojnë masat për realizimin e detyrave.

Preokupacioni i Partisë për forcimin e punës në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, duke u mbështetur në forcat tona, zbulohet në një varg materialesh. Detyrat e rëndësishme që shtroheshin përpara bujqësisë për modernizimin e saj kërkonin realizimin e një hopi të madh cilësor jo vetëm në rendimentet e drithërave, por edhe në blegtori, në pemëtari etj. Kjo do të arrihet me lustë frontale kundër koncepteve të vjetruara, praktikave të dëmshme e rutinës burokratike, tendencave frenuese e punës për bujë, me futjen dhe përdorimin e metodave shkencore, me forcimin e kontrollit për zbatimin e detyrave etj. Kuptimplotë dhe mjaft aktuale mbeten, gjithashtu, orientimet e këshillat për kujdesin që duhet treguar për ullinjtë e bletët, për srymën mobiluese që duhej të përshkonte tërë përonjësit e sektorit të nastes, për të cilën ai porosiste të mendohej si për bukën.

Duke trajtuar probleme të rëndësishme që lidhen

me forcimin e mbrojtjes, shoku Enver Hoxha theksonte idenë se atdheu është i pathyeshëm ushtarakisht kur është i fortë edhe ekonomikisht, që mbrojti ja të shikohet kurdoherë e pandarë nga lufsta për realizimin e planit të shtetit, për edukimin e vazhdueshëm politik e ideologjik të mbarë popullit. Ai tërheq vëmendjen për këmbënguljen me të cilën duhej punuar për kuptimin dhe për zbatimin e direktivave të Partisë dhe vendimere të Këshillit të Mbrojtjes. Me forcë shtronhet detyra për realizimin e direktivës së Partisë «Malet janë kala, por duhen bërë kala edhe fushat» dhe kërkonet mobilizimi i të gjithë popullit të armatosur. Këshilla të çmuara jepen në vëllim edhe për revolucionarizmin dhe demokratizmin e jetës në ushtri, për përvetësimin e Artit Ushtarak të Luftës Popullore, për forcimin e lidhjeve të kuadrove me ushtarët, për rritjen e vigjilencës revolucionare e rruajtjen e sekretit.

Me vëmendje e rigorozitet shkencor trajtohen në këtë vëllim probleme të gjendjes ndërkombëtare, të zhvillimit të situatave në botë, të luftës kundër imperializmit e revizionizmit të të gjitha variantave. Me vlera të mëdha janë analizat që u bën autori këtyre ngjarjeve sidomos në shënimet e mbajtura në muajt prill-maj, në kohën kur punonte për raportin e Kongresit të 7-të të PPSH. Këto shënime shquhen për interpretimin shkencor marksist-leninist të problemave të zhvillimit botëror, duke depërtuar në shkaqet e brendshme të tyre. Trajtim i veçantë u bëhet zhvillimeve në Kinë, kaosit e rrëmujës që e kishin pushtuar këtë vend, të cilat ishin pasojë e kursit maoist të ekzistencës së dy vijave në parti, e luftës për pushtet që bënин klanet e ndryshme

të udhëheqjes kineze. Shoku Enver Hoxha kritikon hapur thelbin kundërrevolucionar të teorisë së «tri botëve», si dhe qëndrimet antimarksiste të udhëheqjes kineze për një varg problemesh teorike e praktike të revolucionit e të socializmit.

Në materiale konfirmohen, gjithashtu, qëndrimet e vlerësimet e matura e konstruktive marksiste-leniniste të PPSH, të pakushtëzuar nga koniunkturat e ndryshme, si dhe politika e çiltër, parimore konsekutive e Republikës Popullore të Shqipërisë ndaj fqinjëve e vendeve të tjera.

Në mënyrë të veçantë demaskohet në këto materiale politika e egër agresive e lufthënxitëse e dy superfuqive dhe nënvizohet se etja e tyre e shfrenuar për ekspansion e hegemoni botërore buron nga natyra e tyre e përbashkët si fuqi imperialistic.

Duke studiuar me vëmendje materialet e këtij vëllimi, komunistët, kuadrot dhe mbarë masat punonjëse do të frymëzohen për të punuar e për të luftuar me forcë të reja për suqizimin e ekonomisë dhe të mbrojtjes së atdheut socialist, për ta çuar përparrë çështjen e revolucionit e të socializmit.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

## KU KA QENË E KU PO SHKON KINA?

Shënimë

1 prill 1976

Kina quhej dhe quhet nga kinezët «Cungo», që në frëngjisht i thonë «l'Empire du Milieu» (kështu është quajtur edhe në shekujt e lashtë), që do të thotë «Perandoria e Mesit». Po përse «Perandori e Mesit»? Sepse kinezët për dhjetëra shekuj me radhë (janë zbuluar vlera arkeologjike të 50 shekujve më parë) e konsideronin vendin e tyre «qendrën e botës». Kjo «qendër e botës» ka pasur një kulturë të madhe e të lashtë, jo që kur e konstatoi Marko Poloja; ajo mund të ishte më e vjetër edhe se ajo e egjiptianëve dhe e sumerëve, të cilët konsiderohen si popuj me kulturë më të vjetër në botë.

Është e kuptueshme se kjo fjalë «Cungo», që vazhdon të përdoret dhe tash nga kinezët, nuk është vetëm një emërtim i thjeshtë tradicional, por rrjedhim i formimit të një botëkupimi mijërvjeçar në të gjitha gjeratat kineze, që, në mënyrë të ndërgjegjshme ose jo, ruhet edhe sot.

Besimet fetare të budizmit dhe të konfucizmit, të

cilin Mao Ce Duni u kujtua pas të vjelave ta vinte «në dukje», «ta luftonte» (dhe këtë ai e lidhi me luftën kundër Lin Biaos), e kanë rrënjosur idenë e «Cungo»-së te kinezët tok me botëkuptimet e tyre fetare mistike e filozofike, me format e tyre të organizimit e të drejtimit, me zakonet e shkruara e të pashkruara. Është e kuptueshme se kultura e vjetër kinezë nuk u bë kulturë e popullit kinez, po mbeti kulturë e mandarinëve dhe gjuha e shkruar mbeti privilegji perandorëve dhe i mandarinëve, i «zotërinjve të luftërave», që shtypnin dhe u pinin gjakun popujve të Kinës.

Shumë herë gjatë historisë Kina u sulmua nga të huajt dhe luftoi kundër tyre, por edhe shumë herë të huajt ndikuan dhe krijuan atje një organizim dhe drejtësim të tyre. Por kultura e pushtuesve, duke lënë gjurmë, nuk mundi të asimilonte kulturën e pasur dhe të lashtë kinezë. Ngjau, natyrisht, e kundërtat.

Feja kishte krijuar në Kinë kultin e vet, kultin e budizmit dhe me të lidhët kultin e «Cungo»-së, ngjallte dhe shtonte te kinezët teoritë e Konfucit. Budizmi dhe konfucizmi ngjallën atje ksenofobinë për çdo gjë që ishte e huaj, ashtu siç ngjallën megalomaninë për çdo gjë që ishte e tyre. e «Cungo»-së. Çdo gjë pleksej me këto botëkuptime fetare dhe etike. Këto dhe varfëria e madhe shekulllore fshatarin kinez, të shtypur nga perandorët e feudalët, e bënë fatalist, punëtor dhe të disiplinuar, patriot, ksenofob, disi të heshtur, dyshues ndaj të tjerëve, vendas e të huaj. Çdo veprim dhe mendim i tij formulohej dhe bëhej me mënyra të atilla që ishte zor të kuptoje mendimin e vërlidë che të ndiqje fillin e problemit. Me fjalë të tjera, në të menduar dhe

në të vepruar, kinezi nuk kishte një mënyrë të hapët. të çiltër, por të të alambikuar me shumë kthesa e dredhi dhe miaft herë këto shenja të karakterit mbrojtës kthe-heshin në shprehi të hipokrizisë.

Por, gjatë shekujve, dhe sidomos në kohët tona, karakteri, besimet dhe zakonet e njerëzve ndryshuan, pësuant një evolucion të thellë, por pa humbur krejtësisht tiparet e vjetra. Edhe pas çlirimit përfundimtar nga zgjedha e huaj, edhe pas krijimit të Republikës Popullore të Kinës, edhe pas revolucionit të udhëhequr nga Partia Komuniste e Kinës, Kina vazhdoi deri diku të mbetej një vend «i mbyllur». Nën maskën e regjimit demokratik popullor dhe nën drejtimin dhe udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës e të Mao Ce Dunit, me gjithë përbysjet që bëri populli i saj, prapë Kina qëndroi në pozita mosbesimi, krijoj «miqësira», por koniunkturale, ia mbylli ose ia mbajti të mbyllura portat kulturës përparimtare botërore dhe çdo gjë, çdo evolucion, u përpoq ta bënte në «vazo të mbyllur». Çdo gjë e huaj, edhe teoria marksiste-leniniste, që u adoptua si «ide udhëheqëse», pësonte ndryshime në forma eklektizmi, gjoja të zbatuara në kushtet e Kinës.

**Kultura kineze,** edhe pas fitores së revolucionit, nuk pati një zhvillim të vrullshëm, as nuk u bënë spastrime të teorive të vjetra regresive dhe reaksionare, nuk u hodhën si duhej baza të shëndosha për një kulturë kombëtare dhe revolucionare. Fakt është se pas Revolucionit të Madh Kulturor, që ishte një revolucion me qëllime të tjera, u hodhën parulla dhe u krijuan disa «balete revolucionare», që u vlerësuan prej tyre

sikur të ishin çdo gjë, sikur të ishin bazat e një kulture revolucionare.

Gjithë kultura kineze ishte dhe vazhdon të jetë nën darën e kulturës së vjetër konfuciste. Ajo që maois-tët quajnë «kulturë revolucionare» është propagandë gazetareske e përditshme politike. Shkollat ose qëndrojnë mbyllur, ose në to mësohen njohuri të shartuara. «Kultura» është kufizuar në luftën kundër Kao Ganit, Pin De Huasë, Liu Shao Çisë, Lin Biaos dhe Ten Hsiao Pinit, pa harruar Konfucin, nën mantelin e të cilit kanë futur me këtë rast të gjithë këta bosër.

Është e çuditshme (dhe jo pa arsy) veprimtaria ideopolitike e Partisë Komuniste të Kinës. Kjo ka qëndruar e mbyllur ndaj të huajve, sidomos ndaj partive komuniste dhe punëtore motra. Mendoj se kjo ka arsyet e veta, që janë parimore. «Të palarat t'i lajmë brenda dhe të mos na i dinë të tjerët». Në Partinë Komuniste të Kinës, që nga themelimi i saj dhe deri sot, janë bërë gabime në vijë, që kanë lënë gjurmë të thella dhe e kanë bërë partinë të ketë një vijë të paqëndrueshme, ku i theksuar është oportunitzmi i djathjtë. Por çfarë gabimesh janë bërë në fakt dhe të ç'natyre kanë qenë këto gabime? Për këtë nuk gjen asnje dokument, asnje analizë. Gjen artikuj politikë me formula të përgjithshme dhe numërim emrash të «elementeve kryesorë antiparti». Partia Komuniste e Kinës nuk e ka akoma tekstin zyrtar të historisë së saj. Gjen shkrime të shkëputura episodike të shkruara pa asnje përgjegjësi, që sot qarkullojnë, nesër hiqen dhe dalin shkrime të tjera me idera të tjera. Botërisht dihen vetëm raportet e kongreseve të 8-të, të 9-të dhe të 10-të të kësaj partie.

Të gjitha këto, ose vetëm këto, konsiderohen të drejta, asnjë pjesë s'është hequr prej tyre, sido që në to ka gabime kolosale. Këto mbulohen të tëra me emrin e Maos, sepse të Maos, të Liut, të Tenit dhe të Çusë kanë qenë, prandaj, po të spastrohen gabimet në vijë, që janë në to, atëherë ku shkon autoriteti i Maos, i cili ka qenë në krye të Partisë?

Ekzistojnë po ashtu katër vëllime të shkruara nga Maoja gjatë kohës së luftës. Këto u përmblodhën, «urregulluan dhe u stolisën» si të bazuara në teorinë marksiste-leniniste. Këto shkrime dolën disa vjet pas çlirimtë të Kinës dhe thonë se janë rregulluar nga filozofi sovjetik Judin që ka qenë ambasador në Kinë. Vepratë tjera të Maos nuk ka. Luftohet me citatet e tij të vjetra eklektike. C'ka bërë ky «teorien i madh» gjatë gjithë këtyre viteve? Ka dhënë mendime, ka folur, ka dhënë zgjidhje për një varg problemesh të mëdha? Pothuajse asgjë nga këto s'ka të botuar. Vetëm propagandohet maocedunideja baras me marksizëmi-leninizmin, bile ka lakenj të Maos që, në radhën e fotografive të klasikëve, kanë futur fotografinë e tij pas asaj të Engelsit dhe para Leninit.

C'rezulton nga gjithë kjo? Një fshehje e së vërtetës në zhvillimin dhe në luftën e Partisë Komuniste të Kinës dhe një pompim artificial i Mao Ce Dunit. Megalomania antimarksiste kineze është shpalosur, kulti i Maos është bërë i njëlojtë me atë të Konsfucit. Çdo gjë që bën Maoja, çdo gjë që thotë ai, është «e drejtë». Të gjithë duhet të binden për çka thotë Mao Ce Duni. S'lejohet arsyetim, por vetëm fanatizëm.

Më lart theksova se në Partinë Komuniste të Kinës

janë bërë shumë gabime në vijë, që në fillim. Po në ç'baza u formua në Kinë partia? Nuk dihet gjë. Maoja vetë s'ka shkruar për këtë, ose ka shkruar pak gjëra, por që edhe ato nuk njihen. Në katër vëllimet e Maos, që janë botuar, trajtohen çështje të politikës dhe të vijës së partisë, flitet mbi organizimin e saj, në to Maoja përpinqet të parafrazojë Marksin dhe Leninin, por çdo gjëje i jep ngjyrën e një leksioni teorik, duke synuar të edukojë kuadro, ose të dalë dhe të hiqet si një teoricien i afirmuar. Në to nuk spikatin, ose spikatin fare pak, lufta e gjallë e partisë, luftërat fraksioniste, lufta e klasave jashtë dhe brenda partisë. Jo, atje ka gjoja teori të tij, por në të vërtetë ato janë parafrazime të cunguara të Marksit ose të Leninit. Në këto vëllime nuk gjen mendime të Stalinit. Në Kinë Stalinin e gjen vetëm në një portret, në «Tien An Men».

Shumë fraksione kanë ekzistuar në Partinë Komuniste të Kinës dhe kjo ngaqë vija bazë e partisë nuk ka qenë plotësisht marksizëm-leninizmi. Kështu duhet të ketë qenë që në themelin e partiisë, sepse protagonistët e saj, Maoja, Cu En Lai, Cu Deja, për të mos folur për Li Li Sanët e të tjerë, nuk kanë qenë marksistë të formuar, por këta nuk kanë bërë as përpjekje sa duhet për të përvetësuar marksizëm-leninizmin. Ata e donin çlirimin nacional dhe social të Kinës, por idetë mbi komunizmin dhe ideologjia e tij nuk duhet të kenë qenë të qarta për këta shokë.

Mbyllja në vjetvete e Kinës i mbyllte edhe Maon e Çunë në këtë ambient. Këta nuk shikonin jashtë Kinës, dhe me siguri në nocionet e tyre fillestare, që i çonin drejt revolucionit, plekseshin shumë pikëpamje nacio-

nale, borgjeze, demokratike, përparimitare dhe mistike. Për republikën e Sun Jat Senit, për të cilën ata flasin mirë, nuk shohim të shfaqet të paktën mendimi kritik në ndonjë material të qartë të Partisë Komuniste të Kinës. Edhe atëherë, edhe tash, gjërat lihen në mjegull, ka mendime dhe interpretime të çfarëdo lloji, prandaj në to -zgjidh e merr-. Më shumë dhe kryesisht janë të huajt që kanë shkruar për këtë epokë revolucionare dhe përparimitare. Për kinezët zgjimi dhe lufta e Kinës fillojnë e mbarojnë me Maon.

Sun Jat Seni ishte një personalitet i madh, që e kuptoi drejt vlerën e miqësisë me Bashkimin Sovjetik të Leninit, i cili i zgjati dorën dhe i dha Kinës ndihmën e përkrahje. Partia Komuniste e Kinës apo ishte formuar në atë kohë dhe, natyrisht, ndikimi i saj në masat ishte i paktë, ndërsa ndikimi i Sun Jat Senit dhe i Guomindanit ishte i madh. Se si veproi, si u lidh dhe si luftoi Partia Komuniste e Kinës në këto momente, as që mund të flasim me siguri, ose mund të flasim vetëm duke u mbështetur në ato që kanë shkruar të huajt, sepse vetëm ata kanë pasë bërë analiza; mirëpo analizat e tyre udhëhiqen nga parime dhe qëllime të tjera, në të cilat ne nuk mund të mbështetemi. Faktet vërtetojnë se Bashkimi Sovjetik, sa ishin gjallë Lenini dhe Stalini, e ruajti dhe e zhvilloi miqësinë me Kinën dhe me Guomindanin si në kohën kur rronte Sun Jat Seni, ashtu edhe kur këtë e zëvendësoi Çan Kai Shia.

Komünistët kinezë baslikëpunuan në këtë vijë, por si, sa, ç'kontradikta lindën dhe pse lindën, ne i marrim me mend, se jemi marksistë dhe e dimë ç'përfaqësonë Çan Kai Shia. Një studim dhe një analizë e tillë nga

ana e Partisë Komuniste të Kinës nuk është bërë, të paktën me sa dimë ne. Asnjë histori e popullit kinez nuk është shkruar nga shteti proletar kinez dhe nga Partia Komuniste e Kinës. Çdo gjë që kemi lexuar mbi këtë problemi të madh, e kemi lexuar nga historianë, shkencëtarë e sociologë të huaj dhe borgjezë.

Shumë gjëra nuk dimë, por dimë që Partia Komuniste e Kinës trumbeton *in petto*<sup>1</sup> se: Kominterni ka gabuar me Kinën, se Stalini ka gabuar (dhe, sipas Maos, Partia Komuniste (b) e Bashkimit Sovjetik ka njojur gabimin), se Bashkimi Sovjetik ka dhënë direktivën që Partia Komuniste e Kinës të bashkëpunonte me Guomindanin, kur nuk duhej etj., etj. Të gjitha këto thuhën qosheve dhe korridoreve dhe mendoj se kanë për qëllim të ngrenë Maon «që s'ka gabuar kurrë» dhe të ulin Stalinin «që ka gabuar».

C'mund të konkludojmë nga gjithë këto gjëra, për të cilat s'ka asnjë analizë? Stalini dhe Kominterni, në vija të përgjithshme, s'kanë gabuar as mbi luftën revolucionare në Kinë dhe as mbi aleancën e Partisë Komuniste të Kinës me Guomindanin. Kurse Maoja dñe Partia Komuniste e Kinës kanë gabuar, këta as që e kanë interpretuar dhe as që e kanë zhvilluar drejt në jetë vijën e Kominternit. Për çlirimin e Kinës kundër kolonizatorëve, kundër Japonisë militariste, duhej aleanca e këtyre dy forcave, komuniste dhe borgjeze përparintare. Ka mundësi që në këtë luftë, në këto kontakte, njerëz si Bluheri e të tjerë delegatë të Kominternit, që dolën trockistë dhe u dënuan, të kenë gabuar,

---

1. Italisht — brendapërbrenda, fshehtazi.

por vija e Kominternit për aleancën e forcave përparrimtare në Kinë, që luftonin kundër Japonisë, ka qenë e drejtë. Çan Kai Shia tradhtoi, ai u nda nga komunistët, u përpoq t'i likuidonte këta, e dobësoi luftën kundër Japonisë dhe hoqi dorë prej saj. Ky është një problem që lidhet me një periudhë të errët e të koklavitur dhe për këtë nuk mund t'i hidhet faji as Stalinit, as Kominternit, siç bëjnë shokët kinezë. «Stalini ka bërë gabime», pretendon Maoja, por, në fakt, është vetë Mao Ce Duni që ka bërë gabime dhë jo vetëm atëherë që do të ketë bërë, por edhe tash ka bërë shumë gabime, të cilat po i shohim bashkë me pasojat e hidhura të tyre. Në Kinë vazhdojnë të thonë se Maoja s'ka gabuar asnjëherë, as dje, as sot dhe as nesër nuk do të gabojë. Për kinezët kjo është tabu, por është një pohim antimarksist.

Qëndrimi i Maos dhe i shokëve të tij ndaj Bashkimit Sovjetik të kohës së Stalinit të lë të dyshosh. Ai nuk ka qenë i drejtë dhe i sinqertë. Gjatë kohës së luftës çlirimtare të Kinës, ne, të paktën, nuk dimë të jenë manifestuar mërrira, sidomos nga ana e Stalinit, e Bashkimit Sovjetik dhe e Kominternit. Kan Shen, një nga udhëheqësit më të mirë revolucionarë marksistë-leninistë të Kinës, ka qenë përfaqësuesi i Partisë Komuniste të Kinës në Komintern dhë asgjë për keq nuk ka solur ai nü këtë drejtim.

Ne e konsideruam Kinën e pasçlirimtët një shtet të demokracisë popullore të udhëhequr nga një parti komuniste e lavdishme, në krye të së cilës ishte një marksist-leninist i madh, që quhej Mao Ce Dun. Si të gjitha vendet tona që u çliruan dhe vendosën rendin e demo-

kracisë popullore, edhe Kina u lidh ngushtë me Bashkimin Sovjetik dhe me Stalinin. Më vonë ne mësuam shumë gjëra për peripecitë e Partisë Komuniste të Kinës dhe të Guomindanit, për «Marshimin e Madh», për miqësinë e Maos me oficerë dhe me gazetarë të huaj, si me amerikanin Edgar Snou e të tjërë, që qëndronin në shtabin e tij; mësuam për kontaktet «e frytshme» të Maos dhe të Çusë me Vandemejerin dhe Marshallin, që organizonin dhënien e ndihmave amerikane Maos dhe Çanit, si dhe për lobitë kineze në Uashington. Këto natyrisht na bënин përshtypje, por i quanim thjesht taktika dhe jo prirje drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, siç u duk qartë më vonë. Te Maoja ne shihnim një komunist, te partia e tij një parti komuniste, dhe te Kina një vend socialist, mik tonia e, në radhë të parë, të Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit.

Sa ishte gjallë Stalini, Maoja vajti një herë në Moskë, ai u takua dhe bisedoi me Stalinin. Ç'biseda bëri, ne nuk dimë gjë, por e marrim me mend se Stalini e ka pritur shumë mirë Maon dhe me siguri i ka pasë akorduar Kinës çdo ndihmë që i ka kërkuar kjo. Vetë Partia Komuniste e Kinës ka deklaruar zyrtarisht se «Si Lenini, edhe Stalini kanë njojur se regjimi carist ka rrëmbyer toka të Kinës, të cilat duhet t'i kthehen se janë të sajat». Këto deklarata kinezët i bënë të njoitura, kur Kina hyri në konflikt me revizionistët hruščovianë.

Pra, me sa mund të gjykojmë ne, Stalini e trajtoi Kinën si mike, si vend socialist, çështjen e kufijve ai e trajtoi në fryshtë marksiste-leniniste dhe Mao Ce Dunin e konsideroi sinqerisht si shok. Por, në Mbledhjen e partive komuniste dhe punëtore që u bë në Moskë në

vitin 1957, pra që përpara Mbledhjes së 81 partive, Maoja, për të nimbëshjetur Hrushovin, që po tradhtonic marksizëm-leninizmin, tha haptazi, me përbuzje dhe me ironi, se kur u takua me Stalinin, iu duk vetja «si nxënësi i vogël përpara mësuesit». Me këtë Maoja donte të mbronte dhe mbrojti në fakt shpifjet e Hrushovit mbi «kultin e Stalinit», i cili gjoja «këtë Mao të madh» e kishte konsideruar si djalkë. Ky ishte një sulm që Maoja bënte kundër Stalinit. Këtë e them me plot bindje, se në takimin tim të parë me Stalinin, kur unë isha aq i ri dhe i emocionuar, Stalini, me atë sjelljen e tij aq të njerëzishme, me dashuri dhe respekt për shokun, më trajtoi si të barabartë dhe biseda e tij aq e ngrohtë e shkrua menjëherë akullin tek unë. Maoja në atë mbledhje shkoi edhe më tej, ai i dha të drejtë Hrushovit që likuidoi grupin «antiparti» të Molotovit etj., bile e quajti Hrushovin «Lenini i kohëve tonas».

C’mund të nxjerrim nga këto veprime të Maos?

Se Maoja ishte kundër Stalinit dhe, bashkë me shokët e tij, punonte që të ngrinte kultin e vet. Qëllimi ishte që Stalinit «të rrëzuar dhe të njollosur» nga tradhtarët, Maoja t’i zinte vendin në radhën e marksistëve të mëdhenj në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ai mendoi se, për hir të ndihmës që po i jepte Hrushovit në këtë rast, ky do ta favorizonte kultin e ri të Maos dhe Kina do të bëhej qendra e revolucionit. «Frym era e Lindjes», «Lindja është e kuqe», «Mao Ce Duni është dielli i botës» — këto ishin sloganet që lëshonte atëherë propaganda kinezë.

Por nuk ngjau siç mendonte dhe dëshironte Maoja. Revizionizmi sovjetik dhe Hrushovi i treguan atij bë-

rrylin. Maoja dhe maoistët u përpoqën të mos i çonin punët majë më majë, por ato s'mund të zhvilloheshin ndryshe. Atëherë taktika e Mao Ce Dunit ndryshoi. Vazhdoi ngritja në qell e kultit të Maos si «marksist-leninist i madh», që luftonte kundër revizionizmit modern dhe, në radhë të parë, kundër atij sovjetik, e njëkohësisht edhe kundër imperializmit amerikan dhe borgjezisë reaksionare botërore. Një luftë e tillë ishte e drejtë, prandaj ne e përkrahëm dhe kinezët na përkrahën ne. Por, në fakt, ata e përdorën këtë taktikë jo nga pozitat klasore dhe në rrugën marksiste-leniniste. Kinezët me këtë taktikë dëshironin dhe u përpoqën të forconin pozitat e Kinës në lëvizjen komuniste dhe në popujt e botës si një «shtet me të vërtetë socialist, i papajtueshëm me armiqëtë e klasës dhe të popujve që luftonin për çlirim». Ndërkaq Maoja dhe maoistët brenda në partinë e tyre duhej të luftonin fraksionin e djathtë të Liu Shao Çisë, Çu En Lait, Ten Hsiao Pinit e të tjerë, që, nën hijen e Maos, luftonin për rivendosjen e kapitalizmit dhe kishin synime ta kthenin politikën drejt miqësisë me hruščovianët.

Mao Ce Duni ishte vënë në mes dy zjarresh që, në fakt, i kishte ndezur vetë, me qëllim që të arrinte objektivat e tij, ta kthente Kinën në një fuqi të madhe botërore. Ai u gjend kështu në mes revizionistëve sovjetikë dhe fraksionit të rrezikshëm të Liu Shao Çisë. Atëherë ai shpërtheu Revolucionin Kulturor, për të cilin këtu nuk do të zgjatem, se kam solur e kam shkruar shumë.

C'rrugë zgjodhi Maoja (sepse më duket se këtu s'bëhet fjalë për vullnetin e partisë) për të arritur në

këto qëndrime jomarksiste? Ai filloi të ndiqte një vijë konformiste. Sa ishte Stalini gjallë, vija e Maos ishte «miqësore» dhe «admiruese» ndaj Stalinit. Në atë kohë kultivohej në Kinë miqësia me Bashkimin Sovjetik. Pas vdekjes së Stalinit Maoja u tregua oportunist dhe u orvat të zinte vendin e Stalinit në lëvizjen komuniste ndërkombejtare. Nga ana e tij filluan edhe lajkat për të gënjer Hrushovin dhe, natyrisht, lëshoi kritikat kundër Stalinit. Para nesh në Pekin, në vitin 1956, ai mbrojti revizionistin dhe tradhtarin Tito, sepse ishte edhe vetë një revizionist, një liberal, një përkrahës i Hrushovit.

Pas prishjes me Hrushovin, kur Liu dhe Teni ishin në fuqi dhe në vende kyç, në organet qendrore të Kinës u botuan një sërë artikuash ideologjikë në vijën marksiste-leniniste kundër revizionistëve hrušovianë. Këta artikuj ishin teorikë dhe jo një propagandë e rëndomtë kundër revizionizmit. Kjo ishte një kthesë, natyrisht një kthesë c mirë, se, duke demaskuar teorikisht revizionizmin, edukohet Partia Komuniste e Kinës. Por ajo pati jetë të shkurtër. Artikujt e kësaj natyre u zhdukën nëpër sirtarc dhe filloi të dukej një lëkundje në vijë. Partia Komuniste e Kinës nuk vazhdoi ta edukonte më masën e komunistëve në vijën e drejtë marksiste-leniniste, por u kufizua duke botuar artikuj ideologjikë të Partisë sonë. Neve na vinte mirë për këtë, por nuk donim, dhe mendonim se nuk ishte e drejtë, që Kina ta pushonte polemikën kundër revizionizmit dhe të tërhiqej nga sheshi i luftës. Kjo tregonte përsëri lëkundje liberale në vijën e Partisë Komuniste të Kinës. Botimi i artikujve tanë teorikë në

shtypin kinez kishte për qëllim jo të mbështeste vijën tonë marksiste-leniniste, por të krijonte përshtypjen se Partia Komuniste e Kinës nuk kishte ndërruar qëndrim në vijë, të fshihte kthesën liberale që po bënte dhe të linte përshtypjen në opinionin botëror se «jam unë, Kina, që ia diktoj Partisë së Punës të Shqipërisë këta artikuj, këtë vijë». Dhe shtypi borgjez botëror fliste hapur se «Shqipëria është satelite e Kinës», se «Shqipëria është gramafoni i Kinës», se «ato që mendon Kina, ia dikton Shqipërisë dhe kjo i shpreh». Ky ishte një qëndrim jo i ndershëm, jomarksist nga ana e Kinës. Por, derisa propagandoheshin idetë marksiste-leniniste të Partisë sonë, ne thoshim «tymi le të vejë drejt.. Mirëpo në Kinë tysi nuk shkonte drejt.

Ra Hrushovi. Përnjëherë doli në drithë vija oportuniste e Maos. Ai mendoi se erdhi koha e tij; prandaj, nëpërmjet Çu En Lait, i cili vrapi është Moskë, kërkoi që edhe ne të venim të merrnim pjesë në «dasmën» e revizionistëve. Në e refuzuam kategorikisht këtë hap oportunist, refuzuam, gjithashtu, kategorikisht propozimin kinez «për krijimin e një fronti antiimperialist bashkë me revizionistët». Kjo tregonte dëshirën e zjarrtë të udhëheqësve kinezë për t'u puqur me revizionistët sovjetikë, por si revizionistë synonin që në këtë rrugë ata të dominonin vetë. Kjo nuk u doli.

Plasi Revolucioni Kulturor. Ky revolucion ishte rezultat i luftës në mes dy rrymave të djathëtë liberale revizioniste, se kush të merrte pushtetin: Maoja apo Liu. Në këtë ndeshje fitoi Maoja, i cili Liun dhë Tenin i akuzoi «armiku numër një» dhe «armiku numër dy». Çunë, Maoja e futi në shërbim të tij, sepse ky, ashtu si

dhe Mikojani në Bashkimin Sovjetik, ishte shërbëtori i të gjithëve. Maoja na doli si «shpëtimtar», si «revolucionar», se po bënte «revolucion», dhe iu shiu fama si «marksist-leninist i madh», mbasi fitoi mbi Liu Shao Çinë.

Ne e mbështetëm Revolucionin Kulturor dhe ishim e vetmja parti në fuqi në krah të tyre. Vetë udhëheqësit kinezë e njohën këtë mbështetje të madhe dhe e propaganduan shumië.

Natyrisht, Revolucioni Kulturor, siç e kam thënë edhe më parë, nuk mbështetej në një vijë të qartë marksiste-leniniste, se partia çë shpartalluar, organizatat e masave, gjithashu, nuk ekzistonin. Vetëm ushtria me Lin Biao qëndronte pa lëvizur pro revolucionit. Çdo gjë ishte rrëmujë, çështja ecte *par inertie*. Çu ja, që shkonte nga frynte era, mbante timonin e pushtetit me një dorë dhe me tjetrën tundte «librin e kuq» të Maos, që kishte përgalitur Lin Biaoja. Gjatë Revolucionit Kulturor u shpreh me forcë ksenofobia, derisa u dogjën ndërtesa ambasadash të huaja, u irrahën diplomatë etj. Në krye të këtyre veprimeve të shëmtuara, që u ngjisnin atyre që kishte bërë Suhartoja në Indonezi, ishte edhe vetë Çu En Lai.

Teni dhe Liu me shokë «u mposhtën», por duhej ngjitur çqe thyer, dhe në fakt ishin thyer shumë gjëra. Këto rregullime i bënte revizionisti Çu En Lai, gjoja me udhëzimet e kryetarit Mao, i cili, në kohën e Revolucionit Kulturor, i shkruante gruas së tij se «shkrimet e mia do t'i përdorin edhe revolucionarët, edhe kundërrevolucionarët». Vetë Maoja pohonte se ai nuk kishte një vijë marksiste-leniniste, por dy dhe dhjetë

vija, njëloj si teoria e «lulëzimit të njëqind luleve».

Partia jonë ka bërë çmos që të forcohej miqësia në mes të dy vendeve dhe të dyja partive tona, por kinezët shumë herë kanë refuzuar të shkëmbenini delegacione pune midis partive tona. Çdo delegacion ata e kthenin në delegacion «miqësie» për mitingje në masë dhe për fjalime në bankete me dollira. Ne konstatonim se udhëhoqësit kinezë nuk e donin një shkëmbim eksperience të partisë së tyre me Partinë tonë, ata u ruhen në debateve politike, ideologjike dhe organizative. Kjo ishte një derë e mbyllur. Unë, ashtu si edhe shokët e tjerë, në biseda me Çunë dhe me Jao Ven Juanin, gjenim rastin të flitnim për probleme partie, duke marrë shkas nga eksperiencia jonë, por ata vazhdonin me formulat e tyre bajate. Vetëm një herë, Çuja, ky clement liberal dhe oportunist, kur erdhi te ne, na bëri një kritikë sikur Partia jonë gjoja nuk zhvillonte luftën e klasave. Kur ne e vumë përpëra me fakte, duke i treguar se gjithë jetën Partia jonë ka zhvilluar një luftë klase të ashpër, brenda dhe jashtë vendit, si dhe në vetë gjirin e Partisë, i ndodhur përpëra faktëve, ai u detyrua të kërkonte falje se «nuk e njoh si duhet historinë e Partisë suaj».

Po ashtu ne nuk e shihnim të drejtë vijën e izolimit të Kinës në arenën ndërkombëtare. Ne ia kishim shtruar pikëpamjet tona zyrtarisht Li Hsien Nienit, duke arsyetuar se lufta duhej vazhduar e ashpër kundër dy superfuqive, kurse me popujt dhe me shtetet e tjera Kina duhej të hapej, se kështu do të përqanim armiqjtë tanë kryesorë dhe do të shqelmonim propagandën e tyre shpifëse kundër vendeve tona. Por ki-

nezët qëndronin në pozitat e tyre dhe nuk ndiqnin këtë rrugë të arsyeshme dhe në interesin e Kinës, tonin dhe të popujve të tjera të botës. Kinezët na çuditin me qëndrimet e tyre. Në këtë rast ata nga liberalë tregoheshin sektarë. Liberalizmi dhe sektarizmi janë motër e vëlla. Kina e injoronte krejt Evropën, ruante qëndrime armiqësore me vendet e Azisë dhe, për vendosjen e marrëdhënieve normale me shtetet e ndryshme, kishte vënë përpara kushtin e njohjes së Tajvanit si pjesë e tokës kineze. Kurse për Afrikën dhe vendet e Amerikës Latine botonin nga një artikull propagandistik një herë në hënë në «Zhenminzhibao». Në arenën ndërkombëtare politika e Kinës ishte e ngrirë, sektare, megalomane, në izolim dhe ksenofobe, si të thuash, deri në «racizëm të verdhë» të padeklaruar.

Kur ne po shqetësoheshim në këtë drejtim, plasën si bombë vizita e fshehtë në Kinë e Kissingerit dhe bisedimet e fshehta të tij me Maon dhe me Çunë. Kina filloi një periudhë të re, një politikë të re, prapë të gabuar, politikën e djathë të drejtim të atrimit me amerikanët, por që do të shkonte shumë më tej, deri te fashistët Franko në Spanjë dhe Pinoçet në Kili.

U duk qartë se në hapjen e Kinës në marrëdhëni e saj me shtetet e ndryshme të botës, arsyjeja që «pengonte» s'kishte qenë njohja e ishullit të Tajvanit si tokë kineze. Si në mënyrë magjike ky problem u shkri dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës filluan lidhjet dhe marrëveshjet me Kinën, pa bërë, në fakt, asnjë lëshim deri tani për Tajvanin. Lidhjet dhe marrëveshjet e fshehta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vajtjen e Niksonit në Kinë ne i kundërshtuan,

si shokë që ishim, duke u folur se kjo miqësi që lidhej nga kinezët me imperializmin amerikan, nuk do të sillte asgjë të mirë përveç së keqes për vetë Kinën, për sozializmin dhe për mbarë botën. Letrës sonë për këtë çështje, por edhe për çështje të tjera, siç kam shkruar edhe më përpara, Mao Ce Duni as që denjoi t'i përgjigjej.

Pse ngjau kjo kthesë e Kinës drejt imperializmit amerikan? Për arsyen se Maoja dhe Çuja ishin revolucionistë, liberalë, oportunistë dhe se politika e tyre ishte një politikë pragmatiste e që synonte ta ngrinte Kinën në një superfuqi. Që të arrihej një gjë e tillë, sipas Maos dhe Çusë, Kina duhej të mbështetej te Bashkimi Sovjetik revisionist osë tek imperializmi amerikan. Lufta në të dy krahët nuk ishte gjë për Maon. Kina, sipas tij, «duhej të mbështetej te njëra superfuqi, për të luftuar tjetrën dhe asaj t'ia nxirrin të tjerët gështhenjat nga zjarri». Këtë punë bëri edhe Bashkimi Sovjetik. Edhe ky s'pranoi të lidhej me Kinën, sepse, kuptohet, Bashkimi Sovjetik nuk pranonte që të sundohej nga Kina. Maoja, nga ana e tij, s'ia arriti dot qëllimit që Bashkimi Sovjetik t'i shërbente Kinës. Bashkimi Sovjetik u hap drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, superfuqi e pasur, nga të cilat mund të merrte kredi dhe të vendoste kështu hegemoninë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga ana e tyre, e pranuan këtë hapje për të rindarë sferat e influencës me Bashkimin Sovjetik dhe për ta dobësuar këtë.

Kina asgjë origjinale nuk bëri. Edhe kjo, duke e parë se qëllimi që kishte ndaj Bashkimit Sovjetik dështoi, u kthye nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga

miqësia e vjetër e Maos. Çuja, po, donte famë, donte dominim. Të dy, Maoja dhe Çuja, ishin revizionistë. Ata përgatitën politikën e re. Mirëpo në rrugën e tyre kishite kundërshtarë brenda dhe një nga më kryesorët ishte Lin Biaoja. Atëherë ky duhej eliminuar dhe u eliminua me akuzën si «komplotist që donte të vriste Maon, por që u zbulua, mori avionin dhe u nis për në Bashkimin Sovjetik, nëpërmjet Mongolisë, mirëpo avioni i tij u dogj në stepat mongole». Pra, Lin Biaoja u vra si «agjent i sovjetikëve».

Në Kongresin e 9-të të Partisë Komuniste të Kinës, që u bë kur qe gjallë Lin Biaoja, silitj për luftën në të dy krahët, ndërsa më vonë, në Kongresin e 10-të, pas vrasjes së Lin Biaos, asnjë fjalë nuk u tha se ç'politikë të jashtme mbronte Lin Biaoja.

Vrasja e Lin Biaos ishte një peshqesh që u vu në duar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat u kënaqën. U shkri akulli. Tash Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si arbitër i botës, do të manovronin edhe nga Bashkimi Sovjetik, edhe nga Kina, kuptohet, për interesat e tyre. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do zuan dhe vazhdojnë të dozojnë si duhet qëndrimet me të dy, edhe Bashkimin Sovjetik ta dobësojnë e të manovrojnë që edhe Kinën ta përdorin kundër Bashkimit Sovjetik. Dhe kështu ngjet. Kina efektivisht e pushoi luftën kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe intensifikoi deri në absurditet propagandën kundër Bashkimit Sovjetik. Them propagandën, sepse artikuj ideologjikë nga ana e Kinës për demaskim kundër Bashkimit Sovjetik nuk ka. Vija e Kinës në këto momente është: «Armiku ynë kryesor është Bashkimi Sovje-

til». Kush del kundër Bashkimit Sovjetik, është miku i Kinës, qoftë ky edhe fashist. Kështu, ndërsa ndaj vendit tonë, që lufton në të dy krahët — kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe socialimperializmit sovjetik — Kina po mban qëndrime jomiqësore, shtetet revizioniste proamerikane që bëjnë disa manovra anti-sovjetike, janë bërë miqtë e Kinës. Këtë qëndrim «e mbajmë për të forcuar dhe për të thelluar kontradiktat», thonë kinezët. Por realiteti tregon se Kina e Maos është dakord me këto shtete, se e tillë është vija e saj revizioniste në ideologji dhe në politikë. Lidhjet e Kinës janë zhvilluar me të gjitha vendet kapitaliste të botës dhe për vete ajo u deklarua zyrtarisht pjesëtare e «botës së tretë». U hapën dyert e Kinës për presidentët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për mbretërit, princërit, princeshat, kryeministrat, senatorët, grupet parlamentare, afaristët, për derrin dhe për dosën. Dyert e Kinës janë mbyllur vetëm për delegacionet zyrtare shqiptare.

Populli kinez ka një dashuri të sinqertë për popullin shqiptar dhe për Partinë e Punës të Shqipërisë. Revisionistët kinezë nuk kanë guxuar akoma ta ata-kojnë këtë miqësi. Kuadrot kryesorë të djathët që, sipas mendimit tonë, në Kinë janë në suqi dhe kanë pozita të forta, po godasin marrëdhëniet ekonomike që ekzistojnë midis nesh. Ata nuk po realizojnë kreditë që na janë akorduar, shtyjnë afatet e livrimit të objekteve që ndërtojmë, kanë ulur nivelin e tregtisë, po ngushtojnë në minimum sferën e kontakteve me vendin tonë. Me një fjalë, udhëheqësit kinezë janë futur në rrugën e Hrushovit kundër nesh. Ata mësuan nga

bllokada sovjetike, e cila erdhi brutalisht, kurse bllokada e këtyre realizohet ngadalë dhe e mbuluar me qëndrime e deklarata hipokrite, si «jemi miq, jemi të varfër, na kuptioni» etj. E tërë kjo kthesë është e dja-të, revisioniste, socialimperialiste.

Kjo është vija e Maos dhe e Çu En Lait, të cilët rehabilituan Tenin dhe e përgatitën që ky të zëvendësonte Çunë dhe Çuja Maon pas vdekjes së këtij. Por personi «i mesëm» i «Perandorisë së Mesit» vdiq i pari. Me vdekjen e tij «radikalët» nuk e pranuan Tenin dhe filluan demaskimin e tij. Kjo gjë bëri që në Kinë, në parti dhe në pushtet, të dalin në pah dy vija, dy grupe rivale, dhe Maoja ndodhet tash në mes të dy rrujëve. Por ai është plak dhe s'mund të veprojë më. U realizua ajo për të cilën e kishte paralajmëruar ai Çian Çinin dikur në letrën që i dërgonte se edhe reaksionarët, edhe revolucionarët do ta përdorin maocedunidenë.

Pra në Kinë po lushtohet, po kush vallë do të fitojë?! Kjo nuk dihet. «Radikalët» kanë në dorë vetëm propagandën, të tjerët kanë në dorë politikën e jashtme, ekonominë dhe ushtrinë, sepse asgjë, në fakt, nuk ka ndryshuar nga kursi i vjetër Mao-Çu-Ten.

Teni është në parti dhe ai po demaskohet, por shokët e tij janë në pushtet, politika me Shtetet e Bashkuara të Amerikës po vazhdon e lulëzon. Kina mbëshitet, gjithashiu, të gjitha qeveritë dhe shtetet reaksionare. Partia Komuniste e Kinës i këshillon marksistë-leninistët, ngado që janë, të bashkohen me borgjezinë e vendeve të tyre, qoftë kjo edhe fashiste, dhe të

mbrojnë aleancat e tyre reaksionare, vetëm të luftojnë kundër Bashkimit Sovjetik revizionist.

Ku po shkon Kina me këtë vijë? Drejt një social-imperializmi të ri, drejt marrjes së fuqisë nga kapitalistët e rinj, por edhe të vjetër, që vija oportuniste e Maos i ka mbajtur në fuqi, i ka ruajtur dhe i ka forcuar.

Në Kinë medoemos ka forca të shëndosha marksiste-leniniste, por unë mendoj se këto nuk mund të identifikohen me të ashtuquajturit radikalë. Këta janë kundër të djathhtëve, por janë maoistë, liberalë, për bashkekzistencën e dy vijave në parti. Vetëm një përmbyrsje e fortë revolucionare marksiste-leniniste do ta shpëtojë Kinën nga rivendosja e kapitalizmit.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, «Shë-  
nime për Kinën», rëll. II.  
f. 225*

*Marrë nga libri:  
Enver Hoxha, «Ditar për çë-  
shtje ndërkombëtare» (botim  
i brendshëm), nr. 8, f. 297*

## TË PUNOJMIË PA U LODHUR PËR TË ECUR GJITHNJE MË PËRPARA

*Nga biseda me kuadro të Partisë, të pushtetit dhe  
të organizatave të masave të rrëthit të Vlorës<sup>1</sup>*

2 prill 1976

*Gjatë kohës që ishte me pushime në qytetin e Vlorës, shoku Enver Hoxha zhvilloi një takim me kuadro të rrëthit. Që në fillim, ai u krijoit të pranishmëve një atmosferë të ngrohtë shoqërore dhe pastaj, si pa kuptuar, kaloi në çështjet që do të trajtonte e që preokuponin aktualisht Partinë e vendin.*

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sot jam shumë i gjëzuar, shokë, që po takohem me ju. Shumicën tuaj, sidomos ata që janë më të moshuar, i njoh, por po shikoj këtu edhe shoqe e shokë të rinj. Kjo është një kënaqësi e madhe për ne, pse kjo do të thotë që organizata e Partisë, si kudo, edhe në rrëthin e Vlorës, ka sjellë në udhëheqje elementë të rinj, që bëjnë përpjekje për të bashkuar

---

1. Në këlë bisedë ishin të pranishëm edhe anëtarë i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH, Hysni Kapo, si dhe anëtarja e KQ të PPSH, Nexhmije Hoxha.

forcat, energjitetë dhe zotësitë e tyre me ne, më të moshuarit.

Sigurisht, ju keni punuar dhe keni korrur suksese në detyrat e rëndësishme që ju kanë ngarkuar dhe besoj se sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit, do të na flasë për disa prej tyre.

*SHOKU GAQO NESHO<sup>1</sup>:* Ju, shoku Enver, shprehët kënaqësinë c madhe që ndieni duke u takuar me ne, por ne ndiejmë, gjithashtu, një kënaqësi edhe më të madhe që takohemi sot me ju. Të gjithë vlonjatët, të qytetit dhe të fshatit, u gjëzuan, porsa morën vesh që ju keni ardhur në këtë stinë të bukur të pushoni disa ditë në qytetin tonë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Këtu me të vërtetë pushohet mirë dhe të gjitha ditët e qëndrimit na kanë qëlluar shumë të bukura. Unë kam pasur rast të pushoj edhe herë tjeter në këtë stinë në Vlorë, por nganjëherë koha ka qenë jo e mirë, me erë të fortë. Sivjet ditët e qëndrimit qenë kaq të bukura, sa më nxitin jo vetëm t'u bëj shokëve propagandë të mirë për Vlorën, por edhe t'u them që të vijnë ta kalojnë vazhdimisht këtu kohën e lejës vjetore.

Erdhi edhe shoku Hysni, për të pushuar ca ditë këtu, po, ama, me zor ia mbushëm mendjen, vështirë ta shkulësh atë të bëjë pushim. E vërteta është se tash që jemi më të moshuar, ndiejmë më tepër nevojë për pushim. Besoj se edhe ju i zbatoni direktivat e Komitetit Qendror për të pushuar, siç parashikojnë ligjet. Kjo

---

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Vlorës.

ka rëndësi dhe duhet të zbatohet, se Partia nuk kërkon nga ne që të punojmë pak vjet, po edhe shumë e shumë të tjerë akoma. Mirëpo, që të punojmë, duhet të kemi shëndet dhe një nga kushtet për ta ruajtur atë është që, pas punës, të çlodhemi që të përtërijmë forcat.

Ne e dimë se të gjithë kuadrot, anëtarë partie dhe të paorganizuar në Parti, shokët e terrenit në mënyrë të veçantë, kanë një punë shumë të zorshme e të lodhshme jo vetëm fizike, por edhe mendore. Ju jeni në kontakt të vazhdueshëm me popullin, me problemet e mëdha që kanë përpara Partia dhe shteti, me hallet e përditshme të punonjësve, që duhet të zgjidhen me kujdes dhe drejt. Pikërisht për të ruajtur shëndetin dhe për të kryer mirë gjithë këtë punë të madhe që kemi, pushimi, që këshillon Partia të bëjë secili e që parashikon ligji, është, natyrisht, i nevojshëm.

Gjatë këtyre ditëve, në shëtitje, jam pjekur me njerëz të moshave të ndryshme si këtu, në qytet, edhe në disa fshatra. Një ditë dola nga Drashovica e Peshkëpia dhe bisedova me grupe kooperativistësh që punonin në fusha, kurse në kthim u takova edhe me pionierë të shkollës tetëvjeçare «Selam Musai» të Babicës. Edhe në qytet kam takuar nxënës, si ata të shkollës së mesme të përgjithshme «Ali Demi», që ishin duke bërë stërvitje ushtarake në kodrat pranë qytetit. Me fëmijët e shkollave e të kopshteve, në mënyrë të veçantë, kur kaloj rrugës, marr, gjithashtu, takime. Kështu, bëj q'bëj, zbres nga makina, i përshëndes dhe bisedoj me ta. Disa më japid lule që i kanë mbledhur për vete gjatë shëtitjeve të tyre të gëzueshme. Një fëmijë kopshti më pyeti se

çfarë do të bëja me to dhe unë iu përgjigja: «Do t'ia jap mbesës së vogël që kam në shtëpi».

*Pastaj shoku Gaqo Nesho informoi për punën e Partisë në rrethin e Vlorës. Shoku Enver Hoxha u interesua veçanërisht rrëth vendburimeve të naftës. Për këtë çështje iu drejtua Zihni Rrokajt, në atë kohë brigadier në një sektor të naftës.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sa puse ka në sektorin ku punon ti, shoku Zihni, sa naftë japid ato mesatarisht dhe në ç'thellësi janë? Në flish janë këto?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Jo, këto janë në gëlqerorë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po flishet a s'janë mbi gëlqerorë? Kur keni shpuar për gëlqerorët, keni konstatauar kanë apo s'kanë gjë flishe?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Është hapur vetëm një pus që ka dhënë shenja të plota naftë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po në puset e tjera nuk ka pasur shfaqje nafte në flishe?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Ka pasur pjesa perëndimore, kurse në zonën tonë shpimi nuk dha asnje rezultat.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk dha rezultate se nuk ekzistonin shenja në flishe, apo për ndonjë arsyetjetë?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Shenjat në flish ekzistojnë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Domethënë në flish kishte imprenjim naftë.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Morën specialistët kampione nga flishi në zonën tuaj kur shpuan për gëlqerorët?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Jo, nuk kanë marrë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pikërisht këtu ta kam fjalën! Sa larg në vijë ajrore është sektori yt nga kjo zonë? E kam çështjen nga vjen kjo naftë në flish në zonën perëndimore? Janë shpuar puse këtu?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Janë shpuar, po thellë, në gëlqerorë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sa vjet keni ju që po shponi në gëlqerorët?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Qysh në vitin 1960.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Domethënë që nga viti 1960 e deri në vitin 1975, gjithsej 15 vjet, janë bërë shpime dhe vetëm në gëlqerorë. Mos janë neglizhuar dy shtresat e tjera, ranorët dhe flishi?

**SHOKU GAQO NESHO:** Në sektorin ku punon Zihniu doli naftë, e cila mbushi tubin, se erdhi me forcë, po pastaj pusin e bllokuan dhe vazhduan të shkojnë më poshtë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pa na thuaj, shoku Zihni, kur ju doli kjo naftë?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Në vitin 1972. Qysh gjatë shpimit, një pus që kapi flishin, dha naftë. Ne nuk e bëmë përvetësimin e këtij pusi, se na thanë që është një punë pa leverdi. Kështu u vazhdua të shpohej më thellë, në gëlqerorët.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Me një fjalë u mbyll ky pus. Nuk më thua, sipas mendimit tuaj, dua të them të punëtorëve, të gjeologëve e të mjeshtërve, në fliшин e sektorit tuaj ka apo s'ka naftë?! T'i shikoni medoemos të tëra këto, të shikoni edhe qimen në vezë, bile. Kjo është detyrë partie dhe shtetërore.

Po puset e tjera, pse rrinë? Çfarë kanë ato që janë lënë mënjanë?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Këto ishin puse, në të cilat bëheshin studime për avancimin e ujit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Bukur! Atëherë çfarë do li nga kjo? Tani uji vjen më shumë si sasi apo mbetet konstant? Ju thoni që nxirrni naftë, po atje buron naftë, buron edhe ujë. Si është përpjesëtimi midis tyre, lëviz apo nuk lëviz ky?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Përpjesëtimi është i drejtë, uji lëviz në bazë të marrjes së naftës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Domethënë naftë vjen më shumë dhe ujë vjen më pak. Apo mos vjen ujë në sasi konstante dhe naftë më shumë? Si ju rezulton juve kjo çështje dhe çfarë thonë gjeologët? Këtu ka dy gjëra: o naftë vjen më shumë dhe sasia e ujit qëndron konstant, ose nafta qëndron konstant dhe uji vjen më pak. Ju ka ardhur këtu ndonjë ekip që të studiojë posaçërisht ujërat nënlokësore?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Ka ardhur një herë vjet, kur u punua për projektin e vendburimit. Më të shumtën punojnë gjeologët tanë për këtë çështje.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Cilët sektorë, në gëlqerorë, janë më produktivë sipas niendimit tënd?

**SHOKU ZIHNI RROKAJ:** Më produktive paraqitet pjesa e sektorit tonë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Bukur shumë! Atëherë, sipas logjikës, se ne flasim këtu me logjikë, dhe jo në bazë të të dhënavë të shkencës, flishi i sektorit tuaj nuk duhet të jetë i imprenjuar nga gëlqerorët me naftë më shumë sesa zona në perëndim? Sepse nga gëlqerorët

vjen nafta dhe imprenjon flishet. Atëherë këto shtresa pse të mos kenë edhe në sektorin fqinj, ku debiti i gëlqerorëve është më i vogël nga juaji dhe ku në flish paska naftë, bile edhe me erupcion?

Po tash mungon atje ndonjë gjë? Mendoni se do të përmirësohet gjendja të ju? Çfarë kërkon që ta realizoni dhe ta tejkaloni planin?

*SHOKU ZIHNI RROKAIJ:* Detyrat për vitin 1975 i plotësuam. Edhe planin e tremujorit të parë të vitit 1976 e realizuam, bile kemi dhënë disa qindra tonë naftë plus.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ky plus që keni dhënë nuk ju ka shqetësuar ndonjë çikë? Mos keni dhënë më pak?

*SHOKU ZIHNI RROKAIJ:* Këtë sasi shtesë ne e kemi realizuar nga puset jashtë fondit të mëparshëm. Janë vënë në shfrytëzim edhe disa puse, nga të cilat mendohej se nuk mund të merrej më prodhim.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Unë e kam parë njërin nga këto puse për të cilat sole ti, shoku Zihni. Është nibi rrugë. Pashë, gjithashtu, edhe monumentin e luftës së Drashovicës, që ishte lënë për të ardhur keq! Gjithë ajo luftë e madhe, që është bërë aty më 1920 dhe më 1943, atë lapidar meriton? Ashtu duhet të lihet, siç e keni lënë ju, shokë të Vlorës? Ai as si lapidar nuk vlen. Atje ka vetëm një metër masë betonarme. Kjo gjë duhet ndrequar! Në monument në çdo gjë duhet të ketë proporcione<sup>1</sup>.

---

1. Sipas kësaj porosie të shokut Enver Hoxha, për të përkujtuar përpjekjet heroike që u zhvilluan më 1920 dhe më 1943,

Gjeologët dhe ju, shokë të sektorit, e keni stabilizuar, bile, c keni përmirësuar koeficientin e nxjerrjes së naftës nga vendburimi që na përmendët. Gjeologët, që kanë njohuri nga nafta, edhe në gëlqerorët duhet ta stabilizojnë gjendjen. Në atë zonë ka një rezervë të mirë nafte, prandaj specialistët duhet të bëjnë pyetjen: C'duhet t'i bëjmë ne më tepër këtij pusi ose gjithë këtyre puseve që po na ngrenë debitin? Po me puset e tjera, që nuk janë në lartësinë e këtij debiti, çfarë duhet të bëjmë që ta shtojmë prodhimin? Pastaj duhet të shohim edhe korelacionet e tyre se distancat midis puseve nuk janë të largëta. Prandaj gjeologët të nxjerrin konkluzione, të reflektojnë dhe të gjejnë arsyet pse na del kështu këtu dhe pse na del ashtu atje, pastaj të verifikojnë edhe rëniet, nëse këto janë të mëdha apo të vogla. Në qoftë se diferenca është e vogël, do të thotë se shtresat në gëlqerorët komunikojnë fare lirisht etj., etj.

Me këtë dua të them se për prodhimin e naftës duhet të intercsohemi edhe ne dhe, në fakt, po interesohemi shumë, vetëm se ne nuk i shohim dhe nuk i shpjegojmë gjërat teknikisht. Logjikisht po, mund të japim ndonjë mendim, kurse ju i shpjegoni problemet edhe teorikisht, edhe praktikisht. Prandaj bëni kujdes dhe për çdo gjë të dilni kurdoherë me konkluzione.

Çështja kryesore për ne është që të marrim naftë sa më shumë, pa prishur regjimet e puseve, por njëkohësisht të punojmë edhe për të zbuluar fusha naftë të

---

në këtë vend, në vitin 1980 u përruua monumenti skulpturor «Drashovica 1920-1943», vepër e Skulptorit të Popullit M. Dhrami.

reja në tri shtresa: në ranorë, në flish dhe në gëlqerorë. Këtu qëndron gjithë rëndësia e çështjes. Prandaj, për t'i bërë këto, ju shokë, që punoni në sektorin e naftës, duhet të merreni edhe me punë studimore e shkencore. Mos u trembni nga termi «shkencore», pse puna që bëjnë shokët e naftës çdo ditë, po të jetë e organizuar mirë në bazë të kërkesave teknike, është punë shkencore. Të marrim, për shembull, metodat e shpimit. Puna e mjeshtrit të naftës është një punë shkencore, punë shkencore bazë bile, që armiqtë e kanë neglizhuar dhe me këtë na kanë sabotuar. Kur një pus dilte i imprenjuar me naftë, teknikut shpues nuk i lejohej të mos mbante shënimë e të mos regjistronte me kujdes e me saktësi të gjitha ato që ndodhnin, si, për shembull, në filan thellësi prej kaq mettrash doli ky material i imprenjuar, të cilin e hoqa dhe mora shllamin etj. Pa i shënuar këto të dhëna, nuk mund të ecet në sektorin e naftës, por, po t'i shënosh me saktësi dhe në kohën e duhur, ja, kjo nuk është tjetër veçse një punë shkencore.

Merreni me mend, shokë, kanë kaluar 16 vjet dhe ne nuk dimë akoma nëse ka apo nuk ka naftë në flish. Po të ishte bërë si duhet kjo punë, do ta mblidhним mendjen dhe do të thoshim që s'ka. Atëherë do të largoheshim andej dhe do të vazhdonim të kërkonisë më tutje.

Me ato që raportoi shoku Gaqo Nesho jemi dakord. Organizata e Partisë e rrethit të Vlorës tash duhet të mobilizojë të gjitha forcat mendore, fizike dhe organizative që problemet, si në fushën e industrisë, ashtu edhe në atë të bujqësisë, të zgjidhen plotësisht. Kur flasim për bujqësinë, nënkuuptojmë edhe blektorinë, pemëtarinë, si dhe gjithë degët e tjera që ndonjërit mund

t'i duken si të parëndësishme, por që kanë vlerë të madhe. Po cilat degë mund të jenë të tilla në bujqësi, për shembull? Unë mund t'ju them se në Vlorë si një nga vendet e luleve, mund të rritet një numër bletësh shumë herë më i madh se tani. Pse, vallë, gjë e vogël ju duket shtimi i zgjojeve të bletëve? Jo, mendoj unë. Po sa gjëra të tilla ka që duken të vogla, por, po t'u kushtohet kujdes, mund të zhvillohen dhe të ndihmojnë në rritjen e prodhimit dhe të të ardhurave të kooperativave bujqësore.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Shokët e Vlorës le të kenë parasysh se sa shumë bletë ka pasur në këtë rreth para luftës. Shifrat do t'i nxitin ata që t'i shtrojnë detyrë vetes që të paktën në çdo kooperativë të ketë aq zgjoje, sa ka pasur atëherë gjithë fshati, lëre pastaj sikur të bëjnë këtë që thoni ju, shoku Enver, fitimet për kooperativat vetëm nga ky zë do të jenë të konsiderueshme. Është me të vërtetë për të ardhur keq, mendoj unë, kur vete pyet në fshat si janë me bletët dhe mëson se zgjoje kolektive ka fare pak. Kur vajta në muajin gusht të vittit të kaluar mësova se kooperativa e Tërbaçit kishte gjithsej vetëm 50 zgjoje, prandaj e shoh shumë të drejtë këtë çështje që ngritet ju, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Këto probleme duhet të jenë në qendër të vëmendjes së Partisë. Të ndalemi pak edhe te çështja e mbrojtjes. Kjo mbetet detyra kryesore mbi të gjitha të tjera, pse atdheun tonë socialist duhet ta mbrojnë nga çdo armik. Partia na ka mësuar se armiqëtë e brendshëm kurdoherë kanë qenë të lidhur me të jashtmit. Gjyqi që iu bë bandës së tradhtarëve Beqir Balluku, Petrit Dume e Hito Çako, si dhe veprim-

taria armiqësore e Abdyl Këllezit, Koço Theodhosit dhe e sabotatorëve të naftës vërtetojnë katërcipërisht ato që ka thënë Komiteti Qendror dhe që janë pasqyruar në të gjitha dokumentet e Partisë. Këta armiq ishin agjentë të fuqive imperialisto-revizoniste. Ata punonin me ndërgjegje për të ndërruar pushtetin në vendin tonë, për ta kthyer Shqipërinë në një vend revizionisto-kapitalist, gjë që u interesonte gjithë armiqve, të hapët ose të kamufluar. Por zgjuarsia e Partisë dhe e Komitecit të saj Qendror bëri që të diktohen e të zbulohen fijet e kësaj veprimtarie.

Armiqtë sabotatorë të ushtrisë, që dolën në gjyq, ashtu edhe të tjerët, Abdyl Këllezi, Koço Theodhos me shokë pohuan vetë me plot gojën, se nuk kanë qenë për komunizmin, kanë qenë armiq të Partisë dhe të shtetit tonë socialist. Beqir Balluku pohoi se ka qenë armik me kohë, që kur kishim marrëdhënie të rregullta me jugosllavët. Ai pranoi me gojën e tij se kishte marrë udhëzime drejtpërdrejt nga Titoja që të krijonte kushte për të okupuar Shqipërinë dhe, me gjithë pengesat që u vunë nga ana jonë, fshehurazi, ai kishte dhënë urdhër të liroheshin nga njësitë tona Korça, Leskoviku etj., me qëllim që aty të vinin forca të armatosura jugosllave.

Edhe të tjerët, Abdyl Këllezi me Koço Theodhosin, pohuan se nuk kanë qenë asnjëherë për socializmin. «Të gjitha veprimet i kemi bërë me qëllim që të dobësonim pushtetin socialist dhe të rivendosnim këtu një pushtet të ri, pushtetin e vëadministrimit» kanë poħuar ata. Abdyl Këllezi nuk ka pohuar si Beqir Balluku se ka marrë direktiva nga Titoja, por thotë se ka qenë kurdoherë i pakënaqur dhe pakënaqësitetë i ka biseduar

dhe i ka zhvilluar me Tuk Jakovën, me iksin, me ipsilonin, me gjithë deviatorët, pa përjashtuar Beqir Ballukun, me të cilin ka biseduar në Pogradec dhe në Tiranë. Po del se ai edhe me jugosllavët ka biseduar nëpërmjet djalit të... një revizionisti shqiptar në Jugosllavi. Më vonë ai ka biseduar, gjithashtu, me djalin e një revizionisti tjetër... Kjo do të thotë se edhe Abdyl Këllezi andej, nga Jugosllavia titiste, i merrte direktivat. Tash këto janë të qarta për ne.

Partia i zbuloi këta armiq dhe i qëroi nga mesi ynë. Ky ishte një sukses i madh. Me këtë operacion Partia shpëtoi edhe një sërë kuadrosh, të cilët, me dashje ose pa dashje, qenë molepsur nga armiku. Fryma jomarksiste, po e maskuar si marksiste, i sjell dëm të madh kauzës sonë. Armiku nuk del kurdoherë ballë për ballë nesh, sidomos kur ka përpara një forcë të çelikëtë, siç janë Partia e populli ynë dhe uniteti i tyre që e ka burimin tek ideologjia marksiste-leniniste. Shpesh armiku vjen te ne tërthorazi, si këta që zbuluan, të cilët përfituan nga pozitat që kishin në Parti e në pushtet dhe, duke i shfrytëzuar këto me dinakëri, bënë që edhe disa shokë që kanë dhënë prova, qoftë në ushtri, qoftë në sektorët e ndryshëm të ndërtimit të socializmit, të futen padashur në lojën e tyre.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria, gjatë veprimtarisë së tyre për ndërtimin e socializmit, marrin të atilla masa që çdo sektor në vendin tonë të ecë kurdoherë përpara me sukses. Për ne, marksistë-leninistët, është e qartë se socializmin nuk e ndërtojnë dy apo pesë veta, atë e ndërtojnë masat dhe, si gjithë të tjera, masë janë edhe kuadrot. Këta kuadro janë inkuadruar

dhe zhvillojnë veprimtarinë e tyre në organe të ndryshme të Partisë dhe të shtetit, ku luftojnë dhe ecin përpara në mënyrë dialektike. Komiteti Qendror mendon se, si kurdoherë, edhe në këtë situatë, kuadrove dhe gjithë organeve, ku punojnë ata, duhet t'u jepet mundësia të kryejnë një punë më të madhe e më të ndërlidhuan.

Partia nuk mund të ecë sot si në periudhën fillestare, kur zbritëm nga mali. Por edhe atëherë kush e rindërtoi vendin, ekonominë e tij? Gjithë ato masa njerrëzish që, vërtet, nuk kishin dijeni për drejtimin e shtetit, por kishin një vullnet të madh për punë dhe, në radhë të parë, i qëndronin besnikë çështjes së popullit dhe të Partisë. Pas kaq vjet pune, lufte dhe eksperience të madhe për ndërtimin e socializmit, kuadrove që i mësoi Partia të drejtonin organet e ndryshme, që nga ato të Partisë, të shtetit, të ekonomisë etj., duhej t'u jepeshin më shumë iniciativa dhe kompetenca. Mirëpo armiqjtë e shtrembëruan këtë orientim të drejtë. Nga ana e shokëve të Partisë, qoftë në bazë, qoftë në qendër, nuk ka pasur shumë vigjilencë që të diktonin nëse direktivat e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë zbatoheshin apo nuk zbatoheshin drejt. Pikërisht nga kjo mungesë vigjilence armiqjtë përfituan për një kohë.

Ju e keni të qartë që grupi i armiqve synonte të realizonte qëllimet me puç. Për ta arritur këtë, armiqjtë kishin shembullin e ardhjes së hrušovianëve në fuqi në Bashkimin Sovjetik, kishin, gjithashtu, shembullin çekoslovak etj. Mirëpo planet e tyre u zbuluan. Tani është çështja që pësimin Partia ta përdorë si një eksperiencë për të mos u përsëritur më të tilla raste. Ma-

terialet e Partisë dhe të Komitetit Qendror për këta armiq duhet të lexohen me kujdesin më të madh dhe të shfrytëzohen si armë kundër armikut të klasës në vendin tonë. Për asnjë çast s'duhet të harrojmë se edhe brenda në Parti zhvillohet luftë klase, prandaj kurrë të mos na zërë gjumi. Duhet të pranojmë, siç konkludoi Komiteti Qendror i Partisë, se ne e kemi pasë sjetur mendjen për një kohë, kemi pasur një besim të t'epruar te disa elementë, të cilëve nuk ua kishim diktuar gjithë këto qëndrime të shëmtuara dhe plane që kishin bërë. Mcgjithëse disa shfaqje qenë parë tek ata, prapë qenë nënvleftësuar, duke menduar që s'ka gjëkafshë, se kanë një të kaluar të mirë. Të kaluarën duhet t'ua respektojmë kuadrove dhe t'i nderojmë për atë që kanë bërë, por Partia na mëson të jemi konsekuentë deri në fund, se, kur ndodhin gabime, je kush je, ato duhen vënë në dukje dhe duhen kritikuar. Në qoftë se përsëriten, atëherë del nevoja të merren masa dhe në qoftë se kuadri vazhdon akoma rrugën e gabuar, ai duhet spastruar, në radhë të parë, nga Partia.

Partinë duhet ta ruajmë kurdohërë të pastör, pse vetëm kështu çdo gjë do të na ecë mirë. Partinë e bëjnë anëtarët e saj, po atë e bëjnë edhe vendimet e direktivat. Në qoftë se direktivat e saj janë marksiste-leniniste dhc i përshtaten zhvillimit të vazhdueshëm të vendit, atëherë Partia do të jetë, gjithashtu, e fortë dhe njerëzit me «lakra» në kokë e veprimet e tyre jo në rrugë partie do të dalin mbi ujë. Kjo është kryesorja.

Njerëzit me «lakra» në kokë, dua të them me kuptime filozofike e ideologjike jomarksiste, nuk duhet t'i futim në Parti, por të punojmë me këmbëngulje që t'i

edukojmë, t'i bëjmë edhe ata të vlefshëm për Partinë. Edhe komunistët nuk lindin të formuar, ata bëhen të uillë me luftë dhe me punë këmbëngulëse. Kjo nuk do të thotë që njerëzit të presin sa të bëhen nga 50 vjeç pastaj të futen në Parti. Këtu kanë të bëjnë shumë zotësia, zgjuarsia e Partisë dhe forca e direktivave të saj marksiste-leniniste, që nga radhët e masës së vajzave dhe të djemve të rinj, të pastër, të vendosur e kurajozë të zgjedhim për t'i përgatitur për në Parti më të mirët dhe t'i brumosim në luftë për zbatimin e vijës së saj.

Situata në vendin tonë politikisht dhe ideologjikisht është e kënaqshme. Ne vetë pamë se, kur Partia e populli morën vesh veprimtarinë kriminale të grupit të Beqir Ballukut e të Abdyl Këllezit me shokë, u ngritën në këmbë dhe kërkonin t'i dënonim sa më rëndë këta tradhtarë. Kjo tregon pjekurinë e madhe politike të popullit, dashurinë e tij të pakufishme për Partinë që i solli këto të mira dhe vendosmërinë për mbrojtjen e pavarësisë së vendit dhe të fitoreve që janë arritur pas Çlirimtit. Virtute të tillë të popullit tonë përbëjnë një thesar të madh, të cilin na vihet detyrë ta ruajmë dhe ta kalitim. Po të mos e bëjmë këtë, as nafta nuk mund të shkojë mirë, as tregtia, as bujqësia, asnjë sektor tjetër. .

Politikisht dhe ideologjikisht Partia duhet të jetë e ngritur, kurajoze dhe e vendosur, të mos ketë frikë nga kurrkush dhe të përvetësojë me zell të madh mark-sizëm-leninizmin, ideologjinë e klasës punëtore, të cilën të punojë vazhdimisht e me këmbëngulje që ta futë në ndërgjegjen e çdo njeriu.

Kur një njeri bën diçka, përpara se të veprojë, të pyesë veten: Është e drejtë kjo që do të bëj apo s'është

e drejtë? U shërben diktaturës së proletariatit, atdheut socialist, apo nuk u shërben? Në qoftë se u shërben, atëherë me kokë dhe me trup përpara, në zjarr, për ta kryer detyrën deri në fund. Në qoftë se nuk u shërben, t'i bëjë analizë vetes për të gjetur ku nuk është në rregull. Po të mos bëhet analiza në bazë të direktivave të Partisë, ajo që do të kryhet, nuk do të kuptohet nëse është apo nuk është në interes të proletariatit, të diktaturës së tij. Kur e ndien veten komunist, duhet të luftosh në veten tënde smirën mikroborgjeze, prirjet për të vënë interesin e ngushtë personal mbi atë të përgjithshëm, mëritë e hatëret e mbeturat dhe si njeri i pastër, i kulluar të mendosh e të veprosh sipas direktivës së Partisë, se vetëm atëherë do të vendosësh drejt për atë që ke ndër mend të bësh.

Në Partinë tonë kudo ka unitet, i cili nuk është për formë, por shpreh ngritjen e nivelit ideologjik e politik të Partisë, ku problemet diskutohen në mënyrë të gjith-anshme dhe pastaj vendoset njëzëri. Ndodh që për këtë osa për atë problem disa njerëz bëjnë vërejtje dhe këto, sigurisht, duhen bërë. Por, siç mund të keni lexuar në shtyp, ka ndonjë organizatë-bazë partie ku komunistët ndahen në grupe. Pse ndodh një gjë e tillë, kur shihet që njëra palë ka të drejtë? Kjo vjen se edhe brenda organizatës ka njerëz nga e njëjta familje ose i njëjti fis. Atëherë njëri nga vëllezërit ose dhëndri, në qoftë se është komunist i vërtetë dhe i formuar me mësimet e Partisë, duhet të ngrihet në organizatë dhe pengesat që nxjerrin njerëzit e familjes ose të fisit të tij t'i demaskojë e të thotë: «Ti, vëllai im, s'ke vend në Parti, edhe ti vëllai tjetër, gjithashtu, s'ke vend në Parti;

as unë vetë, bile s'kam vend në Parti. Pse? Sepse ne e kemi parë këtë problem jo në fryshtë partie, po në atë të interesit të ngushtë familjar. Dhe ja ç'ngjet: nga familjariteti është çarë uniteti në organizatë. A mund ta lejojmë ne një gjë të tillë?». Po të veprohet kështu, do ta spastrojmë me të vërtetë terrenin nga ato të këqija që na ngjasin, veçanërisht në disa fshatra, siç u vu në dukje këtu dhe kundër të cilave lufton gjithë Partia, si në Vlorë, edhe në të gjitha rrethet e tjera.

Që Partia të luajë me të vërtetë rolin e saj pararojë, duhet të brumoset me ideologjinë marksiste-leniniste, të udhëhiqet vetëm nga kjo ideologji dhe në radhët e saj të bëjnë pjesë anëtarë të çeliktë, të vendosur e të palëkundur për çështjen e socializmit. Atëherë me siguri të gjitha detyrat do të kryhen me sukses. Kur themi që do të kryhen të gjitha me sukses, të mos mendojmë se me këtë u zhduk lufta e klasave. Partia duhet të lustojë çdo ditë për eliminimin e ndikimit të ideologjisë së klasave të mundura, me qëllim që në shoqërinë tonë të mbizotërojë botëkuptimi i proletariatit, që vendi të zhvillohet ekonomikisht, që njerëzit tanë të edukohen ideologjikisht dhe politikisht. Kështu do të forcohet shteti ynë socialist, ndërsa armiqjtë do të përpilen ta brejnë e ta shkatërrojnë si minjtë. Po s'u vure dhokanin t'i kapësh ose t'i trembësh që të futen në vrima, ata do të ngrenë kokë, prandaj në asnjë rast nuk duhet t'i lejojmë të na dëmtojnë.

Ju e dini se nuk e bëjnë të gjithë njerëzit punën njësoj. Kjo nuk do të thotë se vetëm ai që punon mirë, është kurdoherë njeri i mirë, kurse një tjetër që punon më pak e me cilësi jo të mirë, medoemos duhet të jetë.

njeri i keq. Jo, nuk është kurdoherë kështu. Për të bërë dallimin, kërkohet pjekuri politike, sepse në punë nuk janë të prerë të tërë me një thikë. Detyra jonë është që të prapambeturit t'i nxitim të ecin përpara, t'i bëjmë edhe ata njerëz të pararojës që t'i zhdukin të metat e paragjykimet, se këto ekzistojnë dhe do të ekzistojnë edhe për shumë kohë.

Të gjithë e dinë që Shqipëria është një shtet afetar. Ideologjikisht ne jemi kundër fesë, prandaj kemi spastruar të gjitha institucionet fetare, shumë prej të cilave në të kaluarën kanë qenë edhe çerdhe të armikut. Megjithatë, në ndërgjegjen e mjaft njerëzve, sidomos të të moshuarve, ku me dashje, ku pa dashje, ekzistojnë akoma pikëpamje idealiste. Feja, e lindur shekuj më parë, është bazuar në frikën që kanë pasur njerëzit nga forcat shkatërruese të natyrës, kur ata akoma nuk ishin në gjendje t'i bënin zap. Por teoria marksiste-leniniste na mëson se njeriu nga shekulli në shekull i ka zbuluar këto forca, shumë prej tyre i ka zotëruar dhe i ka vënë në shërbim të shoqërisë. Shkenca moderne shpjegon se, kur sëmuresh, kjo nuk ndodh se «të hëngri dikush me sy», «të morën sysh» etj., siç mund të ketë akoma njerëz që mendojnë kështu. Ne komunistët, si dhe të rinjtë e të rejat e vendit tonë, nuk u besojmë këtyre përrallave, por pleqtë, diku edhe u besojnë. Mirëpo ata na kanë lindur dhe, meqenëse ne jemi përpara nga ana botëkuimore dhe ata janë pas, e kemi për detyrë t'ua shpjegojmë këto gjëra në baza shkencore.

Pra, njerëzit nuk janë të formuar njësoj në të gjitha këto drejtime. E ka për detyrë Partia t'i përgatitë ata shkallë-shkallë dhe t'ua spastrojë mbeturinat nga ndër-

gjegjja. Kjo punë duhet bërë sidomos me të vjetrit, se tek ata ka më shumë nga këto, por edhe me të rinjtë duhet punuar, sepse, siç u tha këtu, ka disa nga këta, sidomos në qytete, që marrin rrugë të shkrembër dhe, ç'është më e keqja, në mjaft raste këta janë elementë të klasës, bij punëtorësh. Kam bindjen se prindërit e tyre janë njerëz të mirë, ata nuk rrinë pa ua hequr veshin fëmijëve të tillë. Megjithatë është e qartë se familjet nuk kanë punuar sa duhet, nuk kanë treguar tërë kujdesin e nevojshëm ndaj këtyre elementeve.

Partia nuk duhet ta përqendrojë vëmendjen vetëm te këta njerëz, por në gjithë masën e rinisë. Çështja e edukimit të rinisë është një problem i madh, i gjerë, sepse kush ka rininë me vete, ai ka të ardhmen. Preokupimi për rininë është preokupimi për sigurimin e së ardhmes së atdhetë. Shumi nga ju, shokë, kur u çlirua Shqipëria, ishin nga 8-10 vjeç, kurse tash jeni 40-42 vjeç. Ju jeni bërë komunistë të vendosur, trima, drejtues. Por të tillë ju bëri Partia, lufta e saj. Komiteti Qendror dhe Partia, qysh në vilet e para të Çlirimt, treguan kujdes të madh për l'ju përgalitur ju si revolucionarë për këtë të sotme. Pra, kujdesi për rininë duhet të jetë i vazhdueshëm, në mënyrë të veçantë për ata të rinj që do të vijnë në Parti, pasi Partia porosit që në radhët e saj të vijnë sidomos të rinj e të reja, sepse kështu ajo do të jetë kurdoherë e re.

Duke u nisur nga ky kuptim i drejtë, që tash ne duhet të mendojmë, në radhë të parë, për përgatitjen dhe për edukimin si revolucionarë të atyre që do të na zëvendësojnë. Me radhë është kjo, ne do të na zëven-

dësoni ju, kurse ju, më vonë, pas disa dekadalash, do t'ju zëvendësojnë të tjerë. Por, që t'ju zëvendësojnë, këta duhen stërvitur, duhen edukuar. Dhe ne që tash kemi fituar një eksperiencë, një formim ideologjik e politik në rrugën marksiste-leniniste, duhet të punojmë që këtë t'ua japim të rinjve e të reja ve dhe jo brenda 35 vjetëve, sa na u desh neve ta fitonim, por, po të jetë e mundur, brenda 5 vjetëve, maksimalja brenda 10 vjetëve që ata të bëhen, e do të bëhen me siguri, edhe më të zotë nga ne. Unë jam i bindur për këtë. Po pse? Sepse ne s'kishte kush të na edukonte si revolucionarë. Pastaj në kohën tonë ne kemi pasur pak shkollë, bile shumë shokë ishin edhe fare pa shkollë, kurse sot brezin e ri e edukon Partia në shkolla dhe, në radhë të parë, e bën të ndërgjegjshëm si t'u shërbejë popullit, atdheut, socializmit.

Krahas punës së vazhdueshme për edukimin revolucionar të rinisë, të punojmë edhe për rritjen e njoburive të saj teknike dhe shkencore. Për këtë qëllim Partia duhet të kujdeset që të rinjtë e të rejat të mësojnë me vullnet e zell të madh, të mbarojnë edhe shkollat. Kur konstatojmë se ndonjë nuk e ka kryer shkollën, ta këshillojmë dhe ta bindim që ta ndreqë këtë gabim, në radhë të parë duke punuar mirë atje ku është, në fabrikë, në qendrën e punës, apo në koperativë dhe të mësojë pa u lodhur duke mos u shkëputur nga puna. Pastaj ta mësojmë atë që shpërblimin që merr, ta shpenzojë për gjëra të nevojshme, jo ta harxhojë kot. Një të ri nuk e ndalon kush që të pijë një gotë birrë, por as Partia, as populli, as prindi nuk duan që ai të marrë rrugë të keqe. Rinia, kudo që të

jetë, në shkollë, në punë e në shoqëri, të rrrethohet me një kujdes të madh, me ngrohtësi e me dashuri nga Partia dhe nga populli dhe të gjithë, së bashku me familjen, të punojnë për të përgatitur një brez të ri të denjë për socializmin. Por të mos mendojmë se çdo gjë është arritur në këtë drejtim. Jo, ne jemi akoma prapa asaj që duhet të arrijmë.

Mendoni një çikë, shoqe dhe shokë, çfarë ngjau në Bashkimin Sovjetik, në Partinë Bolshevikë që krijoit e brumosi Lenini, që edukoi më tej Stalini në beteja të mëdha klasore. Sa vdiq Stalini, revisionistët e morën menjëherë pushtetin me puç, të përgatitur me shumë mjeshtëri. E dini pse ngjau kjo? Se partia në Bashkimin Sovjetik e kishte humbur forcën revolucionare, mbledhjet e organizatave-bazë të partisë dhe të forumeve bëheshin formale, kritika e autokritika po ashtu, kurse rinia shkonte drejt degjenerimit. Ndonjëri mund të pyessë: Nuk i shikonte Stalini këto që ndodhnin? Mund të themi me bindje se atë e kishin izoluar dhe gjendjen në çdo drejtim si atij, edhe bolshevikëve të tjerë, të cilët nuk mund të ndodheshin kudo përnjëherë, ua raportonin ndryshe.

Prandaj na vihet detyrë që Partia, në radhë të parë, të bëhet luftarake, revolucionare. Kryesore për të janë ideologjia dhe politika, lufta për ndërtimin e socializmit. Ne kemi arritur shumë suksese, shokë. Puna e madhe që ka bërë populli, i udhëhequr nga Partia, ka dhënë shumë fryte. Kjo ka ardhur se të gjithë janë mobilizuar për zbatimin e vijës së drejtë të Partisë. Po, në të njëjtën kohë, kemi pasur edhe të meta në punë, për shkaqe subjektive, por edhe për shkaqe objektive. Por, po të

mendojmë se nuk duhet të lejojmë asnë gabim,asnë parashikim jo të drejtë ose të organizojmë kurdoherë pa më të voglën dobësi, nuk do të jemi realistë. Partia, Komiteti i saj Qendror, na mësojnë që, sa të jetë e mundur, të gjitha këto të zvogëlohen. Kjo do të thotë që situata kudo dhe në të gjitha drejtimet në fushën e ekonomisë, të kulturës, të mbrojtjes, të forcohet vazhdimi shqiptar. Kurrë të mos kënaqemi me sukseset e arritura, se ka mundësi të mëdha për të ecur edhe më përpara. Kur Partia u ngrit në këmbë kundër armiqve të klasës kohët e fundit (ajo kurdoherë në këmbë ka qenë), e mori dijeni se çfarë bënин nën rrugoz Beqir Balluku e Abdyl Këllezi me shokë, hovi në industri, në bujqësi, në ushtri, në kulturë e kudo u rrit në mënyrë të paparë. Kjo tregon që masat revolucionare e shtyjnë gjendjen vazhdimi shqiptar përpara drejt zhvillimit; ato mbytin e shkatërrojnë çdo gjë që i pengon.

Para ca kohësh, duke u bazuar në fitoret e arritura, Komiteti Qendror lëshoi direktivën për hartimin e planit të ri pesëvjeçar. Neve nuk na mungon eksperiencia në hartimin e planeve, por ka disa çështje organizative që duhet të kohen parasysh dhe të korrigohen, si nga ne, edhe nga ju, shokë të bazës. Planet kurdoherë duhet të pasqyrojnë realitetin, na nieson Partia. Kjo do të thotë që të mos bëjmë plane të fryra, por as plane të vogla «për të qenë brenda». Realiteti kërkon, po edhe vetë situata na imponon, që vendi ynë, Shqipëria sociale, e rrethuar nga të katër anët nacarë armiq, të plotësojë me forcat e veta shumicën dërrmuëse të kërkesave që na paraqiten, pse kemi shumë nevoja. Prandaj është e domosdoshme që njerëzit tanë të bëjnë përpjekjet më

të mëdha, të shfrytëzojnë deri në fund të gjitha mundësitë që ekzistojnë. Atëherë planet tona do të jenë me siguri reale dhe mobilizuese. Kjo do të thotë që nga kjo tokë, ku sot arrijmë këtë rendiment, t'i vëmë detyrë vetes të marrim dyfishin, pse jemi të bindur që dituria, organizimi i mirë dhe mjetet që kemi do të na japin mundësi ta realizojmë këtë objektiv.

Para disa ditësh, siç ju thashë në fillim të bisedës, bëra një shëtitje në Drashovicë, në Peshkëpi e në Babicë. Kudo më zuri syri njerëz në punë, sidomos gra e vajza kooperativiste që i njihnin vendimet e Partisë dhe flitnin me kompetencë për çdo çështje. Kjo është një meritë e organizatës së Partisë që ka ditur t'u sqarojë atyre çdo gjë. Shumë nga këto kooperativiste i gjeta tek po bënин kubikë për mbjelljen e misrit. Vura re me kujdes, gjatë bisedës që zhvillova me to dhe u gëzova që ato i dinin mirë të tëra kërkesat e kodit agroteknik për misrin. «Po t'ua bëni si duhet të gjitha shërbimet, — u thashë, — nga këta 9 hektarë sipërsaqe që po mbillni këtu me kubikë, duhet të merrni jo 45-46 kuintalë misër për hektar, po 75-80 kuintalë. Po të mos ua bëni, atëherë fara do të thahet brenda në kubik». Gratë dhe vajzat kooperativiste më premtuan se do të mobilizonin të gjitha forcat dhe shprehën besimin se do ta realizonin këtë detyrë.

Çështjen e kam këtu që të shfrytëzohen të gjitha rezervat e mëdha që ka në bujqësi. Tash në popullin tonë, veçanërisht në kooperativistët, është krijuar ndjenja e lavdërueshme e përgjegjësisë, një ndjenjë e lartë politike. Njerëzit thonë: «More po ku kemi qenë deri tash, shiko ç'po bëhet dhe ç'rezultate po arrinen!». Kush

e bën këtë? E bëjnë direktivat e Partisë, mendja dhe krahët e punonjësve tanë. Ka brigada e sektorë që tash marrin edhe 100 kuintalë misër për hektar.

Lexova një artikull mbrëmë, ku thuhej se në një fshat të vogël të Dropullit, në Haskovë, merren rendimente të larta, rrëth 100 kuintalë misër për hektar. Kur isha djale i vogël, më kujtohet se misri atje mezi bëhej sa gishti dhe fshatarët e varfér me zor merrnin 7-8 kuintalë për hektar që nuk u mjaftonin të ngopnin barkun me bukë, prandaj vuanin nga uria dhe nga frika e pasigurisë për kafshatën e gojës. Ata që tash janë pleq, kur shohin se nga një hektar tokë merren 100 kuintalë misër,, thonë: «More po ç'bëhet kështu, ç'po ndodh këtu te ne? Ku ishim kur qemë të rinj e ku jemi tash që na udhëheq Partia!». Ja, pra, ç'besim i madh është krijuar në fshatarësinë kooperativiste. Me gjithë këto masa që janë marrë, me këtë vijë të drejtë të Partisë në bujqësi, me mekanizimet, farnat, kullimin e ujitjen e tokave, me shërbimet kulturore, me përgatitjen e kuadrove teknikë, me rritjen e njohurive agro-teknike në masë etj., etj., është krijuar mundësia të bëjmë një hop të madh përpëra në bujqësi. Prandaj në hartimin e planeve të mos nisemi nga konceptet e gabuara të disa njerëzve, të cilët nuk mendojnë drejt, mbajnë rezerva dhe përpinqen «të jenë brenda».

Shokë, duhet të mendoni jo për të dalë përpëra Komitetit Qendror të Partisë me një plan të realizuar, prej 35 e 40 kuintalë misër për hektar, po të dilni përpëra popullit me realizim rendimentesh të larta. Mos u përpinqi, pra, të bëni një plan sa për të qenë në rregull me udhëheqjen. Në radhë të parë të jeni në rregull me

popullin, i cili ka nevojë për misër, për grurë dhe për të gjitha prodhimet e tjera bujqësore e blektorale. Është vetë populli që do t'i prodhojë ato me punën e vet dhe do të krijojë një situatë ekonomike akoma më të mirë. Partia i edukon njerëzit me fryshtë revolucionare, i mobilizon dhe i drejton ata që të sigurojnë një organizim të shëndoshë në punë për të shfrytëzuar më së miri të gjitha këto mundësi e njete që kemi, për të realizuar në çdo bimë rendimente të paarritura deri më sot. Ky objektiv duhet të na shtyjë në punë dhe jo pikëpamja e padrejtë «për të qenë brenda». Një pikëpamje të tillë e ndeshim jo vetëm në bujqësi, por edhe në industri e në sektorë të tjera të ekonomisë, të kulturnës etj.

Prandaj, kudo të vëmë politikën në plan të parë, dhe fshatarësinë ta bëjmë të qartë, po krahas kësaj të forcojmë edhe organizimin e punës, pse pa organizim, ka thënë Stalini, direktiva s'ka sukses. Me një zgjidhje të drejtë të çështjes dhe me organizim të mirë, ne do t'i realizojmë me siguri planet tona. Në këtë mënyrë ta bëjmë planin në bujqësi, kështu të veprojmë edhe në çdo sektor tjetër të ekonomisë, si edhe në industrinë e naftës, ku armiqtë na kanë dëmtuar veçanërisht shumë.

Komiteti Qendror i Partisë asgjë nuk ju ka mbajtur të fshehur, por fakti është që në këtë sektor ne jemi pas. Përgjegjësit e sektorit të naftës na paraqiten këtë vit një projektpлан shumë të ulët. Me shumë përpjekje ne mezi e çuam pak më shumë, për arsy se punonjësit dhe specialistët e naftës nuk qenë të bindur se ekzistonte tek ata akoma një fryshtë e sëmurë. Të gjithë

ata që ngulnin këmbë për një plan aq të ulët, të kup-tohem, nuk janë armiq, por të mos harrojmë se fryshten e sëmurë armiq të e kanë lënë edhe te mjaft kuadro dhe specialistë të këtij sektori, tek të cilët ekzistonte njëfarë druajtjeje, njëfarë frike. Prandaj specialistët e naftës thoshin se «Vështirë do të jetë që ta realizojmë shisfrën e planifikuar. Po sikur të mos na dalë një fushë e re, si do të bëjmë? C'do të thonë për ne?». Prandaj u duhej shpjeguar me durim kjo çështje dhe prapë u duhet shpjeguar akoma.

Dihet se, duke shpuar për të gjetur naftë, mund të mos qëllosh kurdoherë në shenjë që me shpimin e parë, por ama jo të dështosh në 13 apo në 20 puse, siç ndodhët me sabotatorët. Asnjë nga pushtet që shponin ata nuk jepte naftë. Kuptohet që ky ishte sabotim i rëndë. Partia köshillon që fushës së naftës studimi i bëhet me kujdes që nga a-ja e deri te zh-ja, pastaj të shpohet, me një fjalë, si të kesh bërë vrojtimin dhe të kesh shtënë në dorë të dhëna të sigurta. Megjithë-këtë mund të mos dalë naftë dhe kjo nuk do të thotë se je armik. Në asnjë mënyrë! Prandaj duhet vazduhar puna të shpohet më tutje, se me siguri do të gjendet naftë, nëse është kryer në rregull studimi.

Në planin e ri pesëvjeçar është vënë detyrë që të zbulohen fusha të reja naftë. Specialistët tanë të kësaj dege e dinë më mirë se kushdo që Shqipëria është vend naftëmbajtës. Që ka naftë te ne, na e kanë thënë edhe specialistë sovjetikë në kohën e Stalinit, edhe ata që erdhën më vonë, por këta, natyrisht, e thanë fshehurazi Hrushovit dhe hrušovianëve. Se midis atyre që na dërguan revizionistët hrušovianë, ka pasur edhe ndo-

një specialist të mirë si njeri, siç ishte ai që u ka folur në vesh njerëzve tanë. Sipas tij, pra, tërë Vlora qëndron mbi naftë, «po ju lutem mos e hapni këtë fjalë», thoshte ai me druajtje dhe i trembur, sepse urdhri nga Moska ishte që asgjë të mos na thoshin neve, shqiptarëve. Po nuk është vetëm kjo e thënë mbi të cilën bazoimi ne, ka edhe të dhëna të tjera që na bindin se vendi ynë është naftëmbajtës dhe jo vetëm në tokë, por edhe në det. Ne kemi, gjithashtu, gaz; vetëm se për nxjerrjen e tyre nga thellësitë e tokës duhet aplikacion, kërkohet një metodë e shëndoshë shkencore, si për t'i zbuluar ekzaktësisht fushat ku fshihen këto pasuri, ashtu edhe për t'i nxjerrë që të rritet medoëmos prodhimi i tyre, sepse pa naftë nuk ecet.

Ashtu si nuk mund të jetojë një organizëm i gjallë pa gjak, edhe ekonomia jonë socialiste nuk mund të zhvillohet pa naftë, pa benzinë etj. Pa këto produkte të domosdoshme do të paralizohej gjithë ekonomia jonë popullore. Prandaj, derisa naftë kemi, derisa kemi edhe kuadro e mjete moderne, atëherë Partia, punëtorët, kuadrot dhe specialistët me ndërgjegje, me guxim, me heroizëm, me zell të madh, e kanë për detyrë t'i vihen punës dhe të mendojnë ditë e natë për nevojat që ka atdheu socialist, për ta nxjerrë këtë prodhim me vlerë. Ata të mendojnë ditë e natë për naftën, njëloj si edhe për bukën, sepse nafta duhet edhe për nevojat e mbrojtjes. Po nuk patëm një mbrojtje të fortë e të organizuar më së miri, të gjitha fitoret që janë arritur deri tash do të qëndrojnë si një kala mbi rrërë.

Mbrojtja e atdheut është e lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të vendit e me ndërtimin e plotë të socia-

lizmit, me mirëqenien e njerëzve tanë. Direktiva e Partisë është që i madh e i vogël të jenë të gatshëm edhe si ushtarë në çdo front pune. Punëtori i bujqësisë duhet të jetë njëkohësisht ushtar me pushkë për të mbrojtur atdheun; punëtori në naftë të jetë në pararojë për t'i dhënë sa më shumë naftë atdheut, por të jetë njëkohësisht edhe ushtar me pushkë; punëtorja që prodhon teknike, në të njëjtën kohë të mbajë pranë pushkën për t'u kthyer menjëherë, po ta kërkojë nevoja, në ushtare për mbrojtjen e atdheut. I tillë duhet të jetë çdo punonjës te ne, kjo është rruga jonë leniniste.

Lenini na mëson, gjithashtu, se si ta organizojmë ushtrinë për sigurimin e mbrojtjes së vendit. Ai na flet për shkollën e lirë ushtarake, që është një nga frytet e gjenisë së tij. Vetëm me këtë formë organizimi, vetëm me këtë mënyrë mund të mbrohet vendi nga çdo armik. Çdo qytetar duhet të kuptojë se, përveç punës që bën, kudo që të jetë, e ka për detyrë të punojë edhe për mbrojtjen e atdheut, pse vetëm kështu mbron jetën e vet dhe fitoret e arritura. Por që secili ta mbrojë me sukses atdheun, është e domosdoshme të përvetësojë Artin Ushtarak të Luftës Popullore dhe për këtë duhet shkollë, duhen teori dhe praktikë. Për këto probleme kyç Komiteti Qendror i Partisë ka menduar dhe ka dhënë udhëzime. Partia i likuidoi tradhtarët që pëngonin mbrojtjen dhe tash përgatitja ushtarake e popullit tonë ushtar është rritur e po forcohet në rrugë revolucionare.

Kuadrot e ushtrisë e kanë kuptuar se ç'dëm i shkaktoi vendit puna sabotuese e grupit tradhtar të Beqir Ballukut, Petrit Dumes, Hito Çakos dhe e të tjerëve, që

tashmë i kemi fshirë. Tash, në mënyrë shumë më të organizuar, duhet vënë në vend brenda një afati sa më të shkurtër koha që armiqtë na kanë bërë të humbasim. Partia ka lëshuar direktivën «malet janë kala, por duhen bërë kala edhe fushat». Kjo do të thotë që edhe fushat duhen fortifikuar, me qëllim që nëpër to të mos kalojë as miza. Dhe të jeni të bindur se armiku nuk do të kalojë, pse oficerë e ushtarë, mbarë populli, të gjithë së bashku po marrin pjesë në punën përfortifikimin e vendit dhe njëkohësisht në punën e gjithashme përforkimin teoriko-praktik përmbrojtje.

Asnjeri të mos e flejë mendjen dhe të mos harrojë rrezikun e luftës. Partia nuk thotë se lufta është te pragu i derës, por të jetë e qartë përfundimtare gjithçka se lufta mund të shpërthecjë, prandaj ne duhet të stërvitemi dhe të organizohemi sa më mirë. Dhe stërvitjet, në fakt, ne po i bëjmë dhe do t'i bëjmë vazhdimisht. Por kjo s'mjaaston. Duhet, gjithashtu, të bëhem i edhe ekonomikisht përherë e më të fortë. Me siguri çdo vit që kalon, në sajë të rritjes së pandërprerë të forcave producente në vend, do të bëhem më të fortë. Por të fortë do të jemi edhe në rast se masat e popullit, me Partinë në krye, vazhdimisht ngrihen politikisht e ideologjisht. Kaliten e tyre politike e ideologjike ne po e bëjmë dhe do ta bëjmë akoma më të madhe. Këto masa janë të domosdoshme që të merren, me qëllim që armiku të mos na gjejë një besasi e të papërgatitur, ndryshtë kur të gjen të dobët, ai të sulmon.

Eksperiencia historike tregon se luftërat lokale mund të shkaktojnë një luftë botërore. Partia jonë mendon se luftërat lokale sot janë në rendin e ditës dhe më të

mundshme për të shpërthyer. Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe borgjezia reaksionare në botë luftojnë për ndarjen dhe për rindarjen e sferave të influencës. Ndarja e vendeve të ndryshme në sfera influence dhe zaptimi i tregjeve të reja, nuk bëhet pa fërkime, po me goditje dhe me luftëra, të cilat aktualisht janë të lokalizuara. Imperialistët dhe socialimperialistët tash vënë të tjerët të luftojnë për ta. Të tilla janë shumë klika reaksionare borgjeze që sundojnë mbi popujt e që përpilen të ruajnë interesat e tyre në kurritë masave që qeverisin, duke i lidhur këta interesa me këtë ose me atë superfuqi.

Partia jonë zbaton me besnikëri teorinë e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit që na mëson se proletariati, klasa punëtore kudo në botë, duhet të bashkohet. Në «Manifestin e Partisë Komuniste» bëhet thirrje: «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!». Kjo dëtë thotë se lufta kundër kapitalizmit botëror, kundër imperializmit, që, siç thekson Lenini, ka arritur në stadin e kalbëzimit e në të cilin ndodhet edhe socialimperializmi sovjetik, nga ana e proletariatit dhe e aleatëve të tij të natyrshëm duhet të zhvillohet në shkallë kombëtare dhe në shkallë botërore.

Partia jonë mendon se kjo luftë duhet të bëhet nëtë dy krahët, edhe kundër imperializmit amerikan e satelitëve të tij, edhe kundër socialimperializmit sovjetik e satelitëve të tij, për arsyen se të dyja superfuqitë dhe satelitët e tyre, domethënë forcat reaksionare që u qëndrojnë përsipër popujve të ndryshëm, shtypin e duan ta mbajnë në zgjedhë, si proletariatin kombëtar, ashtu edhe atë botëror. Komunistët, siç na mësojnë

Marks, Engels, Lenin dhe Stalin, duhet të luftojnë kundër gjithë kësaj force armike të proletariatit dhe të popujve.

Marks dhe Engels na mësojnë, gjithashtu, se ka vetëm dy botë, jo tri. Por sot ka njerëz, bile shtete dhe parti, që mbrojnë nocionin e ekzistencës së tri botëve. Partia jonë, duke u mbështetur në mësimet e mësuesve tanë të mëdhenj, ka pikëpamjen se aktualisht nuk mund të ketë tri botë, por vetëm dy: nga një anë qëndron proletariati me alcatët e tij besnikë, fshatarësinë e varfér e të mesme dhe gjithë njerëzit përparimtarë, nga ana tjetër e barrikadës janë imperializmi amerikan me satelitët e tij, socialimperializmi sovjetik e revizionizmi modern, si dhe gjithë kapitalizmi botëror. Në këto pozita qëndron e do të qëndrojë Partia e Punës e Shqipërisë, pse ato janë të drejta, marksiste-leniniste, që e shikojnë gjendjen botërore në prizmin klasor dhe jo koniunkturor. Në botë ka dy pole: njëri kërkon të shtypë tjetrin, i dyti lufton t'i bëjë varrin të parit. Atij që mendon ndryshe, Partia jonë i thotë të reflektojë, se e ka gabim.

Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik janë dy superfuqi që përpinqen të shfrytëzojnë popujt dhe të shtypin kudo revolucionin, ndërsa popujt e botës kërkojnë çlirim. Vihet pyetja: prej kujt kërkojnë të çlirohen? Ata kërkojnë të çlirohen nga zgjedha e dy superfuqive dhe e atij grushti borgjezësh e kapitalistësh që sundojnë në kurriz të tyre në vendet e ndryshme. Prandaj, në platformën ndërkombëtare, Partia jonë dhe shteti ynë luftojnë pa mëshirë si socialimperialistët sovjetikë, ashtu edhe imperialistët ameri-

kanë, si dhe gjithë reaksionarët e tjerë dhe ndihmojnë e mbështetin, në radhë të parë, luftërat nacionalçlirimtare të popujve, por edhe ndonjë vend borgjez që ndjek një politikë antiimperialiste, siç ishte Kili në kohën e Alendes. Ky demokrat revolucionar e ngriti vendin e vet në një fazë më përparimitare, por nuk u shty më tej për të marrë masa radikale. Pinoçeti dhe klika e tij reaksionare ushtarako-fashiste organizuan grushtin e shtetit, rrëzuan Alenden dhe zhdukën me qindra e mijëra njerëz të tjerë përparimtarë.

Në politikën e vet të jashtme parimore, konskuentë, Partia dhe shteti ynë mbajnë një qëndrim të caktuar edhe ndaj disa shteteve borgjeze. Po kjo nuk duhet kuptuar se ne jemi dakord, fjala vjen, me qeverinë e Sadatit. Jo, ne e dimë kush është Anvar Sadati. Ky është një pasanik arab që, ashtu si edhe Naseri, ka qenë në shërbim të feldmareshalit nazist Romel. Të tillë njerëz janë përfaqësues të interesave të borgjezisë kapitaliste të vendit të vet. Mirëpo pas Luftës së Dytë Botërore këta njerëz rrëzuan monarkinë e mbretit Faruk në Egjipt, shpallën republikën, bënë edhe disa reforma. Në këto kushte ne ndihmojmë dhe flasim mirë për popujt arabë, si popuj heroikë, që luftojnë për t'u çliruar nga fuqitë imperialiste, të cilat i kanë futur në luftë me njëri-tjetrin për interesat e tyre dhe të klikave në fuqi. Ky qëndrim yni është qëndrim i drejtë klasor dhe diametralisht i kundërt me pikëpamjen se të tilla shtete bëjnë pjesë në një botë të ashtuquajtur të tretë. Çfarë «botë e tretë» janë ato? Këto vende janë shtete kapitaliste, kurse njerëz si Sadati, që janë në pushtet, shfrytëzojnë, si kudo në vendet e tjera kapitaliste, po-

pujt e tyre. Ne jemi me popullin egjiptian, me popullin sirian, me atë të Libanit, si dhe me gjithë popujt e tjerë arabë. Do të ishte një gabim i madh, pra, po të thoshim se nc, Republika Popullore e Shqipërisë, bëjmë pjesë në «botën e tretë». Ne nuk jemi pjesëtarë të një bote të tillë, por vend socialist.

Edhe pikëpamja tjeter, sipas së cilës, për të shkatterruar njérën fuqi imperialiste, të mbështetemi te fuqia tjeter imperialiste, është krejt e gabuar. Ne deklarojmë se jemi me popujt, me proletariatin, i cili kudo që është, duhet të organizohet, të forcojë aleancat me fshatarësinë dhe me inteligjencien përparimtare dhe të gjithë së toku, nën udhëheqjen e proletariatit e të partisë së tij marksiste-leniniste, të ngrihen e të luftojnë, për të rrëzuar pushtetin e borgjezisë, për të vendosur pushtetin e proletariatit; të gjithë së bashku të luftojnë imperialistët, socialimperialisët, partitë revisioniste dhe gjithë reaksionarët e tjerë. Për këtë rruge jemi ne. Kjo është vija jonë, vijë tjeter për ne nuk mund të ketë.

Politikën tonë ne e themi haptazi. Kush na do të mirën, na duartrokët për këtë politikë, kush nuk na e pëlqen, mundet edhe të mos flasë ose të ndjekë rruge e vet, por edhe Partia e Punës e Shqipërisë bën punën e saj. Ne jemi të sigurt për një gjë: proletariati ndërkombëtar dhe njerëzit përparimtarë në botë kanë admirim të madh për Partinë e Punës të Shqipërisë, për Qeverinë, për politikën e shtetit tonë dhe entuziazmohen për qëndrimet e Partisë dhe të shtetit tonë. Shumë nga këta elementë përparimtarë, entuziazmohen për qëndrimet e Partisë e të shtetit tonë, ata thonë: «I

lumtë Shqipërisë, është shembull për të gjithë ne, prandaj të ndjekim rrugën e saj!», «Na jepni materiale të mësojmë përvojën tuaj». Dhe ne u shpjegojmë gjithçka u intereson. Ka bile dhe kryetarë shtetesh, që po hojnë se qëndrimet që mbajmë ne, shqiptarët, nuk mund t'i mbajë asnje shtet në botë. Pse e thonë këtë? Shumë nga këta e kanë të qartë se ne dëshirojmë që proletariati e populli i këtyre vendeve t'u bëjnë varrin borgjezisë kapitaliste, por e dinë, gjithashtu, se ne nuk ndërhyjmë në çështjet e brendshme të të tjerëve, ashtu siç bën Bashkimi Sovjetik, ku mund t'i arrijë çizmja ose fuqia e armëve. Ne interesohemi për proletariatin suedez dhe atë botëror, për njerëzit përparimtarë kudo që janë, të cilët gjykojnë me realizëm q'bëhet në vendin tonë të vogël, prej dy milionë banorësh të udhëhequr nga një Parti marksiste-leniniste, që ndjek me besnikëri socializmin shkencor, duke i qëndruar përballë sypatrembur gjithë kësaj force kolosale reaksionare dhe ecën përpala në rrugën e vet të pavarur.

Qëndrimet tona janë rezultat i një luftë të gjatë që ka bërë populli ynë, jo vetëm gjatë këtyre 35 vjetëve që udhëhiqet nga Partia, por i gjithë luftërave që ka bërë ai gjatë historisë së vet. Kurrë populli ynë s'e ka duruar robërinë. Ai ka luftuar e ka derdhur shumë gjak në të kaluarën, por fuqinë ia kanë marrë bezlerët dhe agallarët, të cilët e kanë shtypur. Megjithatë ai prapë është ngritur e kështu ka jetuar vazhdimesht, në luftë. Këto tradita luflarake, që na i kanë lënë trashëgim të parët, Partia jonë diti t'i brumosë me mësimet e mëdha të Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit dhe t'i ngrejë në një nivel shumë të lartë, prandaj ato po

ia japin këto rezultate që dimë. Politikën tonë nuk e duan, përkundrazi e lusfojnë të gjitha klikat dhe shtetet e fuqishme kapitaliste e revisioniste, por, pavarësisht nga qëndrimi që ato mbajnë kundër nesh, ne nuk undemi nga politika jonë e drejtë, marksiste-leniniste.

Ne kemi deklaruar se jemi kundër Tregut të Përbashkët Evropian. Kush bën pjesë në këtë organizatë? Fuqitë kapitaliste, oligarkitë e mëdha financiare imperialiste, që e kanë humbur forcën imperialiste të mëparshme. Dy superfuqitë që kanë dalë në skenë ua kanë marrë sot këtë forcë. (Për këtë arsyе shtetet kapitaliste të Evropës krijuan Tregun e Përbashkët në kontinentin tonë.) Po në kurriz të kujt është ky treg? Sikur të mblidheshin në një shoqëri gjithë agallarët e Vlorës, kundër kujt do të organizoheshin dhe do të vepronin? Është e qartë se ata do të mblidheshin për të mbrojtur çifligjet e tyre, për të siguruar të gjitha prodhimet, drithërat, bagëtitë, ullinjtë etj. dhe populli le të ngojej me ujin e detit. Prandaj Partia jonë lufton kundër Tregut të Përbashkët Evropian dhe kjo luftë është e drejtë, marksiste. Popujt që jetojnë në këto vende janë të përqarë e të gënjen, por pjesa më e ndërgjegjshme e proletariatit dhe e njerëzve përparimtarë në to pohojnë se Shqipëria e ka drejt. Ka edhe shtete që nuk e kuptojnë kështu si ne qëndrimin që duhet mbajtur ndaj Tregut të Përbashkët Evropian, e mbështetin atë, me gjithëse quhen komuniste. Ne mendojmë se ata bëjnë gabim.

«Evropa e Bashkuar» është, gjithashtu, organ i trusteve të mëdha të Anglisë, të Gjermanisë Perëndimore, të Francës, të Italisë etj., pra i shtetëve kapita-

liste. Përse është krijuar ky organ? Për të shmangur rrezikun e revolucionit, në radhë të parë, në Evropë e pastaj për t'i rezistuar një invazioni të mundshëm sovjetik. Këtë të vërtetë ia ka pohuar një shokut tonë një diplomat francez. Sipas francezit, shtetet që bëjnë pjesë në «Evropën e Bashkuar», nuk ia kanë frikën socialimperializmit sovjetik, pse me gjithë ato organizime që bëjnë, duke qenë të bashkuar, e ndiejnë veten të fortë se kanë edhe ushtri, edhe armë më të përsosura se të socialimperialistëve. Ajo që i shqetëson shumë ata është gjendja e rëndë e brendshme, e shkaktuar nga kriza e madhe që ka prekur të gjitha vendet e tyre. Kjo krizë ka rënë kryesisht në kurriz të proletariatit. Në këto vende sot numërohen me miliona të papunë. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vendet e Evropës Perëndimore dhe në të gjitha vendet kapitaliste të mëdha të botës përditë bëhen greva të fuqishme. Sa për shtetet e Evropës Lindore, dihet se atje kërcet pushka dhe terrori — tipikë për diktaturën fashiste (se në shtetet kapitaliste të Evropës Perëndimore ka njëfarë demokracie borgjeze, ekzistojnë sindikatat, si do që këto janë organizma grevëthyes). Kriza e madhe në botën kapitaliste është rrjedhim i fitimeve të mëdha që ka nxjerrë dhe po nxjerr vazhdimisht kapitalizmi. Sa më të pasur bëhen kapitalistët, aq më i varfër bëhet populli, të cilin kapitalizmi e gënjen, ashtu siç gënjejnë proletariatin sindikatat reformiste, siç e gënjejnë edhe partitë revisioniste që kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin.

Por nuk mund të gënjenë të tëra masat e popullit. Lëvizja revolucionare, me shumë mundime dhe dal-

ngadalë, por fakt është që po ngrihet kudo në botë. Po ngrihet, së pari, ndërgjegjja klasore e punëtorëve dhe e masave të tjera punonjëse. Në një vend kapitalist si Italia përditë dalin nëpër rrugë dhe protestojnë me mijëra e dhjetëra mijëra njerëz. Ata shprehin ndjenjat e revoltës e të pakënaqësisë ndaj rendit kapitalist. Të pakënaqur nuk janë vetëm të papunët. Edhe ata që punojnë, kalojnë një jetë të vështirë, se rritet inflacioni, shtohen taksat, rëndohet kostojë e jetesës etj. Kjo gjendje e tillë nuk është vetëm në Itali, por edhe në Francë, në Gjermaninë Perëndimore, në Spanjë, në Angli e kudo. Greva e punëtorëve të qomyrgurit në Angli paralizoi tërë jetën e vendit. E dini ç'i thonë të mos lëvizin për disa ditë tërë vaporët, gjithë trenat e mjetet e tjera të transportit e të konunikacionit të një vendi? Shihni, pra, ç'forcë të madhe ka proletariati!

Proletariati, kudo në botë, e aprovon vijën tonë. Por, duhet pasur parasysh që ai nuk është i gjithi i ndërgjegjshëm, që të mendojë siç mendojmë ne, siç mendon klasa jonë punëtore. Borgjezia me kohë, nëpërmjet partive të ndryshme dhe sindikatave, ka mundur të krijojë në çdo vend kapitalist një pyll me ligje që e kanë karbosur proletariatin politikisht, ekonomikisht, ideologjikisht, me qëllim që ky të mos jetë në gjendje të lëvizë. Ka vende kapitaliste ku punëtori nuk guxon të mbajë një gazetë komuniste marksiste-leniniste në xhep, se padroni e pushon nga puna menjëherë dhe pushimi nga puna në kapitalizëm do të thotë mjerim, vdekje për punëtorin.

Në këto kushte nevojitet një forcë që ta organizojë, ta frysëzojë dhe ta hedhë në luftë proletariatin.

Kjo forcë janë partitë marksiste-leniniste, që ende nuk janë krijuar si duhet në të tëra vendet kapitaliste. Ato nuk janë akoma në nivelin e kërkuar, nuk kanë shtrirjen e mjaftueshme që t'i japid një shtytje të madhe asaj aspirate të shkëlqyer të klasës punëtore, që është bashkimi dhe organizimi i radhëve të saj, pse edhe armiqtë kapitalistë punojnë e përpilen ta përcajnë. Për këtë qëllim atyre u vijnë në ndihmë partitë revisioniste dhe udhëheqjet sindikaliste që subvencionohen nga kapitali. Të tërë këta janë bërë grevëthyes, janë shndërruar në aristokraci të klasës punëtore. Me anën e këtyre elementëve kapitali kapërcecen situata, mjaft që t'u japë nga pesë grosh për t'u hedhur në inaktivitet, që klasa punëtore të mos bëjë grevë, të mos organizohet e të mos hidhet në luftë. Pastaj di borgjezia si të veprojë, ajo ngre përnjëherë çmimet.

Po të lexoni artikullin<sup>1</sup> e botuar sot në «Zërin e popullit», do të shihni në ç' shkallë janë ngritur çmimet në botë, si po zhvillohet tmerrësisht kudo inflacioni. Pikërisht këtë inflacion, këtë krizë, kapitalizmi, imperializmi dhc revizionizmi kërkojnë ta kapërcejnë me të gjitha mënyrat, sepse rreziku që vjen prej tij është më i madh se çdo rrezik tjetër. Kjo arsyen nxit ata të mendojnë dhe të krijojnë gjithë këta organizma antipopullorë e antiproletarë, si Tregu i Përbashkët Evropian, «Evropa e Bashkuar», KNER-i, Traktati i Varshavës. Traktati i NATO-s e të gjitha të tjerat me radhë. Çfarë duhet të bëjë një parti marksiste-leniniste dhe një vend

---

1. «Në dërin e një krize të thellë». Shih: «Zëri i popullit», nr. 79 (8622), 2 prill 1976.

socialist përballë këtyre organizmave, të mbrojë njërin apo tjetrin, apo t'i luftojë këta të tërë? Partia jonë e Punës dhe shteti ynë socialist mendojnë se duhen luftuar të tërë dhe kështu bëjnë, i luftojnë, prandaj ka kudo në botë një respekt të veçantë për vendin dhe për Partinë tonë.

Disa thonë: «Të mbështetim një imperializëm, për të luftuar imperializmin tjetër». Edhe kjo është një pikëpamje e gabuar, sipas mendimit tonë. Ata që nendojnë kështu justifikohen se edhe Stalini paska bërë një gjë të tillë. Kjo s'është aspak e vërtetë. Stalini dhe Partia Bolshevikë s'kanë vepruar kështu në asnje rast. Ata kanë luftuar me konsekuencë nazizmin gjerman dhe fashizmin në përgjithësi, si ideologjikisht e politikisht, edhe me armë. Ata kanë luftuar me konsekuencë gjithë borgjezinë reaksionare të vendeve të ndryshme, kanë mbrojtur kurdoherë interesat e proletariatit botëror, kanë ndihmuar në organizimin e partive komuniste të botës, në kalitjen e tyre, si dhe në organizimin e sindikatave që ishin në ato kohë nën drejtimin e partive komuniste.

Është e vërtetë që Stalini nënshkroi një marrëveshje mossulmimi me Gjermaninë hitleriane në vitin 1939. «Kur është kështu, përsë të mos bëjmë edhe në marrëveshje me amerikanët për të luftuar sovjetikët», thonë disa. Jo, u përgjigjemi ne, se Stalini marrëveshjen nuk e bëri në kushte si këto aktualet dhe as e nënshkroi atë duke hequr dorë nga demaskimi i hitlerianëve dhe i fashizmit. Është vërtetuar se ajo që bëri Stalini ishte një taktikë e përkohshme, që i jepte mundësi Bashkimit Sovjetik të fitonte kohë me qëllim që

të armatosej më mirë. Veç kësaj, Stalini aprovoi nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje me Gjermaninë, kur u pa qartë se traktatet që ishin nënshkruar me Francën sidomos, por edhe me Anglinë për t'i bërë ballë nazizmit gjerman që po ngrihej, u shkelën nga ana e këtyre të fundit.

Kur do të sulmohej Çekoslovakia, ekzistonin traktate midis Francës e Çekoslovakisë dhe Bashkimit Sovjetik e Çekoslovakisë, sipas të cilave, në qoftë se do të sulmohej ky vend, Franca dhe Bashkimi Sovjetik do t'i vinin në ndihmë me armë. Por Franca u tërroq, e shkeli traktatin, që kishte me Çekoslovakinë.

Bashkimi Sovjetik dhe Stalini u bënë edhe një herë thirrje Anglisë, Francës dhe gjithë shtetet e tjerë aleatë të tyre që të bënin një marrëveshje të përbashkët kundër Gjermanisë hitleriane, e cila ishte bërë edhe vazhdonte të bëhej çdo ditë e më e rrezikshme. Pasi kishte rrëmbyer më parë Austrinë, ajo pushtoi më pas edhe Çekoslovakinë. As Franca, as Anglia nuk deshën ta nënshkruanin këtë traktat me Bashkimin Sovjetik kundër Gjermanisë së Hitlerit, sepse ishin të lidhura me detyrimet që kishin marrë në Munih. Qëlli mi i tyre ishte ta drejtonin Gjermaninë hitleriane kundër Bashkimit Sovjetik.

Vetëm në këto kushte dhe pas gjithë këtyre përpjekjeve e nënshkroi Bashkimi Sovjetik marrëveshjen e mossulmimit me Gjermaninë naziste dhe këtë e bëri për të fituar kohë.

Pra, politika e balancimit që po bëhet sot, nuk mund të përligjet me atë që thuhet se edhe Stalini ka vepruar kështu. Ai e ka bërë këtë në kushte krejt të

tjera. Analogjia historike nuk qëndron. Pastaj, me gjithëse e nënshkroi për një kohë marrëveshjen, Bashkimi Sovjetik forcoi kufijtë e tij perëndimorë dhe përgatitej kundër agresionit të mundshëm gjerman. Siç dihet, Bashkimi Sovjetik luftoi dhe fitoi mbi Gjermaninë e Hitlerit. Shteti sovjetik dhe Partia Bolshevikë, nën drejtimin e Stalinit, ishin dhe mbetën kurdoherë antinazistë e antifashistë të vendosur, pro revolucionit, pro proletariatit dhe pro gjithë partive proletare të botës. Qëndrimin e Partisë sonë për këtë çështje populli ynë e aprovon dhe e mbështet plotësisht.

Ne, gjithashtu, jemi për bashkekzistencën midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore, por në rrugën leniniste, jo për bashkekzistencë në fushën ideologjike. Partia dhe shteti ynë nuk mund të komprometohen as në dallaveret që thurin shtetet fqinje. Ne jemi për marrëdhënie të fqinjësisë korrekte, të mirë, bëjmë tregti me shtete kufitare deri në atë masë sa kemi leverdi dhe asgjë tjetër. Mbledhja<sup>1</sup> që organizuan kohët e fundit krerët e vendeve ballkanike nuk dha asnjë rezultat. Rezultati është vetëm forcimi i klikave të këtyre vendeve, me të cilat ne kemi kundërshtime. Ne jemi përkrah popujve të Ballkanit dhe, me aq sa mundim, i mbështetim aspiratat e tyre, pa u ndërhyrë në punët e tyre të brendshme. Ndaj këtyre shteteve politikisht dhe ideologjikisht mbajmë qëndrimet tonë të njohura, ndërsa për sa u përket Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik,

---

1. Konferenca ballkanike e Athinës. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 56, f. 467.

Partia jonë i ka kritikuar dhe do të vazhdojë t'i kritikojë me forcë ideologjikisht dhe politikisht edhe nü të ardhmen.

Këto qëndrime tonat disave nuk u pëlqejnë, por neve nuk na prishet puna. Është pikërisht kjo politikë që i bëjnë Partinë dhe shtetin tonë të fortë, ndryshtë do të ishim kalbur, do të shkonim në rrugë të gabuar.

Në situatat kur mbretëron një krizë e madhe në gjithë botën kapitaliste e revizioniste, në vendin tonë gjendja është e kënaqshme, çmimet janë të qëndrueshme, tregu është i furnizuar, papunësi nuk ka. Për disa qindra ose mijëra forca të reja pune që na janë krijuar e do të na krijojen ne kemi dhe do të kemi vende pune, kryesisht në bujqësi, ku ka punë sa të duash. Çështja këtu është që të punojmë me durim me njerëzit, për t'i bindur ata, për të krijuar koncepte të drejta për punën e bindje të shëndosha politiko-ideologjike. Duhet të kemi parasysh që mbeturinat mikroborgjeze nuk zhdulen lehtë, përnjëherësh nga ndërgjegjja. Rëndësi ka që situata ekonomike në vendin tonë është e kënaqshme, situata politike, gjithashtu, është e shëndoshë.

Në Kinë prapë ka turbullira, ka krizë. Tash atje luftojnë dy rryma. rryma e djafhtë, në krye të së cilës qëndron Ten Hsiao Pini, kundër të majtëve. Organi qendror i Partisë Komuniste të Kinës, «Zhenminzhibao», pohon se në parti ka kurdoherë dy vija. Ne themi që në gjirin e partisë komuniste nuk mund dhe nuk duhet të ketë dy vija, po vetëm një: vija marksiste-leniniste. ndryshtë nuk mund të ketë unitet mendimi dhe veprimi. Vijë tjeter, në qoftë se ka, është

jashtë partisë. Në qoftë se te ne del një njeri, ose dy, pesë, gjashtë veta kundër Partisë dhe diktaturës së proletariatit, si Beqir Balluku, Partia jonë u bie kokës, pse në parti duhet të sundoje vetëm marksizëm-leninizmi. Kinezët le të vazhdojnë me dy vija, po të duan, po këto dy vija nesër mund të bëhen katër, pasnesër tetë c gjashtëmbëdhjetë, kjo është punë për ta, ne nuk u ndërhyjmë në punët e brendshme. Situata le ne e tillë është: ne udhëhiqemi vetëm nga një ideologji, nga ideologja marksiste-leniniste.

Klasa punëtore në vendin tonë është në fuqi, ajo ka vendosur diktaturën e saj. Te ne, sipas teorisë së Marksit, kjo diktaturë është një mjet për të shtypur armiqjtë e klasës. Liri në atdheun tonë socialist ka vetëm për popullin, për klasën punëtore, për fshatarësinë dhe për inteligjencien popullor që punojnë për ndërtimin e socializmit, ndërsa me armiqjtë diktatura e proletariatit vepron që nga edukimi, për ata që dëshironë të punojnë e të rrojnë me ndër, e deri atje sa u jep plumbin atyre që ngrenë krye.

Edhe në Kinë thuhet që diktatura e proletariatit është në fuqi. Nga sa jemi në dijeni, në këtë vend diktatura e proletariatit, ekziston vetëm me edukim. Atje ka, me një fjalë, diktaturë pa gjak. Ndoshfa kështu mund të jetë teoria nga e cila udhëhiqen atje. Ten Hsiao Pinin Revolucioni Kulturor e cilësoi armikun numër 2 të Kinës, pas Liu Shao Çisë, bile Tenit i vunë edhe kapelën në kokë, e nxorën në stadium para popullit, e vunë përpara me fërshëllima dhe, më së fundi, e futën në shkollën e edukimit, ku ndenji nja 6 vjet. Pas kësaj

kohe deklaruan se «u edukua», bëri edhe «autokritikë» dhe në fund e bënë nënkryetar të partisë, zëvendëskryetar të këshillit të shtetit dhe shef të shtabit të ushtrisë. Këta tre vjet e gjysmë Ten Hsiao Pini bëri ligjin në Kinë, priti e përçolli nga tre-katër delegacione çdo ditë me të cilët fliste në emër të Çu En Lait. Pas vdekjes së këtij, ai prapë u bë «reaksionari numër një», «Hrushovi numër 2» i Kinës, «njeriu i borgjezisë», «armik i socializmit», dhe ashtu mund të jetë, ky është kokëfortë, nuk bën autokritikë, se s'përjashtohet që ta lënë prapë me përgjegjësitë që kishte në parti dhe në shtet.

Sic e shikoni, ka një ndryshim ndërmjet qëndrimit që mbajtëm ne ndaj tradhtarit Beqir Balluku me shokë dhe qëndrimeve që mbajnë në Kinë ndaj tradhtarëve që dalin. Njerëz të tillë atje bëhen deri nënkryetarë të partisë, kurse te ne marrin dënimin kapital, pse mendojmë o është diktaturë dhe atëherë shtype armikun, o s'është diktaturë. Përveç Beqir Ballukut, Abdyl Këllezit etj.; kishin bërë gabime edhe të tjerë në ushtri e në ekonomi, por vetëm kryesorëve u dhamë dënim kapital, sepse ata udhëhiqnin koniplotin për të shkatërruar Shqipërinë, për të përbysur rendin socialist, për të shkelur mbi gjakun e mijëra e mijëra djemve e vajzave të rënë në luftë dhe mbi djersën e gjithë popullit. Ne nuk i falim elementë të tillë, po u tregojmë vendin! Këtë s'na e lejon as ideologjia, as populli ynë! Partia jonë secilit i jep dënimin sipas shkallës së fajt, kurse në përgjegjësi nuk i vë kurrë njerëz të tillë.

Vijën që kemi ne për klasën punëtore të vendit tonë, në radhë të parë, por edhe për proletariatin

botëror, për revolucionin dhe për miqtë, sidomos për Kinën, e konsiderojmë të drejtë. Elementë armiq të hapët, siç është Ten Hsiao Pini në Kinë, ne i luftojmë pa mëshirë, po ne luftojmë edhe Ten Hsiao Pinët e fshehtë, si edhe të gjitha ato vende që kanë Ten Hsiao Pinër në krye. Kush është në rrugë të drejtë, nuk ka pse t'i mbetet qejfi nga qëndriimet tonë kundër armiqve të tillë. Në qoftë se dikush nuk është dakord, Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë kurdoherë e predispozuar të bisedojë, bile, ajo kërkon të bisedojë me miqtë dhe me shokët. Ne jemi dakord të takohemi dhe në mënyrë shoqërore të shqyrtojmë bashkërisht nëse e kemi apo s'e kemi drejt rrugën. Në rast se s'e kemi drejt, atëherë të tjerët të na thonë përsë s'e kemi drejt, po njëkohësisht edhe ne e kemi për detyrë dhe të drejtë t'u themi bashkëbiseduesve e kanë apo s'e kanë drejt qëndrimin që mbajnë për këtë ose për atë problem.

Mund t'ju themi me këtë rast se ndihmën përpesëvjeçarin e ri shokët kinezë na e dhanë të paktë, bile jashtëzakonisht të paktë. Përsë mbajtën këtë qëndrim kësaj radhe, e dinë atë, por që nga vetë Çu En Lai e me radhë gjithë të tjerët, nga më i madhi e deri te nië i vogli në Kinë, na kanë theksuar kurdoherë se «ndihmën që ju kemi dhënë ju, shqiptarëve, duhet ta konsideroni si shumë minimale». Nuk ekzagjeroj asgjë me këtë shprehje, po, kur ne bënim vlerësimin e ndihmave që na kishin dhënë, vazhdimisht na kanë thënë: «Mos e përsëritni më atë fjalë, shokë shqiptarë, ndihma që ju japid ne, është shumë e vogël». Çu En Lai, që e kemi dëgjuar me veshët

tanë, personalisht, është shprehur kështu: «Ju lutemi. shokë shqiptarë, sa të kalojnë edhe pesë vjet, pastaj do ta shtojmë vazhdimisht ndihmën për Shqipërinë, do t'ju japim ndihma më të mëdha. Kina nuk e lë në harresë Shqipërinë, po sa të na krijohen mundësitë, ndërsa ndihmën që na keni dhënë ju, s'na e ka dhënë askush në botë». Ne modestë jemi, po me sinqeritet u thoshim: «E ç'ndihmë ju kemi dhënë ne, ndihma jonë është vetëm në fushën politike».

Mirëpo vjet, kur delegacioni ynë shkoi në Pekin për të nënshkruar marrëveshjen për pesëvjeçarin e ri, ndryshe nga qëndrimet e përparshme, udhëheqësit kinezë u thanë shokëve të delegacionit tonë: «Jemi shumë të varfër, nuk kemi mundësi t'ju ndihmojmë më shumë». Ne ua thainë hapur: «S'jemi të kënaqur nga kjo ndihmi». «Kaq kemi, — ngulën këmbë ata, — s'kemi më shumë». «Natyrisht ne do t'i pranojmë edhe këto që na jepni, po sa për atë që thoni, se jeni të varfër, mendojmë se s'është kështu. Ju deri dje na thoshit se ndihmat do t'jua shtojmë progresivisht nga viti në vit»<sup>1</sup>. Po nuk përjashtohet, shokë, që këto

1. Në Ditarin Politik, më 1 janar 1976, shoku Enver Hoxha shkruante: «Ndihmat ekonomike që ne kërkuan për veprat e periudhës pesëvjeçare 1976-1980, të cilat me siguri do të mbaronin për 6-7 vjet, kinezët na i dhanë shumë të reduktuara. Ata na dhanë 20-25 për qind të kredive që kërkuan, duke na pritur ftohtë, duke na myllur derën për çdo shtesë e duke na thënë se «ky është edhe mendimi i Maos», ... «Mos kërkoni gjë, se s'pranohet asnjë kërkësë tjetër». Mund ta quajmë këtë presion ekonomik? Mund ta quajmë, bile me plot gojën. Pse mbahen këtë qëndrime nga ana e tyre? Sepse s'janë dakord me ne në vijë». Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 56, f. 231.

qëndrime të reja të jenë rezultat i gjithë këtyre turbullirave që po ndodhin atje.

Prandaj, kur flasim për çështjet ideologjike, për çështjen e diktaturës së proletariatit, për ligjet dhe për planet tona, për politikën tonë të jashtme, për politikën me Kinën dhe me vende të tjera, ne flasim haptazi dhe sinqerisht. Kështu për disa nga problemet, që përmenda, mendimet tona nuk i fshehim, ndryshe do të bënim gabim. Megjithatë në polemikë publike me miqtë dhe me shokët nuk hyjmë, veçse vijën tonë e bëjmë të njohur dhe e mbrojmë. Të tjerët, po të dëshirojnë, le të nxjerrin konkluzione nëse bëjmë mirë apo jo, nëse e kemi drejt a s'e kemi drejt.

Shokët kinezë i konsiderojmë miq dhe duam që të tillë të jemi kurdoherë dhe, për këtë, kemi shpresat e mëdha, pavarësisht nga qëndrimet jo të njëllojta që ka secili nga palët tona për disa nga çështjet që përmenda.

Natyrisht, këto që po ju them, janë vetëm për ju, shokë, jo për t'i bërë llafe pazari. Në punën me masat kurdoherë orientohuni nga propaganda e Partisë, sepse çështja e Kinës është shumë e madhe dhe me një rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm për vendin tonë, por për gjithë revolucionin në botë. Merrni parasysh se çfarë dëme të mëdha i solli revolucionit botëror tradhtia e revisionistëve sovjetikë. Një tragedji e tillë e madhe nuk dëshirojmë të ndodhë përsëri me Kinën. Dëshira jonë e madhe, forcat dhe përpjekjet tona janë që Kina t'i kapërcejë këto vështirësi, veç në rrugën marksiste-leniniste. Vetëm kështu kapërcimi i tyre do të jetë një fitore e madhe për revolucionin.

Për gjendjen brenda në Bashkimin Sovjetik mund t'ju them se në situatat aktuale që po kalon bota, revisionistët sovjetikë janë dobësuar shumë edhe ekonomikisht. Këtë e vërteton fakti që ata kanë qenë të detyruar të blejnë me dhjetëra milionë tonë drithë çdo vit në tregjet kapitaliste. Edhe industrinë ata e kanë prapa në krahasim me të tjerët, për shkak të teknologjisë së vjetruar. Megjithatë, nga burime të ndryshme të vendeve borgjeze del se atje ka lëvizje, bëhen greva nga punëlorët sovjetikë dhe kjo është e natyrshme. Përveç këtyre në Bashkimin Sovjetik ka, gjithashtu, disidentë të djathët, domethënë fashistë, agjentë të imperializmit amerikan, anglez, francez, agjentë të sionizmit, të cilët sulmojnë nga pozitat e tyre reaksionare udhëheqjen sovjetike, me Brezhnjevin në krye, që përpinqet të duket se është në unitet, por që në realitet nuk është kështu.

Edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë në krizë shumë të madhe, në krizë ekonomike, në krizë politike e morale dhe në krizë aleancash. Ashtu si edhe socialimperialistët sovjetikë, Shtetet e Bashkuara bëjnë gjithfarë manovrimesh për t'i kapërcyer ato. Nga një anë bëjnë përpjekje t'u vënë bërrylin sovjetikëve nga Lindja e Mesme, ku sot ndodhet pasuria më e madhe botërore e vajgurit, për t'u lënë dorë të lirë në Afrikë, si fjala vjen në Angola. Socialimperialistët sovjetikë, duke përdorur mercenarët kubanë, ndërhyjnë në Angola dhe sollën në fuqi një klikë në favor të tyre. Natyrisht kjo nuk është veçse njëfarë ndarjeje e zonave të influencës që bëjnë superfuqitë me njëra-tjetrën, ndarje që bie në kundërshtim me interesat e vetë popujve.

Ne mbajmë lidhje me shumë vende arabe. Ato i aprovojnë qëndrimet e Partisë dhe të Qeverisë sonë dhe pohojnë se si imperialistët amerikanë, edhe social-imperialistët sovjetikë janë vrasësit dhe gjakpirësit e tyre, po «jemi zënë ngushtë», thonë. Dhe me të vërtetë janë zënë ngushtë, mbasi në udhëheqje të shteteve të tyre kanë edhe elementë borgjezë, kapitalistë, që përpinqen të ruajnë interesat e tyre klasorë në kurri të interesave kombëtarë.

Deri në njëfarë kohe Anvar Sadati ua kishte nevojën sovjetikëve, bile, u dha atyre shumë koncesione në Egjipt si shpërblim për armët dhe për kreditë që revisionistët e Moskës u dhanë egjiptianëve. Kohët e fundit ai i prishi të gjitha traktatet me sovjetikët dhe u lidh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të mburrësh një element të tillë, që nuk bën gjë tjetër veçse heq një zgjedhë, për ta futur vendin e tij në një zgjedhë të re po aq të rëndë, të botosh edhe artikuj për të, se ky qenka gjoja një hero etj., siç mund të bëhet në ndonjë vend, është e gabuar. E si ta mburrësh për shembull mbretin e Arabisë Saudite, i cili ka kaq të ardhura, sa në çdo sekondë fiton 15 mijë dollarë? Ky apo ndonjë tjetër si ky, që një herë bëhet me amerikanët, një herë me sovjetikët, do të luftojë për komunizmin? Të gjitha lodrat e këtyre elementëve bien në kurri të popujve. Popujt arabë po bëhen gjahu i imperialistëve, i revisionistëve dhe i klikave që janë në fuqi mbi këta popuj.

Në këtë situatë, kur imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik janë në kriza të mëdha politike dhe ekonomike, qëndrimi i Partisë sonë është

i qartë, por ka shtete që mbajnë qëndrime që janë në favor të këtyre dy shteteve agresive gjakpirëse. Përse të mos flasim haptazi? Niksonin, ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, një batakçi ndërkombëtar, një njeri i diskredituar në gjithë botën dhe në vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku e hodhën tej si një leckë të ndytë, siç e dini, udhëheqësit kinezë e pritën në vendin e tyre. Kjo nuk shkon, shokë. Mund të na vijë mirë ne për këtë? Jo, nuk na vjen hiç mirë, sepse e dimë ç'është ai, një vrasës i komunistëve, që ka gjakosur popullin vietnamez, ka ndihmuar Pinochetin të vijë në fuqi në Kili etj., etj.

Në gjithë botën aktualisht kanë filluar të shkëputen nga orbita sovjetike mjaft parti dhe të kalojnë hapur në anën e borgjezisë së vendeve të tyre. Kongresi i 25-të i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u bë nën saçin e divergjencave të mëdha midis partive revizioniste. Nga njëra anë kanë dalë Partia Komuniste Franceze, ajo e Italisë dhe e Spanjës, nga ana tjetër janë renditur parti të tjera që vijnë rreth e rrotull sovjetikëve. Parti të tilla si ajo e Francës, nuk u kursyen të ruajnë as formën, as maskën, po dolën hapur me pikëpamjet e tyre antimarksiste. Kështu, në kongresin e saj të fundit<sup>1</sup>, Partia Komuniste Franceze deklaroi se sot nuk ka më proletariat, nuk ka më nevojë për diktaturë të proletariatit, se ajo është e gatshme

---

1. Është fjala për Kongresin e 22-të të kësaj partie që shënoi shndërrimin e plotë e përfundimtar të saj në një parti të tipit socialdemokrat, kalimin e saj zyrtar në shërbim të borgjezisë.

për të shkuar në socializëm me të gjithë, pa asnje dallim klasor.

Revisionistët francezë pohuan se janë të gatshëm të shkojnë në socializëm me këdo, me partinë socialiste, me radikalët, me parti të reaksionit, me oficerët, me të tërë, se të tërë pa dallim mund të ecin në këtë rrugë, por vetëm duhet vullnet. Kundër këtyre pikëpamjeve armiqësore antimarksiste ne botuam një artikull në «Zërin e popullit»<sup>1</sup>. Kjo dalje kaq hapur e francezëve, natyrisht, i revoltoi shumë revisionistët sovjetikë, sepse i demaskoi akoma më tepër.

Megjithatë sot revisionistët francezë nuk po bëjnë asgjë më shumë nga sa kanë bërë deri tash sovjetikët. Në fakt këta e shkatërruan diktaturën e proletariatit dhe e kthyen Bashkimin Sovjetik në socialimperializëm. Dhe Marsheja po fillon atje ku kanë arritur sovjetikët: revisionistët francezë nuk janë për diktaturën e proletariatit, por dëshirojnë të shkojnë në socializëm me të gjithë. Kështu kanë deklaruar edhe revisionistët italianë, edhe ata spanjollë. Karriljoja sekretari i përgjithshëm i partisë revolucioniste spanjolle, pohon se anëtarët e partisë së tij nuk kanë qenë kundër Huan Karlosit. Vetëkuptohet që ky pohim do të thotë se të dyja palët janë një.

Të gjithë revisionistët në botë po përpiken t'ia lehtësojnë kapitalizmit krizën e rëndë politike dhe ekonomike që e ka karbosur. I tërë ky aktivitet i tyre është në dëm të proletariatit. Po përsëritet kështu, por në

---

1. «Një kongres socialdemokrat i revisionistëve francezë». Shih: «Zëri i popullit», nr. 44 (8587), 21 shkurt 1976.

forma dhe në situata të tjera, lufta që ka bërë Marksit në kohën e vet kundër Prudonit e gjithë armiqve të proletariatit dhe më vonë Lenini kundër Kautskit, Bernshtajnit dhe tradhtarëve të tjerë.

Duke u bazuar në këto analiza, Partia jonë përpinqet që vijën e saj t'ia përshtatë situatës, duke shikuar çdo gjë në prizmin klasor në bazë të teorisë së Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Vija e Partisë sonë ka aprovimin e mbarë popullit shqiptar, të klasës punëtore, të fshatarësisë, të inteligjencies, por ajo ka, gjithashtu, aprovimin e mbështetet me forcë nga marksistë-leninistët, nga proletariati botëror, nga partitë marksiste-leniniste. Vështirësitë që këto parti kanë përpjekje, do të kalohen me siguri në sheshin e luftës klasore dhe me përpjekje. Lëvizja revolucionare në botë do të rritet, proletariati do të kalitet nëpërmjet luftës dhe punës së dendur ideologjike dhe politike, që do të bëhet nën udhëheqjen e partive komuniste marksiste-leniniste të vërteta.

Në këto situata na vihet detyrë që të jemi kurdoherë të vendosur dhe të marrim me kohë masa pér të forcuar mbrojtjen e vendit, të realizojmë detyrat që kemi në ekonomi, të përmirësojmë jetesën e popullit.

Vendimi i fundit i Komitetit Qendror të Partisë mbi shkurtimin e pagave të larta, mbi disa përmirësimë të tjera në sistemin e pagave të punonjësve dhe mbi ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve midis fshatit dhe qytetit ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe në çdo situatë pér vendin tonë. Por tash, kur në botë ekziston një gjendje e rëndë me kriza ekonomike, me

ngritje të vazhdueshme çmimesh, me papunësi etj., masat që mori Partia nëpërmjet këtij vendimi marrin një rëndësi të madhe të veçantë edhe në fushën ndër-kombëtare. Të tilla masa nuk mund të merren në asnje vend tjetër të botës, ku midis rrogave më të ulëta dhe atyre të lartave ka diferenca jashtëzakonisht të mëdha. Kurse te ne diferencat midis rrogave të ulëta dhe atyre të larta janë shumë të vogla dhe përsëri synojmë t'i ngushtojmë akoma.

Përveç këtyre janë marrë masa të tjera të shumta në dobi të fshatarësisë, që bëjnë pjesë në politikën që ndjek Partia jonë për ngushtimin e dallimeve midis fshatit dhe qytetit.

Këto masa do ta forcojnë akoma më tepër pozitën e vendit tonë jashtë, të huajt do të habiten dhe kanë pse të habiten. Gjetkë është një me njëzet përpjesëtimi i rrogave, kurse te ne një me dy. Pra, as që mund ta imagjinojë një njeri jashtë një masë të tillë dhe në një kohë kur çmimet te ne nuk lëvizin e jepen edhe gjithifarë ndihmash të tjera.

Vendimi i Komitetit Qendror të Partisë duhet shpjeguar mirë në masat tona punonjëse. Ne jemi të bindur se edhe ata, të cilëve do t'u ulet rroga, do ta presin mirë këtë masë të Partisë dhe do ta kuptojnë drejt, sepse asgjë nuk do të ndryshojë në nivelin e tyre të jetesës. Pavarësisht nga ulja e pagës të disa kategorive punonjësish, çmimet te ne mbeten njësoj. Vendimi, pra, duhet të bëhet nxitje që të prodhojmë më tepër, pse rritja e prodhimit bujqësor e industrial do të sigurojë më mirë stabilizimin e çmimeve. Ky duhet të jetë synimi ynë kryesor imediat në koniunk-

turat aktuale, që te ne të mos ketë kurrë lëvizje në çmimet, siç ka në botën kapitalisto-revizoniste. Në Jugosllavi, për shembull, ato janë rritur vazhdimisht nga koha në kohë, kurse te nc qëndrojnë njësoj. Kështu do të jetë edhe në të ardhmen. Megjithatë, në rast se do të bëjmë plane kurajoze dhe do t'i realizojmë e do t'i tejkalojmë ato, dhe për këtë i kemi të gjitha mundësitë, mund të vijë një kohë që punonjësve tanë t'u bëhen favore më tepër si me uljen e çmimeve, ashtu edhe me masa të tjera.

Mos kujtoni se plani ynë do të jetë i ulët meqenëse Kina për pesëvjeçarin e ri nuk na dha ndihmën e parashikuar. Jo! Partia, Qeveria dhe populli ynë kurdoherë kanë ecur me ekonomi, prandaj me forcat tona do të bëjmë investime shumë të rëndësishme edhe gjatë pesëvjeçarit të ri.

Kombinati Metalurgjik, që po ndërtojmë në Elbasan, do të prodhojë shumë materiale të kushtueshme, që nuk i gjen dot lehtë në tregun botëror. Tash, ja, giza jonë e parë u derdh në Kombinatin Metalurgjik në Elbasan. Furrat filluan të prodhojnë gizë të cilësisë së mirë. Në muajin maj do të dalë, gjithashtu, çeliku ynë i parë, kurse në korrik të gjitha bateritë e koksit do të fillojnë të funksionojnë. Kështu do të na krijohen mundësi të ngremë fabrika të reja, siç është ajo e hekur-nikelit që po ndërtohet me sukses. Në të ardhmen do të forcoheni edhe më shuinë nga ana ekonomike. Tani që nuk nxjerrim akoma prodhimet tona metalurgjike, harxhojmë shumë devizë, por së shpejti të tilla shpenzime nuk do t'i bëjnië, sepse do të prodhojmë vetë çelik, nikkel dhe kobalt. Atëherë ku do të venë fondet që do të

kursejmë prej tyre? Në përmirësimin e jetës së popullit tonë dhe në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë.

Për t'i dhënë fund bisedës, dëshiroj t'ju them se ne kemi mundësi të mëdha për të ecur gjithnjë përpara, vetëm duhet të administrojmë me nikoqirllék të madh çdo gjë. Po të shikojmë me një sy më të kujdesshëm vetëm investimet që bëjmë për ndërtimet, do të na dalë sa shpenzime të kota e të paparashikuara bëhen, sa gjëra të tjera lihen pas dore dhe prishen. Po pse ndodh kjo? Në qoftë se do të bëjmë të ndërgjegjshëm çdo njeri, për këtë perspektivë kaq të ndritur që hapet përpara vendit tonë në një kohë kur tërë bota nxin, ne do të bëjmë përparime edhe më të mëdha se deri tash. Prandaj t'i vëmë rëndësi edhe gjësë më të vogël.

S'ka top që të na luajë ne në rrugën tonë. Armiqtë, para se të veprojnë kundër vendit tonë, duhet të mendojnë thellë. Ne jemi të vendosur të jetojmë të lirë e të pavarur dhe për këtë tash i kemi edhe kushtet, se kemi një situatë të brendshme të shëndoshë, kemi, mbi të gjitha, një Parti të fortë që udhëhiqet pa lëkundje nga teoria marksiste-leniniste, kemi përkrahjen e madhe të proletariatit ndërkombëtar, si dhe miqësinë me vendet që ia duan të mirën Shqipërisë.

Prandaj, shokë, duke ju falenderuar për vëmendjen e treguar, ju uroj për sukseset që keni shënuar, por kini parasysh që këto të mos ju dehin, as mos i konsideroni sikur janë maja më e lartë që keni arritur. Jo, ato s'janë kulmi, prandaj të punojmë, pa u lodhur, për të ecur gjithnjë më përpara.

Edhe një herë, në emër të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Këshillit të Ministrave, ju për-

shëndes dhe ju ftoj t'i përvisheni punës për të kryer me ndër planet që do të vendosim dhe në nëntor të vini në Kongres me sukseset e mëdha që do të keni arri-  
tur gjatë këtij viti të parë të planit të gjashtë pesëvjeçar.

Të rrojë Partia!

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtim, në librin:  
Enver Hoxha, "Raporte e  
fjalime 1976-1977", f. 60*

*Botohet i plotë sipas shënime-  
ve të mbajtura në këtë takim  
që gjenden në AQP*

# KAOS NË KINË

Shënimë

9 prill 1976

Këto ditë ngjarjet në Kinë kanë marrë zhvillime të rrezikshme për vetë Kinën dhe popullin kinez. Më është dashur të merrem me ndjekjen e tyre, sepse me sa shoh, do të kenë pasoja shumë të rënda.

Që prej tre muajsh as në Kinë dhe as në vendet e tjera të botës nuk merr vesh njeri se ç'po ngjet në atë vend. Vazhdojnë rrëmuja dhe kaosi, aq shumë të dëshiruar nga vetë Mao Ce Duni, «timonieri i madh». Por, në fakt, Maoja asnjëherë nuk e ka drejtuar si duhet timonin e Kinës. Tash, që nga pleqëria atij i dridhen duart, në timonin e drejtimit të Kinës i kanë hedhur duart dy rrymat e kundërta, një e djathtë dhe një e majtë, një borgjeze dhe një «proletare» me ujë trëndafili, të cilat i ka krijuar, i ka rritur, i ka ujitur në parti vetë Maoja sipas teorisë së tij të «ekzistencës» së dy rrymave në parti. Pra, është sfala për dy rryma të pranuara dhe të lejuara me plot ndërgjegje sipas «marksizmit» maoist nga vetë kryetari Mao. Jo vetëm kaq, këto dy rryma, natyrisht, ndahen edhe në nënrryма, që i bien «zurnasë» sipas pikëpamjeve të ngu-

shta të krerëve të tyre. Ja, këto rrryma e nënrrryma u quajtën nga «poeti e timonieri i madh» «njëqind lule» kur nga «maja e Olimpit» dekretoi: «Le të lulëzojnë njëqind lulet». Kështu, ngulte këmbë «timonieri i madh», «revolucioni do të ecë përparrë»!

C'objektiv synonte të arrinte «timonieri i madh» Mao që zhvillonte dhe zbatonte një teori të tillë e që sa për formë e paraqiste si marksiste-leniniste, por që në të vërtetë ishte krejt në kundërshtim me marksizëm-leninizmin? Qëllimi ishte të zbatonte teorinë e tij të ekzistencës së dy vijave në parti, të kujdesej «të ujiste lulet e mira», sa të mëkëmbeshin pak pa harruar që njëkohësisht «të ujiste» edhe lulet e këqija. Veç këto të fundit gjenin edhe vetë fushë të lirë dhe rriteshin derisa mbulonin «lulet e mira» e ua zhduknin edhe aromëen. Atëherë ndërhynte «timonieri i madh» dhe i dozonte «erërat», bënte nga një «revolucion të madh kulturor proletar» dhe dilte i kënaqur, sepse pas kësaj, sipas tij, çdo gjë ecte në normat e «revolucionit». Ç'katastrofë, ç'gjenjeshtër, ç'idealizëm (nën pretekstin e luftës kundër idealizmit), ç'megalomani hyjnore e «timonierit të madh» që rregullonte çdo gjë (duke u hequr si njeri i thjeshtë), ç'liberal dhe ç'oportunist (duke u hequr si revolucionar marksist-leninist)! E gjithë kjo punë ishte një blof i madh, i fryrë, si nga brenda, ashtu edhe nga jashtë si një «mit revolucionar», pse, si të brendshmëve, ashtu edhe të jashtëmve, kjo u interesonte. Me sjalë të tjera, ky zhvillim në këtë rrugë u interesonte, si «marksistëve», që rriteshin sipas teorisë së «timonierit të madh», ashtu edhe reaksionit, i cili vepronë, forcohej, fuste në duart e veta shtetin, par-

tinë, ekonominë, ushtrinë. Duke u fshetur këta nën parullat e nën flamurin e «timonierit të madh», Maoja nuk humbiste asgjë, sepse, e para, një gjë e tillë e lejonte atë të vepronë lirisht dhe e dyta, sepse reaksionit «timonieri i madh» i shërbente si «dielli» që pëqte «frutat».

Kur «vinte vera», të djathtët nuk e duronin dot «vapën» e Maos dhe përpinqeshin të merrnin fuqinë hë-përhcë «pa gjakderdhje». Mao «timonieri», nga ana e tij, i jepte timonit një të rrotulluar për të futur në errësirë disa krerë, si Liu Shao Çinë, Pen Çenin, Ten Hsiao Pinin e bonzë të tjerë. Pastaj fuste në errësirë ata që më parë futën në errësirë të tjerët që përmenda më sipër, domethënë, likuidonte Lin Biaon, Çen Po Tanë e të tjerë. Kështu Maoja zhduku Lin Biaon dhe nxori në dritë përsëri «floririn e vogël», Ten Hsiao Pinin, i cili, për tre vjet me radhë u bë Çu En Lai i dytë në parti e në shtet, bile edhe në ushtri, kurse vetë «timonieri i madh», bënte «politikën e madhe», priste Kissingerët, Fordët, Niksonët, Markosët, në një kohë kur asnjëherë nuk deshi të priste ndonjë delegacion shqiptar të nivelit të lartë.

«Floriri i vogël», në emër të tij, domeithënë të Maos, dhe të Çu En Lait e të Liu Shao Çisë (të gjallë ose të vdekur), punonte me këmbëngulje, konsolidohet, rehabilitohet, rehabilitonte shokët e vet dhe i vinte në poste kyç. Teni punoi intensivisht në këtë drejtim për tre vjet e gjysmë dhe i duheshin edhe disa kohë që të ngulitej mirë, por Çu En Lai vdiq!. Me vdekjen

---

1. Çu En Lai vdiq më 8 janar 1976.

e Çusë, filloi «loja revolucionare» midis dy rrymave. Ten Hsiao Pini, që ka në dorë çdo gjë, ka ngulur këmbë dhe nuk lëviz, ndërsa shtypin dhe mjetet e propagandës i kanë në dorë ata që quhen «radikalë». Në këtë gjendje e raport forcash «timonieri» hesht, bën sehir, thotë nga një fjalë dhe sodit përleshjen.

As Liu Shao Çia, as Çu En Lai, as Ten Hsiao Pini nuk e donin Maon dhe as i aprovonin mënyrat e drejtimit të tij. Këta e «respektonin» Maon vetëm se ishte krijuar një «mit» për të, dhe përgatitjet për të marrë pushtetin në Kinë i fshihnin me flamurin e tij. Disa nga këta, në momente të caktuara, gjykuani se duhej vepruar më energjikisht, jo se nuk e analizuan mirë gjendjen, por synuan, para kohe, të rrëzonin «kokën», Maon. Por ky, për këtë çështje, ishte tepër vigjilent dhe njëkohësisht i bindur se kulti i madh i tij do të rrëzonte çdo revoltë. Dhe kështu ngjau, Liu Shao Çia dhe shokët e tij nuk shkuan deri në fund, kurse Maoja doli nga letargjia dhe ngriti studentët në «revolucion». Për këtë Maoja u mbështet te Lin Biaoja, te Çen Po Taja e Çian Çini. Ndërsa Çu En Lai u konservua për kohët që do të vinin. Maoja e mbrojti Çunë, sepse kishte nevojë për të dhe ishte oportunist si ai vëtë. Shokët e vjetër të tij, si Liu, Teni e të tjera e pranuan këtë kthesë të Çusë, i cili i forcoi pozitat dhe u bë personi i tretë pas Maos. Duhej likuiduar i dyti, Lin Biaoja, i cili ishte me Revolucionin Kulturor dhe armik i betuar i Liut, Tenit, Çusë. Çuja ia arriti qëllimit. Lin Biaoja gjoja u arratis për në Bashkinin Sovjetik, por avioni me të cilin iku u rrëzua në Mongoli. Kjo ndodhi në një kohë kur Maoja dhe Çuja përgatitnin miqë-

sinë spektakulare me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kështu «agjenti i sovjetikëve» Lin Biao «u dogj me avion në Mongoli», kurse Çuja triumfoi e u bë i dytë në udhëheqjen kineze.

Çuja punoi për t'i zënë vendin Maos (kur të vdiste dhe shpresonte që ai të vdiste shpejt, pse ishte plak), por, për fatin e tij të keq, vdiq vetë më përpara, pa e realizuar planin. Sidoqoftë, Çuja nuk ndenji me duar lidhur dhe, si revisionist e mandarin pragmatist që ishte, në të njëjtën kohë përgatiste edhe Ten Hsiao Pinin që ta plotësonte amanetin e tij.

Teni, që e njihte fuqinë e vet dhe dinte se nga do të anonte reaksiuni kinez, arriti në përfundimin se ai duhej ta zëvendësonë të vdekurin, domethënë Çu En Lain. Për t'ia arritur kësaj, për Tenin kishte dy rrugë: ose të bënte si Çu En Lai, domethënë «të bënte të bindurin», ose të ngulte këmbë në rrugën që kishte filluar. Por Teni jo vetëm nuk kishte «as prestigjin», as zotësinë e Çu En Lait, por edhe «marksistët» e rinj, ala Mao, ngritën krye duke thënë «E duruam Çu En Lain, por nuk mund ta durojmë edhe këlyshin e tij», prandaj zgjodhi rrugën e dytë, atë të puçit.

Në këto situata e në këtë zhvillim të ngjarjeve filloj «fushata» dhe «rrëmuja». Rrëmujë e lëkundshme, sepse reaksiuni revisionist üshtë i vendosur, por edhe «të majlët», duke mos qenë të sigurt në ngritjen në këmbë të masave, përpiken të bindin të pabindurit, pa bërë një «Revolucion të dyti Kulturor».

Në Revolucionin e parë Kulturor ushtria u radhit me Maon dhe me Lin Biaon. Po tash a do të radhitet ajo vallë me Maon e me Çian Çinin? Kuadrot e Liut, të

Lin Biaos, të Çusë e të Ten Hsiao Pinit në ushtri, a do të zbatojnë përsëri urdhrin e Maos, ashtu siç bënë në Revolucionin e parë Kulturor? Kjo pyetje bëri që të hezitonin si kryetari Mao, ashtu edhe pasuesit e tij.

Maoja bëri përsëri pyetjen «kush do të fitojë?».

Djathhtistët u hodhën në sulm, por, duke u mbësh-tetur në flamurin e Çu En Lait dhe jo në atë të Maos. Pra, tash u bënë dy flamurë, ai i Maos dhe ai i Çusë. Ditën e të rënëve, më 4 a 5 prill të këtij viti, me dhjetëra e dhjetëra mijëra veta, shkuan në sheshin «Tien An Men» dhe vendosën kurora te monumenti i të rënëve vetëm për Çu En Lain. Siç thoshin agjencitë e laj-meve, ishte fjala' për mijëra kurora, disa prej të cilave shumë të mëdha; pati edhe banderola nga pesë metra të gjata, si dhe parulla, në të cilat shkruhej «Ngreu Çu se të kërkon populli dhc ushtria, që të mbrosh kushtetutën». Por, në darkë, natën, të gjitha kurorat e parullat u zhdukën dhe populli filloi përleshjen me «mbrojtësit e rendit». U sulmua pallati i Asamblesë, u dogjën disa makina, u plagosën e u vranë mijëra veta.

Komiteti i Partisë i Pekinit i cilësoi këto ngjarje «veprime të reaksionarëve».

Ato mund të ishin të tilla, por ku dihet? Demons-truesit dogjën në fakt edhe një shtëpi, ku ishin vënë kurorat e hequra nga sheshi «Tien An Men».

Pas kësaj «rrëmuje», siç njoftojnë buletinet e laj-meve, «në shesh ra qetësia». Parqet rrëth pallatit të Asamblesë u mbushën me ushtarë të veshur civilë e të armatosur me shkopinj.

Pardje lexova tekstet e dy komunikatave të plenumit të KQ të PK të Kinës, transmetuar nga agjencia

HSINHUA. E para, siç kam shkruar<sup>1</sup>, njoftonte se me propozimin e vetë kryetarit Mao Ce Dun, Hua Kuo Feni emërohet nga Byroja Politike zëvendëskryetar i parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe kryetar i Këshillit të Shtetit të Republikës Populllore të Kinës.

Komunikata e dytë njoftonte se me propozimin e Maos Byroja Politike shkarkon Ten Hsiao Pinin nga të gjitha funksionet brenda e jashtë partisë, «por duke e lënë anëtar partie...» që «të ndreqet»!

Teni, pra, u hoq. Por është vetëm ai apo ka dhe shokë? Është fjala për «revolucion të madh kulturor proletar» me gjak apo pa gjak? Të shohim.

Li Hsien Nieni doli në pjacë tok me komunikatat e plenumit. Tash ai qëndron në postin që kishte e si ishtë dhe filloi nga pritjet zyrtare. Edhe njerëzit e Çu En Lait qëndrojnë në vendet ku ishin. Atëherë kush është ky «buçko» Hua Kuo Feni? Shkurtimi shët: Huaja ka qenë kritikuar në kohën e Revolucionit Kulturor, kurse Çu En Lai e bëri ministër të Brendshëm. Merrët me mend, pra, që ai është një nga heronjtë e «dramës» së Lin Biaos. Pra, ky Hua Kuo Fen qëndron në dy karrige.

Ndërkohë vazhdon «dozazhi» i alkimistit të madh, vazhdojnë dy vijat në parti, në një dorë shkopin, në dorën tjeter karotën, edhe «radikalët» (që s'janë radikalë) morën një satisfaksion, edhe të djathët, përveç Tenit, nuk humbën gjë.

Në Kinë do të vijnë kohë të reja, me ose pa «ti-

1. Në ditar.

monierin». «Radikalët» fituan pa bërë «revolucion», të djathët «me revolucion» humbën një udhëheqës, Çu En Lain.

Në efirin e Kinës, me vullnetin e Maos lindi një «yil i ri». Të shohim ç'dritë do të hedhë ai: të kuqe, të verdhë, apo të bardhë? Sidoqoftë, «jeshilja», që hap rrugët për të dyja vijat, «për njëqind lulet», do të vazhdojë. Ky është mësimi teorik i «timonierit të madh».

Sot ambasada jonë në Pekin na njoftoi se, sipas të thënave, në përlleshjet që u bënë në sheshin «Tien An Men», pati shumë të vrarë. Qindra veta, me orë të tëra fshinin me fshesë, lanin dhe pastronin me pompa uji njollat e gjakut.

Bagara<sup>1</sup>, pra, për të cilën shkrova, ka qenë e fortë dhe e përgatitur mirë, pse njëqind mijë veta nuk mblidhen në mënyrë spontane dhe, me thika e me satëre nuk shkohet për përkujtimin e të rënëve. Edhe «radikalët» i janë trembur kësaj gjëje.

«Timonieri i madh» zgjodhi rrugën e mesme: Tenin e mbajti në parti, Li Hsien Nienin, krahun e djathtë e më reaksionar të Çu En Lait, e nxori në dritë, e la në postin që kishte, në funksione të larta, kurse një milion e shtatëqind mijë demonstrues në Shanghai dolën rrugëve duke thirrur «Të varet Teni!», «Varni Ten Hsiao Pinin!».

C'mbjell, o Mao ziu, atë do të korrësh! S'mund të marrësh grurë nga urthi. Maoja deklaron se borgjezia është në parti. Por nuk thotë që ajo është në

---

1. Nga frëngjishtja — përlleshje.

parti se e ka lënë dhe po e lë vetë ai. Bile, jo vetëm e lë të gjallë si klasë, por lë të sundojë fryshtë e saj. Kënaqu, o Mao, që «të thurin lëvdata», por populli kinez do të vuajë për çka po bën ti.

*Botohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# **ORGANIZIMI I PUNËS — NJË NGA ARMËT MË TË FUQISHME PËR ZBATIMIN E DIREKTIVAVE TË PARTISË**

*Nga biseda me shoqen Lenka Çuko<sup>1</sup>*

**17 prill 1976**

*Shoqja Lenka Çuko, nëpërmjet shokut Hysni Kapo kishte kërkuar një takim me shokun Enver Hoxha. Porsa mori dijeni, shoku Enver e priti menjëherë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë se erdhe, shoqja Lenkë! Si jeni andej nga Lushnja? Po ti vetë, si je me shëndet?

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Faleminderit, mirë. Ju si jeni, shoku Enver?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë mirë janë, se pu shova ca. Ke bërë mirë që erdhe. Kështu të bësh nga hera kur vjen në Tiranë. Po të kesh ndonjë problem për të shtruar apo vërejtje për të bërë, eja të bisedojmë.

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Në përgjithësi punët na shkojnë mirë. Krahas punëve që po kryejmë në frontin

---

1. Në atë kohë sekretare e parë e Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës.

e bujqësisë kemi edhe një ngjarje të gjëzueshme, për të cilën besoj se ju kanë vënë në dijeni. E kam fjalën për pusin e ri që dha shenja naftë.

*Pastaj shoqja Lenka Çuko informon rreth të dhënavë të grumbulluara nga sektori i kërkimeve të naftës për pusin në fjalë dhe për puset e tjera të zonës.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Komunistët që kanë ardhur nga rrethet e tjera në këto puse, e kanë sjellë lidhjen?

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Po, e kanë sjellë dhe kanë ardhur nga Saranda e nga Vlora.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sa kohë kanë ata në këto puse?

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Kanë një muaj e gjysmë. Tani duhet të tregojmë shumë kujdes që të mos nambulojë euforia, për shkak se doli gazi, dhe njëkohësisht të rritim edhe vigjilencën.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Drejt e keni, se kemi vuajtur nga kjo dobësi.

Nuk është hera e parë që puset për të cilat solët ju, jepin naftë, sepse ajo zonë është naftëmbajtëse, por zbulimin e vendburimeve të naftës na e kanë sabotuar armiqëtë. Ti e ke parasysh se zona që përfshihet nga Lushnja dhe që kalon nga Karbunara deri në Vlorë, e më tej, është e tëra fushë naftëmbajtëse. Specialistët sovjetikë kanë pasur prirjen ta kufizonin dhe ta ngshtonin shumë nxjerrjen e naftës në vendin tonë. Kjo prirje e tyre u duk pas vdekjes së Stalinit, kur specialistët sovjetikë që u dërguan në vendin tonë kishin marrë direktiva nga revizionistët të na jepnin pikashpimi vetëm për aq naftë sa do të kishim ne mundësi

të zhvillonim industrinë në Shqipëri. Këto m'i kanë thënë vetë Hrushovi e Mikojani<sup>1</sup>. Këta kishin menduar që Shqipëria të kënaqeje me një sasi të vogël nafte. Në u kërkonim traktorë sovjetikëve, ata na dhanë disa, por jo sa kërkonim ne. Këtë politikë bënин revizionistët edhe për naftën tonë, me qëllim që të na kishin në dorë nga ana ekonomike.

Po çfarë bënин ata te ne? Shkuan, për shembull, në atë zonë që përmenda pak më parë, bënë kërkime atje, por në momentin kur marrëdhëni tona me ta u acaruan, na luanë se «Kjo fushë u konturua, po naftë nuk ka». Kështu na sabotuan duke u përpjekur të na bindnin se fusha gjoja kishte shteruar. Në këtë drejtim ata zhvilluan disa «teori». Një ndër këto ishte dhe «teoria e konturimit». Nga ana e tyre u ndalua studimi i fushave të tjera. Në mënyrë indirekte ata nënvylerësuan dhe mënjanuan të dhënat shkencore, që nuk i shënonin me qëllim për të na i fshetur neve. Kështu u krijuai një frysë pesimizmi tek inxhinierët dhe gjeologët e naftës, që i neglizonin të gjitha këto çështje. Kur, si rezultat i kësaj gjendjeje, atje ishte krijuar amullia, sabotatorët ndërhynë dhe dëmtuan.

Ti mund t'i thérresëh inxhinierët e gjeologët e naftës dhe t'u thuash se dëshiron të dish se sa puse janë hapur, në ç'zonë janë hapur, kur janë hapur dhe kur janë mbyllur, me sa filloj debiti, sa dhanë dhe sa kohë vazhduan? Këto të dhëna duken të thjeshta, por nëpërmjet tyre kuptohet nëse i kanë ato apo nuk i

---

1. Shih: Enver Hoxha, «Hrushovianët» — Kujtime, botim i dytë, Tiranë, 1982, f. 62-63, 68-69, 72-76.

kanë, janë nxjerrë prej tyre konkluzione apo jo? Në qoftë se të përgjigjen, për shembull, që për këto probleme «nuk dimë ne, por Institut i Naftës», atyre u duhet thënë: «Po pse, nuk është kjo një punë e përbashkët juaja dhe e institutit? Kur i keni paraqitur këto të dhëna, keni vajtur të diskutooni pse shteroi ky pus dhe pse nuk mund të shikohet më tutje?» etj., etj.

Këto pyetje u duhen bërë inxhinierëve e gjeologëve, që të janë vigjilentë në zbulimin e fushave naftëmbajtëse. Ata mund të thonë se fusha ku kërkohet nafta është e re, por nuk është kështu, për arsyen se ne kemi hapur puse nga e majta dhe nga e djathta. Katalizmat e mëdha, që janë vërtetuar gjatë epokave gjeologjike në globin tokësor, nuk mund të janë zhvilluar ashtu siç predikonin specialistët revisionistë sovjetikë. Disa specialistë sovjetikë, që i dinë këto probleme, përpinqen të gënjejnë, duke krijuar të çara të thella në pikëpamjet teorike për shembjet e mëdha në pjesët e ndryshme të globit. Këto «teori», sipas të cilave «në qoftë se gjejni një fushë këtu, kjo do të thotë që kemi fushë të re më tutje», nuk janë të drejta. Zona e Lushnjës, bile dhe lërë Shqipëria janë një pikë në oqeanin botëror. Kur u formua nafta, përmbyset kanë ndodhur në sipërsaqe të mëdha, kështu që fusha naftëmbajtëse nund të jetë e gjerë dy mijë, tre mijë e deri në gjashtë mijë metra. Pra, kjo do të thotë që ka shtresa të mëdha naftë.

Tani le të vijmë te Kolonja. Kjo nuk mund të quhet fushë tjetër se na ka dhënë disa shtresa që korespondojnë me fushat sqinje, por ne, për të gjelur

gëlqerorët, kemi shkuar më thellë se zakonisht, për arsyen se në gëlqerorët gjendet naftë. Nafta ka veti që emigron, prandaj është futur në flishe, është futur në ranorë. Teoria më e fundit, e sigurt, është ajo sipas së cilës gëlqerorët në përgjithësi janë naftëmbajtës, por kryesor është fakti që nga gëlqerorët ka emigracion. Ne ndjekim gëlqerorët se parimi shqiptar atje duhet të ketë naftë në masive të mëdha, ku janë zbuluar mikroorganizmat, nga të cilët është formuar nafta. Thuhet, gjithashtu, se ka naftë edhe nën shtresat me kripë. Ne kemi shpuar, por edhe në këtë drejtim nuk kanë sabotuar.

Duke biseduar me inxhinierët dhe me gjeologët, duke marrë mendimin e tyre, ata duhen nxitur që çdo gjë ta bëjnë shkencërisht. Në radhë të parë, ata duhet t'u referohen të gjitha të dhënave që ekzistojnë përfushat naftëmbajtëse, duke studiuar regjimin e këtyre puseve që janë zbuluar këtu. Po ta kishin bërë këtë, ata do të flitnin më me siguri nëse kjo që doli në këtë ose atë zonë ishte kupolë gazi, shtresë gazi apo gaz e naftë. Konkluzioni i saktë do të arrihet po të njiheshin mirë situatat, sepse gazi ka vazhduar të dalë 10-15 ditë dhe pastaj ka dhënë naftë. Është një mënyrë veprimi që pusi mund të taposet, veçse me këtë metodë mund të bësh mirë, por mund të bësh edhe dëm. Në këto procese pune nuk duhet të humbasë durimi dhe asgjë të mos bëhet pa u mbështetur në të dhëna shkencore. Kur Maria e Pjer Kyri zbuluan radiumin, punuan katër vjet me radhë pa pushim në një garazh, duke u përpjekur natë e ditë me një këmbëngulje të jashtëzakonshme, me njete primitive, për

të përpunuar me qindra tonelata mineral, nga të cilat nxorën një decigram radium. Kështu duhet vepruar edhe me naftën, duke bërë me durim studimin e bazuar rreth e rrrotull e të vetë pusit, me qëllim që të mos humbasim edhe gazin e naftës, që është shumë i vlefshëm.

Në qoftë se herët e tjera nuk janë bërë studime shkencore, këto duhet të bëhen tanë. Prandaj të ruhen kampione, të bëhen studime, të mbahen shënimë të sakta rreth konstatimeve dhe të procedohet në mënyrë teknike. Një nga format e sabotimit që përdorën armiqjtë në industrinë e naftës ishte dhënia e pikave të shpimit të pastudiuarë. Edhe në qoftë se dihej nafta, ata ose i mbyllnin puset e hapura, ose i braktisnin kur dilte naftë. Përpunimi i pusit është shkencë më vete, se kërkon të bëhen studime që të dihet si përpunohet. Shokët inxhinierë e gjeologët nuk e dinë mirë përpunimin e këtyre shtresave, por kjo është një çështje me shumë rëndësi. Për këtë flet edhe rasti që u vërtetua atje te ju, kur thuhej që nuk ka naftë, por pasi punëtorët filluan përpunimin me guxim, arritëm të marrim naftë.

Në këto çështje, ka edhe nga ato me karakter teknik që, natyrisht, unë dhe ti nuk i dimë mirë. Edhe unë nuk kam ditur shumë gjëra, por kam mësuar nga shokët. Kështu do të mësosh edhe ti, shoqja Lenkë, prandaj bisedo me punëtorë e specialistë të naftës, u kërko atyre të të shpjegojnë si paraqitet situata, bëj edhe ndonjë debat me ta për t'i quar punët përpara. Ju, shokët e Partisë e të pushtetit në rrithin e Lushnjës, kini parasysh se fusha juaj është naftëmbajtëse,

është me perspektivë, kështu mendojnë të gjithë, bashkë me të tjerët edhe unë.

Intelixhens Servisi e bëri lord ambasadorin anglez në Shqipëri që gjeli një koncesion naftë për «Anglo-Persian Oil Kompani». Imperializmi anglez, «Anglo-Persian Oil Kompani» kishin koncesione nga të katër anët e botës. «Anglo-Persian Oil Kompani» kishte marrë koncesione nga Zogu për 99 vjet. Perandoria angleze e quante veten të pacenueshme në koncesionet që posedonte, por këtu në Shqipëri nuk e bëri dot tokën të sajën, se u bë Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe luftëtarët, tanë nuk i lanë ata të bënin si të donin me atdheun tonë. Anglezët kanë vajtur në Gregi dhe atje po shpojnë për të gjetur naftë, zona e së cilës shtrihet në jug të Sarandës. Këto të dhëna për vendburimet e naftës, në bazë të të dhënave të tokës, ata i gjejnë edhe me ndihmën e satelitëve artificialë dhe me mjete të tjera.

Gjeologjia shqiptare, formacionet e tokës sonë, nuk mund të jenë të kundërtë me Alpet Dinarike dhe me ato të Gregisë. Shqipëria është një copë e vogël toke si të tjera, pra, duhet të jetë vazhdim i tyre. Po kështu kemi zonën nga malet e Uralit në Bashkimin Sovjetik deri në Arabinë Saudite. Kështu janë përbërja, ndërtimi dhe historia e tokës që studion shkenca e gjeologjisë. Prandaj duhet të vëmë rregull për të realizuar të gjitha ato kërkesa që përmendëm në drejtim të naftës.

Në krye të Ministrisë së Industrisë dhe të Minerave është shoku Pali Miska, një shok i mirë e i shkakthët, por, që të kemi suksese, duhet të punojmë të tërë

me kujdes, të mbajinë parasysh të gjitha detyrat që të mos na ndodhë asnjë avari.

Zbulimi i naftës në vendin tonë, përvceç rëndësisë ekonomike, ka rëndësi të madhe politike, për arsyet se: Së pari, vërteton pikëpamjen e drejtë të Partisë që vendi ynë është naftëmbajtës. Së dyti, hedh poshtë tezën e sabotatorëve që në Shqipëri gjoja s'ka naftë. Këta armiq, që, sikundër kanë pohuar vetë, na kanë sabotuar, Partia dhe klasa punëtore i zbuluan. Por ata nuk na thonë asgjë se ku ka naftë. Së treti, inkurajon naftëtarët, inxhinierët, gjeologët, teknikët, të cilët, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se ky sabotim, për pesë vjet me radhë, i ka tronditur.

Situata e shëndoshë që u krijua në industrinë e naftës pas zbulimit të veprimtarisë armiqësore, është një fitore e madhe në të gjitha drejtimet. Gëzimi i kësaj fitoreje do të ndihet më tepër kur të na dalë naftë. Pas këtij suksesi ne do të shikojmë se çfarë forcë shpirtërore do të shpërthejë te punëtorët, teknikët dhe inxhinierët e naftës. Ne kemi besim se punëtorët dhe specialistët e naftës me punën e tyre vetëmohuese, do ta ndihmojnë Partinë, prandaj të mos kenë frikë kur marrin vendime për caktimin e pikave të shpimit. Edhe dështime mund të kemi, por këto nuk duhen përzier me dështimet që ishin pasojë e veprimtarisë sabotuese të armiqve. Dështimet në zbulimin e vendburimeve të reja të naftës duhet të shërbejnë si mësimë për ne dhe të largohet ndjenja e frikës nga ndonjë dështim, por shpimet të bëhen në bazë të studimeve. Kur është rasti, t'i thuhet Partisë me ballë hapur që -shpuan, por nuk gjotëm naftë- dhe kjo të mos i dekurajojë

njerëzit. Të shpojmë edhe herë tjetër. Natyrisht, nuk mund t'i biesh në kokë menjëherë vendburimit të naftës, por, po t'i studiosh me kujdes e t'i caktosh mirë pikat e shpimit, nafta do të gjendet.

Prandaj, shoqja Lenkë, punoni që të mobilizoni organizatën e Partisë në sektorin e naftës, që naftëtarët të jenë të guximshëm në përcaktimin e të dhënave shkencore konkrete. Këto të dhëna të evidencohen në rregull dhe kurdoherë të nxirren konkluzione shkencore prej tyre.

Shokët që punojnë në industrinë e naftës ta mësojnë dhe ta njohin mirë vijën e Partisë, ta kenë të qartë se shteti shqiptar i punëtorëve dhe i fshatarëve do naftë, se nafta është bukë. Kjo është vija dhe, që të zbatohet kjo vijë, lypset organizim, zbatim i përpiktë i shkencës. T'i mobilizojmë njerëzit, duke ua bërë të qarta të gjitha kërkesat nga ana politike, ideologjike, shkencore e teknike.

Në fushën e ekonomisë nuk del problemi vetëm i përgjegjësisë ideologjike e politike, por shtrohet edhe përgjegjësia shtetërore. Në qoftë se dikush nuk bën përpjekje që ta kuptojë drejt ideologjikisht dhe politikisht një problem, çështja e tij mund të shikohet nga Partia, por, kur shkelen ligjet e shtetit, jepet llogari deri para gjyqit. Shokët duhet t'i ndihmojmë në mënyrë të gjithanshme, veprimet e tyre duhen gjykuar gjithmonë drejt dhe me gjakftohtësi.

E përsëris, të mos harrojmë masat teknike. Ne presim që puna e filluar të mbarojë me sukses.

Ne kemi shpresë dhe jemi të bindur që do të dalë naftë.

Si shkoni me punët e tjera?

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Gjendja moralo-politike nü rrethin tonë është e shëndoshë. Letra që u dërguat ju, shoku Enver, kooperativistev të kooperativës bujqësore të Këmishtajt<sup>1</sup>, diskutimi i madh popullor i Projektkushtetutës dhe veçanërisht Vendimi i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave të RPSH për uljen e pagave të larta, për disa përmirësimë në sistemin e pagave të punonjësve dhe pëngushtimin e mëtejshëm të dallimeve midis fshalit e qytetit, kanë ngjallur hov të madh në punë. Komunisët, kuadrot dhe të gjithë punonjësit i kanë vlerësuar këto vendime, në radhë të parë, me syrin politik, si masa që Partia i merr me qëllim që të përmirësojë jetën e popullit në tërësi dhe në mënyrë të veçantë pëfshatarësinë punonjëse.

*Në vazhdim shoqja Lenka Çuko foli për punën e bërë lidhur me diskutimin e kuotave orientuese të projektpianit të pesëvjeçarit të ri përritjen e rendimenteve dhe për realizimin e planit të drithërave.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Lushnja duhet të zëro vendin e parë në Shqipëri për prodhimin e drithërave, se i ka të gjitha mundositë. Me punën që ka bërë Partia atje, ky rrethi ka lënë shumë prapa disa rrethe, të cilat 10-15 vjet përpara kanë qenë të përparruara.

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Ne e kemi një pjesë të mirë të tokave të kripura, acide e bazike. Përmirësimi i tyre është një çështje që na shqetëson. Po të kishte qenë në nivelin e duhur ndihma e Ministrisë së Buj-

---

1. Siuh: Enver Hoxha, Vepra, v. II, f. 351.

qësisë, mendoj se sot këto toka do t'i kishim më të mira.

*SHOKU ENVER HOXHA:* I trajtoni me plehra dhe me torfë tokat acide?

*SHOQJA LENKA ÇUKO:* Po.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Është sa duhet nën kontrollin e Partisë Institutit i Kërkimeve Bujqësore në Lushnjë?

*SHOQJA LENKA ÇUKO:* Ashtu sa duhet nuk është.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ai institut është në vartësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe interesohet për bujqësinë e gjithë vendit tonë. Si bazë eksperimentimi, pra, ai duhet të ketë jo vetëm parcelat e veta, por tërë tokat e rrethit të Lushnjës. Në qoftë se nuk eksperimenton në gjithë territorin e rrethit të Lushnjës, atëherë instituti nuk ka si të bëjë studime, bie fjala, për tokat e Gjirokastrës. Një farë e zgjedhur për tokat e Lushnjës duhet të rezistojë jo vetëm në parcelën eksperimentale, por në gjithë sipërfaqen e mbjellë të Shqipërisë.

Ti, shoqja Lenkë, i njeh mirë problemet e bujqësisë, prandaj të vesh jo vetëm në ato mbledhje të institutit ku paraqitet programi i përgjithshëm, por edhe kur diskutohet për programe pune e studimi të veçanta e të kërkosh nga komunistët e punonjësit e institutit se çfarë vendimesh kanë marrë, çfarë duhet të bëjnë akoma, ku përfshihen detyrat aktuale dhe të perspektivës, me kë kanë biseduar dhe q'masa të tjera do të marrin. Ti dhe shokët e tu, natyrisht, kërkoni llogari nga ana e Partisë, qoftë në mbledhjen e or-

ganizatës-bazë, qoftë jashtë saj, që instituti ta bëjë punën e tij me baza me të vërtetë shkencore.

Pesë kooperativat bujqësore të tipit të lartë në rrethin tuaj kanë bërë përparime të mëdha, ato i kanë kapërcyer edhe rezultalet ekonomike të ndërmarrjeve bujqësore. Këto kooperativa duhet të vazhdojnë të ecin përpara, por as ndërmarrjet bujqësore të mos qëndrojnë në vend. Edhe këto duhet t'i shtyjë përpara organizimi i mirë i punës. Ato e kanë për detyrë t'i kalojnë kooperativat bujqësore për sa u përket rezultateve në prodhime. Po mbeten në bisht këto ndërmarrje, nuk ecën mirë puna në bujqësi. Në këtë drejtim duhen marrë masa.

Së pari, meqenëse kooperativat bujqësore të tipit të lartë janë të mëdha, Partia duhet të jetë në krye të punëve për mbarëvajtjen e tyre, prandaj shumica e komunistëve të punojnë drejtpërdrejt në prodhim. Organizatat-bazë të Partisë në bujqësi dhe veçanërisht ato në kooperativat bujqësore të tipit të lartë duhet të zbatojnë të gjitha orientimet që ka caktuar Partia. Të gjithë kooperativistët të jenë luftëtarë të pararojës.

Së dyti, t'u mësohet të gjithë kooperativistëve agroteknika. Vit për vit, nga kurset që organizohen dhe nga eksperiencia e fituar në punën praktike, duhet të dalin punonjës me një nivel gjithnjë e më të lartë. Ashtu siç thashë për naftën, edhe në bujqësi duhet të mbahen shënimë, për çarsyc e bë kjo e ajo punë etj. Përgjegjësit e sektorëve të tregojnë kujdes që të pasqyrohen në dokumentacionin e kooperativave bujqësore rendimentet e larta, kur u morën dhe si u arrin ato, pse u bënë këto e ato shërbime etj. Mbi bazën

e rezultateve të arritura të zhvillohet debati në Parti, për të parë nëse janë bërë më parë këto, që po bëhen tani dhe të dilet me konkluzione. Kështu, shënimet statistikore nuk mbeten të vdekura, se mbi bazën e tyre jepet mundësia të arsyetohet; dalin edhe vërejtjet, edhe kritikat, shfaqen prirjet e mëdha revolucionare, ndershmëria, ndërgjegjja e pastër, sakrifica, por dhe përtacia, indiferentizmi e të tjera. Në këtë proces evidencohen të mirët, të përparuarit, bëhet edukimi i njerëzve dhe zhvillohen veprimtaria e iniciativa e tyre. Me të dhëna konkrete, me kritikë e autokritikë realizohet edhe edukimi revolucionar i njerëzve. Me këtë metodë pune do të ketë rezultate akoma më të mira, se kështu u mësohet agroteknika kooperativistëve.

Revolucionarizimi i njerëzve duhet parë sidomos gjatë punës, sepse ka njerëz që jashtë saj mund të sillen si revolucionarë, por në punë e sipër duken mirë që nuk janë gjithnjë të tillë.

Ti e di rëndësinë që ka organizimi i punës në zbatimin e direktivave të Partisë për edukimin e njerëzve, por duhet të kesh parasysh se në qoftë se kjo nuk mbahet gjithnjë në qendër të vëmendjes, ai që gaboi të ra në ujë dhe u mbyt. Si sekretare e parë e komitetit të Partisë në rreth, me bashkëpunëtorët e tutë merrni masat për organizimin e mirë të kësaj punc, duke iu shmangur rutinës. Çështja është që të përfishtohet nga eksperiencia, nga të dhënat e praktikës. Në qoftë se një organizim, për shembull, ka dhënë rezultate të mira, kurse tjetri nuk ka dhënë atë që prisnim, atëherë nuk duhet të ecim më me këtë lloj organizimi jo të mirë që na pengon në ecjen përpara. Çështjen

e organizimit të punës të gjithë shokët ta konsiderojnë një nga armët më të fuqishme për zbatimin e direktivave të Partisë.

Rëndësi ka edhe ana financiare, kontabile. Kjo është çështje e rëndësishme jo vetëm ekonomike, por edhe politike e ideologjike për jetën e kooperativave. Në të gjitha kooperativat bujqësore, veçanërisht në ato të tipit të lartë, kemi financiorë dhe ekonomistë. Këta kuadro nuk duhet të janë regjistrues, por ekonomistë me kuptimin e plotë të fjalës. Ata duhet të konsiderohen nga organizata-bazë e Partisë dhe nga kryesin e kooperativës së tipit të lartë si një nga faktorët kryesorë për administrimin e mirë monetar, përkoston, për harxhimin me nikogirillëk të të ardhurave. Nga regjimi i rreptë finansiar varet shumë përmirësimi i jetës së kooperativës dhe shtimi i të ardhurave kombëtare. Puna e këtyre njerëzve, sidomos tani, merr një rëndësi të veçantë.

Kur bëhet plani njëvjeçar ose pesëvjeçar i ndërmarrjes, i kooperativës etj., duhet të janë të pranishëm edhe ekonomisti, shefi i llogarisë, revizori e të tjera. Asgjë nuk mund të bëhet pa pyetur edhe këta, pa marrë edhe mendimin e tyre për caktimin e detyrave të planit, pa diskutuar së bashku me ta se do të punohen kaq toka, do të mbillen kaq rrënje ullinj, kaq pemë frutore etj. Ata do të bëjnë llogaritjet, se sa do të fitohet nga këto punë, sa kuintalë grurë do të merrin, sa do të arrijë numri i lopëve etj. Financieri i shënon të tëra projektet që i thuhen dhe, në fund, pasi bën përllogaritjet, ka të drejtë të thotë: «Unë, shokë, nuk jam dakord me këto që thuhen, se kështu prodhimi

dhe nivel i të ardhurave qëndron në vend. Puna e parë është që Republika Popullore e Shqipërisë të ketë më shumë grurë dhe masa e kooperativistëve tanë të marrin më shumë lckë për ditë-punë. Me këtë plan që mendohet, as republika, as kooperativistët nuk marrin më shumë nga ç'kanë marrë, prandaj lypset të shtojmë këto dhe ato prodhime». Pasi diskutohen çështjet me radhë dhe vendoset, zyra e llogarisë imban shënime për të tëra.

Diskutimet nuk duhet të bëhen shkel e shko. Shtrohet pyetja: «Çfarë pemësh do të mbjellim?». Diskush mendon të mbillen, bie fjala, qershi dhe argumenton mendimin e vet para shokëve, mirëpo një tjetër kundërshton, duke thënë se qershia jep fruta pas 10 vjetësh, kurse kooperativa ka nevojë t'i shtojë të ardhurat më shpejt, veç kësaj edhe toka është e kuqe, prandaj do të ishte më mirë të mbilleshin hardhi, që japid prodhim pas tre vjetësh. Kështu bien dakord. Financieri ka të drejtë t'i bëjë pyetje, për shembull, agronomit: «Pse nuk flet ti, shoku agronom, pse u bindesh qorrazi shokëve të kryesisë?». Si frenues i harkimit të kotojë të lekut, financieri nuk e pranon urdhrin e kryetarit që të japë kaq osc aq lekë për të blerë mëshqerra, pa u bërë mirë llogaritë paraprake. «Nuk të jap asgjë, se ky urdhër vjen në kundërshtim me vendimin e mbledljes së përgjithshme, ku isha dhe unë», t'i thotë ai kryetarit. «Sipas vendimit do të blejmë kaq dhe jo aq mëshqerra dhe do të marrim kaq qumësht» etj. Me shtimin e bagëtive do të shtohet doemos edhe plani i foragjereve, po kështu edhe të tjerat. Kur shikon se gruri, për shembull, po zverdhet nga

mungesa e shërbimeve dhe për këtë shkak, kryesia, nitratin e caktuar për ullinjtë, e disponon për grurin, ekonomisti kundërshton, duke thënë: «Të zbatohen detyrat sipas vendimit, sepse ulliri na jep vajin, prandaj nuk lejohet të përdoret për bimët e arave plehu i caktuar për ullirin! Për të gjitha këto janë bërë llogaritë të ndara në tabelat e veçanta për çdo sektor». Kur është rasti, ekonomisti i drejtohet organizatës-bazë të Partisë që të kontrollohet çështja dhe të mos lejohet të shkelet detyra e caktuar.

Financimi është çështje e rëndësishme ekonomike, është parim që nuk duron shkelje, prandaj ka persona e institucionë të ngarkuar posaçërisht për ruajtjen e një regjimi të reptë financiar, me qëllim që t'u vihet fre keqpërdorimive. Sikur t'i kërkosh para jashtë rregullave të vendosura, Banka e Shtetit nuk të jep rru-gë. Kur nuk ke kredi të celur pranë saj, ajo nuk të jep asnje santim. Kështu duhet të veprojë edhe ekonomisti i kooperativës, i cili evidencion personat përgjegjës për shpërdorimet e vërtetuara dhe këta vihen para përgjegjësisë. Kështu mund të veprohet në rastin që mora si shembull kur, plehun për ullirin, ia hedhin grurit.

Një çështje tjeter e njojur, që unë e theksoj nga eksperienca që ka Partia, është ajo që ti dhe sidomos sekretari i komitetit të Partisë, që merret me bujqësinë, duhet t'i vini në lëvizje të gjithë punonjësit e sektionit të bujqësisë pranë komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit. Kryetari i komitetit ekzekutiv duhet të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e bujqësisë. (Po flas më tepër për bujqësinë, sepse rrethi i

Lushnjës është bujqësor.) Në qoftë se ju keni atje, për shembull, njëzet specialistë, studioni si e organizojnë ata punën për të mobilizuar edhe punonjësit e tjerë në kryerjen e detyrave. Sado të aftë qofshin, me njëzet veta nuk mund të bëhen shumë gjëra në gjithë rrithin. Specialistët e bujqësisë janë përgjegjës për aq sa u takon, por për bujqësinë, në radhë të parë, kemi Partinë në krye të punëve, kemi kuadrot që punojnë në këtë sektor, në ndërmarrjet apo në kooperativat bujqësore.

Partia në rrith duhet të drejtojë dhe të mbikëqyrë si e organizojnë punën kuadrot e bujqësisë, si i japin këta udhëzimet për problemet ekonomike e të planifikimit, si i trajtojnë ato nga ana politike, si e organizojnë kontrollin e punimeve në kooperativë, si bëhet kontrolli i zbatimit të çdo shërbimi, si raportojnë ata për punën që bëjnë, si i shfrytëzojnë të dhënat statistikore për nxjerrjen e konkluzioneve të drejta etj. Duhet parë a diskutojnë shokët e seksionit të bujqësisë për metodat shkencore që duhen përdorur për shtimin e prodhimeve bujqësore dhe a nxjerrin ata konkluzione se cilat metoda janë përdorur dhe cilat nuk janë përdorur? Vijnë të përgatitur në mbledhjet për kooperativat bujqësore punonjësit e seksionit të bujqësisë për ato çështje që diskutohen apo flasin çka t'u vijë për mbarë? Kuadrot dhe specialistët në këto mbledhje duhet të marrin në shqyrtim një apo dy probleme kryesore e jo të gjitha çështjet njëherësh, pasi në kooperativat bujqësore ka edhe probleme anësore, dñe të gjykojnë se çfarë masa duhet të merren për zgjidhjen e problemit që diskutohet.

Kryetari i kooperativës duhet ta ketë situatën në dorë, të ketë autoritet dhe të gjëzojë respektin e shokëve, por ai, për veprimtarinë e tij duhet t'i japë llogari, në radhë të parë, Partisë. Kryetari dhe kuadrot janë punëtorë partie dhe si të tillë, të gjithë, me punë të vendosur, duhet të zbatojnë direktivat e Partisë e jo të marrin çantën në dorë dhe të venë vend e pa vend të shikojnë pambukun nga këndi i fushës sa për të thënë: «Vajtëm dhe pamë». Ata duhet të shkijnë atje ku ka të dhëna se nuk vete puna mirë, të venë t'i pyesin e të bisedojnë në vend me kooperativistët për shkaqet që pengojnë dhe përrugët e eliminimit të tyre. Pasi të përcaktohen bashkë me kooperativistët masat që do të merren, kryetari dhe kuadrot e tjerë të mbikëqyrin zbatimin e detyrave, duke vajtur prapë për këtë qëllim në arë. Në këto punë kërkohet organizim dhe të mos lejojmë anarki.

Masat punonjëse janë në lëvizje të përhershme revolucionare, ato janë të gatshme t'i mësojnë e t'i zbatojnë gjërat e mira. Duhet të kemi kurdoherë parasysh se pikërisht këto e bëjnë revolucionin. Udhëheqësit kanë një përgjegjësi të madhe për të luajtur rolin drejtues në organizimin e tyre. Hovin revolucionar të masave ta drejtojmë për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit, për ngritjen politike e ideologjike të tyre, prandaj kryesor për ne është rregulli revolucionar dhe jo anarkia mikroborgjeze. Duke luftuar kundër anarkisë, rrëmujës, punës për bujë dhe çrrëgullimeve, Partia në rreth duhet të shkundë komitetin ekzekutiv të këshillit popullor, që ai të jetë kurdoherë në ballë të punës.

Për sa u përket investimeve që jep shteti për bujqësinë, për industrinë, për banesat, për kooperativat bujqësore etj., këto duhet të bëhen me preventive të hartuara përpara se të fillojë vepra. Fjala preventiv vjen nga gjuha frëngje *prévoir*, që do të thotë — parashikoj, domethënë, në qoftë se investitori në bazë të llogarive ka dhënë pesë milionë lekë për të bërë me to 10 banesa, ndërtuesi ka përgjegjësi që të ndërtojë me këto para ato banesa që janë parashikuar. Se ku do të ndërtohen banesat, këtë do ta parashikojë komiteti ezekutiv, kurse vlerën e dhomave të parashikuara, të materialeve që nevojiten për t'i bërë këto dhoma si, bie fjala, gëlqere, tulla e të tjera, të gjitha këto do t'i përllogaritë financieri. Pastaj porosia e investorit do t'i jepet ndërmarrjes projektuese, së cilës i thuhet se si kërkohet banesa. Pasi të studiohet kjo çështje, atëherë të bëhet planifikimi dhe të shihet nûse llogaritë janë kryer në rregull. Mund të bëhet edhe ndonjë ndryshim me marrëveshje, si fjala vjen, shkallët të thjeshtohen mië tepër etj. Ndërmarrja e ndërtimit, pasi merr projektin, llogarit sa punëtorë e sa materiale duhen. Këto llogari bëhen me preventive.

Investitori e ka për detyrë të kontrollojë si zbatohet projekt, kurse ndërtuesi nuk ka të drejtë të shtojë asgjë mbi atë që është parashikuar. Po të shtojë ndërtuesi vlerën e punimeve, investitori nuk duhet ta pranojë aspak dhe për këtë qëndrim antiekonomik duhet t'i bëjë raport deri edhe Komitetit Qendror të Partisë dhe Qeverisë.

Kur të ndërtoni ndonjë vepër për ujitjen, i kërkoni inxhinierit që do të projektojë të caktohet gjecolo-

gjikisht vendi ku duhet ndërtuar, materialet që nevojiten, numrin e forcave të punës dhe koston e tërë veprës. Ti thuhet inxhinierit se «Ne nuk marrim përsipër asnjë lck të tepërt. Në qoftë se gjatë zbatimit del nevoja për më tepër të holla, atëherë, ti, shoku inxhinier, do të mbash përgjegjësi». Çdo gjë ta bëjmë me plan, me organizim, me kërkesë llogarie, se ndryshe nuk mund të ecet.

Zëri i Ministrisë së Bujqësisë a dëgjohet te ju, në Lushnjë?

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Është bërë gjithë ajo punë e mirë, por ata të ministrisë nuk janë dukur fare, të paktën për të parë sa për kuriozitet.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk kanë punuar mirë as ministri i Bujqësisë Pirro Dodbiba, as zëvendësministrat.

Ju kanë kërkuar ata mendim se çfarë makinerish ju duhen?

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Unë nuk di për një gjë të tillë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nuk i dini ju, por as të tjerët nuk dinë gjë. Sigurisht që makineritë ata i kanë, por i mbajnë pa shfrytëzuar. Pse rrinë kështu? Sepse, në qoftë se rrethi i Lushnjës ka kërkuar, ta zëmë, pesë makina bujqësore, ata «halal hesap», domethënëc në hava, i bëjnë dhjetë. Ju i keni marrë ato të dhjeta, por, meqenëse nuk ju duhen të gjitha, i keni lënë të rrinë kot.

Pirro Dodbiba pohoi në mbledhjen e Qeverisë se ai me shokë e kishin konsideruar Ministrinë e Bujqësisë si «këshilltare» (!). Këtë e ka pasë thënë vite më

parë, kur ishte ministër i Bujqësisë, edhe armiku Maço Çomo, i cili pretendonte të merrej vetëm me ndërmarrjet bujqësore e jo me kooperativat. Le të marrim si shembull ndërmarrjen bujqësore «29 Nëntori» të Lushnjës, e cila, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Bujqësisë, është e ndarë në 10 sektorë, që veprojnë secili me hozrashot të plotë. Çfarë është ky organizim? Ky organizim është me prirje decentralizuese, vetadministruese. Që nga Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi e deri te Fadil Paçrami, të gjithë kanë pohuar se kanë qenë me kohë armiq të Partisë dhe të direktivave të saj, armiq të socializmit. Këta ne i zbuluam dhe për veprimtarinë e tyre kriminale do të jasin llogari para gjyqit, por çështja është se duhet me qenë gjithmonë vigjilentë. Pikërisht këtu qëndron zotësia dhe mprehëtësia në ushtrimin e kontrollit të Partisë.

Tani mund të thirren nga ana juaj drejtori i ndërmarrjes bujqësore dhe kryetarët e kooperativave dhe t'u thuhet që sikur të mos ketë kaq hozrashote ç'bëhet, cilat prej tyre mund të heqim? Është e domosdoshme të kemi 9 apo 12 sektorë në ndërmarrje, apo mund të kemi vetëm tre-katër sektorë? Drejtori apo kuadrot e tjerë do të thonë mendimet e tyre për këtë çështje dhe ju, që e dini sa gjërsi ka Krutja, Kënnish-taj, Bubullima etj., pasi t'i dëgjoni, do t'u thoni atyre: «Po përse duhet të ketë 11 sektorë kjo kooperativë, kur ajo tjetra ka shunië më pak sektorë dhe punon mirë? Pse ju të keni gjithë köto favore për plehërimin e në drejtime të tjera?». Çështjen e kam që të kuptohet se lypset t'u bëhet një analizë e mirë këtyre fenomeneve.

Ju mund të vini për t'u konsultuar këtu, në Komitetin Qendror, për probleme të ndryshme. Ne kemi nevojë për këto takime për probleme me rëndësi, në radhë të parë me sekretarët e parë të komiteve të Partisë të rretheve. Shikojini gjërat që janë bërë me fryshten e vjetër, përpinquni t'i analizoni, të nxirri konkluzione të drejtë prej tyre dhe ejani këtu për të biseduar se çfarë ju bie në sy, si ka ndodhur dhe shprehni mendimin tuaj.

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Mendoj se ne duhet të ruhemti nga ndjenja e vetëkënaqësisë që të mos na dehin sukseset e arritura, prandaj të bëjmë kontroll në të gjitha drejtimet, për të konstatuar të metat dhe dobësitë që kemi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kontrolli punëtor dhe fshatar është një nga ndihmësit kryesorë për mbikëqyrjen e zbatimit të politikës së Partisë dhe të ligjeve të shtetit proletar. Ky është kontroll vullnetar, i përbërë nga punëtorë, të cilët nuk shpërblehen për këtë punë që bëjnë. Partia kërkon që këta njerëz të klasës, të ardhur nga radhët e masave të gjera të popullit punonjës, edhe të prodrojnë, edhe të mësojnë, edhe të vigjilojnë. Ata, kur kryejnë këtë punë shoqërore, shkëputen nga puna. Kur ka shumë veta në përbërje të ekipit të kontrollit punëtor, këta e kryejnë kontrollin e një dyqani, ta zëmë, shumë më shpejt nga ç'mund ta përfundonin pak veta.

Në përbërje të këtyre kontrolleve duhen zgjedhur punëtorë revolucionarë, të cilët të instruktohen nëpërmjet kurseve të veçanta për mënyrën e ushtrimit të kontrollit në emër të klasës. Për kontrollin në sektorin

e tregtisë, për shembull, të mos ketë tre veta, por shumë më tepër, po kështu edhe për kontrollin në fushën e kulturës etj. Nga ky kontroll i klasës të këqijtë do të dridhen, kurse të mirët do të jenë plot shëndet e gjallëri. Në kontolle të tilla të mos jenë kurdoherë po ata njerëz për të njëjtët sektorë, por përbërja e tyre të ndryshohet. Grupi i kontrollit duhet të raportojë për kontrollin që ka bërë, blic të propozojë edhe masa për eliminimin e dobësive që konstaton. Kjo gjë ka rëndësi të madhe dhe duhet të vihet në jetë. Ne kemi të dhëna se rrëthet kanë vepruar në këtë drejtim dhe kjo veprimtari ka dhënë rezultate.

Kontrolli i' aparatit të komitetit të Partisë, i instruktorëve, ka vlerën e tij të madhe, por kontrolli i gjithanshëm punëtor është një mbështetje e fuqishme, një mbështetje kolosale e Partisë. Vërtet instruktorët e komitetit të Partisë dhe inspektorët e seksioneve të komitetit ekzekutiv janë të specializuar për sektorët me të cilët merren, por megjithëkëtë ata janë pak dhe nuk mund të pretendohet që gjithçka të mund ta bëjnë vetëm këta. Veç kësaj një njeri apo pak njerëz, të paformuar si duhet e të pakalitur në kudhrën e klasës, mund të korruptohen, se njerëzit e pandërgjegjshëm ose armiq mund «t'u lyejnë dorën me mjaltë», por, duke shkuar për kontroll sot njëri, nesër tjetri e pasnesër i treti, pra, shumë veta me radhë, korruptimi bëhet tepër i vështirë. Kontrolli, sidomos në fshat, të bëhet në momente kyç, kur të mos jetë as shpejt, as vonë dhe të ketë kohë që gabimet e vërtetuara të ndrezen. Kjo gjë duhet pasur parasysh, se, po kaloi koha e punës në bujqësi, prodhimi të ikën nga duart dhe,

sado të përpinqesh më pas, nuk ke ku e gjen më kohën e humbur.

Nuk më thua shoqja Lenkë, me ullinjtë jeni mirë?

**SHOQJA LENKA ÇUKO:** Kemi bërë dy aksione dhe kemi përfunduar disa punime të kohës në vreshtat dhe ullinjtë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po në Fabrikën e Plastmasit vete mirë puna? Këtu duhet të punojnë gra të qytetit, burra të ketë fare pak. Kijeni parasysh këtë çështje, se puna e gruas është me rëndësi të madhe për ndërtimin e socializmit. Emancipimi i gruas është një nga veprat më të mëdha që ka realizuar Partia, prandaj atyre t'u jepen punë me përgjegjësi. Duhet të marrë fund praktika e gabuar që, kur vjen puna për përgjegjësi, zakonisht paraqiten kandidaturat e burrave. Pse të paraqiten vetëm burra dhe jo gra, kur dihet se edhe gratë i kanë të tëra mundësitetë përtuar e përtuar?

Situata morale e politike te ne është e shëndoshë dhe do të vazhdojë të jetë e tillë edhe në të ardhmen. Vendimi i fundit i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave të RPSH «Mbi uljen e pagave të larta, mbi disa përmirësimë në sistemin e pagave të punonjësve dhe mbi ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve midis fshatit dhe qytetit», që përmende edhe ti, shoqja Lenkë, i ka forcuar edhe më shumë dashurinë dhe respektin e popullit tonë për pushtetin popullor. Për këtë situatë që është krijuar, Partisë çdo ditë i vijnë shumë njoftime. Armiqtë e pushtetit tonë popullor nuk gjejnë argumente të luftojnë kundër synimeve të këtij vendimi, megjithatë ka nga ata që

flasin. Llafet e tyre, natyrisht, nuk i përkrah njieri, se realiteti është ndryshe nga ç'duan ta paraqesin ata. Për fshatin Partia po merr masa konstruktive. Pagat e larta u ulën përsëri, me qëllim që në të ardhurat nga puna të mos ketë shpërpjesëtime të paarsyeshme. Në kushtet aktuale neve na vihet detyra e rëndësishme që të punojmë pér përmirësimin e jetës së gjithë popullit, prandaj jo vetëm të ruajmë nivelin e arritur të të ardhurave të popullsisë, por të luftojmë t'i shtojmë vazhdlimisht. Shteti do të marrë përsipër pürballimin me mjetet e tij të shpenzimeve pér ambulancat, konsultoret, shtëpitë e lindjes, kopshtet dhe çerdhet e fëmijëve në fshat e pér të tjera gjëra që shprehen në vendim. Kështu do të shtohen të ardhurat e kooperativistëve.

Vetëm këto masa nuk janë të mjaftueshme pér të rritur nivelin ekonomik, social e kulturor të fshatarësisë kooperativiste, prandaj duhet të prodrojmë më shumë, më mirë dhe më lirë, në mënyrë që në të ardhmen të ketë edhe ulje çmimesh.

Të bëhet gjithçka që duhet pér rritjen e pulave, sepse ndërsa përpara një kokërr vezë shitej me 1-1,5 lekë, tanj ajo shitet me 0,8 lekë, por në të ardhmen të shitet edhe më pak. Në qoftë se do të shtojmë numrin e lopëve e të bagëtive të tjera dhe do t'i trajtojmë ato më mirë, mund të ulet çmimi i shitjes së qumështit, do të kemi më shumë mish etj. Në këtë mënyrë te ne do të krijohet një situatë e favorshme pér ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve midis fshatit dhe qytetit.

Të gjitha këto suksese që po arritmë dhe tërë kjo rrugë e drejtë që po përshkojmë, vërtetojnë pëjekurinë

e madhe të Partisë, patriotizmin dhe mobilizimin e gjithanshëm të masave. Njerëzit tanë nuk i zë gjumi, kur është fjala për interesat e Partisë, prandaj të vazhdojmë ta mbajmë të gjallë dhe ta shumëfishojmë këtë patriotizëm popullor.

Bëre shumë mirë që erdhe në takim, shoqja Lenkë. Mund të të them diçka edhe për situatën në Kinë. Atje kanë ndodhur trazira të organizuara nga elementët e djathtë, ka pasur të plagosur, janë djegur makina. Përveç incidentit në sheshin «Tien An Men» mund të ketë pasur ngatërresa edhe në qytete të tjera. Ten Hsiao Pinin e shkarkuan nga të gjitha postet brenda dhe jashtë partisë, por në Kinë shqetësues nuk është vetëm qëndrimi i Ten Hsiao Pinit. Shqetësuese është kryesisht ekzistенca në parti e shumë elementëve të djathtë revisionistë, duke filluar që nga Ten Hsiao Pini, Pen Çeni e të tjerë. Në Partinë Komuniste të Kinës, në vend të një vije të vetme marksiste-leniniste, kanë vepruar dy vija.

Në një parti proletare mund të ketë njerëz që gabojnë (këta duhen zbuluar dhe ndihmuar që të mos vazhdojnë më në rrugën e gabuar), por që të ketë dy vija brenda saj, nuk është marksiste. Kështu na mëson Marks. Po t'i lësh të rriten e të shumëzohen «barërat e këqija», ato e mbytin partinë, ashtu siç mbyt egjra grurin. Në parti, siç del nga mësimet e Marksit e të Engelsit, duhet të ketë një lulc dhe jo edhe njëqind barëra të këqija, se po u lanë edhe këto, atëherë do të rriten e do të shtohen gjersa një ditë t'i marrin fryshtë, ta fishkin dhe ta thajnë lulen e vaditur me gjakun e djersën e klasës.

Ten Hsiao Pini i ka deklaruuar dikur Mao Ce Dunit se nuk i ndryshonte mendimet e tij. Dhe vërtet, ai kurë nuk i ka ndryshuar mendimet e tij të djathta re-vizioniste. Për këto qëndrime, në vend që ta ndëshkonin, atë e futën në një vilë dhe e lanë të qetë. Më pas e nxorën nga vila ku ishte dhe e bënë nënkyretar të Komitetit Qendror të Partisë dhe zëvendëskryetar të Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Kinës! Pas vdekjes së Çu En Lait, përkrahësit e këtij, të Liu Shao Çisë, të Pen Çenit, të vctë Ten Hsiao Pinit e të tjerë organizuan trazirat kundërrevolucionare të kohëve të fundit.

Ne dëshirojmë që kinezët të ccin në rrugën marksiste-leniniste, sepse qëndrimi i Kinës ka rëndësi të madhe për revolucionin ndërkombëtar, por, me keq-ardhje, po shikojmë se në politikën e tyre të jashtme po mbahen disa qëndrime që janë të ndryshme nga parimet marksiste-leniniste.

Sipas kinezëve rreziku kryesor për popujt e botës dhe për revolucionin është Bashkimi Sovjetik, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë më pak të rrezikshme; në fakt, të dyja këto superfuqi janë bërë shumë të rrezikshme.

Ata thonë se ka tri botë, kurse ne themi jo, në botë ka vetëm dy fuqi që janë kundër njëra-tjetrës — proletariati dhe borgjezia. Revolucioni proletar duhet të shkatërrojë, në radhë të parë, borgjezinë reaksionare të çdo vendi dhe pastaj fuqitë e mëdha imperialiste.

Kinczët mendojnë se duhet të mbështetemi te njëri armik për të luftuar tjetrin, sepse, sipas tyre, «armiqjtë e armiqve tanë janë miqtë tanë», domethënë

armiqjtë e Bashkimit Sovjetik janë miqtë tanë, kurse për ne nuk është kështu. Sipas pikëpamjes së Partisë sonë borgjezia reaksionare e çdo vendi është armike e revolucionit proletar dhe e popujve të botës. Imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë janë armiqjtë më të rrezikshëm të revolucionit dhe të popujve. Të dyja superfuqitë kanë kontradikta me njëra-tjetrën dhe ne duhet të ndihmojmë që këto kontradikta në gjirin e tyre të thollohen, por jo duke u mbështetur tek imperialistët amerikanë kundër revisionistëve sovjetikë ose anasjelltas.

Ne duhet të luftojmë për të demaskuar të gjithë ata pseudomarksistë, që kërkojnë të mbrojnë borgjezinë në vendet e tyre. Marks, Engels, Lenin dhe marksistët gjermanë luftuan në kohën e tyre kundër borgjezisë. Lenin na mëson që, në qoftë se nuk mund të ndalojmë luftën grabitqare, atëherë ta shfrytëzojmë atë, duke ngritur popujt në luftë civile. Karl Libknehti edhe kur ishte në burg luftoi kundër kreditit të luftës, kurse Kautski dhe renegatët e tjerë votuan pro tij.

Kinezët mbrojnë Tregun e Përbashkët Evropian të përbërë nga shtetet kapitaliste të Evropës, që përgatitin luftën, që shtypin dhe shfrytëzojnë popujt, vetëm sepse këto shtete janë kundër Bashkimit Sovjetik. Ne, përkundrazi, kemi pikëpanjen se duhet ta luftojmë këtë organizëm imperialist dhe të punojmë për të ngritur në këmbë popujt e vendeve pjesëmarrëse në të kundër NATO-s, kundër Bashkimit revisionist Sovjetik, kundër Traktatit të Varshavës dhe KNER-it.

Kinezët janë për «Evropën e Bashkuar», sepse kjo, sipas tyre, duhet përdorur si mjet kundër sulmeve

eventuale të Bashkimit Sovjetik. Ne themi: Jo, nuk jemi për «Evropën e Bashkuar», sepse edhe Lenini ka qenë kundër «Evropës së Bashkuar», bile e ka dënuar këtë bashkim. Mësimi i Leninit imbetet përherë aktual. Shtetet imperialiste të Evropës janë ato që shpërthyen luftërat botërore, kurse sot atyre u është shtuar edhe socialimperializmi sovjetik, që shtyp egërsisht popujt e vendeve të ish-demokracive popullore.

Ne jemi gati t'i diskutojmë këto mendime me cilindot që pretendon të kundërtën. Pikëpamjet tona i kemi shprehur haptazi në të gjitha dokumentet tona të shkruara e të botuara, kemi solur për to në shtyp e në kongreset e Partisë sonë. Ne jemi kundër Tregut të Përbashkët, kundër NATO-s dhe organizatave të tjera të kësaj natyre. Çdo njeri objektiv e di mirë dhe e vlerëson pozitën e drejtë dhe parimore të Partisë sonë. Këto pozita politike të shëndosha të Partisë së Punës të Shqipërisë e bëjnë atë më të fortë dhe më me autoritet. Popujt e botës dhe proletariati ndërkombëtar, bile dhe borgjezia përparimi tare kanë respekt të madh për ne dhë për qëndrimet tona. Ata thonë: komunistët shqiptarë janë të vetmit në botë që flasin hapur dhe pa u trembur nga e vërteta, që nuk u druhën kërcënimeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik dhe që kanë kurajën të shprehin haptas ato që mendojnë. Miqtë tanë proletarë, me përjashtim të atyre që janë të ndikuar nga demagogjia sovjetike, nga socialdemokracia dhe sindikatat reformiste, inkurajohen nga qëndrimi ynë parimor dhe burrëror.

Vite të tëra demagogët revisionistë, socialdemo-

kratë dhe sindikaliste reformistë e kanë lidhur dhe e kanë mashtruar proletariatin me lloj-lloj paragjykimesh e konceptesh antimarksiste. Në këto rrethana, sado që bëhen greva, punëtorët drejtohen nga revisionistët që janë në shërbim të kapitalizmit. Kërkesat e tyre janë të bujshme, por pa efekt, se në të vërtetë ato nuk të lejojnë të shkosh më tutje, domethënë në përmibysjen e borgjezisë e nö fitoren e proletariatit.

Njoftime të shumta jepen nga shtypi ynë për rritjen e çmimeve, për rritjen e numrit të të papunëve, për inflacionin etj. në botën kapitaliste. Aktualisht qindra milionë të papunë janë sot në të gjithë botën. Si pasojë e thellimit të vazhdueshëm të krizës ekonomike që ka përfshirë të gjitha vendet kapitaliste edhe monedhat e tyre vazhdojnë të zhvleftësohen me ritme të shpejta. Në mënyrë të veçantë vazhdon rënia e vlerës së liretës italiane. Kjo gjendje ka reperkusione të mëdha dhe shpreh një banditizëm të madh të anëtarëve të tjerë të Tregut të Përbashkët ndaj aleates së tyre. Megjithëkëtë kinezët thonë se duhet t'i ndihmojmë këta myflizzë, këta tregtarë të tmerrshëm të armëve dhe partitië e tyre fashiste që sundojnë popujt, të cilët vuajnë nën thundrën e tyre. Nga burime të ndryshme informative del se ka vende kapitaliste, ku prindër të mjeruar, që kanë vite pa ngopur barkun, detyrohen të shesin deri edhe kalamajtë e tyre. Përse u dashka t'i ndihmojnë shtetet e Evropës Perëndimore, që po grinden me njëri-tjetrin si ujqër? Jo, përkundrazi, ne duhet të përfitojmë nga këto mosmarrëveshje për t'i hapur sytë proletariatit që ky të bëhet më i ndërgjegjshëm për misionin historik që ka.

Më fal që të mbajta shumë, shoqja Lenkë. Urime dhe suksese në punë. Të fala të gjithë shokëve e shqeve në Lushnjë. Në këtë vit jubilar të 35-vjetorit të themelimit të Partisë, të bëjmë të gjitha përpjekjet që t'i plotësojmë detyrat e mëdha që na ka caktuar Partia.

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtim, në librin:  
Enver Hoxha, «Për shken-  
cën» (Përmbledhje veprash),  
vëll. II, f. 21*

*Botohet i plotë sipas shënimive  
të mbajtura në këtë takim  
që gjenden në AQP*

# PËR PROBLEME TË GJENDJES NDËRKOMBËTARE

Shënime

Prill-maj 1976

Këto shënime shoku Enver Hoxha i ka shkruar në periudhën 20 prill — 19 maj 1976. Ai e kishte në metodën e tij të punës që, me kohë, hidhte mendime në letër, të cilat më vonë i përpunonte dhe i thellonte më tej.

Shënimet, megjithëse janë mbajtur në data të ndryshme, këtu po botohen së bashku. Ato janë një analizë shkencore e disa problemeve të situatës ndërkombëtare. Gjykimet që jepen për këto probleme bazohen në parimet e marksizëm-leninizmit dhe në analizat që ka bërë Partia jonë. Këto shënime u përdorën nga autorit përaportin e Kongresit të 7-të të Partisë dhe në plenumin të Komitetit Qendror të saj.

Në luftën tonë kundër devijimeve nga teoria e marksizëm-leninizmit, në luftën tonë kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit dhe kapitalizmit duhet të udhëhiqemi vazhdimisht nga marksizëm-leninizmi, që përbën një të tërë të pandarë kurrë dhe që

nuk lejon interpretime fantaziste, koniunkturale, sofizma dhe interpretime false, të mbuluara me terma marksistë-leninistë. Çdo interpretim i falsifikuar duhet demaskuar. Marksia dhe Lenini jo vetëm kanë shpjeguar dhe kanë hedhur dritë mbi natyrën e imperializmit dhe të socialimperializmit, por dhe i kanë demaskuar dhe kanë treguar luftën që duhet zhvilluar kundër këtyre armiqve, që pengojnë zhvillimin e shoqërisë njerëzore drejt socializmit dhe komunizmit. Ata kanë treguar format evolutive të imperializmit për të shtypur vende e popuj, për t'u pirë gjakun dhe për t'i skllavëruar në interes të borgjezisë së egër, në interes të kapitalit financiar, në interes të trusteeve e të koncerneve që arrijnë të shtien në dorë shtete dhe t'i urdhërojnë qeveritë e tyre të hedhin popujt në luftë grabitqare për fitime sa më të mëdha, për tregje sa më të gjera.

Marksia dhe Lenini kanë shpjeguar me një qartësi të madhe çështë kolonializmi, neokolonializmi në format e tij të ndryshme, çështë socialdemokracia, revizionizmi dhe kujt e si i shërbijnë këto kapitalit monopolist. Marksizëm-leninizmi ka demaskuar të gjitha teoritë eklektike dhe tendencat false të interpretimit të ngjarjeve dhe të fenomeneve në etapa të ndryshme deri në fazën e kalbëzimit të kapitalizmit.

Pra, Partia jonë mendon që analiza klasore kyç për luftën e klasave, për luftën e konfrontimit të ideve dhe të veprimeve, për luftën kundër imperializmit botëror, me atë amerikan në krye, që është një fenomen global, kundër socialimperializmit, me atë sovjetik në krye, që edhe ky është bërë një fenomen global, duhet

të udhëhiqet nga teoria e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Çdo devijim nga këto parime bazë, ku duhet të bazohen strategjia dhe taktika e proletariatit botëror dhe e udhëheqjeve të tij — partive komuniste dhe punëtore marksiste-leniniste të vërteta. jo velëm që është një krim, por duhet lusuar dhe duhet demaskuar pa hezitim, nga të gjithë, pavarësisht se kush e shtrembëron këtë teori. Analizat për ne komunistët, për proletariatin botëror dhe për popujt që luftojnë shtypjen dhe shfrytëzimin, duhet të bazohen në teorinë marksiste-leniniste dhe jo pse i dashka qejfi njërit apo tjektrit që bëjnë interpretime fantaziste, që duan t'ua imponojnë këto të tjerëve, që s'pranojnë diskutime.

Partia jonë e quan gabim teorik (dhe jo vetëm gabim emërtimi) atë që disa parti njerëzimin e ndajnë në tri botë. Kjo ndarje, nga ana klasore do të thotë që proletariatit e popujve u fshihen, pas kësaj shifre, imperializmi, kapitali monopolist, socialimperializmi, kolonializmi, neokolonializmi.

Kush bën pjesë në këto tri botë? Ecet sipas dëshirës së njërit a të tjektrit, sipas disa kritereve fantaziste, të qena e të paqena, pa marrë parasysh luftën klasore që zhvillohet në çdonjërin nga këto shtete të inkudruar në këto skema, jo vetëm pa e marrë parasysh këtë luftë, që është forca më e madhe lëvizëse dhe çon drejt çlirimt kombëtar e shoqëror, por duke e zhdukur, duke e shuar dhe duke e vënë në surdinë. Për Partinë tonë është reaksionare jo vetëm teza që pranon një ndarje të tillë, por ca më keq kur një vend socialist deklaron se bën pjesë në «botën e tretë». Për Partinë tonë ka vetëm dy botë: bota socialiste, ku sundon klasa

punëtore me diktaturën e proletariatit, me në krye partinë e saj komuniste dhe punëtore marksiste-leniniste, dhe bota kapitaliste, ku përfshihen shtetet imperialiste, socialimperialiste, revisioniste e kapitaliste të çdo forme e të çdo tipi qofshin. Kjo është një ndarje klasore dhe lufta klasore në këtë platformë zhvillohet dhe në asnje platformë tjetër.

Nuk mund të konfondohen me këtë analizë parimore aleancat, ndihma e mbështetja e dozuar që vendet socialiste u jepin shteteve dhe popujve që luftojnë për çlirimin nacional dhe social. Taktikat koniunkturale duhet t'i shërbejnë strategjisë. Nuk është e lejueshme as teorikisht, as praktikisht, të shuash personalitetin e shtetit socialist për t'u futur në «bolën e tretë». Kjo është një gënjeshtër e dënueshme, është një devijim nga teoria e Marksit dhe e Leninit.

Në qoftë se nuk ecet në rrugën e marksizëmi-leninizmit, në qoftë se nuk ndiqet filli i kuq i tij në mendimet teoriko-politike dhe në aksionet revolucionare, atëherë lihen në harresë burimet e të këqijave të mëdha që kanë pllakosur njerëzimin, imperializmi dhe revolucionizmi modern i kthyer në një sistem shtetëror, dhe dobësohet lufta kundër tyre. Këto kalbësira të shoqërisë njerëzore synojnë të dobësohet lufta revolucionare e proletariatit dhe e popujve, sepse e shohin që po fshihen nga faqja e dheut, prandaj, «për të shpëtuar», përdorin lloj-lloj mjetesh teorike, politike, kredi skllavëruese dhc, më në fund, luftën grabitqare botërore ose të pjesshme.

Imperializmi amerikan me fjalë quhet imperializëm, po nönvlefësohet rrezikshmëria kolosale e tij. Për

disa, edhe të ashtuquajtur marksistë, ai qenka bërë më pak i rrezikshëm. Për këta rreziku kryesor botëror është socialimperializmi sovjetik. Po pse ngjet kështu dhe a e vërtetojnë këtë teorikisht, politikisht dhe praktikisht? Jo. Vëlëm thonë «socialimperializmi sovjetik është më i rrezikshëm, se ai maskohet prapa leninizmit, kurse imperializmi amerikan është i demaskuar». «Ar-miku që harrohet është më i rrezikshmi», thotë populli. Prandaj Partia jonë lufton kundër të dyja superfuqive me të njëjtën ashpërsi.

Të mendosh e të veprosh siç mendojnë disa «filozofë», të çoroditur, do të thotë se mësimet dhe konkluzionet e mëdha teorike të Leninit mbi imperializmin ose s'i ke kënduar fare, osc i ke harruar, ose do e i shtrembëron.

Imperializmi është i etshëm për koloni, domethënë për zaptim tokash e tregjesh; kërkon të grabitë lëndët e para, të skllavërojë popuj, t'u pijë gjakun dhe të nxjerrë sa më shumë fitime. Vendet zaptoheshin me ushtarë, me topa, me kolonë dhe ktheheshin kështu nga vende indipendente në vende të varura nga metropolet. Pra, në stadin e imperializmit, kolonializëm do të thoshte ndarje e botës dhe e tregjeve nga një grusht shtetesh ekspluatuese të shtcteve të tjera dhe të popujve të tyre, për llogari të monopoleve.

Ky eksploratim bëhej me okupim ushtarak, fetar, kulturor etj. dhe i gjithë ky shfrytëzim i egër maskohej me «çuarjen e qytetërimit te njerëzit e egër pa kulturë»; gjenocidet e boerëve dhe të indianëve shpjegoheshin me teorinë e «darwinizmit social» etj.

Bota dukej sikur ishte një dhe e pandarë, por më

1917 fitoi Revolucioni i Madh i Totorit, që hapi një epokë të re për njerëzimin. Popujt e botës do të luftonin për t'u çliruar, për të mposhtur kolonializmin.

Kapitalizmi botëror, pas Revolucionit të Totorit, kaloi krizën e madhe në shkallë botërore. Ai në stadin e imperializmit pësoi një çarje të thellë që vinte si rezultat dhe si rrjedhim i situatave objektive dhe i kontradiktave që e brejnë brendapërbrenda dhe që janë të pazgjithshme nga ana e tij. Vendet kapitaliste filluan të degradohen dhe të degjenerohen në të gjithë përbërjen e tyre ekonomiko-shoqërore.

Lufta e Dytë Botërore, me formimin e një sërë shtetesh të tjera socialiste, si dhe me fitoren e lirisë dhe të indipendencës të një sërë shtetesh të tjera, e thelloi edhe më shumë krizën e kapitalizmit. Kjo ishte kriza e dytë e rëndë e kapitalizmit, i cili nuk ishte më i vetmi sistem shoqëror si përparr Luftës së Parë Botërore.

Rreth vitit 1950, kur Bashkimi Sovjetik, me në krye Stalinin, ishte në unitet të plotë ideologjik e politik me vendet e tjera socialiste dhe ndihmonte vendet që luftonin për çlirim, kapitalizmi botëror, në fazën kurdoherë të imperializmit, hyri në një krizë të tretë shumë të rrezikshme për të. Vende të reja po fitonin lirinë dhe po shkëputeshin nga kapitalizmi. Lëvizja nacionalçlirimtare e popujve po merrte hov. Kjo krizë e re antikolonialiste nuk filloi me një luftë të re botërore, por u zhvillua me luftëra të përgjakshme lokale, me zëvendësimin e një imperializmi me një tjetër, me një neokolonializëm tjetër okupues e skillavërues.

Vendet kapitaliste për të përballuar krizën zhvi-

Iluan prodhimin, e modernizuan këtë, zhvilluan pa mës armatimet dhe sidomos armët atomike për të përgatitur një luftë të re botërore dhe për të rifituar ato që kishin humbur.

Mirëpo kontradiktat ndërmjet kapitalit dhe punëtorëve, në mes këtyre të fundit dhe një grushti kapitalistësh, monopoleve dhe trusteve, kapitalit bankar, që merr tipare të theksuara kozmopolite, sa venë dhe shtohen. E gjithë kjo krizë në të tri rastet që përmendëm tregon epërsinë e socializmit mbi kapitalizmin dhe vërteton në realitet parashikimet e Marksit dhe të Leninit për fitoren e socializmit me rrugën e revolucionit.

Por, ashtu sikundër socialdemokracia i erdhi në ndihmë kapitalit monopolist në Luftën e Parë Botërore, edhe revizionizmi modern, me atë sovjetik në krye, pas vdekjes së Stalinit, shkaktoi përqarjen e thellë në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe u erdhi në ndihmë imperializmit amerikan dhe kapitalit monopolist botëror. Revizionizmi modern sovjetik u kthye në një socialimperializëm të ri, të ngjashëm me atë socialimperializëm të tredunioneve angleze në shërbim të imperializmit anglez, të asaj aristokracie punëtore në shërbim të padronëve të vendeve kapitaliste që mbajnë lidhur pas qerres së këtyre klasën punëtore të përqarë e njëkohësisht të inkuadruar në sindikata reformiste.

Por socialimperializmi sovjetik është një fuqi në shtet, i etur për fitime, për tregje dhe për skllavërim popujsh. Ai kryen veprime agresive dhe përgatit luftën e tretë botërore, ashtu si edhe partneri dhe konkurrenti i tij i madh SHBA. Që të dy këta janë për shtypje, për skllavërim, janë për luftë kundër proletariatit, kundër

socializmit dhe komunizmit. Këta janë dhe praktikojnë neokolonializmin në formën gjoja të «koekzistencës pa-qësore», derisa kontradiktat të acarohen dhe do të acarohen pür të shkuar në një luftë të tretë botërore. Ata që llomotitin se bota është ndarë në tri, e harrojnë fare sistemin e ri të kolonializmit të vjetër, që quhet neokolonializëm. Kjo fjalë nuk është një emërtim pa kuptim, por shpreh një sistem që përfshin masa të shumëlllojtë politike, ekonomike, ideologjike, ushtarake etj. I gjithë ky sistem është stisur dhe krijuar nga imperializmi botëror në përgjithësi dhe nga ai amerikan në veçanti, për të mbajtur popujt nën zgjedhën e tyre ekonomike, për të nxjerrë fitime kolosale nga lëndët e para të vendeve të tjera, për të pasur në këto vende baza ushtarake me specialistë të tyre. Me një fjalë, imperializmi dhe në veçanti ai amerikan, që, siç do ta shohim më poshtë, ka marrë pjesën e luanit, duke u lënë popujve njëfarë lirie ose independence ose autonomi false, kërkon t'i mbajë popujt e këtyre vendeve në skllavërinë e vjetër koloniale të sheqerosur me një «indipendencë» inekzistuese dhe pa përbajtje.

Këtë gjendje në vendet që shpëtuan nga kolonializmi dhe hynë në neokolonializëm e dëshmojnë klikat borgjeze reaksionare vendase. Klika të tillë reaksionare përbëjnë «barin nën këmbë» të imperializmit në këto vende, prandaj proletariati dhe popujt e këtyre vendeve, që të mos rrojnë si skllevër dhe të mos bëhen mish për top për imperialistët, duhet t'ua presin këtyre «barin nën këmbë».

Si konkluzion, unë dal te mësimet e Marksit dhe të Leninit që thoshin se nuk mund të luftohet impe-

rializmi i jashtëm pa luftuar kapitalizmin reaksionar dhe borgjezinë kompradore të vendit të shitur tek të huajt.

Si në Azi, në Afrikë, në Amerikën Latine e gjetkë ka shtete që janë «të lira politikisht», por ekonomikisht janë të varura nga kapitali amerikan dhe kapitalistët e tjerë, të cilët bëjnë si të duan dhe kur të duan kohën e mirë dhe kohën e keqe në këto vende.

Neokolonializmi duket hapur edhe në të famshmet «ndihma ekonomike» dhe «kredira» që marrin shtetet e pazhvilluara nga SHBA-ja, nga shtete të tjera kapitaliste, nga socialimperializmi sovjetik dhe nga bankat e mëdha ndërkombëtare, kapitali i të cilave dominon kapitalin industrial në këto vende si dhe në vende të «botës së tretë». Kapitalet e huaja skllavëruese futin intrigat dhe luftërat lokale në këto vende, për të ruajtur kështu sistemin neokolonialist.

Këto vende dhe këta popuj renegati Tito i quan «të paangazhuar» kur imperializmi dhe socialimperializmi me «kredi» dhe «ndihma» ka blerë gjysmën e vendit, siç ndodh edhe në rastin e vetë Jugosllavisë, e cila është e krimibur në borxhe dhe e shitur kokë e këmbë tek të huajt, duke u vetëquajtur vend socialist.

Partia jonë e Punës, në bazë të një analize të mbështetur në teorinë marksiste-leniniste, nuk mund të shkojë nga rruga që të luftojë dhe të demaskojë vetëm socialimperializmin sovjetik dhe të dobësojë luftën kundër armikut tjeter, po aq të rrezikshëm, imperializmit amerikan. PPSH nuk e quan marksiste, por antimarksiste, atë rrugë gjoja socialiste, që u bën thirrje popujve dhe marksistë-leninistëve të bashkohen me borgjezinë

e vendit dhe të vihen nën urdhrat e saj për të luftuar socialimperializmin sovjetik. Këto janë pikëpamje anti-marksiste, të dënueshme.

Ne asistojmë aktualisht në vuajtjen dhe në varfërimin e popujve nën thundrën e imperializmit amerikan, të socialimperializmit sovjetik e të kapitalistëve të tjerë.

Cila është rruga e të gjithë këtyre popujve? E vetmja rrugë është lufta e klasave kundër klasës kapitaliste, kundër borgjezisë dhe aleatëve të saj, kundër dy superfuqive, kundër monopoleve dhe trusteve. Kjo është një luftë politike, ideologjike, luftë kundër strukturës dhe superstrukturës së vjetër; kjo është dhe duhet të jetë vetëm një luftë revolucionare me armë, e përgatitur mirë, pse vetëm një rrugë e tillë sjell fitoren e socializmit dhe të komunizmit.

Ky është, përmblledhtazi, mendimi teorik i Partisë sonë për disa probleme të zhvillimit botëror, të cilat do t'i shtjelloj më gjërë edhe më poshtë.

Në të gjithë botën, në të gjitha kontinentet janë krijuar shtete të reja. Këto shtete të reja në Afrikë e në Azi janë rezultat i luftërave çlirimtare me armë në dorë kundër kolonizatorëve amerikanë dhe evropianë, ose janë si rezultat i krizës botërore të parë dhe të luftës antifashiste, antinaziste, antimilitariste kundër agresorëve italianë, gjermanë dhe japonezë. Fitorja e madhe e popujve në Luftën e Dytë Botërore u arrit me thyerjen e hitlerizmit, të Rajhut të Tretë gjerman, të regjimit fashist italian dhe të militarizmit japonez. Sido që Franca dhe Anglia ishin pjesëtare të koalicionit antifa-

shist, ato dolën nga lufta të dobësuara, ndaj edhe pushteti kolonial francez ishte në greminë, edhe perandoria angleze po bëhej gërmadhë.

Imperializmi amerikan, në përgjithësi, nuk u dëmtua nga lufta, përkundrazi u pasurua dhe u bë finançuesi i mëkëmbjes jo vetëm të Anglisë e të Francës, por edhe i vendeve fashiste dhe militariste të mundura. Këto shtete ndihmoheshin për t'u bërë mbështetjet dhe aleatet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kundër Bashkimit Sovjetik, kundër socializmit në përgjithësi dhe kundër luftërave të reja nacionalçirimtare që do të shpërthenin pa asnje dyshim në të gjitha kontinentet.

E ashtuquajtura rezistencë e fuqive të mëdha (me përjashtim të Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë populllore) ishte e paqenë përballë invadimit «paqësor» amerikan, i cili çdo ndihmë shteteve të mëdha, që dolën fituese ose të mundura nga lufta, e jepte duke marrë hipoteka të rënda mbi to: hipoteka në ekonomi, ku rezervoi pjesën e luanit; hipoteka në ish-kolonitë e tyre, ku zëvendësoi ligjin e vjetër kolonial me ligjin e tij të ri neokolonial; hipoteka të rënda ushtarake, që synuan dhe realizuan krijimin e traktateve agresive, krijimin e ushtrive agresive dhe armatimin e tyre me armë moderne të modelit amerikan.

Imperializmi amerikan u bë dominuesi dhe imponeusi i ligjit të tij të forcës mbi të gjitha vendet dhe shtetet kapitaliste. Kjo gjendje shkaktoi shkatërrimin e formës së vjetër të perandorisë angleze, e cila nuk e kishte më atë forcë të mbante nën zgjedhë totale dhe në format viktoriiane popujt e kolonive të saj. Imperializmi amerikan e «ndihmoi» me të gjitha forcat «alea-

tin» dhe konkurrentin anglez të heqë armët nga kolonitë dhe zuri atje vendin e tij. Anglia u detyrua, ku nga rezistenca e popujve, ku e shtrënguar, t'u japë «lirinë dhe indipendencën» vendeve koloniale, pasi i grabiti dhe i shtypi deri në palcë. Por këtë lëshim të sforuar Anglia nuk e bëri pa ruajtur në këto vende koncesione ekonomike të konsiderueshme, aq sa ishte e mundur. Ajo u përpdq të ruante zonën e sterlinës me shpirt ndër dhëmbë, sepse zona e dollarit po kapërcente dete, oqeane e kontinente dhe krijonte kolonitë e reja të imperializmit amerikan për t'u thithur gjakun dhe pasuritë vendeve që «fitonin» indipendencën, por që, në fakt, dilnin nga një zgjedhë për t'u futur në një zgjedhë të re akoma më të fortë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës krijuan bazat ushtarake, krijuan bankat dhe zhvilluan dumpingun nën formën e «ndihmës» dhe të «bamirësisë demokratike» janki. Anglia, duke larë duart nga shumië gjëra, krijoj Komonuelthin për të mbuluar fytyrën, por ky Komonuelth formal u shkri si floku i borës në ujë. Luani britanik mbeti vetëm kockë e lëkurë dhe u kthye jo vetëm në një «aneks» të politikës amerikane, natyrisht, nën maskën e alcates së saj, por u kthye dhe në një zëdhënës ose më mirë me thënë në «një kolonë të pestë» të Amerikës në grupimet borgjezo-kapitaliste të paslustës. Anglia e «humbi» indipendencën politike, pse u bë e varur ekonomikisht, zëri tash asaj nuk i dëgjohet aq shumë më në arenën ndërkombëtare, ajo üshtë «mbledhur», si me thënë, kruspull në hallet e veta. Edhe një herë që ngriti pushkën në alcancë me Francën për të ndaluar Naserin të nacionalizonte kana-

lin e Suezit, i ra duarve Xhon Foster Dallesi dhe Anglia e Franca tok me të, u kthyen nga erdhën. Anglia pësoi kështu disfatë në Izrael dhe u detyrua të tërhiqej, pësoi disfatën ushtarako-politike edhe në Suez.

Kurse borgjezisë franceze, që kapitulloi me turp para Hitlerit, pas çlirimit iu ngjallën kryclartësia dhe egërsia kolonialiste. Dolën Liotej dhe Galienë të rinj. Franca borgjeze peteniste e goliste u përpoq me të gjitha forcat të ruante kolonitë e saj në botë. Ajo nuk kishte nxjerrë mësimë nga Lufta e Dytë Botërore dhe nga një vend gati i mundur, aspironte të nibetej një suqi e madhe botërore. Borgjezia franceze nuk kuptoi dhe as që bëri të paktën një përpjekje për të kuptuar se me të vërljetë lufta e popujve kundër hitlerizmit dhe aleatëve të tij shkaktoi aq rrënime dhe aq gjakderdhje saqë nuk qenë parë në luftërat e mëparshme, por popujt jo vetëni nuk u përkulen, po luftuan dhe fituan. Lufta u hapi popujve të botës syltë se kush ua shkaktonte atyre mjerimin dhe skllavërimin; ata filluan të gjykojnë me kokën e tyre dhe jo me kokën e guvernatorëve, të administratorëve, të nënmbretërve dhe të të deleguarve të përgjithshëm të ardhur nga metropolet kapitaliste me ushtri, me gjeneralë e me topa që gjoja sillnin qytetërimin evropian.

Këtë transformim të madh revolucionar, përparimtar, antikolonial që ngjiste në popujt e kolonizuar, Franca borgjeze as e pa, por edhe në qoftë se e pa, nuk deshi ta kuptonte. Ajo iu ngjit, si ai oktapodi gjakpirës, Vietnamit, Algjerisë, Tunizisë dhe gjithë kolonive të saj afrikane. Iu desh Francës të përdorte armët kundër këtyre popujve, por lufta e saj e padrejtë do t'i sillte,

me siguri, siç i solli, disfatën. Ushtria borgjeze franceze e kurseu së tepërmi gjakun e saj kur erdhi koha dhe duhej derdhur për të mbrojtur lirinë e Francës nga hitlerianët, por nuk e kurseu aspak atë gjak të saj dhe të popujve që donte t'i shtypte për të ruajtur fitimet e mëdha që i sillte perandoria koloniale e saj që po shembet.

Lusta e popujve e detyroi Francën të ngrinte lekkat në krahë dhe të largohej me turp nga vendet e pushtuara. Gjelit francez i ranë keq pendët dhe ai me zor të madh qëmtonte ndonjë thërrime ekonomike në disa vende të Afrikës, si Çadi, Senegali etj., të cilave u detyrua t'u jepte autonominë ose indipendencën. Shtetet e Bashkuara të Amerikës që ishin majmur, e «ndihmonin» sa mundnin edhe Francën borgjeze, me synim për ta spastruar atë nga tregjet e zonës së frangut, për t'i okupuar ato me zonën e dollarit, kurse kulturën ose mënyrën e jetesës franceze ta zëvendësonin me kulturen dhe me mënyrën e jetesës janki. Kështu Franca e dikurshme, fodulle dhe e fuqishme, u gjend në mëshirën e «Planit Marshall» dhc ishte e detyruar të pranonte diktatin amerikan, bashkëpunimin ekonomik dhe ushtarak që vendoste Uashingtoni.

Imperializmi amerikan pas Luftës së Dytë Botërore, me fuqinë e madhe ekonomike të tij dhe me potencialin kolosal të luftës, jo vetëm aspironte, por dhe lufkonte për të dominuar botën. Synimet e tij ishin të dobësonte Bashkimin Sovjetik që doli fitimitar në luftë, që dha kontributin më të madh për fitoren, që fitoi një prestigj të madh e të merituar në vendet dhe popujt e botës, duke u bërë të qartë këtyre se bota dhc njerëzimi

ecin drejt socializmit dhe komunizmit dhe ideologjia udhëheqëse e revolucionit, e çlirimit të popujve është marksizëm-leninizmi. Bashkimi Sovjetik në atë kohë u bë feneri i madh për të gjithë popujt e botës, që u tregonte atyre se armiqtë kryesorë të tyre ishin imperialistët, borgjezia reaksionare dhe kapitalizmi. Kundër këtyre armiqve duhej që popujt të ishin vigjilentë dhe t'i luftonin me të gjitha mënyrat që të rronin të lirë dhe indipendentë.

Për të arritur dobësimin e Bashkimit Sovjetik imperializmit amerikan i duhej të arrinte edhe qëllimin e dytë: të përfitonë nga rrënimet e mëdha të luftës, nga dobësimi, mungesa dhe pamundësia e kohezionit, që vireshin re te qeveritarët borgjezë të shumë vendeve, nga uria dhe nga konfuzioni politik që mbretëronin në këto vende. Shtetet e Bashkuara të Amerikës punuan sistematikisht të jepnin «ndihma» ekonomike për «rimëkëmbjen» e ekonomisë së këtyre vendeve, natyrisht, duke siguruar për vete dividendët më të mëdhenj. Këto «ndihma» ishin të dozuara proporcionalisht me shkallën e nënshtimit politik të këtyre vendeve ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës; në tregje të ndryshme të botës, që invaduan «në mënyrë paqësore», këto «ndihma» ishin të dozuara proporcionalisht me besnikërinë e klikave të këtyre vendeve ndaj Uashingtonit, i cili luante me to si me marionotë në një teatër kukullash, i sillte në fuqi, i mbështeste, i shtrydhte dhe pastaj i hidhte. Kjo mënyrë veprimi i lejonte imperializmit amerikan të pasurohej pa masë, të thithët gjakun e popujve, të zhvillonte në mënyrë monstruoze industrinë dhe bujqësinë e vet dhe

të zhvillonte tmerrësishët armët e luftës për të ruajtur këtë perandori kolosale që po krijonte.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës i lidhën këta «alcatë» pas qerres së tyre me traktatë ushtarake aggressive, ku ato dominonin, drejtonin, kurse të tjerët ishin mish për top. Ato ndërmorën masa që të mëkëmbnin, të forconin dhe të armatosnin ushtritë e këtyre aleatëve me armatime moderne, okupuan dhe janë duke mbajtur në këto vende forca ushtarake amerikane dhe armë bërthamore, krijuan në këto vende aleate dhe në shumë vende të tjera të botës baza të fuqishme ushtarake të ekipuara me armët moderne të tipit të fundit.

Me këto qëllime e veprime djallëzore imperializmi amerikan përgatiste terrenin për një luftë të tretë botërore, e cila duhej të shpërthente prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve të tyre kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste. Kjo psikozë e luftës fryhej çdo ditë nga imperializmi amerikan dhe u kthye në «luftën e ftohtë», term ky që i përshtatej Uashingtonit për të përgatitur «luftën e nxehë», për të mbajtur të gjallë dhe për t'ua shtuar borgjezive kombëtare të vendeve perëndimore dhe borgjezisë ndërkombëtare idenë e kërcënimit imminent që gjoja u vinte atyre dhe tërë botës nga Bashkimi Sovjetik dhe Stalini. Imperializmi amerikan mbillte kështu në botë një frikë të madhe, të papërshkruar dhe të pandjerë kurrë, për arsy se lufta e ardhshme nuk do të ishte më një luftë që do të zhvillohej vetëm me armë konvencionale, por ajo do të ishte njëkohësisht një luftë atomike. Mbi këto tmerre të ardhshme spekulonte Amerika dhe ajo i shtoi pa masë buxhetet e luftës, të cilat shërbën për per-

feksionimin me shumicë të armëve më moderne nukleare. Në këtë mënyrë imperializmi amerikan jo vetëm ruante dhe shtonte armatimet në krahasim me Bashkimin Sovjetik, për të pasur superioritetin, por, nëpërmjet perfeksionimit të armëve dhe duke ruajtur monopolin e armëve të fundit, ai u bë furnitori më i madh i armëve në botë. Me këto armë të shitura njërit e tjetrit Amerika shtonte fitimet, u thithë vendeve të tjera lëndët e para më të rëndësishme që i nevojiteshin. Ajo u impononte çmimet që i gjente të arsyeshme për veten e saj, u akaparonte vendeve të tjera koncesione të konsiderueshme dhe vërvshonte në këto vende dollarin në një sasi aq të madhe, saqë më në fund shuma e dollarëve jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës ishte aq e madhe sa vlera e tij filloj të bjerë dhe të tërheqë në një kaos zhvleftësimi të gjitha monedhat e tjera të botës kapitaliste dhe revizioniste, monedha që, në një mënyrë ose në një tjetër, kush më shumë e kush më pak, e kishin lidhur fatin e tyre me dollarin.

Filloi kështu kriza e madhe e kapitalizmit botëror dhe e imperializmit amerikan, filloi kriza e madhe në Bashkimin Sovjetik revizionist dhe tok me të u futën në krizë të gjithë satelitët e tij, të gjitha vendet revizioniste me radhë. Kriza e madhe që pllakosi të dyja superfuqitë dhe alegatët e tyre ishte politike, ideologjike, ekonomike, ushtarake. Kjo krizë pati efekte të mëdha që quan në dobësimin e aleancave agresive që të dyja superfuqitë kishin kurdisur. Kriza e madhe tronditi shumë shtete të botës dhe u ngjalli atyre dyshimin e bazuar se kjo fatkeqësi që po i pllakoste e kishte burimin në veprimet agresive dhe grabitqare të imperializmit

amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik. Sa lindi ky dyshim dhe kur u konkretizua mosbesimi i këtyre shteteve nga veprimet politike agresive, demagogjike dhe skllavëruesc të të dyja superfuqive, filloi edhe çarja në aleanca, u vërletuan gjysmëshkëputje ose shkëputje të plota prej tyre, filloi të shfaqet, ku hapur dhe i deklaruar, ku i mbyllur, po veprues dhe gjerryes, mosbesimi ndaj superfuqive, filluan dhe kundërshtimet e hapëta politike, ideologjike dhe goditjet me armë. U kurdisën luftëra lokale, u çor maska mashtruese e dy superfuqive, mbaroi *l'âge d'or*<sup>1</sup> e tyre.

Superfuqitë në krizë, dhe me plot kontradikta mes tyre, mes tyre dhe aleatëve, mes tyre dhe popujve, u përpoqën dhe përpinqen të gjejnë forma të reja bashkëpunimi, të hartojnë plane të reja skllavërimi, ndarje të reja zonash të influencës dhe ndarje të re të tregjeve.

Sa ishte gjallë Stalini, nxënësi besnik i Leninit, Bashkimi Sovjetik ishte atdheu i socializmit, besnik i marksizëm-leninizmit, ishte mbrojtësi dhe ndihmësi më i sigurt, më besniku dhe më i fuqishmi i popujve të botës, që luftonin për çlirimin e tyre politik, ekonomik e shqëror kundër kolonialistëve, neokolonialistëve dhe ushtrive të okupatorëve imperialistë. Dashuria për Stalinin dhe për Bashkinin Sovjetik ishte e madhe në çdo vend dhe në çdo popull, me përjashtim të imperializmit amerikan dhe borgjezisë reaksionare që kërkonin t'u bënin varrin nëpërmjet një lufte të tretë botërore.

Natyrisht, përpara kërcënimit imperialist, Bash-

---

1. Frëngjisht — epoka e artë.

kimi Sovjetik i kohës së Stalinit, krahas forcimit ekonomik të vendit dhe ndihmës internasionaliste që u jepet miqve, forconte edhe mbrojtjen e vet të shumanshme dhe të aleatëve të tij. E tërë kjo vepër madhështore dhe e drejtë krijonte besim kudo në partitë komuniste dhe punëtore të botës, në proletariatin botëror, të njerëzit përparimtarë. Kjo siguri dhe ky besim u viheshin përballë forcës së egër imperialiste dhe frikës që përhapte imperializmi amerikan.

Imperializmi amerikan, ai anglez, francez dhe në përgjithësi kapitalizmi botëror, nuk u dobësuan vetëm nga lufta që u bërl Hitleri, por edhe nga tronditja që u shkaktoi atyre fitorja e Bashkimit Sovjetik, fitorja dhe superioriteti i socializmit në këtë vend dhe në shumë vende të tjera të Evropës dhe të Azisë.

Epoka e Stalinit ishte vazhdimësia e fitoreve të Leninit, që ndihmoi, gjithashtu, në demaskimin e luftës grabitqare të imperialistëve amerikanë, e luftës atomike që përgatitnin këta dhe e të gjitha mënyrave e mashtrimeve politike dhe të shfrytëzimit ekonomik që u bënë popujve.

Kriza aktuale që ka pllakosur Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Sovjetik, e ka burimin në rezistencën e proletariatit botëror e të popujve revolucionarë dhe rol vendimtar për këtë ka luajtur teoria e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Është kjo teori që zbatoi me besnikëri Stalini gjatë epokës së tij, si brenda Bashkimit Sovjetik, dhe në arenën ndërkombëtare, që jo vetëm u shkaktoi disfatën aktuale të dyja superfuqive, por udhëheq tash dhe do të udhëheqë edhe më shumë akoma në të ardhmen revolucionet

nacionale dhe revolucionin botëror, që do të varrosë imperializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik dhe kapitalizmin.

Epoka e ndritur e Stalinit në Bashkimin Sovjetik dhe jashtë tij me ardhjen në fuqi të revizionizmit modern, me atë hrushovian në krye, humbi një betejë, por nuk humbi luftën, marksizëm-leninizmi do të fitojë.

Pas vdekjes së Stalinit të madh, tradhtarët e marksizëm-leninizmit, të Bashkimit Sovjetik dhe të revolucionit, revisionistët modernë sovjetikë, morën pushtetin në Bashkimin Sovjetik. PPSH e ka analizuar gjerë e thellë këtë tradhti dhe këtë analizë ajo e ka bërë në prizmin e teorisë marksiste-leniniste, në bazë të eksperiencës së luftës revolucionare të proletariatit të udhëhequr nga Marks, Engels, Lenin dhe Stalini dhe në bazë të eksperiencës së saj.

Revizionizmi modern që mori fuqinë në Bashkimin Sovjetik e në vendet e ish-demokracisë populllore të Evropës, me përjashtim të Shqipërisë, dhe u vendos edhe në një numër të madh të partive komuniste e punëtore të botës, ishte një rrymë e fortë reaksionare në shkallë botërore kundër teorisë marksiste-leniniste dhe atyre vendeve socialiste ku kishin fuqinë partitë e vërteta komuniste që i qëndronin besnikë teorisë së Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Marrja e fuqisë nga revisionistët hrushovianë në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera të ish-demokracisë populllore, ishte një grusht i rëndë për proletariatin botëror, për revolucionin. Tradhtia e klikave revizioniste në partitë komuniste e punëtore të botës, që braktisën marksizëm-leninizmin dhe revolucionin

dhe që ndoqën Bashkimin Sovjetik revizionist, e bëri edhe më të rëndë gjendjen në lëvizjen komuniste. Këto klika revizioniste, si atje ku morën fuqinë, dhe atje ku nuk erdhën në pushtet, morën masa drakoniane kundër marksistë-leninistëve të vërtetë dhe revolucionarë, zhviluan një propagandë shpifëse e denigruese kundër Partisë Komuniste Bolshevikë të Leninit, kundër veprës dhe figurës së Stalinit, kundër vetë fitoreve të arritura nga Bashkimi Sovjetik. Këta renegatë i gërmuan varrin Bashkimit Sovjetik socialist dhe ndërmorën shuarjen e revolucionit, duke u përpjekur të diskreditojnë socializmin shkencor. Revisionistët modernë krijuan një përqarje të pashebullt në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, krijuan konfuzion dhe kaos në proletariatin ndërkombëtar, ngjallën dhe ushqyen me sloganë dhe teori trockiste, anarkiste e socialdemokrate dyshimin në teorinë shkencore të marksizëm-leninizmit dhe u erdhën në ndihmë fuqimisht kapitalizmit botëror, imperializmit amerikan në radhë të parë.

Njihen taktikat djallëzore që përdorën hrušovianët për të hedhur baltë mbi bolshevizmin dhe Stalinin, dhe këlë ala e bënë se ishin renegatë dhe tradhtarë, por edhe për të fituar besimin e borgjezisë botërore dhe të imperializmit amerikan. Hrušovianët aprouan dhe përhapën propagandën e kapitalizmit dhe shpisën më tej, duke thënë atë që vite e vite me radhë kapitalizmi kishte shpisur kundër socializmit shkencor, kundër diktaturës së proletariatit. Ky ishte kapari i madh dhe sigurimi që hrušovianët i dhanë kapitalit botëror se «mbaroi» epoka e revolucioneve, filloi detanta, u zhduk lufta e klasave si teori, si brenda Bashkimit Sovjetik

dhe jashtë tij, filluan bashkekzistenca dhe gara «paqësore» në çdo fushë. Teoricienët revizionistë, ngado që ishin, filluan të predikojnë sikur pushteti i proletariatit nuk do të merret me dhunë e me revolucion, por me forma «demokratike», me «vota», me «parlamentarizëm», në rrugë paqësore.

Eshtë e vërtetë të afirmohet që borgjezia reaksionare botërore dhe imperializmi amerikan, sidomos që nuk u besonin as syve, as veshëve të tyre për çka po ndodhët në Bashkimin Sovjetik dhe pa e ulur për asnjë çast vigjilencën, ndjenë «njëfarë detante» filluan të shpresonin në fitoren e tyre definitive dhe në largimin e revolucionit. Tradhtia në Bashkimin Sovjetik e kishte burimin në ideologjinë reaksionare, imperialiste, borgjeze, e cila do ta çonte Bashkimin Sovjetik në kapitalizëm dhe do t'i jepte këtij tiparet e egra të një imperializmi social. Ky proces filloi dhe u desh një kohë të zhvillohej e të merrte format aktuale.

Hrushovianëve u çshtë dashur, në radhë të parë, të gjenjenin popujt e Bashkimit Sovjetik, të luftotonin kundërshtarët e vet të brendshëm dhe të jashtëm, të gjenjenin opinionin botëror dhe t'i jepnin garanci botës kapitaliste se koha e Stalinit u mbyll, se në Bashkimin Sovjetik nuk ekzistonë as diktatura e proletariatit, as partia komuniste dhe se socializmi po transformohet gradualisht në kapitalizëm. Në të gjitha këto drejtime hrushovianët luftuan frontalisht. Strategja e revizionizmit hrushovian ishte që Bashkimi Sovjetik të bëhej një superfuqi socialimperialiste, të sundonte botën dhe popujt tok me imperializmin amerikan dhe të përdorte, siç përdori, një mijë taktika.

Revizionistët u përpoqën të ruanin «unitetin» e partive komuniste dhe punëtore të botës frejtë partisë revizioniste të Bashkimit Sovjetik, unitet ky në baza krejt antimarksiste. Ata u përpoqën me çdo kusht të shuanin polemikën ideologjike, pasi shuarja e saj ishte një variant i dominimit nga ana e tyre. Qëllimi dhe taktika e tyre me rëndësi ishte që edhe sikur të mos shuhej polemika, të vazhdohej një miqësi false e bazuar në një «marksizëm-leninizëm të ri», që merr parasysh rrëthanat e krijuara në botë. E gjithë kjo bëhej me pikësynimin që Bashkimi Sovjetik të vendoste hegemoninë e tij në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, duke zëvendësuar marksizëm-leninizmin me revizionizmin modern, të ruante hegemoninë politike dhe ekonomike dhe dominimin ushtarak mbi vendet ish-socialiste, të siguronte mbështetjen e këtyre për politikën imperialiste botërore që do të ndiqte Bashkimi Sovjetik. Ky gjoja hyri në garë me SHBA-në dhe Hrushovi i nderte imperializmit amerikan edhe shkopin, edhe karotën, ose më mirë i kërkonte «karotën» për shumë arsyesh.

Arsyeja e parë e këtij qëndrimi ishte se pozitat e revizionizmit në vetë Bashkimin Sovjetik akoma nuk ishin forcuar.

Arsyeja e dytë ishte se hrušovianët nuk ua imponuan dot tradhtinë e tyre, në radhë të parë, Shqipërisë dhe Kinës, as si shtete, as si parti. Partia jonë i shpalli luftë ideologjike të ashpër në baza marksiste-leniniste revizionizmit hrušovian dhe atyre që e pasonin atë. Pas Mbledhjes historike të 81 partive komuniste e punëtore të botës pati dhe nga ato parti, sidomos të Azisë, që qën-

druan në dy karrige. Por edhe në partitë e tjera revisioniste, sidon që e pranuan pa hezitim vijën hrushoviane, pati dhe nga ato që aspironin për më shumë dhe u bënë «më katolike se papa» në rrugën hrushoviane. Kështu që edhe në klanin revisionist nuk kishte që në fillim «unitet». Kjo ishte logjike dhe e paevitueshme për ato vende dhe ato parti që tradhtuan marksizëm-leninizmin. Kontradiktat mes tyre do të thelloheshin. Ky ishte një minus i madh dhe një pengesë serioze për realizimin e strategjisë hrushoviane.

Arsyeja e tretë ishte ajo që imperializmi amerikan dhe shtetet borgjeze kërkonin sigurime, në radhë të parë, liberalizith më të madh, «çlirim» më të plotë të vendeve të Lindjes dhe depërtim lirisht në këto vende të turistëve, të propagandës, të ideve borgjeze. Me fjalë të tjera, imperializmi amerikan shkonte në të kundërtën e strategjisë së lartpërmendur sovjetike, domethënë, përpinqej të mos e linte socialimperializmin sovjetik të forcohej dhe vepronë tok me shtetet e tjera kapitaliste bolërorë që ta minonte «forcën» e Bashkimit Sovjetik si brenda, ashtu dhe jashtë. Këtu u drejtua lehu i imperializmit amerikan.

Arsyeja e katërt ishte se Bashkimi Sovjetik ekonomikisht u dobësua me ardhjen e hrushovianëve dhe me ndryshimin e politikës dhe të strukturave; industria dhe bujqësia ranë; shuma kolosale u derdhën për armatime, pse kjo, sipas hrushovianëve, ishte «shkopi» i madh për të gjithë. Bashkimi Sovjetik kishte një industri të vjetruar, s'kishte mekanizm të mjaftë në bujqësi, me plehra kimike ishte përtokë. Kur ishte Hrushovi në fuqi, edhe ndihmë lypte, edhe mburrej, edhe kërcënonte,

edhe mashtronë e blosonte përballë «miqve të vjetër», por edhe përballë miqve të rinj që kërkonte të bënte dhe që i donte miq për siq. Por «miqtë» nuk i lëshonin pa koncesione «siqtë».

Politika e hrushovianëve sovjetikë me Traktatin e Varshavës eternizoi okupimin e vendeve pjesëtare të Traklatit, me përjashtim të Shqipërisë socialiste. Bashkimi Sovjetik praktikonte, edhe ai si imperializmi amerikan, propagandimin e tmerreve të luftës, të sulmit perëndimor. Pra, është e vërtetë se të dyja superfuqitë përgatiteshin për një luftë imperialiste, prandaj si njëra, si tjetra, i mbanin aleatët nën zapin ushtarak të tyre.

Bashkimi Sovjetik krijoi KNER-in. Kjo organizatë me karakter ekonomik, në fillim gjoja koordinonte planet ekonomike të pjesëtarëve, por, në fakt, kjo donte të thoshte që të gjithë partnerët e KNER-it duhej t'i hartonin planet e tyre ekonomike në koordinim me ato të Bashkimit Sovjetik, gjë që ndihmonte, në radhë të parë, ekonominë sovjetike, e cila i diktonte gjithsej cilit vend ç'do të prodhonte, sa do të prodhonte, sa do t'i jepte Bashkimit Sovjetik për të larë kreditë që i jepte ky dhe sa do të mbante për vete. Kështu që Bashkimi Sovjetik hrushovian ndoqi po atë rrugë që ndoqën Shitet e Bashkuara të Amerikës me «Planin Marshall» me ato shtete që e pranuan «ndihmën» amerikane. Por veprimitaria e KNER-it dhe shfrytëzimi ekonomik i partnerëve nga Bashkimi Sovjetik bëhej nën etiketën false marksiste-leniniste dhe të «zhvillimit të menjë-hershëm» të të gjitha vendeve socialiste. KNER-i çorganizoi prodhimin e vendeve të ish-demokracisë popullare !

llore, dobësoi ekonominë, ndryshoi strukturat e organizimit të prodhimit dhe të drejtimit dhe e gjithë kjo zhvillohej në interes të Bashkimit Sovjetik revizionist. KNER-i inkurajonte kooperimin në format e vendosura nga qeveria sovjetike, e cila e përdorte atë si një mjet për të plotësuar, në radhë të parë, nevojat e saj, së dyti, për të favorizuar njërin vend në kurrit të tjetrit, kur e donte interes i vct, për të bërë ndryshime politike në këto vende. KNER-i synonte dhe synon që nga kooperimi të kalohej në integrim të pjesshëm dhe më vonë në integrim të plotë të ekonomive të pjesëtarëve të kësaj organizate në ekonominë e madhe sovjetike. Kjo është rruga dhe forma e kolonializmit të ri.

Stalini me gojën e tij më ka thënë mua se „në asnje mënyrë ne nuk pranojmë të bëjmë shoqëri të përbashkëta ekonomike, ne kemi bërë disa me shtëjet miq, por do t'i prishim menjëherë, pse kemi gabuar, pasi një mënyrë e tillë nuk është marksiste-leniniste“. Kurse hrušovianët me të tilla veprime politike, ekonomike dhe ushtarake skllavëruan popujt e këtyre vendeve, nuk i lanë të shiñnin jashtë prodhimet e tyre dhe kjo bëhej për arsyen politike, pse shiñnin rrezikun e shthurjes, por edhe sepse prodhimet e tyre ishin të kualitetit të dobët dhe tregjet, ku ndonjëherë mund të dilnin edhe të tilla mallra, ishin zënë më përpëra nga tregu sovjetik. Rruga e socialimperializmit sovjetik ishte çelur dhe ai po e cte drejt kthimit në një superfuqi botërore në konkurrencë dhe njëkohësisht në bashkëpunim me imperializmin amerikan.

Kjo konkurrencë dhe ky bashkëpunim nuk mund të ecnin me metodat e Hrušovit. Nuk mund t'i dilej

përpara potencialit të madh amerikan edhe duke qenë lypës edhe fodull, si hidalgot e vjetër spanjollë të shekullit të Kolombit kur zbuloi Amerikën, prandaj Hrušovi u qërua nga fuqia, vendin e tij e zuri Brezhnjevi, i cili e hapi gojën e tij prej kali për t'i qeshur Amerikës. Atij i lëshonte goja mjaltë për Amerikën, për bashkëpunim «të singertë» me të në çdo fushë, gjoja për të balancuar forcat ushtarake dhe për të kërkuar kredi të shumta nga SHBA-ja dhe nga vendet e tjera kapitaliste deri edhe nga mafiozët kapitalistë italianë. Brezhnjevi ndiqte rrugën e revizionistit Tito, i cili ishte bërë mjeshtër në marrje kredish nga çdo anë, duke ua shitur Jugosllavinë kreditorëve.

Kredia e dhënë nga kapitalistët është kurdoherë e shoqëruar me kushte politike dhe me taksa të rënda ekonomike. Kapitalisti nuk të jep ndihma për të varfëruar veten dhe për të pasuruar kundërshtarin. As revizionistët nuk e bëjnë një gjë të tillë. Prandaj dhënia e ndihmave ekonomike dhe e kredive nga imperializmi amerikan, nga socialimperializmi sovjetik, nga vendet borgjeze kapitaliste dhe nga shitet revizioniste ka karakter shfrytëzues të egër, ka për qëllim imponime politike dhe lëshime e koncesione të tjera që zhdukin personalitetin e atij shteti që merr kredi e ndihma të këtij lloji, i zhdukin atij lirinë ose e lidhin pas qerres së të huajit dhe më në fund bëhet mish për top.

Vetëm Shqipëria socialiste as nuk ka marrë dhe as do të marrë kredi e ndihma të tilla sklavëruese. Ajo është mbështetur në forcat e veta dhe në ndihmën reciproke, internacionliste, pa kurrsfarë kondite.

Por ç'forma mori zhvillimi i këtyre synimeve të të dyja supersfuqive, ç'metoda u përdorën prej tyre? Ç'atraktate dhe ç'marrëveshje u lidhën dhe u zgjidhën ndërmjet tyre dhe me popujt e botës? Ç'konsekuencia politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake patën këto veprime në arenën ndërkomëtare e në opinionin e popujve dhe ç'reagime u vunë re te këta të fundit, që influencojnë për të ndihmuar ose për të luftuar imperializmin amerikan dhe socialimperializmin sovjetik? Natyrisht, këto janë probleme të shumta dhe me rëndësi të madhe për të ardhmen e botës dhe të shteteve.

Në qoftë se unë përpinqem t'u bëj një analizë gjithë këtyre problemeve kapitale, nuk kam as më të voglin pretendim se do të jap zgjidjen e tyre. Jo, por si anëtar dhe Sekretar i Parë i PPSH e kam për detyrë të parë të luftoj për Partinë dhe për lirinë e indipendencën e atdheut tonë socialist, për mbrojtjen e socializmit dhe të marksizëm-leninizmit, për jetën dhe interesat e mëdhenj të popullit tonë.

Do të përpinqem që të gjitha gjykimet mbi këto probleme t'i analizoj nën prizmin e parimeve të mësipërme të Partisë sonë, duke u bazuar në analizat e shumta dhe të drejta që u kanë bërë problemeve ndërkomëtare dhe kombëtare kongreset dhe plenumet e KQ të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Zhvillimi i ngjarjeve, shkaqet që i krijojnë, rrethanat dhe forcat antagoniste që janë në veprim, janë aq të ndryshme nga karakteri, nga nevojat, nga qëndrueshmëria, nga mënyrat dhe nga format që përdoren në luftëra e në përpjekje, saqë, në rast se nuk kapemi nga kryesoret, nga parimoret dhe nuk u bëjmë atyre një

analizë marksiste-leniniste, është zor të dalësh nga ky pyll i dendur dhe plot ferra, pa u çjerrë prej tyre dhe të arrish në konkluzione të drejta dhe të vlefshme, për t'i sqaruar Partinë dhe masat e popullit që të orientohen drejt në çdo veprim dhe në çdo situatë.

Është e qartë se imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë nuk mund ta vendosnin e ta zbatonin lehtë dhe sipas dëshirës hegemonizmin e tyre mbi partnerët e vet në grupimin e NATO-s dhe në Traktatin e Varšavës. Kjo vështirësi e vendosjes së hegemonisë së tyre edhe jashtë këtyre grupimeve, ushtarakë qoftë, por edhe ekonomike e politike, shkaktoi në mes tyre plasaritje të thella, të cilat bëheshin çdo ditë e më serioze për superfuqitë. Këto plasaritje dhe kundërshtime që lindën në mes tyre i detyruan superfuqitë që të merrnin masa drakoniane për të shtypur tendencën e shpartallimit të unitetit fals, duke u bazuar në fuqinë e armëve ose duke marrë masa të shumta pressioni ekonomik ndaj atyre shteteve që ishin futur në darën e tyre, por që shfaqnin tendenca kundërshtimi.

Në përgjithësi mund të themi se forcat centrifugale, qoftë të shteteve borgjeze kapitaliste perëndimore, qoftë të shteteve revizioniste lindore, u bënë çdo ditë e më të dukshme dhe më aktive, kuptohet, duke synuar çlirimin e këtyre shteteve nga hegemonia dhe nga dominimi i imperializmit amerikan apo ai sovjetik.

Të marrim socialimperializmin sovjetik dhe satellitetët e tij. Të gjitha udhëheqjet e këtyre vendeve janë revizioniste dhe ecin drejt kapitalizmit. Për rrjedhojë nuk mund të ketë unitet në mes tyre, as ideologjik, as politik, as ekonomik, as ushtarak. «Uniteti», për të cilin

flasin ata, mbahet me forcën e armëve sovjetike dhe me ushtrinë e socialimperializmit që ka okupuar këto vende. Bashkimi Sovjetik nuk lejon asnjë shkarje të asnjë shteti revizionist nga zgjedha e tij. Çdo tentativë nga ana e tyre shtypet si në Çekosllovaki. Traktati i Varshavës është një armë në duart e udhëheqjes sovjetike. Me këtë grupim ushtararak ajo ka mbytur ushtritë e vendeve satelite. Në këto vende mund të ekzistojë dëshira për të thyer prangat, por mundësitetë për këtë janë të pakta në këto situata. Mbajtja nën zgjedhë ushtarake e këtyre vendeve nga ana e sovjetikëve është vitale për ekzistencën e socialimperializmit sovjetik, prandaj ky vëzhgon mirë që asnjë orvatje për shkëputje të mos ndodhë në radhët e «aleatëve» të tij. Megjithatë armiqësia politike, divergjencat ideologjike, në mos të hapëta si në Çekosllovaki në kohën e Dubçekut, ekzistojnë kudo të heshtura dhe manifestohen në formatë ndryshme e në lëme të ndryshme, sidomos në çështjet ekonomike.

Bashkimi Sovjetik i ka varfëruar aleatët e vet ekonomikisht, u ka lidhur duart dhe këmbët, u imponon çmimet e veta, kondicionon sipas interesit të tij zhvililimin e ekonomisë së tyre, u jep sa do dhe kur do aq lëndë të parë të nevojshme për industrinë e tyre. Kreditë që Bashkimi Sovjetik u akordon satelitëve janë kredi skllavëruese. Të gjitha këto pakënaqësi që po shfaqen në çdo lëmë, në marrëdhëniet e tyre mbulohen me teorinë e «sovranitetit të kufizuar» të Brezhnjevit, që do të thotë, me fjalë të tjera, për interes të «socializmit» duhet të ruhet dhe të mos kundërshtohet diktati sovjetik mbi këto vende. E ashtuquajtura bashkekzis-

tencë paqësore hruščoviane, bashkëpunimi me leverdi ekonomike dhe marrëdhëniet kulturore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vendet e tjera perëndimore, u kuptuan dhe u zbatuan vëtëm në mënyrë të njëanshme. Vetëm Bashkimi Sovjetik mund të bënte tregti me ta, vetëm ai mund të merrte kredi e mund të zhvillonte marrëdhënie kulturore me Perëndimin, kurse pjesëtarët e tjerë të KNER-it, jo. «Në parim» edhe satelitët e Bashkimit Sovjetik e kishin këtë të drejtë, por në realitet Bashkimi Sovjetik nuk i lejonte ta bënin këtë gjë. Fakt është Çekoslovakia. Këtë donte të bënte Dubçeku, por ai u shtyp nga ushtria e Jakubovskit.

Mirëpo zhvillimi i marrëdhënieve të njëanshme me Perëndimin nga ana e Bashkimit Sovjetik, nuk u interesonte as amerikanëve, as demokratave borgjeze kapitaliste perëndimore, por as edhe vetë shteteve revizioniste të Lindjes. Në këtë drejtim në gjirin e vendeve revizioniste u krijuan fërkime të rrezikshme ndërmjet tyre dhe Bashkimit Sovjetik dhe kjo pakënaqësi nxitej nga imperializmi amerikan dhe aleatët e tij. Situatë e vështirë u krijuua për revizionistët sovjetikë, të cilëve u duhej që satelitëve të tyre «t'u hapnin rrugën» që edhe ata të bënin tratativa me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e me Perëndimin, siç bënte Bashkimi Sovjetik. Por këtij i duhej «edhe t'u frenonte zellin dhe dëshirat · vendeve satelite për të thyer prangat sovjetike».

Imperializmi amerikan synonte të dobësonte Bashkinin Sovjetik, t'u vinte fre aspiratave hegemoniste të tij, t'ia shkëpuste atij satelitët dhe t'i afronte nga veta.

Edhe dëshira e satelitëve sovjetikë ishte e tillë dhe këta kishin dhe kanë shpresë në ndihmën e Shteteve të

Bashkuara të Amerikës. Pra imperializmi amerikan, duke e ditur dobësinë ekonomike të Bashkinit Sovjetik, duke marrë parasysh zgjedhën e tij mbi shtetet revisioniste etj., pranoi t'i jepte kredi Bashkimit Sovjetik, por edhe vendet e tjera revisioniste, me konditë që edhe vendet e tjera kapitaliste përendimore të investonin kapitalet e tyre në Bashkimin Sovjetik.

Një veprimtari e tillë e demokracie borgjeze kapitaliste përendimore edhe nuk i interesonte imperializmit amerikan, por edhe i interesonte deri në njëfarë pike, sepse strategjia e tyre ishte e njëjtë dhe, nga ana tjetër, sepse në këtë mënyrë krijuarët premisa të fortë për të përqarë kampin revolucionar sovjetik. Kapitali i Evropës Perëndimore kërkonte ekspansion ekonomik dhe përhapje të ideve borgjeze, antimarkiste.

Në këto situata Bashkimi revolucionar Sovjetik, duke i mbajtur satelitët nën zgjedhë ushtarake dhe politike, duke i mbajtur të nënshtuar ekonomikisht me shumë zinxhirë të çeliktë, u detyrua t'i lejonte këto vende të merrnin kontakte me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vende të tjera kapitaliste, të kërkonin dhe të merrnin kredi prej tyre. Natyrisht, tok me kreditinë hynte dhe hipotekimi politiko-ekonomik. Nga një veprimtari e tillë, që ishte relative për të dyja anët, u shqetësua shumë Bashkimi Sovjetik.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përendimorët, por edhe vetë vendet e Evropës Lindore dëshironin shumë qarkullimin e lirë, në çdo fushë, në mes Perëndimit dhe Lindjes. Vetëm Bashkimit Sovjetik nuk i interesonte një gjë e tillë dhe, për t'i hedhur ujë verës,

për të bërë zhurmë dhe për të mos pranuar një situatë që po kërkohej, ai hodhi idenë e «mbledhjes së sigurimit evropian». Kjo ishte një komedi që u luajt në Helsinki dhe aktorët kryesorë që luanin sijet e marionetave ishin Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mali polli një mi. U duk blofi që në javët e para pas Mbledhjes së Helsinkit.

Partia jonë e ka deklaruar në kohën e duhur pikëpamjen e saj për Mbledhjen e Helsinkit dhe e ka quajtur këtë mbledhje «të mossigurimit evropian». Në fakt, asgjë nuk ndryshoi nga gjendja e mëparshme, vecse bëhen përpjekje të krijohet një atmosferë sikur në mes shteteve të Evropës po vendoset një «statuko politiko-ideologjike» dhe një bashkëpunim më i zhvilluar ekonomik në mes shteteve me përjashtim të Shqipërisë. Në të gjitha këto drejtime jo vetëm që statukoja nuk u vërtetua, por lindën edhe konflikte të reja në mes Greqisë e Turqisë lidhur me Qipron. Sa deklaroit Greqia se po dilte nga NATO-ja, sovjetikët vrapiuan të mbushnin boshllëkun.

Për sa i përket gjoja sigurimit evropian nga një luftë botërore, ky nuk ka bërë asnjë hap përpara. Zaten kjo është diçka e pamundur të realizohet, pse as Lindja, as Perëndimi nuk mund të çarmatosen dhe as që mund të bëjnë qoftë edhe orvatjen më të vogël në këtë drejtim, pse do të dëmtoheshin si Bashkimi Sovjetik, ashtu edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të dyja këto fuqi imperialiste nuk bëjnë gjë tjetër veç përpjekjeve për të shtuar armët ofensive të luftës dhe armët atomike. Mbledhjet e SALT-it nuk dhanë, gjithashtu,

asnjë rezultat, ato qëndrojnë në vend. Kuptohet se palët në bisedim po bëjnë vetëm muhabete pa bukë.

Sovjetikët përpinqeshin nga ana e tyre të krijonin ndonjë të çarë për t'u futur në vendet perëndimore, por këtë nuk e gjetën dot. Perëndimorët bënë shumë bujë për çfarë po ngjiste në Portugali, se atje gjoja po ndërhyrni sovjetikët me anën e partisë «komuniste» të Kunjalit. Dhe në fakt një orvatje të tillë ata e bënë. Por zhurma nga ana e perëndimorëve u bë më tepër për bujë sesa nga frika e një infiltrimi të sovjetikëve në Gadishullin Iberik.

Të dyja superfuqitë çdo krizë që lind, në cilëndo anë të botës, e shoqërojnë me një propagandë shurdhuese. Këtë e kanë gjetur si një mjet të fuqishëm për mbajtjen e psikozës së luftës «iminent», qoftë të një lufte të përgjithshme atomike, qoftë të ndonjë lufte të pjesshme. Çështja e Portugalisë «do të rregullohej», siç u rregullua, me zgjedhjet e fundit në favorin e partive socialiste që janë nën ndikimin dhe të varura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe të partive të tjera të së djathtës; partia revizioniste e Kunjalit nuk mbeti pa marrë disa vende në parlament, por kjo ishte larg asaj frike që perëndimorët e trumbetonin për të fshehur intrigat e tyre për neutralizimin e ndërhyrjes sovjetike.

Marrëdhëniet e sovjetikëve me perëndimorët e tjerë nuk patën ndonjë ndryshim të dukshëm. Është fakt se për perëndimorët u krijuar një situatë «më e lehtë». Këta panë se sovjetikët dhe aleatët e tyre lindorë ndodheshin në pozita të dobëta politike dhe organizative, se ekonomia e tyre ishte në krizë saqë haptazi kërko-

nin ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të shteteve të tjera kapitaliste të Evropës. Kështu, pa i ndërprerë për asnjë çast përgatitjet për luftë, për të përballuar një sulm eventual nga ana e sovjetikëve, shtetet perëndimore kanë zhvilluar marrëdhënie tregtare dhe ekonomike me vendet e Evropës Lindore, natyrisht për të siguruar fitime për vete dhe për të infiltruar në këto vende idetë dhe mënyrën borgjezo-kapitaliste të jetesës.

Por Bashkimi Sovjetik revizionist nuk shkoi drejt përgatitjes dhe shpalljes së luftës «iminente» në Evropë. Sipas mendimit tonë ai i trembej një lufte në kontinent, jo se nuk do t'i dilte dot mbanë në qoftë se do të kishte përballë vetëm forcat ushtarake të shteteve perëndimore të Evropës, por nga frika se do të ndodhej edhe përballë potencialit të madh ushtarak amerikan. Është e vërtetë se Bashkimi Sovjetik gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore bëri përpjekje të mëdha heroike dhe Ushtria Sovjetike u tregua në një shkallë të lartë përgatitjeje dhe vetëmohimi, pasi ajo ishte ushqyer e ishte zhvilluar me idetë e marksizëm-leninizmit dhe me besimin te Partia Bolshevikë dhe te Stalini. Por revisionistët hrushovianë, që morën fuqinë në Bashkimin Sovjetik, nuk përfaqësojnë as trimërinë, as forcën morale të bolshevikëve. Ata janë të frikshëm dhe tregohen të frikshëm kur mburren e kërcënojnë me fuqinë e tyre ushtarake. Edhe kur flasin për një «paqe sociale», ata përsëri vazhdojnë të forcohen ushtarakisht, pse kanë për qëllim të dominojnë botën, të vendosin hegemoninë me çdo kusht, duke mos përjashtuar edhe agresionin. Por pa llogari, mendojmë nc, ata nuk shkojnë.

Në qoftë se sulmuani Çekoslovakianë, revisionistët sovjeticë e bënë këtë, së pari, se ishin jë lidhur me traktatet dhe se këtë vend e konsideronin si «pjesë» të tyre dhe, së dyti, kolona e tyre e pestë brenda në Çekoslovakia kishte vepruar me kohë dhe i kishte siguruar se, në rast sulmi ushtarak, nuk do të hidhej asnjë pushkë nga ana e çekoslovakëve.

Por okupimi i Çekoslovakisë e uli shunë prestigjin e madh që ka pasur Bashkimi Sovjetik dhe nga kjo përfitoi shumë imperializmi për t'u kallur frikën satelitëve të vet se një agresion ushtarak të tillë sovjetikët mund ta bënin çdo ditë dhe kundër çdo shteti. Një shantazh i tillë nga ana e imperialistëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës kishte për qëllim që t'i mbante anëtarët e NATO-s në zap ekonomik, politik dhe ushtarak. Por nuk ekskludohet që socialimperialistët sovjetikë të ndërmarrin edhe sulme të tjera në Evropë, por jo pa bërë llogari të thella. Ne e quajni të pamatur dhe të gabuar mendimin se Bashkimi Sovjetik mund të fillojë kur të dojë një sulm të tillë dhe të likuidojë fuqinë ushtarake të NATO-s dhe rezistencën e popujve të tjerë të Evropës brenda dy-tri ditësh. Kështu thonë disa strategë të çmendur që e kanë për zanat të krijojnë në popujt psikozën e frikës e të luftës atomike.

Bashkimi Sovjetik socialimperialist ka nevojë të madhe të zhvillojë ndikimin e vet në kontinente të ndryshme, veçanërisht në Afrikë, në Lindjen e Mesme, në Indi, në Turqi dhe në vende të tjera. Ai është agresiv, «del për gjah» dhe, ku gjen, mbyt popuj, zë pozita strategjike, jep «ndihma» dhe kredi dhe krijon tregje

për të shitur mallrat e tij, grabit lëndët e para të vendeve të tjera, duke thithur, nöpërmjet këtyre rrugëve, gjakun e popujve të vendeve ku ai depërton.

Prandaj nü këtë situatë, kur akoma nuk ekziston rreziku iminent i një konflagracioni botëror, veçanërisht mes imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik, ky i fundit përpinqet të ndajë zonat e influencës dhe tregjet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, natyrisht, jo pa fërkime dhe pa kontradikta të thella midis njëri-tjetrit që tanjjanë ndalur në buzën e greminës.

Një luftë të tillë për zona influence e tregje ne e shikojmë të zhvillohet e ashpër në Lindjen e Mesme, ku të dyja superfuqitë kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një mijë e një intrigë në kurri zonat e popujve arabë. Me këto intrigë ato nxitin agresionin izraelit dhe shkaktojnë gjakderdhjen e vuajtjet e këtyre popujve. Njëra superfuqi ndihmon Izraelin, tjetra gjoja ndihmon Egjiptin, por me këto «ndihma» ato orvaten për të ndarë zonat e influencës, zhvillojnë një luftë të ashpër për naftë, bëjnë përgatitje për një luftë të re botërore. Të gjitha këto qëllime të fugive të mëdha imperialiste për t'u vendosur në këtë apo atë vend arab të Lindjes së Mesme fshihen me një propagandë të madhe të shoqëruar «me parulla paqësore».

Egjipti ishte lidhur për një kohë me Bashkimin Sovjetik që i jepte armë të vjetra për ta mbajtur në fre dhe për të krijuar atje, për interesat e tij, një gjendje «as paqe, as luftë». Tash Egjipti i dha drunë Bashkimit Sovjetik dhe u drejtua nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që i kanë forcuar mirë pozitat në Lindjen e Afërt.

Eashkimi Sovjetik ka sot marrëdhëniet me Sirinë, ku mund të ankorojë disa anije luftarake dhe po përpinqet të gjejë edhe ndonjë port tjetër mesdhetar, si në Libi ose në Algjeri, ku të mundë. Flota sovjetike bredh nëpër Mesdhe si ujku që del në borë për të gjetur ndonjë dele ta shqyejë.

Është fakt se Bashkimi Sovjetik pësoi disfatë në vendet arabe, ndërsa imperializmi amerikan duket sikur fitoi një betejë, por luftën ai nuk e ka fituar. Bashkimi Sovjetik po bën përpjekje të krijojë baza ushtarake në Detin e Kuq, në Libi, në Indi dhe kudo gjatkë ku të mundet, ai përpinqet të forcojë pozitat e tij ushtarake dhe politike përtej Lindjes së Mesme për të krijuar një unazë të hekurt rrëth Kinës Popullore në-përmjet Afganistanit, Malezisë, Tajlandës, mundësisht edhe Japonisë etj. Pra, Bashkimi Sovjetik bën të gjitha përpjekjet që këto vende t'i lidhë pas politikës së vet. Por ai nuk i ka ato mundësi të mëdha ekonomike si të imperializmit amerikan, i cili ia njeh këtë pikë të dobët dhe vepron kundër tij.

Gjithë këto shtete borgjeze kapitaliste që Bashkinë Sovjetik kërkon t'i kthejë në baza të tij, nuk e duan. Në koniunkturat aktuale ato «mund ta duan» atë për ndonjë ndihmë, por do të jetë e zorshme, për të mos thënë e pamundur, që të bëhen mashë dhe mish për top për Bashkimin Sovjetik. Këto shtete borgjeze mund të bashkohen më lehtë me imperializmin amerikan, për arsyen se klikat që i udhëheqin dëshirojnë të mbështeten te një shtet më i fuqishëm ushtarak, por i fuqishëm edhe nga ana ekonomike. Imperializmi amerikan mund t'i kënaqë më mirë aspiratat e këtyre ve-

ndeve dhe klikat e tyre, kurse Bashkimi Sovjetik nuk është në gjendje t'i kënaqë. Qëllimi i Bashkimit Sovjetik është i qartë, ai do që t'i ketë këto vende si pika mbështetjeje të fuqishme ushtarake dhe ekonomike, si prapavija të tij tash në kohë paqeje për shfrytëzimin e tyre, ndërsa në kohë lufte t'i ketë mish për top për interesat e tij.

Sipas mendimit tonë, agresiviteti i Bashkimit Sovjetik imperialist drejtohet më tepër ndaj Kinës sesa ndaj vendeve të Evropës Perëndimore. Nuk ekskludohet as njëra, as tjetra, por në kushtet aktuale dhe duke hedhur në balancë potencialin ekonomik dhe ushtarak të të dyja supersuqive, llogaritë nuk të lënë të mendosh që Bashkimi Sovjetik do të sulmojë më parë Evropën sesa Kinën. Në qoftë se fiasim për agresion sovjetik, probabiliteti është më shumë kundër Kinës, pse këtë ai e konsideron si një vend të dobët ekonomikisht dhe ushtarakisht. Në këtë drejtim Bashkimi Sovjetik përpinqet të evitojë edhe luftën bërthamore me imperializmin amerikan, ai përpinqet të evitojë, gjithashtu, edhe ato konflikte lokale ku do të ndesheshin haptazi interesat e Bashkimit Sovjetik dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Por të dyja këto supersuqi kanë taktikat e tyre, përpinqen të dobësojnë njëra-tjetrën brenda vendit dhe jashtë ku orvaten të hedhin bazat. Në këtë drejtim Bashkimi Sovjetik është më inferior dhe më vulnerabël nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pse brenda në Shtetet e Bashkuara Bashkimi Sovjetik nuk ka mundësi të bëjë atë që imperializmi amerikan po bën në shtetin sovjetik. Bashkimi Sovjetik nuk ka mundësi as në Amerikën

e Jugut të bëjë atë që bëjnë Shtetet e Bashkuara në vendet revizioniste të Evropës Lindore. Ai nuk ka mundësi ta prekë në strofkën e vet imperializmin amerikan, kurse ky po e prek imperializmin sovjetik pikërisht në strofkën e tij. Bashkimi Sovjetik nuk mund të zhdukë as influencën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vendet e Amerikës Latine, kurse imperializmi amerikan po ia gjerryen tregjet Bashkimit Sovjetik jo vetëm në vende të ndryshme të botës, ku ky po orvatet të depërtojë, por edhe në vende të Evropës Lindore, si në Jugosllavi, në Rumani e gjelkë.

Pra, duke i gjykuar kështu këto situata, imperializmi amerikan, i cili ka pësuar e do të pësojë edhe më pas disfata të reja, aktualisht po ndjek një strategji dhe një taktikë të re. Strategjia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synon të vendosë, si edhe më parë, hegemoninë e tyre botërore, duke u përpjekur të eliminojnë konkurrentin kryesor, socialimperializmin sovjetik. Nuk është e kotë as ajo që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e tyre po e «ndihmojnë» me kredi Bashkimin Sovjetik, që ky të rindërtojë industriën e tij të rëndë, të lehtë dhe bujqësinë e prapambetur dhe t'i japid, gjithashtu, mundësinë të rezervoje fonde të mëdha për të shtuar edhe armatimet. Do të jetë një logjikë absurde, që natyrisht nuk e ka as imperializmi amerikan dhe as të tjerët, që t'i japid kredi një imperialisti tjetër që ky pastaj t'i drejtojë armët kundër tij e t'i bëjë varrin. Qëllimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës është që socialimperializmin sovjetik ta drejtojnë në një luftë kundër Kinës, të dobësojnë në këtë rrugë edhe Bashkimin Sovjetik dhe Kinën në të

njëjtën kohë, me qëllim që më pas ato të bëhen arbitri i fateve të botës.

Prandaj në këtë çështje ne nuk mund të ndajmë rrezikshmërinë e imperializmit amerikan nga rrezikshmëria e Bashkimit Sovjetik. Që të dy janë shumë të rrezikshëm, që të dy janë agresivë, që të dy duhen luttuar. Këtë del se nuk u lejohet marksistëve të mendojnë që për të thyer një superfuqi imperialiste, të mbështeten te një superfuqi tjetër imperialiste. Mbështetja jonë duhet të jetë në mobilizimin dhe në forcën e popujve, në unitetin e gjithë atyre që dëshirojnë të hedhin poshtë zgjedhën imperialisto-revisioniste. Ne jemi për unitetin e proletariatit botëror, i cili me luftë do të thyejë planet agresive të lustënxitësve imperialiste e socialimperialistë dhe do të hidhet në revolucion.

Ne nuk jemi të atij mendimi, sipas të cilit imperializmi amerikan është dobësuar apo është në térheqje, ndërsa Bashkimi Sovjetik revisionist është në ngritje dhe në ofensivë. Le të shikojmë faktet.

Imperializmi amerikan i ka hedhur kthetrat në të gjitha kontinentet dhe kudo po forcon pozicionet e veta me të gjitha mënyrat, me «ndihma», me kredi skllavëruese ku hapur, ku tërthorazi, me marrëveshje e traktate të shumëlojta, deri edhe me sulme të armatosura. Të gjitha këto janë tipare të shëmtuara të imperializmit të egër amerikan, pa të cilat ai nuk është e mundur që të mbajë fuqinë në botë.

Siq e kemi përmendur, pas Luftës së Dytë Botërore, imperializmi amerikan u bë furnizuesi i gati të gjitha shteteve, me përjashtim të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, me kredi, me armë

dhe me municionc. Evropa për imperializmin amerikan ka qenë kurdoherë në ballin e vëmendjes së tij. Ai që në fillim u përpinq dhe ia arriti qëllimit t'u impononte vendeve të Evropës Perëndimore vullnetin e tij. Ky qëllim u realizua lehtë nga ana e tij, për arsyet e shkatërrimit të madh që solli Lufta e Dytë Botërore në këto vende, borgjezia e të cilave kishte shumë nevojë dhe luftonte të forconte pozitat e veta, të rimëkëmbte ekonominë e shkatërruar nga lufta, industrinë dhe bujqësinë, të rimëkëmbte e të forconte edhe ushtrinë e vet. Në këtë drejtim Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo për ndjenja humanitare, por për fitime materiale përveten e tyre, «ndihmuani» dhe u përpinqën për të krijuar në udhëheqjet borgjeze të këtyre vendeve besimin te mbështetja e tyre për të përgatitur rezervën mbrojtëse të kontinentit amerikan dhe të kolonive që ajo do t'u grabiste aleatëve «që po ndihmonte» dhe të krijonte kështu së bashku me të gjitha ato një blok të fuqishëm kundër Bashkimit Sovjetik.

«Plani Marshall» me bashkëpunimin që rrodhi prej tij, ku më shumë e ku më pak, i hapi rrugën depërtimit të thellë të kapitalit amerikan në vendet perëndimore dhe kooperimit të tij të ngushtë me firmat e vendeve që po mëkëmbeshin ekonomikisht, duke mbajtur kështu nën kontroll dhe nën drejtimin e vet prodhimin e këtyre vendeve dhe drejtimin e zhvillimit të tyre. Kuptohet se tok me këtë drejtim Shtetet e Bashkuara të Amerikës krijuan në këto shtete rrjetin e tyre të fuqishëm të spiunazhit dhe të kundërspiunazhit, veçanërisht në ekonomi dhe në ushtri, pa përmendur këtu zhvillimin dhe përhapjen e mënyrës së jetesës ame-

rikane dhe mbushjen e këtyre vendeve me literaturë dekadente dhe pornografike. Imperializmit amerikan i interesonte që vendet evropiane të rimëkëmbeshin dhe ta ndienin veten sikur ishin të pavarura, por, në fakt, ai përpinqej dhe punonte që ato të ishin të varura prej tij.

Eshtë e qartë se në situatat që po zhvilloheshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës i bënин të gjitha këto veprime në bazë të prirjeve e të «simpatisë» ndaj njërit apo ndaj tjetrit vend, në bazë të besnikërisë që njëra apo tjetra klikë udhëheqëse e këtyre vendeve ushqente ndaj imperializmit amerikan.

Kështu Anglia mbeti aleatja më e afërt e Shteteve të Bashkuara, pavarësisht se këto i rrapën pasuritë dhe kolonitë e saj. Veç kësaj Anglia ishte e vetmja partnere e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në prodhimin e bombës atomike. Kjo nuk do të thotë se potenciali atomik anglez ndihej në mënyrë proporcionale me atë amerikan, por traktatet e mëparshme të vendosura nga Çërçilli dhe Etli e kishin lidhur Anglinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si një partner gjoja të barabartë.

Me Francën, Shtetet e Bashkuara të Amerikës u treguan «alcate» të saj, por jo aq të zellshme. Gjatë Luftës së Dytë Botërore Shtetet e Bashkuara u hodhën në pozita reaksionare përballë *La drôle de guerre*<sup>1</sup> të francezëve. Rusvelti për një kohë të gjatë mbajti ambasadorin amerikan të akredituar në Vishi dhe nuk tregoi asnjë interesim, bile shprehte mosbesim ndaj rezistencës së Francës dhe grupimit golist me qendër

---

1. Frëngjisht — luftë e çuditshme.

në Londër. Qysh në këtë kohë Dë Goli ishte në konflikt, natyrisht, jo të hapët, por të maskuar, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat, edhe kur invaduan Afrikën, nuk e trajtuan Francën, kolonitë e saj, njëlloj si aleatët e tjerë, ndërsa vetë Dë Golin e trajtuan si përfaqësues të një vendi të okupuar dhe si një personalitet pa kurrfarë kredie ndaj tyre. Rusvelti e shfaqi hapur këtë mosbesim kur thirri në Kazablanka edhe gjeneralin Dë Gol, edhe gjeneralin Zhiro, i cili kishte ikur nga kampet gjermane të përqendrimit, ishte dorëzuar tek amerikanët dhe këta e sollën në Algjer dhe e vunë përballë Dë Golit. Ky i fundit, natyrisht, u revoltua dhe vetëm pas shumë peripecish Shitetet e Bashkuara të Amerikës u detyruan ta abandononin Zhironë në favor të Dë Golit. Për këto arsyе pas çlirimtë të Francës, ky dhe gjithë grapi i tij e kishin humbur besimin te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sido që Franca qëndronte në organizatën agresive të NATO-s dhe si pjesëtare e saj lejonte zhvillimin e kooperimit ekonomik në mes dy vendeve.

Me Italinë dhe me Gjermaninë Perëndimore Shtetet e Bashkuara të Amerikës u treguan «shumë bujare», për arsyë se Italia në planet e saj do të bëhej një plas-darm i imperializmit amerikan, do të ishte ai shtet i mundur që do të zhytej më shpejt në një kaos ekonomik, në një degjenerim të thellë politik dhe do t'i lejonte kështu imperializmit amerikan që të kishte në këtë vend një pushtet të pakondicionuar.

Ndryshe ishin punët me Gjermaninë e Bonit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndihmuani fuqimisht dhe në mënyrë të veçantë për rimëkëmbjen e Republikës

Federale të Gjermanisë. Njëra pas tjetrës u zhdukën të gjitha gjoja pengesat e vendosura pas luftës, u rehabilituan shumë nazistë, u krijuan në këtë vend parti të ndryshme me etiketa pseudodemokratike, u rimëkëmb siderurgjia e madhe gjermane, u vendosën forca të mëdha ushtarake aleate brenda territorit të Republikës Federale të Gjermanisë, si dhe në Berlinin Perëndimor, të cilat u bënë koka e ndërhyrjes amerikane në Gjermaninë e Bonit. Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës një rol të madh do të luante dhe luajti në Evropë Republika Federale e Gjermanisë.

Vendet e tjera të Evropës Perëndimore, si Belgjika, Holanda, Luksemburgu apo Austria u zhvilluan, gjithashtu, nën hijen e kësaj potencë. Në këtë kuadër, pas shumë peripecish dhe ngjarjesh ndërkombëtare, u arrit në krijimin e Beneluksit, gjoja si një organizatë politike, ekonomike dhe koordinimi të ekonomisë dhe të politikës në njëfarë shkalle të tri vendeve të para, të cilat qëndronin nën këtë emër, por që qenë të lidhura ngushtë dhe të kondicionuara njëkohësisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Anglia, Franca dhe Gjermania Perëndimore.

I gjithë ky zhvillim, natyrisht u sillte të mira të mëdha Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por kishte edhe anën tjetër të tij se gjithë këto shtete, edhe pse vareshin me shumë fije nga imperializmi amerikan, gradualisht u mëkëmbën. Ligji i zhvillimit të pabarabartë të shoqërisë kapitaliste borgjeze krijon me domosdo kontradikta që e brejnë atë përbrenda. Ligji i fitimit maksimal shkaktoi në vendet kapitaliste të Evropës Perëndimore ringjalljen e tendencave cen-

trifugale, «të pavarësisë» ekonomike, bile dhe të asaj ushtarake. Të gjitha vendet e Evropës Perëndimore, pér sa i pérket mbrojtjes, kanë vazhdimisht frikën e një sulmi eventual nga ana e Bashkimit Sovjetik. Siç e thamë, këtë psikozë e kanë ushqyer dhe e kanë zhvilluar edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por e kanë nxitur dhe vetë shtetet borgjeze kapitaliste të kontinentit, pse ndiejnë nevojën e mbrojtjes dhe të vënies nën ombrellën atomike amerikane pér të përballuar forcën atomike sovjetike. Të gjitha këto shtete kapitaliste-imperialiste, siç na mëson Marksia, kanë si qëllim të fundit luftën, ndarjen e pasurive të botës, nxjerrjen e fitimeve sa më të mëdha pér vete dhe varfërimin e proletariatit botëror dhe të të gjithë popujve. Prandaj këto shtete lidheshin në këtë drejtim në NATO, që i zgjeroi radhët e saj me shtete të tjera kapitaliste, me synimin që të arrinte të rrethonte nga të katër anët Bashkimin Sovjetik.

«Besimi» te Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe te forcat e tyre ushtarake, kuptohet, nuk mund të ishte absolut dhe përgjithmonë. Mosbesimi ndaj tyre bëri që Dë Goli i Francës, me kalimin e kohës, të dilte nga NATO-ja dhe t'u kërkonte amerikanëve të largonin nga Franca, brenda një kohe sa më të shkurtër, çdo forcë dhe çdo organ të NATO-s. Kjo u vendos pastaj në Belgjikë. Natyrisht, një gjë e tillë shkaktoi një minus të konsiderueshmëm në këtë aleancë, sidomë që Franca nuk i shkëputi krejt lidhjet e veta prej saj. Pas asaj që bëri me NATO-n, tok me shtetet e tjera perëndimore, Franca u përpoq të krijonte Tregun e Përbashkët Evropian dhe «Evropën e Bashkuar».

Tregu i Përbashkët Evropian nuk ishte veçse një organizim i trusteeve kapitaliste të Evropës Perëndimore për të përballuar mosmarrëveshjet dhe grindjet e mëdha midis tyre në lëmin ekonomik dhe në fushën e tregtisë etj. Kjo organizatë ka për qëllim të krijojë njëfarë kooperimi dhe të bëjë njëfarë shpërndarjeje të mallrave të fabrikuara ose të prodhua rana vende të ndryshme, pa lejuar, sa të ishte e mundur, një konkurrencë të pafrenuar. U bënë për këtë ligje, u lidhën marrëveshje dhe u përcaktuan modalitetet pune e kontrolli mes tyre dhe shteteve të tjera jashtë Tregut të Përbashkët Evropian.

Imperializmit amerikan, natyrisht, nuk i interesonte një grupim i tillë, pse donte t'i manipulonte një nga një sipas interesit të vet shtetet e Evropës, por ai u gjend në pamundësi që të pengonte këtë proces. Megjithëse zyrtarisht gjenden jashtë Tregut të Përbashkët Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet pleksjes së kapitalit të tyre me kapitalin e seceilit prej vendeve që bëjnë pjesë në këtë organizatë, e bëjnë tërthorazi ligjin në këtë Treg. Më vonë, pas shumë diskutimesh, debatesh e kundërshtimesh, u pranuan në këtë organizatë edhe Anglia e vende të tjera.

Qëllimi i kësaj organizate reaksionare ishte gjetja e mënyrave të shfrytëzimit më të egër të proletariatit dhe të popujve të këtyre vendeve në fitim të trusteeve dhe të koncerneve të mëdha që eliminojnë ndërmarrjet e vogla e të mesme dhe për të penguar zhvillimin e krizave të mëdha të ardhshme që parashikoheshin të vinin në dëm të kapitalit botëror. Është e qartë se brenda në Tregun e Përbashkët Evropian çdo shtet pjesë-

marrës bënte të gjitha përpjekjet që të shtonte realizimin e prodhimeve të tij, të kthente çdo ligj dhe dokument të përbashkët në favorin e tij. Shtetet më të fuqishme kapitaliste në këtë organ janë përpjekur të imponojnë vullnetin e më të fortit. Një qëndrim të tillë ka mbajtur aty edhe Franca goliste dhe pasgoliste. Franca, me një ekonomi mjaft të zhvilluar dhe me një «kre-nari arrogant», kishte tendencën që të impononte vullnetin e vet në Tregun e Përbashkët. Ajo luftoi deri në fund që Anglia të mos pranohej në këtë organizatë pa pranuar kushte të rënda, për arsy se ajo do të bëhej një konkurrente e rëndësishme e financuar dhe e nxitur si kolonë e pestë nga ekonomia amerikane për të bërë ligjin më drejtpërsëdrejti në Tregun e Përbashkët. Sidoqoftë, rrethanat e krijuara e detyruan Francën të lëshojë pe dhe Anglia u bë më së fundi pjesëtare e Tregut të Përbashkët.

Gjermania e Bonit, në fakt, u zhvillua më shpejt nga të gjitha shtetet kapitaliste të Evropës, qoftë në NATO, qoftë në Tregun e Përbashkët, ajo u bë një fuqi e madhe ekonomike e ushtarake në Evropën Perëndimore dhe mbështetja kryesore e imperializmit amerikan dhe evropian. Franca goliste e shikonte këtë rrezik dhc natyrisht parashikonte se në të ardhmen mund të lindnin edhe armiqësitë e vjetra franko-gjermane në rast se revanshizmi gjerman, i fuqizuar nga imperializmi amerikan, arrinte kulmin e një force aggressive. Në këtë rast shikojmë të zhvillohet «një politikë afrimi» midis Dë Golit dhe Adenauerit, midis Francës dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Qëllimi i këtij afrimi, i cili u kristalizua në një sërë konsultimesh e

marrëveshjesh ekonomike dhe marrëveshjesh të tjera, ishte që këto dy vende jo vetëm të dominonin në Tregun e Përbashkët, por edhe të kundërshtonin e të frenonin, gjithashtu, imperializmin amerikan e Bashkimin Sovjetik revisionist. Në gjithë zhvillimin e kësaj politike të Tregut të Përbashkët, Shtetet e Bashkuara të Amerikës shikonin dhe ndienin një dobësim të pozitive të tyrc, prandaj janë përpjekur dhe do të përpilen që këto pozita t'i forcojnë, duke dobësuar Francën dhe duke forcuar më tej Gjermaninë Perëndimore dhe Anglinë, krahas robërimit të pjesëtarëve të tjerë më të dobët të Tregut të Përbashkët.

Pra, Tregu i Përbashkët Evropian, sipas pikëpmes sonë, është një grupim kapitalist për shfrytëzimin e egër të popujve të Evropës dhe të botës. Ai tok me NATO-n është një përgatitje dhe prapavijë e organizuar për të përballuar një luftë të tretë botërore kundër forcës tjetër socialimperialiste, Bashkimit Sovjetik revisionist. Tregu i Përbashkët solli varfërimin e popujve të këtyre vendeve dhe ndihmoi krizën botërore, pse marrëdhëniet tregtare të vendeve të ndryshme të botës u gjendën nën diktatin e dy superfuqive imperialiste dhe të grupimit të Tregut të Përbashkët Evropian, të cilët thihin pasuritë e popujve dhe u imponojnë atyre çmimet e lëndëve të para dhe të mallrave të fabrikuara.

Sidoqoftë imperializmi amerikan kishte dhe ka në Evropën Perëndimore një mbështetje të fuqishme kundër bllokut tjetër socialimperialist, me Bashkimin Sovjetik në krye. Në bllokun e shtcteve të Evropës Perëndimore nuk mungoi «të hynte» Frankoja, tash edhe

Portugalia, pa përmendur këtu Greqinë dhe Turqinë dhe jo zyrtarisht edhe Jugosllavinë, pse kjo, siç do ta shikojmë, është një shtet i varur edhe nga kapitali amerikan, edhe nga vendet e Tregut të Përbashkët.

Krahas Tregut të Përbashkët u krijua edhe «Evropa e Bashkuar», njëfarë «Komiteti i Evropës me parlament», me «qeveri të përbashkët», me disa ligje formale, që kanë për qëllim të krijojnë unifikimin shtetëror të vendeve evropiane. Synimi i krijimit të shteteve të «Evropës së Bashkuar», është asimilimi i nacionit të kombësisë së vendeve të ndryshme evropiane, integrimi dhe amalgamimi i kulturës dhe i traditave të tyre, me fjalë të tjera, zhdukja e personalitetit të popujve dhe të shteteve të Evropës Perëndimore nën drejtimin e borgjezisë reaksionare kozmopolite të këtij kontinenti, me një ushtri të përbashkët dhe të armatosur deri në dhërbë dhe me një ekonomi kapitaliste «të fuqishme», gjoja për të përballuar të dyja supersfuqitë.

Pra, «Evropa e Bashkuar», me synimin e saj reaksionar të dënuar me kohë dhe të demaskuar nga Lenini, orvatej të bëhej një forcë goditëse përballë revizionizmit sovjetik dhe ndaj imperializmit amerikan, një partner dhe aleat i singertë, por i barabartë me të. Natyrisht, qëllimi i këtyre organizimeve të ndryshme ndeshte çdo ditë dhe çdo vit në kontradikta të mëdha midis shteteve pjesëmarrëse dhe në daljen para tyre të shumë problemeve të pazgjidhshme ose të zgjdhshme me mballoma.

Përfundimisht, kriza e madhe botërore që mbuloi botën kapitaliste dhe revisioniste e thelloi akoma më tepër këtë kontradiktë, ajo tronditi ekzistencën e «uni-

tetit» të Tregut të Përbashkët Evropian dhe të «Evropës së Bashkuar». Përveç krizës botërore është çështja e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve revizioniste që thamë më sipër, që ngjalli te pjesëtarët më të fuqishëm të Tregut të Përbashkët dhe të «Evropës së Bashkuar» dëshirën e lidhjeve ekonomike dhe të emigrimit të kapitalit të tyre në ato vende ku kjo u sillte më shumë fitime.

Duhet thënë se vendet e Evropës Perëndimore, pavarësisht nga organizmat që krijuan, nuk mbeten pa bërë përpjekje të mëdha të veçanta që kush e kush të kapë sa më shumë koncesione dhe tregje në të gjithë botën. Kjo është, natyrisht, një konkurrencë që u bëhet dy superfuqive, por, në krahasim me forcën ekonomike, ushtarake dhe politike të dy të mëdhenjve dhe veçanërisht të imperializmit amerikan, ajo është e dobët. Kështu këto shtete të Evropës Perëndimore s'e ngjyen dot gishtin «në mjaltë» jo vetëm në fushën ekonomike në vendet në zhvillim, por edhe mendimi politik i tyre dëgjohet fare pak pér të mos thënë se nuk dëgjohet fare. Imperializmi amerikan ka krijuar një situatë të atillë, që ka eliminuar jo vetëm mundësitë e ndërhyrjes ekonomike të këtyre vendeve, por u ka mbyllur edhe gojën partnerëve të tij në aleancë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin aq të fuqishme sa brenda në Tregun e Përbashkët ngatërruan letrat e pjesëmarrësve, krijuan kriza, inosmarrëveshje dhe grindje në këto vende, gjë që u shërbeu atyre pér të zhvilluar më lehtë politikën e tyre imperialiste në botë dhe të kishin si të vetmin konkurrent politik, ekonomik dhe ushtarak Bashkimin Sovjetik. Siç e pa-

më, Bashkimit Sovjetik, me transformimet që u zhvilluan në këtë vend nga hruščovianët, iu hap oreksi për pushtimin e botës dhe për krijimin e perandorisë së vet. Ai duhet të krijonte për këtë qëllim mjetet e sulmit, prandaj u vuri rëndësi të madhe armatimeve, duke lënë shumë pas zhvillimin ekonomik të vendit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik u bënë tregtarët më të mëdhenj të armëve. Nëpërmjet tregtisë së armëve dha psikozës së luftës, të cilën e zhvillojnë me një forcë propagandistike të madhe, të dyja superfuqitë përpiken të depërtojnë në vende të ndryshme të botës, veçanërisht në Afrikë, në Lindjen e Mesme dhe në Azi, pse në Amerikën e Jugut dhe në Oqeani imperializmi amerikan kishte pozita të forta të vendosura që më parë.

Në këto vende të dyja superfuqitë konkurrojnë njëra-tjctrën dhe kanë suksese jo të barabarta dhe astë qëndrueshme, pse me gjithë psikozën e luftës që krijonin, me gjithë armët që shitnin, me gjithë propagandën e madhe që zhvillonin, popujt e këtyre vendove nuk gënjeleshin aq lehtë nga synimet e vërteta të tyre. Të dyja superfuqitë krijojnë e vendosin në këto vende klika gjoja me ngjyra çlirimtare, i vënë ato në konflikt me njëra-tjetrën për interesat e tyrc, për të forcuar sundimin e tyre në këto vende. Në të vërtetë qoftë imperializmi amerikan, në mënyrë të hapët dhe të egër, qoftë socialimperializmi sovjetik në mënyrë të egër, por të maskuar me një propagandë pseudosocialiste, acarojnë marrëdhëniet, nxitin dhe fryjnë kontradiktat mes popujve të ndryshëm dhe, në interes të vet, vendosin në këto vende baza detare, krijojnë aleanca

ushtarake, bëjnë marrëveshje tregtare skllavëruesc etj.

Një nga shembujt më tipikë të kësaj politike të të dyja superfuqive është Lindja e Mesme, ku çështja kryesore është ajo e naftës. Të dyja superfuqitë luftojnë kush ta ketë për vete naftën që ndodhet në këtë pellg të madh. Luftërat midis popujve arabë dhe Izraelit, gjendja në mes vetë popujve arabë, të përçarë e në mosmarrëveshje me njëri-tjetrin, janë rrjedhime të këtij problemi kyç, të përpjekjeve të të dyja superfuqive për të zaptuar burimet e naftës. Për këtë pasuri është derdhur dhe po derdhet gjaku i popujve arabë, në këto vende shiten armët edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe nga Bashkimi Sovjetik. Këtu gjoja ndahen të dyja superfuqitë, por në realitet ato atje puhën. Imperializmi amerikan ndihmon haptazi Izraelin për të mbajtur botën arabe të përçarë, Bashkimi Sovjetik gjoja ndihmon popujt arabë, duke u shitur armë, por nga ana tjetër dërgon me shumicë popullsi cifute sovjetike në Izrael, që do të thotë se me këtë ai i siguron këtij mish për top kundër popujve arabë.

Imperializmi amerikan, me gjithë pozitat e tij të qarta pro Izraelit, jo vetëm u përpoq dhe mbajti në drejtimin e vet «miqësinë» me Arabinë Saudite dhe me emiratet e Gjirit Persik, por minoi pozitat e sovjetikëve në këtë zonë, derisa arriti që Egjipti të denoncojë traktatin egjipto-sovjetik dhe të dëbojë nga portet e tij flotën agresive sovjetike. Kjo ishte një disfatë dhe jo fitore për socialimperializmin sovjetik. Tash në këtë pellg është politika amerikane që bën ligjin dhe dikton. Natyrisht as socialimperializmi sovjetik nuk rri duarlidhur, por përpinqet ta kompensojë humbjen në

Egjipt, duke ruajtur pozitat që ka akoma në ndonjë vend arab, ose duke kërkuar të sigurojë ndonjë bazë të re.

Për të ilustruar çfarë thamë më sipër, i dëbuar nga Egjipti, Bashkimi Sovjetik kapet nga Kadaфи, që kërkon të arrijë unitetin e gjithë popujve arabë nën flamurin e tij. Këtë ëndërr të tij e lavdërojnë sovjetikët për të marrë ndonjë bazë detare në Tripoli apo në Bengazi. Të njëjtën gjë po bëjnë sovjetikët edhe me Tunizinë, e cila deri tanë tregohet shumë prudente në këto manovra. Po këtë gjë bëjnë sovjetikët edhe me Algjerinë.

Pra, në këtë zonë ne shikojmë ndeshjen e dy superfuqive, por nuk mund të arrijmë në konkluzionin, siç bëjnë disa që thonë se socialimperializmi sovjetik është në ngritje, ndërsa imperializmi amerikan është në rënje. Në kontinentin afrikan lufta midis dy superfuqive sa po ka filluar dhe është larg që të ketë mbaruar. Por edhe atje imperializmi amerikan ka epërsi mbi socialimperializmin sovjetik. Imperializmi amerikan i ka hedhur atje bazat me kohë dhe interesat e tij imperialistë janë gërshtuar edhe me interesat e aleatëve të tij të Evropës Perëndimore, dhe së bashku përbëjnë një barrierë të fuqishme ndaj depërtimit sovjetik në këtë zonë. Ngjarjet e Angolës trumbetohen si «një sukses i madh» sovjetik dhe kjo i shërbën imperializmit sovjetik për t'u vetëquajtur gjoja si çlirimtar, por kjo u shërbën edhe imperializmit amerikan dhe gjithë kapitalizmit botëror, për të nxitur psikozën e frikës dhe të luftës antikomuniste, megjithëse komunizmi nuk ka të bëjë fare në këtë mes. Lufta

aktuale e popujve afrikanë është një revoltë kundër ndërhyrjes dhe grabitjes së dy superfuqive.

Afrika përbëhet nga shtete të vjetra dhe të reja, por të gjitha janë nga ato shtete, tek të cilat regjimi kolonial ka sunduar me vite të tëra. Ato kanë shpalillur lirinë dhe pavarësinë e tyre, për konsolidimin e të cilave duhet punuar e duhet luftuar shumë, por kjo është një çështje dekadash. Është një çështje që ka të bëjë me zgjimin e popujve të këtyre vendeve, të cilët ekonomikisht gjenden në mjerim dhe në prapambetje të madhe. Udhëheqjet e këtyre vendeve, ku demokrate, ku përparimtare dhe ku reaksionare, janë larg që të bëjnë vetë një politikë të pavarur dhe të ruhen nga synimet dhe nga ambiciet e dy superfuqive dhe gjithë botës tjetër kapitaliste. janë larg të bazohen në forcat e veta për forcimin e lirisë dhe të pavarësisë kombëtare dhe për zhvillimin e jetës shoqërore, ekonomike e kulturore të vendeve të tyre. Prandaj ne shikojmë që në Afrikë thuren e shthuren një mijë e një intrigë, zhvillohen ide reaksionare dhe «progresive», të qëndrueshme dhe të paqëndrueshme, me etiketë sovjetike dhe antisovjetike, por që nuk kanë asgjë socialiste.

Fuqitë e mëdha imperialiste i shfrytëzojnë shumë situatat e vështira ekonomiko-shoqërore të popujve, të vendeve e të shteteve të Afrikës. Edhe duke ruajtur formalisht pavarësinë e njërit apo të tjetrit prej tyre, superfuqitë u shesin këtyre vendeve armë dhe i nxitin kundër njëri-tjetrit, duke shfrytëzuar mëritë, kontradiktat, ndarjet tokësore, burimet e ujërave dhe deri

korridoret ajrore të këtyre shteteve. Këto janë intrigat pa mbarim që bëhen për të dobësuar rilindjen e këtij kontinenti të madh me një popullsi të mjeruar në shekuj, por me një kulturë të vjetër, me një forcë dhe energji të re, e cila nuk lejohet nga imperializmi e socialimperializmi të kanalizohet në rrugën e drejtë të përparimit, të lirisë, të demokracisë, të pavarësisë dhe të sovranitetit të plotë të këtyre shteteve.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës po ndeshen me Bashkimin Sovjetik edhe në vende të tjera të gadi-shullit të Indokinës. Deri tash shikojmë se Kamboxhia nuk po lejon ndërhyrjen e sovjetikëve në vendin e vet, por sovjetikët po forcojnë pozitat e tyre në Laos, Tajlandë, Filipine dhe gjetkë, pa harruar këtu pikëmbështetjen e tij të rëndësishme në Afganistan, në Indi etj.

Është e qartë se socialimperialistët sovjetikë e shikojnë se kanë më tepër shans të forcohen në vendet më të prapambetura të Azisë dhe të Afrikës dhe t'i gjenjejnë popujt e këtyre vendeve me sloganë socialistë, pseudosocialiste dhe me armatimet e me disa kredi që u japid. Kjo politikë sjell, natyrisht, rrëzimin e mbretërve, si në Afganistan, osc krizën e Bangladeshit, të kurdisur nga India dhe nga sovjetikët. Por, me kallimin e kohës, shikojmë se edhe në Indi, ku Hrushovi filloi të hidhte bazat e qëndrimit antikinez dhe të zhvillojë miqësinë me Nehrunë, me Lal Bahadur Shastrin dhe me Indira Gandin, aktualisht kjo miqësi qëndron nën predhat e imperializmit amerikan dhe rrezikohet të shkrihet. Forca ekonomike dhe ushtarake e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është më e madhe e më e fuqishme nga ajo e Bashkimit Sovjetik dhe, derisa

imperializmi amerikan i jep kredi edhe Bashkimit Sovjetik, ai i bën mirë llogaritë «se si e qysh do të forcohet shteti sovjetik» për të arritur qëllimet e tij imperialiste dhe për të nxjerrë nga pozitat e veta imperializmin amerikan kreditor të tij. Indira Gandhi dhe maharaxhatë indianë janë shumë larg që të kenë besim te sovjetikët përpara traditave kapitaliste angleze të mëparshme, përpara lidhjeve të tyre me to dhe tash me kapitalin amerikan. Sidoqoftë, edhe në këtë pellg të madh zhvillohen e thellohen kontradikta, pse këtu janë tregjet e mëdha dhe zonat e influencës që përpinqen të krijojnë të dyja superfuqitë.

Si konkluzion, siç mund ta gjykojmë nga zhvillimi i ngjarjeve, ne nuk mund të dalim në pikëpamjen se Bashkimi Sovjetik imperialist është në ngritje përballë imperializmit amerikan dhe, duke kaluar nga një gjykim i tillë i padrejtë, nuk mund të mbështetim imperializmin amerikan kundër imperializmit sovjetik, por ne duhet t'i luftojmë të dy njëlloj, për arsyen themelore vendimtare dhe parimore se të dyja këto shtete janë superfuqi imperialiste, armike të popujve dhe të lirive të tyre, armike të socializmit dhe të komunizmit.

Armiqtë e revolucionit e të proletariatit botëror, armiqjtë e popujve të shtypur që luftojnë për të fituar lirinë politike, ekonomike dhe të drejtat demokratike të vërteta, për një sovranitet të plotë të atdheut të tyre, janë imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe borgjezia reaksionare e çdo vendi. Këto fuqi përbëjnë dhe përfaqësojnë kapitalizmin e egër botëror, që e ka burimin dhe forcën në shfrytëzimin çnjerëzor

të masave dhe të popujve. Kundër këtyre fuqive të egra, kundër ideologjisë së tyre, kundër formave të ndryshme të organizimit të tyre, që nga partitë e ndryshme reaksionare dhe demagogjike, që nga trustet, koncernet shuinëkombëshe dhe organizmat e tjerë më të vegjël ndërkombëtarë dhe kombëtarë, që nga bankat dhe aleancat politike, ekonomike, ushtarake e deri tek ushtritë e tyre agresive dhe, më në fund, deri në shkattërrimin që nga themellet të pushtetit të tyre, duhet të organizohet dhe të zhvillohet lufta e ashpër dhe e vendosur.

Kjo luftë e pamëshirshme dhe e shumanshme duhet të bëhet nga të gjithë popujt e botës, nga të gjithë njërizit progresistë që kanë zemër e qëllim të luftës dhe të jetës interesat e vërtetë dhe integralë të popujve të tyre; kjo luftë e pamëshirshme duhet të bëhet dhe të udhëhiqet nga proletariati botëror dhe nga avangarda e tij, partia komuniste, që frysmezohet dhe udhëhiqet nga teoria e pagabueshme e marksizëm-leninizmit. Proletariati botëror dhe avangarda e tij duhet të ndërtojnë luftën e tyre në shkallë ndërkombëtare në bazë të teorisë marksiste-leniniste. Kjo do të thotë që proletariati ndërkombëtar dhe ai kombëtar dhe avangarda e tyre, të kenë strategjinë e tyre globale dhe taktika të ndryshme, sipas situatave të çdo vendi, sipas kohës, dhe këto të shërbejnë për programet minimale dhe maksimale, si ndërkombëtare, ashtu dhe kombëtare. Kjo është rruga e revolucionit botëror dhe e revolucioneve proletare të vendeve të ndryshme të botës.

Revolucioni botëror nuk është një çështje që do të fitojë sot me nesër. Jo. Deri në fitoren përfundimtata

re ai do të dojë shumë vjet, do të dojë gjak e sakrifica, do të ecë nëpërmjet zigzagesh, fitoresh dhe disfatash, nëpërmes sulmesh dhe tërheqjesh. Duhet punuar e luftruar dhe duhet organizuar puna për të, sepse edhe armiqtë e revolucionit luftojnë, punojnë, organizojnë dhe veprojnë kundër revolucionit. Antagonizmi i përgjakshëm ndërmjet revolucionit dhe kapitalit ekziston dhe do të ekzistojë deri në fitoren e të parit mbi të dytin.

Kundërshtarët e revolucionit luftojnë në platformë ndërkombëtare, përdorin të gjitha mjetet mendore, politike, ekonomike dhe ushtarake për dominimin e botës, për dominimin, skllavërimin dhe shfrytëzimin e popujve; ata përgatitin dhe shpërthejnë luftëra të padrejtë, të pjesshme dhe të përgjithshme, për të siguruar trengjet shfrytëzuese, për të ndarë dhe rindarë zona të influencës, sipas madhësisë dhe forcave të tyre ekonomiko-ushtarake.

Kundërshtarët e revolucionit luftojnë edhe në platformat kombëtare, ku fuqitë e mëdha agresive bashkëpunojnë me borgjezinë reaksionare, kompradore, të degjeneruar vendase. Duhet mbajtur kurdoherë parasysh se nuk mund të kalohet në revolucionin botëror pa kaluar nga revolucionet kombëtare. Duhet kuptuar se armiqtë kryesorë imperialistë dhe socialimperialistë kanë aleatë të ngushtë borgjezinë reaksionare të çdo vendi ku shtrihet influenca e tyre. Këta aleatë janë masha dhe kërbaçi i tyre që i ushqejnë dhe i armatosin për të krijuar forcën goditëse në një konflagracion botëror dhe kundër popujve që ngrihen në revolucion kundër shtypësve të brendshëm dhe të jashtëm. Prandaj këto dy forca nuk duhen parë të shkëputura nga njëra-

-tjetra, sepse pa luftuar njëren, nuk mund të luftosh tjetren, pa luftuar armikun e brendshëm, nuk mund të luftosh armikun e jashtëm. Duhet t'u shkatërrosh superfuqive të gjitha llojet e bazave që kanë vendosur dhe kanë krijuar në një vend, sepse kështu u ke dobësuar dhe u ke shkatërruar influencën dhe forcën botërore. që e bazojnë në sklavërimin e popujve dhe të vendeve. Fuqia e Samisonit qëndronte në leshrat e tij, prandaj këto leshra Dalila, thotë mitologjia, ia preu.

Për dobësimin e kësaj lufte çlirimtare në shkallë botërore dhe kombëtare superfuqitë imperialiste dhe partitë që kanë krijuar kapitali dhe borgjezia ndërmarrin një fushatë të përhershme demagogjike për të gjenjyer masat, për t'u ushqyer iluzionin se jetojnë në demokraci dhe u lejojnë atyre, në njësarë shkalle, derisa të mos arrijnë shkallën e rrezikshmërisë për ta, «lirinë e fjalës dhe të organizimit». Mbi këtë farë «demokracie borgjeze» qëndrojnë si shpata e Damokleut forca e armatosur goditëse, policia dhe të gjitha mjetet koncizive, që nga kushtetuta, ligjet dhe gjykatat, që u shërbejnë interesave jetikë të kapitalit dhe të borgjezisë.

Reaksiioni botëror dhe ai kombëtar me teori gjoja demokratike, i kanë inkadruar proletariatin dhe punonjësit në një organizim shumëformësh, në «sindikata» gjoja të shkëputura nga patronati dhe nga partitë e ndryshme «demokratike», «socialiste», «socialdemokrate». Këto të ashtuquajtura sindikata, të manipuluara, ku haptazi, ku në mënyrë të maskuar, nga partitë borgjeze osc nga pushteti i kapitalit, udhëhiqen nga aristokracia punëtore dhe nga ligjet që kanë të bëjnë me aktivitetin e me luftën e punëtorëve. Ato janë të ndër-

tuara dhe të dozuara nga kapitali i madh. Kur grevat e fuqishme shpërthejnë, ato kthehen nga liderët socialdemokratë ose revizionistë, në greva ekonomike dhe zbutin karakterin politik të tyre, me qëllim që të mos cenohen themellet e pushtetit kapitalist. Fillojnë diskutimet në mes aristokracisë punëtore dhe padronëve, ndërtohen kompromise në mes tyre, ndahen dividendë dhe në rast se nuk arrihet ndonjë rezultat, atëherë ndërhyn shteti borgjez me ligje, me dhunë, me kërbaç, shpërndan, thyen grevat dhe demonstratat.

Në momente krize të rëndë të fuqive imperialiste, socialimperialiste dhe të pushtetit borgjez të çdo vendi, hidhen në rrugë miliona punëtorë, inflacioni zhvillohet në mënyrë galopante, ngrihen çmimet e sendeve të nevojshme të jetesës. Varfëria shtohet nga një anë dhe, nga ana tjetër, pasurohen kapitalistët dhe kapitalizmi botëror, pra ndodh fenomeni i polarizimit, përtë cilin ka folur Marks. Në këto situata rreziku i fashizmit bëhet gjithnjë e më kërcënues dhe kur e ka të pamundur t'u bëjë ballë revoltave të punëtorëve dhe të popullit me format pseudodemokratike ose me metodat llafologjike të parlamenteve, kapitali, në qorr-sokak, ose çshtë i detyruar të falimentojë nën goditjet e forta të klasës punëtore, ose ai vendos diktaturën fashiste dhe ecën drejt luftës.

Kapitalizmi botëror, i zhvilluar drejt krizave dhe kalbëzimit, sig e kanë parashikuar klasikët e marksi-zëm-leninizmit, ka arritur në stadin e imperializmit të kalbëzuar dhe ka ndërtuar forma të atilla shfrytëzimi që krijojnë varfërimin e madh të masave në shkallë botërore dhe nationale, ka krijuar formën e fundit të

grabitjes, neokolonializmin, ka krijuar lidhje financiare dhe aleanca ekonomike e ushtarake për të pasur në varësi të plotë ose parciale shtete, që disa i quajnë të «botës së dytë» ose të «botës së tretë», disa të vendeve «të paangazhuara» ose të «vendeve në zhvillim». Të gjitha këto apelacione, që tregojnë forca të ndryshme politike që veprojnë në botë, nuk ndryshojnë asgjë në vijën e përgjithshme të problemit kyç dominues dhe të vctëm, në shkallë botërore dhe në shkallë kombëtare, luftës së pamëshirshme që zhvillohet ndërmjet botës kapitalisto-imperialiste dhe proletariatit botëror e aleatëve të natyrshëm të tij.

Kjo «ndarje» e këto emërtime, që qarkullojnë në botë, qoftë nga shtete dhe parti progresiste, bile, edhe nga parti komuniste, tregojnë, të shumitën, proporcionin e influencës dhe të forcës së kapitalit botëror ndërkom-bëtar ose kombëtar në shtete të ndryshme dhe zona të botës. Ato tregojnë, gjithashtu, pikat e mbështetjes më të forta ose më pak të forta të imperializmit dhe të socialimperializmit, por nga pikëpamja klasore ato asgjë tjetër nuk tregojnë, sepse në këto shtete ekzistojnë klasat antagoniste, ekziston shfrytëzimi i njeriut prej njeriut, mbi proletariatin dhe punonjësit e këtyre vendeve sundon borgjezia reaksionare ose liberale qoftë. Kjo borgjezi mbështet kapitalin vendas, shtyp klasën, shtyp demokracinë dhe lirinë. Apelacionet «bota e dytë», «bota e tretë», «vendet e paangazhuara» ose «vendet në zhvillim» janë krijesa kapitalisto-trockisto-revisioniste-socialdemokrate për të mbjellë në masat e gjera, që lustojnë, iluzionin se gjoja kanë gjetur një çati për të futur kokën nga kërcënimi i superfuqive. Ky është një

mashtrim teorik, këto janë teori reaksionarc dhe, në praktikë, vendet e «botës së tretë», «vendet e paangazhuara» ose «në zhvillim» nuk janë aspak të tillë, përkundrazi janë të pleksura dhe të varura politikisht, ideologjikisht, ekonomikisht me të ashtuquajturën botë të parë dhe të dytë. Duhet të jesh i verbër osc të jesh larguar nga bazat e teorisë marksiste-leniniste që të mos e shikosh këtë gjendje reale të të ashtuquajturave tri botë.

Titistët mbrojnë idenë e «vendevë të paangazhuara». Ç’do të thotë kjo? Sipas tyre këtu futen ato vendë që janë gjoja të lira dhë nuk janë angazhuar me traktate ushtarake me fuqitë e mëdha imperialiste dhe re-visioniste, kryesisht me NATO-n dhe me Traktatin e Varshavës. Por, pa qenë angazhuar formalisht në të tillë traktate, shumë nga këto shtete «të paangazhuara» janë plotësisht të angazhuara në një mori traktatesh e marrëveshjesh me superfuqitë e me fuqitë e mëdha kapitaliste, prandaj fjalë i paangazhuar tingëllon si një blof i vërtetë, pse të tillë vende «të paangazhuara» me udhëheqjet dhe organizmat që janë krijuar prej tyre, janë të varura në çdo pikëpamje nga fuqitë e mëdha, të cilat u japid kredi, u shesin armë, u kanë blerë at-dheun dhe pasuritë e tyre dhe u kanë lënë të mbajnë titullin «të paangazhuara».

Përveç asaj, midis shteteve që pretendojnë se janë të paangazhuara (edhe pse ndërmjet tyre dhe mes këtyre shteteve figurojnë edhe imperialistë) ekzistojnë traktate ushtarake, mbrojtëse dhe sulmuese. Asnjë nga këto shtete në fjalë nuk i ka denoncuar këto traktate. Të tillë janë SEATO, SENTO etj. Socialimperializmi

sovjetik përpinqet të krijojë traktat «për sigurimin aziatik», nesër për «sigurimin afrikan» etj. Të gjitha këto janë forma të ndryshme organizimi, me qëllim që një vend gjoja i paangazhuar të kthehet, në fakt, në një vend të urdhëruar nga çdo pikëpamje.

Të marrim disa shembuj që vërtetojnë tezat tona. Republika Federative e Jugosllavisë hiqet «vend socialist», «vend i paangazhuar», «vend në zhvillim», «vend i botës së tretë», sidom që këtë titull të fundit nuk e ka përvetësuar. E gjithë kjo është një blof. Jugosllavia nuk është vend socialist, por kapitalist, anarkist dhe vet-administrues, sipas teorisë antimarksiste të Bakuninit dhe Prudonit. Jugosllavia nuk është as vend i paangazhuar. Ajo ka një traktat të miqësisë dhe të ndihmës reciproke me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera revizioniste dhe, në qoftë se nuk gaboheni, këto traktate nuk janë denoncuar, janë në gjumë dhe mund të gjallërohen në momente oportune. Jugosllavia është krimbur në borxhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Sovjetik dhe me vende të tjera kapitaliste, të cilave me ligj u ka dhënë 49 për qind të aksioneve në veprat ku ato kanë bërë investime. Me fjalë të tjera, e gjithë Jugosllavia është pasuri e të huajve. Jugosllavia është vendi i portave të hapura, nga çdo pikëpamje, është e hapur për ideologjitet, për kapitalet e për spiunët e huaj. Nga të tjerët ajo blen armë dhe të gjithë njohin fuqinë mbrojtëse dhe ekonomike të saj. Jugosllavia i ka dhënë koncesione flotës sovjetike të vijë të ankorohet në portet e saj gjoja për t'u riparuar, gjoja për gjashtë muaj, por pas 6 muajsh e zënë vendin të tjera anije lufte.

Jugosllavia hiqet vend i lirë. I lirë është vetëm Titoja të bredhë me suita të mëdha në çdo vend të botës për të thurur dhe shthurur aleanca dhe intriga herë në shërbim të njërit imperialist, herë në shërbim të tjetrit socialimperialist. Çfarë lirie ka Jugosllavia kur të tjerët, kapitalistë, imperialistë, socialimperialistë, mbajnë në duart e tyre të gjitha kyçet e jetës së saj politike, ekonomike dhe të mbrojtjes? Dhe mbi gjithë këtë gërmadhë, Titoja ka krijuar sloganin «vendet e paangazhuara» dhe Jugosllavia titiste dhe Titoja vetë janë bërë teoricienët dhe kaporionët e këtij grupimi me qëllime reaksionare, fijet e të cilët luhen nga tjetër-kush në prapaskenë.

Slogani «vende të paangazhuara» është pjellë e kapitalizmit botëror, e imperializmit dhe e socialimperializmit. Kjo krijesë e tyre jep përshtypjen e rreme të krijimit të një grupei shtëlesh që kanë mundësi t'u kundërshtojnë blloqeve të superfuqive, të krijon përshtypjen se të gjitha ato vende janë antiimperialiste, kundër luftës, kundër diktatit të të tjerve, janë demokrate, bile edhe «socialiste» të çdo kallëpi dhe të çdo ngjyre dhe nga kjo anë lidhen dhe përdridhen edhe me «botën e tretë» edhe me «vendet në zhvillim».

Pse janë krijuar këta organizma në fakt pa organizim dhe me disa parulla politike ekuivoke? Arsyja qëndron në nevojën për të forcuar pozitat e grupeve drejtuese të këtyre shteteve të inkuadruara dhe pa asnjë efekt në këto grupime, të pozitave të tyre pseudodemokrate dhe antipopullore dhe t'u krijojnë popujve të këtyre vendeve përshtypjen se të gjitha marrëdhëniet, të çfarëdo lloji dhe të çfarëdo natyre, që krerët lidhin

dhe zgjidhin me imperialistët dhe socialimperialistët, haptazi ose fshchurazi, i bëjnë jo vetëm si qeveri popullore, por edhe si grupime shtetesh «me të cilat duhet të llogaritin edhe superfuqitë».

Ky organizim u përngjet sindikatave reformiste në vendet kapitaliste-revizoniste; të sindikuarit në këto grupime shtetesh janë popujt, siç janë në sindikatat punëtorët dhe punonjësit, kurse udhëheqësit e shteteve të këtyre grupimeve janë nga aristokracia punëtore, që qëndron në krye të sindikatave borgjeze dhc që janë kolaboratorët mië të afërt të patronatit. Në çështjen e sindikatave udhëheqësit borgjezë të tyre as kanë dhe as lejojnë të marrin armë punëtorët, kurse qeveritarët borgjezë të shteteve në këto grupime kanë armët dhe marrin armë nga padronët e tyre imperialistë-revizonistë, për të ndihmuar njërin ose tjetrën superfuqi dhe për të shtypur revoltën e popujve kundër tyre.

Pra këto grupime të quajtura «të paangazhuara» dhe «bota e tretë» janë variante borgjezo-revizoniste për të shtypur popujt dhe për t'i futur këta në luftë me njëri-tjetrin, për hatërin e njërs ose të tjetrës fuqi imperialiste.

Luftërat lokale të nxitura nga imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik zhvillohen në këto shtete, këtu përgatiten komplotë, këto janë molla e sherrit, këtu janë zonat e influencës të njërit dhe të tjeterit imperialist, këtu po futin duart të gjithë, të gjithë thonë fjalën e tyre, kurdisin dhe shkurdisin intrigë në kurriz të popujve, për të cilët ka kërbaç, varfëri, inflacion, papunësi, robëri, vdekje.

Popujt e këtyre vendeve të paangazhuara duhet

të janë «të lumtur», siç thotë Titoja, sepse janë «të paangazhuar» dhe vendet e «botës së tretë» që deklaroj zyrtarisht në OKB djathtisti dhe tradhtari i marksizëm-lenismit, Ten Hsiao Pini, duhet të janë «të kënaqura», se janë në «botën e tretë» dhe në këtë «botë të tretë» bën pjesë zyrtarisht dhe Kina. Partia Komuniste e Kinës, sipas mendimit tonë, këto probleme jetike për të, për socializmin dhe për botën nuk i shikon drejt dhe nuk vepron drejt. «Bota e tretë», që mbron Kina, nuk ka asnë bazë teorike, parimore dhe marksiste-leniniste. Një grumbullim i tillë i shteteve përgon zhvillimin e revolucionit dhe i fut të gjitha në një thes, duke sheshuar kontradiktat e shumta që ekzistojnë në vendet e kësaj «bote të tretë», konfondon dhe shuan, jo në rrugë marksiste revolucionare, kulturat e ndryshme nacionale, afilitetin dhe kontradiktat që ekzistojnë, si ndërmjet popullit dhe udhëheqjes së tij brenda vendit, ashtu dhe kontradiktat antagoniste me shtetet e tjera.

Izraeli është vend agresor, por, sipas teorisë së «tribotëve», për këtë shtet duhet të përcaktosh definicionin e pjesëtarit të «botës së tretë». Për amerikanët dhe për shumë të tjerë Izraeli nuk është agresor, ai, sipas tyre, «lufton për ekzistencën e vet», pra, mund të jetë i «botës së tretë». Regjimi i Pinochetit mbështetet nga Kina, pra edhe Kili është një shtet i «botës së tretë». Jo, thonë të tjerët. Po atëherë, vihet pyetja pse të jetë në «botën e tretë» Indonezia, regjimi reaksionar i së cilës vrau 500 000 veta, pse të jetë në të, gjithashtu, India e Indira Gandit që sulmoi Pakistanin Lindor? Kinezët mund të thonë, «ne kemi parasysh vendin dhe jo udhëheqjen».

Kjo nuk është një pamje klasore e problemit. Kina bën gabim teorik që e ka konfonduar veten e saj me «botën e tretë».

Udhëheqja kineze nuk duhet ta vërë veten as me Frankon, as me Pinoçetin, as me Titon, as me Golda Mejerin. Marrëdhënie Kina mund të ketë dhe duhet të ketë me të gjitha shtetet, por këto marrëdhënie të shihen nga ana klasore, që t'u shërbejnë vetë Kinës, socializmit dhe revolucionit. Kina sulmon me të drejtë Izraelin dhe nuk sulmon, por i ndihmon, Pinoçetin, Frankon, Titon e të tjera. Sipas mendimit tonë, kjo nuk është një politikë marksiste-leniniste. Siç e ka thënë Gën Biaoja, Kina ndjek këtë politikë: «Armiqtë e armiqve tanë janë miqtë tanë». Kjo pikëpamje është antimarksiste, antirevolucionare, antiproletare dhe kundër lirisë së popujve dhe luftërave nacionalçlirimitare.

Aktualisht, Kina ka deklaruar se Bashkimi Sovjetik është armiku kryesor i popujve, kurse imperializmi amerikan po dobësohet, po tërhiqet, prandaj, sipas politikës kineze, pa dallim, të gjithë ata, kushdo qofshin, por që janë antisovjetikë, janë miqtë e tyre, dhe si të tillë cilësohen prej tyre krerët e imperializmit amerikan, krerët konservatorë anglezë, shahu i Iranit dhe djalli me të birin.

Pse kjo pikëpamje është antimarksiste? Sepse kjo nuk i shikon problemet botërore me syrin klasor. Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe borgjezia reaksionarc e kompradore janë armiqtë e proletariatit, të popujve, të socializmit dhe të komunizmit. Këto fuqi dhe ideologjia e tyre nuk mund të konside-

rohen në asnë rast as miq, as aleatë, por armiq dhe si të tillë duhen luftuar.

Miq dhe aleatë të vendeve të vërteta socialiste, që udhëhiqen në çdo gjë nga marksizëm-lininizmi shkencor, janë proletariati botëror, popujt përparimtarë të botës me fshatarësinë e varfër dhe të mesme dhe me të gjithë njerëzit progresistë, me shtetet demokratike përparimtare revolucionare, të gjithë ata që janë kundër dy superfuqive dhe borgjezisë reaksionare vendase.

Politika e jashtme e Kinës, që është një politikë proamerikane dhe pro të gjitha atyre shteteve dhe njerëzve që mbrojnë imperializmin amerikan, nuk mund të konsiderohet veçse një politikë e gabuar e një shteti të madh, që synon të luajë jo vetëm rolin e një shteti të madh me një politikë jomarksiste, por të bëhet dhe ajo një fuqi e madhe e tretë në botë dhe të vendosë nga duhet të anojë balanca.

Kina e fillimit të viteve 50-të mendonte se imperializmi amerikan ishte më i egri dhe «arbitri» i fateve të njerëzimit. Pas vitit 1957 Kina filloi të mendojë se Bashkimi Sovjetik po forcohej, natyrisht, duke e errësuar rolin e Kinës. Pas viteve 60-të Bashkimi Sovjetik filloi të bëhej superfuqi dhe Kina i luftonte edhe atë, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, derisa arriti në pozitat e sotme, kur Kina pretendon se Bashkimi Sovjetik u bë më i fuqishëm, ndërsa imperializmi amerikan, sipas saj, u dobësua. Me fjalë të tjera, për Kinën balanca u prish dhe ajo, në rrugë jo të drejtë, duhet të bëjë politikën e «baskulës» që praktikonte imperializmi anglez në kohën e lulëzimit të tij.

Çështjen e drejtë që vendet socialiste duhet të the-

Ilojnë kontradiktat ndërmjet armiqve, për t'i dobësuar këta, çështje që Kina e trumbezon shumë, ajo nuk e zhvillon në rrugën klasore, por vetëm në interes të shtetit të saj dhe me propagandën që po bën, ajo nxit një luftë të tretë botërore mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara, që nuk mund të jetë veçse një luftë grabitqare në dëm të mbarë njerëzimit dhe të Kinës vetë.

Partia jonë u qëndron fort tezave të Marksit dhe të Leninit mbi luftërat grabitqare imperialiste, të cilat duhet të luftojnë të mos shpërthejnë, por në qoftë se nuk i ndalojmë dot, atëherë vija jonë është që revolucionarët dhe proletariati t'i kthejnë këto në luftëra çlirimtare.

Kështu si i ndajnë kampet emisarët e qeverisë dhe të Partisë Komuniste të Kinës të çojnë në rrugë shumë të gabuar. Kjo rrugë shuan luftën e proletariatit dhe të punonjësve kundër borgjezisë shtypëse të vendeve të tyre, e cila është e lidhur ose me NATO-n, ose me Traktatin e Varshavës, ose me Tregun e Përbashkët dhe «Evropën e Bashkuar», ose me KNER-in. Ata u thonë haptazi partive marksiste-leniniste në Perëndim dhe gjithë komunistëve dhe njerëzve përparimtarë: mbështetni borgjezinë e vendit dhe ushtrinë e saj kundër revizionizmit sovjetik, domethënë, bëhuni me NATO-n kundër Traktatit të Varshavës. Ata janë në pozitat e partive të Internacionales së Dytë.

Të jesh kundër përgalitjes së luftës grabitqare imperialiste do të thotë të kuptosh dhe të veprosh me një organizim të fortë, me shumë sakrifica dhe me një perspektivë të qartë, për të të gërryer, dobësuar, denora-

lizuar, shkatërruar dhe sabotuar me një mijë lloj formash të gjitha përgatitjet për luftën imperialiste, do të thotë të demaskosh politikën demagogjike të imperialistëve me të gjitha format e mundshme. Duke vepruar kështu dobësohen përgatitjet për luftëra grabitqare imperialiste.

Po kush do ta bëjë këtë luftë kundër luftërave të padrejta dhe grabitqare? Natyrisht s'ka kush e bën vëçse proletariati, fshatarësia në aleancë me të dhe e udhëhequr nga ideologjia marksiste-leniniste. Kjo ideologji na orionon drejt, sepse analizon shkencërisht momentet, parashikon drejt aleancat, ka parasysh forcat në përpjekje; në bazë të saj mund të caktohen drejt programet minimale dhe maksimale, përcaktohen drejt strategjia e luftimeve dhe takтикat e ndryshme; ajo na mëson kur duhet sulmuar dhe kur duhet tërhequr për të risulmuar e për të fituar betejat; na mëson mënyrat e ndryshme të luftimeve, legale dhe ilegale; na mëson se si të luftojmë edhe kur jemi inferiorë, edhe kur jemi superiorë mbi armikun.

«Teoritë» kineze që po zhvillohen nga emisarët e Partisë Komuniste të Kinës aktualisht jo vetëm që nuk i marrin parasysh këto parime të drejta, por këshillojnë të kundërtën e tyre. Këto pikëpamje të tyre bien erë nacionalizëm të një shteti të madh që, i njojur si një vend socialist, i maskon këto ide të gabuara me «ngjyrën e kuqe». Kinezët mund të mendojnë: «Bëni kështu si themi ne tash, lëreni çështjen e revolucionit për më vonë, kemi kohë, tash të thyejmë një herë sovjetikët, pastaj i kthehem Amerikës dhe revolucionin e kemi në xhep». Duke parë këto qëndrime e veprime të Ki-

nës, njeriu nuk ka përsë të mos nxjerrë konkluzionin se ato janë qëndrime dhe veprime absurde dhe të padrejta.

Kinezët, sidomë që në realitet janë kundër Stalinit, pavarësisht se mbajnë portretin e tij në sheshin «Tien An Men», fshihen pas tij dhe thonë: «Edhe Stalini ka bërë një politikë të tillë, ai nënshkroi traktatin e mos-sulmimit me Gjermaninë hitleriane, prandaj pse na kritikoni ne dhe nuk kritikoni Stalinin?».

Partia jonë mendon se Stalini nuk gaboi, por e nënshkroi atë marrëveshje në orën e fundit, kur Franca nuk mbajti angazhimet ndaj Çekoslovakisë, kur Hitleri kishte zaptuar Austrinë dhe bëri «Anschluss»-in, kur Anglia dhe Franca bënë Munihun dhe bënë çmos ta drejtonin Hitlerin kundër Bashkimit Sovjetik, duke refuzuar të nënshkruan një traktat antihillerian me të. Bashkimi Sovjetik dhe Stalini, vetëm përfshirë fituar kohë e nënshkruan traktatin, të cilin e shkeli Hitleri. Por kurrë Stalini nuk i konsideroi miq e alcatës as fashizmin italian, që zaptoi Abisininë dhe Shqipërinë, as nazizmin gjerman, as imperializmin amerikan, anglez, francez dhe as borgjezinë reaksionare botërore. Shkrimet e tij janë monumente të pashlyeshme dhe as revolucionarët, as kapitalistët nuk mund t'i zhdukin. Stalini çdo gjë gjatë luftës e ka parë në prizmin klasor. Edhe aleancën antifashiste ai e pa dhe e zhvilloi në prizmin klasor, gjithashtu, marrëveshjet konkluzive të pasluftës i pa dhe i vendosi brenda mundësive të krijuara, në prizmin klasor, në prizmin e marksizëm-leninizmit, në interes të popujve. Akuzojnë borgjezia dhe titistët se Stalini në Jaltë «ndau zonat e influencës» me aleatët,

por edhe Leninin menshevikët dhe imperialistët anglo-francezë e akuzonin për traktatin e Brest-Litovskit. Stalini në Jaltë nuk sakrifikoi asnjë popull që aspironte për l'u çliruar.

Situata të çuditshme! Kinezët thonë të mbështetim Amerikën dhe NATO-n kundër sovjetikëve. Kisingeri me anën e Sonnerfildit deklaron që «të mbretërojë imobilizimi, Bashkimi Sovjetik të ruajë zonën e influencës mbi shtetet lindore dhe këto të mos shpejtohen e të shlikëputen prej tij» etj. Me fjalë të tjera, Amerika është për forcimin e pozitave të Bashkimit Sovjetik në Evropën Lindore dhe Evropën Perëndimore, nre siguri në marrëveshje me Bashkimin Sovjetik, e ka zonën e vet të influencës. Ç'del këtej nga kjo deklaratë e köshilltarit të Kisingerit, që shpreh këto teza në mbledhjen e ambasadorëve amerikanë në Evropë?

E para, pakënaqësi në vendet e Evropës Lindore, që kisnin shpresë në një shkëputje nga Bashkimi Sovjetik e që vetë Fordi e kishte deklaruar se ishte për independentë e tyre.

E dyta, pakëraqësi në vendet e Evropës Perëndimore, të cilat vilhen përpëra një dileme: «Ose të nënshتروheni nën diktatin amerikan, ose unë, Amerika marr rrugën e izolacionizmit dhe, po të doni, ju mbrohuni vetë kundër një sulmi eventual sovjetik». Amerika nuk lejon që partitë revizioniste të këtyre vendeve të marrin pjesë në qeveritë, pse ndryshe NATO-ja prishet.

E treta, kompromis ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik për të qëndruar në statukuonë në Evropë.

E katërtë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i thonë Bashkimit Sovjetik: drejtoji armët nga Kina.

E pesta, ne Shtetet e Bashkuara, jemi aleatë të Kinës, po i japim asaj kredi dhe armë që t'i drejtojë kundër Bashkimit Sovjetik.

E gjashta, Kina deklaron me gojën e kryeministrit të ri se «politika e jashtme e Kinës nuk do të ndryshojë, bile do të bëhet dhe më e mirë» dhe këto i thotë këto ditë, kur vajtën në Kinë 10 kongresmenë për t'i akorduar armë e kredi dhe kur më pas, në maj, do të shkojë vetë Shlezingeri, ish-ministër i Mbrojtjes i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe tanë udhëheqës i koncerneve amerikane të armëve.

Shlezingeri deklaroi haptazi që Kina e Mao Ce Dunit është aleatja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, prandaj duhet t'i japim kredi dhe armë, siç i jepen edhe Bashkimit Sovjetik.

Kina tash, siç duket, nuk ndjek rrugën e ecjes përpara me këmbët e veta, po ecën dhe me këmbët e amerikanëve. Me siguri kinezët edhe për këtë do të thonë se ndjekin rrugën e Leninit, sepse edhe ai, sipas tyre, «pranonte kredi nga të huajt». Por Leninin ata nuk e përlyejnë dot, Lenini është i pastër si qelibari.

Kinezët hynë në atë rrugë dhe në ato kllapa, në të cilat u futën dhe revizionistët sovjetikë kur tradhtuan marksizëm-leninizmin. Aktualisht në Kinë as mund të kuqtoh kush drejton, ç'vijë ndiqet, atje ç'tuhet sot, nuk thuhet nesër, flitet shumë në emër të Maos, «këtë e lha Maoja», «këtë e bëri Maoja», vetëm se populli është në rrëmujë, partia është në rrëmujë, por kjo rrëmujë dhe paqartësi ideologjike e politike po përhapet

në botë, armiku po i frysni zjarrit kurse miqtë revolucionarë s'dinë ç'të thonë. Ata duan të flasin, por kanë frikë se mos prishin punë.

Një punë armiqësore dhe e turbullt po zhvillohet në Kinë dhe ka po të njëjtat reperkusione në botë.

Fakt është se kinezët kanë humbur toruan, drejtimin, orientimin. Tymi ka mbuluar një popull dhe një parti që ne i kemi dashur dhe i duam, por vetëm në rrugën marksiste-leniniste dhe me një shoqëri të vërtetë socialiste.

Në vazhdim të asaj çka thashë më sipër, qëndrimet e Partisë sonë kanë qenë vazhdimit të bazuara, në kohë dhe për ngjarje të ndryshme, në ideologjinë marksiste-leniniste. Partia jonë ka mbajtur për çdo gjë qëndrime të drejta dhe ka armatosur anëtarët e saj me një vijë të qartë, pa lejuar as konfuzionin më të vogël në gjykimin e çdo problemi ndërkombëtar. Këto gjykime kanë qenë konkluzione të analizave, të cilat nuk janë të bazuara vetëm në koniunkturat ndërkombëtare, por edhe kombëtare dhe sidomos në vijën marksiste-leniniste që udhëheq strategjinë dhe taktikën e Partisë.

Partia e Punës e Shqipërisë ka zhvilluar dhe deri në fund do të vazhdojë të bëjë një luftë ideologjike parimore kundër revizionizmit modern, në çdo formë që ai të shifqet. Ajo ka demaskuar dhe demaskon parështur veprimitarinë keqbërëse, antimarksiste, shoviniste dhe kundërrevolucionare të revisionistëve sovjetikë. Kjo luftë i ka armatosur anëtarët e Partisë sonë dhe i ka bërë ata edhe më të ndërgjegjshëm për rrezi-

kun e madh të revizionizmit modern sovjetik dhe të adeptëve të tij.

Partia jonë ka bërë, gjithashtu, një propagandë të zgjuar marksiste-leniniste edhe në botën e jashtme të bazuar në dokumente, në fakte dhe me arsyetime të padiskutueshme për të demaskuar revizionistët sovjetikë dhe revizionistët e tjera dhe për të dhënë njëkohësisht pikëpamjen marksiste-leniniste të saj në një frymë revolucionare për luftën që duhet bërë kudo kundër këtij armiku të rrezikshëm të socializmit dhe të komunizmit.

Kështu Partia jonë ka kontribuar në demaskimin e revizionistëve sovjetikë edhe të manovrave që ata përdorin. Këtë kontribut e kanë gjykuar dhe e kanë vlerësuar proletariati e revolucionarët në botë. Partia jonë ka analizuar, gjithashtu, veprimitarë ekonomike, ushtarake, si dhe çdo veprimi tjetër që kryejnë revizionistët hruščovianë për të mbajtur nën zgjedhë popujt e vendeve të tjera revizioniste. Ajo ka parashikuar me kohë se revizionistët modernë, qofshin këta sovjetikë, qofshin jugosllavë e të tjerë, do të punonin, në radhë të parë, për të shkatërruar sistemin socialist jo vetëm në vendet ku ata erdhën në fuqi, por do të bënin, sikurse edhe bënë, të gjitha përpjekjet për të luftuar e për të shkatërruar socializmin edhe në Shqipëri e gjetkë. Partia jonë parashikoi, gjithashtu, se këta armiq të egër të marksizëm-leninizmit do të punonin për të dobësuar dhe për të zhdukur besimin që proletariati botëror dhe njerëzit përparimtarë kanë në idetë e Marksit, Engelsit Leninit dhe Stalinit, në shoqërinë e ardhshme socialiste e komuniste.

Këto arsyetime që pati për këta tradhitarë Partia e Punës e Shqipërisë, tashmë i ka vërtetuar jeta. Jeta ka vërtetuar, gjithashtu, se partitë që përqafuan revisionizmin nuk janë më parti komuniste. Ato nuk udhëhiqen nga teoria shkencore e marksizëm-léninizmit, por nga teori antimarksiste, me përbajtje dhe formë të bastarduar, sido që disa prej tyre, për t'u maskuar, përpinqen të ruajnë pak a shumë format marksiste-léniniste.

Partia e Punës e Shqipërisë ka parashikuar e ka denoncuar se revisionistët sovjetikë do të degjenerojnë, siç degjeneruan, dhe se do t'u hapin rrugën ideve borgjeze reaksionare në vendin e tyre dhe metodave të huaja për proletariatin për të shfrytëzuar popujt e tyre.

Partia e Punës e Shqipërisë ka parashikuar e ka denoncuar se revisionistët modernë do të shkaktojnë konflikte kombëtare brenda në çdo shtet revisionist, ku ekzistojnë, të federuara, republika me kombësi të ndryshme ose minoritete kombëtare, se në to do të dominojë kombi më i madh dhe më i fuqishëm, kurse të tjerët do të shtypen dhe do të shfrytëzohen pasi me degjenerimin e rendit socialist në to, do të mbretërojnë ligjet kapitaliste.

Partia e Punës e Shqipërisë ka parashikuar me kohë se nuk mund të ekzistojë unitet mes shteteve ku në fuqi janë revisionistët, si dhe midis partive revisioniste, sepse nën parullën se janë «të pavarura», «sovranë» dhe «të zonjat» për të drejtuar dhe për të udhëhequr, për të zbatuar vëtë, në kushtet e vendit të tyre, teorinë marksiste-léniniste, jo vëtëm do të shkë-

puteshin nga Bashkimi Sovjetik dhe nga e ashtuquajtura familje socialiste, por do të hynin, siç kanë hyrë, në konflikte të papajtueshme me njëra-tjetrën. Kështu kishte ndodhur edhe në kohën e Leninit, me ndarjen e madhe që ngjau në partitë e Internacionales së Dytë, kur proletariati nxori nga gjiri i tij parti të reja, që i qëndruan besnikë marksizëm-leninizmit.

E njëjtë gjendje u shkaktua edhe në kampin revisionist. Revisionistët hrushovianë menduan se «uniteti» me revisionistët e vendeve ku ata janë në fuqi, do të mbahej me anën e forcës ushtarake, ekonomike, ashtu dhe me anën e subvencioneve të fshehta që u jepnin partive të vendeve kapitaliste për t'u bashkuar me ta «në luftën kundër imperializmit dhe borgjezisë». Qëllimi i partisë revisioniste sovjetike ishte që të mbante të bashkuara rreth vetes gjithë partitë e tjera revisioniste, që me këtë bashkim t'u bëhej ballë jo vetëm kundërshtimeve ideologjike dhe politike të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Partisë Komuniste të Kinës dhe të partive të tjera marksiste-leniniste, por edhe fuqisë konkurruese të imperializmit amerikan.

Parullat e revisionistëve sovjetikë nuk i hëngri kush. Jeta tregoi se partitë revisioniste, në brendi, nuk ishin dhë nuk janë dakord me partinë revisioniste sovjetike. Tani kjo bën përpjekje që të ruhen format, por edhe këto çalojnë dhe kështu patericat mbi të cilat mbahet uniteti revisionist, thyhen.

Orvatje të shumta janë bërë nga ana e revisionistëve sovjetikë për të thirrur mbledhjet e partive «komuniste» të botës, në të cilat të afismohej «uniteti» i tyre ideologjik «marksist-leninist», po këto orvatje

kanë qenë njëloj sikur të bësh një stan me lepuj. Pavarësisht nga disa mbledhje që janë bërë dhe nga vendimet që janë marrë në to, në fakt asnjë parti nuk i zbaton ato, sepse gjithsecila punon sipas kokës së vet, në rrugën antimarksiste. Partia revizioniste sovjetike përpinqej dhe diku ia arrinte, diku jo, që të ruante disa forma bashkëpunimi ideoologjik formal në suazën e perandorisë hruščoviane, ajo nuk shkonte më drejt socializmit, por drejt zhvillimit të borgjezisë së re kapitaliste në Bashkimin Sovjetik dhe, për analogji, edhe në vendet e tjera ku janë në fuqi revizionistët.

Ideja revizioniste hruščoviane, që u trumbetua me të madhe, sipas së cilës tashmë paska kaluar koha e revolucioneve proletare me dhunë dhe se pushteti mund të merret nga duart e borgjezisë «në rrugën paqësore», «në rrugën parlamentare», u erdhi shumë për hosh revizionistëve të vendeve të ndryshme të botës. Duke e shfrytëzuar këtë ide, ata ndërtuan strategji dhe takтика të atilla, që mendonin se do t'i ndihmonin për të fituar besimin e borgjezisë së tyre, e cila do të shihte se tashmë komunistët janë zbutur, se nuk ekziston më rreziku i vjetër që predikonin Marksit dhe Lenini, se revolucioni i tyre do të jetë një revolucion «paqësor», «reformist», «humanitar».

Këtoj lindën një varg teorish në Francë, në Angli, në Gjermani, në Itali e gjetkë jo vetëm të frysmezuara nga partitë revizioniste të këtyre vendeve, por edhe nga grupime të tjera, që nuk kanë të bëjnë fare me socializmin shkencor, por, për të krijuar dhe për të ndihmuar përcarjen dhe konfuzionin në lëvizjen ko-

muniste dhe punëtore ndërkombe të, paraqiteshin me parulla mëngjërashe, e hiqnin veten si revolucionare, por në fakt vepronin për të përforcuar pushtetin e borgjezisë kapitaliste. Teoritë anarkiste prudoniste lulëzuan në të katër anët, trockizmi u bë i modës. Gjithë kjo situatë, natyrisht, krijoj një turbullirë të madhe në mendjen e njerëzve, turbullirë që fuqizohet nga propaganda e përditshme e kapitalit dhe nga mënyra e jetesës që zhvillohet në vende të ndryshme kapitaliste.

Këto çështje, natyrisht, sikurse ka thënë Partia jonë, kanë pasur për synim dobësimin «e shkopit të dirigjentit». Duke qenë të përçarë, «dirigjenti» nuk ka më kë të drejtojë. Ato parti që drejtonte në shtetet e tjera revizioniste dhe që i mbante nën kërbacin dhe frikën e ushtrisë sovjetike që okupon këto vende ose në partitë e vendeve kapitaliste që i mbante me subvencionet e fshehta të dërguara nga Moska, nuk mund të mbaheshin për shumë kohë dhe, nga qëndrimet disidente, disa haptazi arritën të deklarojnë «teoritë» e tyre socialiste. Këtu arriti partia revizioniste italiane me «kompromisin historik» dhe më vonë ish-Partia Komuniste Franceze e cila në kongresin e fundit hodhi poshtë haptazi teorinë e diktaturës së proletariatit dhe të luftës së klasave. Këto dy parti, të ndjekura dhe nga shumë parti të tjera, si ajo e Anglisë, e Belgjikës dhe e Spanjës, u shkëputën haptazi nga partia revizioniste sovjetike, midis tyre filloj polemika formale për hegemoni dhe jo për «unitet».

Pse e hodhën këtë hap këto parti revizioniste? Partitë revizioniste, si ajo e Italisë dhe e Francës, e

hodhën këtë hap se janë, në radhë të parë, parti të borgjezisë. Por ato, duke pasur prejardhjen e tyre nga partitë e vjetra komuniste, përpinqen të bindin borgjezinë e vendeve të tyre se janë të disponuara plotësisht të marrin pjesë në qeveri dhe të hyjnë në lojën e demokracisë kapitaliste. Ato e bëjnë këtë edhe për t'i treguar borgjezisë së vendit se i shkëputën marrëdhëni e vjetra me «Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik», se tashmë «ka perënduar koha e unitetit internacionalist». Këta tradhtarë pasardhës të Bernshtajnit, që nga Titoja, Berlingueri e Marsheja, për t'u maskuar, hiqen se janë «internacionalistë», ata thonë se internacionalizmi proletar me gjithë mos-marrëveshjet, duhet të ekzistojë i pacenuar, por në realitet ky është një blof, sepse te këta armiq të komunizmit nuk ekzistojnë as fijet më të holla të internacionalizmit me socialimperialistët sovjetikë dhe me asnjë parti tjeter të revizionizmit modern, të tërë janë shkoqur e janë shkëputur me njëri-tjetrin, pikërisht se janë antimarksistë dhe s'mund të jenë internacionalistë, por kjo është një përpjekje vetëm sa për të ruajtur format e «një uniteti» që nuk ekziston. Ky është një kuptim ideologjik krejt i kundërt me atë nocion të madh të internacionalizmit proletar që predikonin Marks, Engels, Lenini dhe Stalini.

Në këtë çarje flagrante të pashmangshme dikush sa për sy e faqe mbron formën «e diktaturës së proletariatit», siç veprojnë revizionistët dhe partitë e vendeve që bëjnë pjesë në të ashtuquajturën familje socialiste; të tjerë hedhin poshtë këtë maskë, siç bëjnë Marsheja, Berlingueri dhe Karriljoja. Në fakt nga

ana e revizionistëve të Moskës, ky është një blof, sepse diktatura e proletariatit nuk ekziston më as në Bashkimin Sovjetik dhe as në vendet e Evropës Lindore. Atje ekziston vetëm një diktaturë, diktatura kapitaliste, fashiste. Partia Komuniste Italiane, Partia Komuniste Franceze dhe ajo e spanjollit Karriljo, e kanë hedhur poshtë haptazi diktaturën e proletariatit dhe teorinë e luftës së klasave.

Në këtë «bllok» të revizionizmit sovjetik, me çarje të shumta të pandreqshme, flitet sa për sy e faqë edhe për luftën e klasave, por edhe kjo është një blof, pasi luftë klasash në kuptimin marksist-leninist nuk zhvillohet as në Bashkimin Sovjetik, as në vendet e tjera të Evropës Lindore. Kurse Marsheja dhe Berlingueri predikojnë «vëllazërimin në divergjenca», vëllazërim e bashkim për të shkuar «në socializëm me reforma», të gjithë bashkë: borgjezë, kapitalistë, punëtorë, polici, ushtri borgjeze etj. Hrushovianët ka kohë që e kanë deklaruar si inekzistuese luftën e klasave në Bashkimin Sovjetik, por në fakt atje ekziston lufta që bën borgjezia e re kundër klasës punëtore. Atje dhe në vendet e tjera revizioniste ekziston dhe zhvillohet lufta e proletariatit kundër shfrytëzimit të egër që po i bën borgjezia e re, e cila ka vendosur në këto vende diktaturën fashiste. Me siguri kjo luftë do të zhvillohet nën ngritje në të ardhmen.

Në këto situata, detyra e madhe e Partisë sonë ka qenë dhe është që të mbrojë teorinë marksiste-leniniste, të japë mendimin e saj mbi të gjitha këto probleme jetike që po kalon bota, të demaskojë qëllimet armiqësore antiproletare dhe antisocialiste të revizio-

nistëve modernë, të cilët janë kthyer në parti naciona-liste të fshehur pas parullave gjoja socialiste. Ata gënjejnë proletariatin në vendet e tyre si dhe proletariatin botëror dhe deformojnë teorinë shkencore të marksizëm-leninizmit.

Të gjitha këta që bëjnë këta armiq ndihmojnë organizimin e borgjezisë dhe forcimin e pushtetit borgjez kapitalist të imperialistëve amerikanë dhe të socialimperialistëve sovjetikë. Në këtë çështje nuk mund të ketë dhe nuk ka ekuiroke. Është i gabuar çdo mendim që largohet nga mbrojtja e parimeve marksiste-leniniste, që bazohet në koniunktura mbi bazën e të cilave armiqtë e proletariatit lidhin e zgjidhin interesat e tyre. Partia jonë mendon se është gabim fatal të mbrohet imperializmi amerikan apo socialimperializmi sovjetik, është gabim fatal të mbështetesh në njërin nga këta imperialistë për të luftuar tjetrin. Partitë e vërteta marksiste-leniniste dhe gjithë revolucionarët kudo në botë, në krye të proletariatit botëror, duhet t'u shpallin luftë të pamëshirshme, pa dallim, të dy superfuqive, pa lejuar veprime ekuiroke, konsuzionin dhe dobësimin e kësaj lufte. Çdo veprimitari që zhvillohet kundër revolucionit botëror, kundër interesave jetikë të proletariatit botëror, kundër interesave të popujve që kërkojnë të fitojnë lirinë, duhet të demaskohet. Uniteti në këtë luftë krijohet, brumoset dhe çelikoset vetëm mbi bazën e teorisë marksiste-leniniste.

Partia jonë mendon se të gjithë organizmat që u përmendën më lart, marrëveshjet dhe traktatet, metodat dhe mënyrat që përdorin imperialistët dhe revizionistët modernë sovjetikë për të vendosur hegemoninë

e tyre në botë, duhen demaskuar dhe duhen luftuar. Tregu i Përbashkët Evropian, mendon Partia johë, është një organizëm i kapitalit botëror, që nëpërmjet trusteeve e koncerneve vigane vepron për të arritur qëllimet që u shpjeguan më lart. Prandaj marksistë-leninistët nuk lejohen jo vetëm të mburrin dhe të mbështetin Tregun e Përbashkët Evropian, por ata s'duhet të mbajnë as më të voglin qëndrimi ekuivok, duke shpresuar se ka diçka pozitive në këtë organizëm. Të mbrosh një organizëm të tillë, duke pretenduar se kjo do të krijojë një barrierë kundër socialimperializmit sovjetik, kundër një kërcënimi sovjetik, do të thotë t'i predikosh proletariatit të vendeve të Evropës që të ulë kurrizin dhe t'u nënshtrohet borgjezisë kapitaliste dhe koncerneve gjakpirëse. Kjo do të thotë t'u predikosh partive marksiste-leniniste të këtyre vendeve, që janë formuar dhe po ngrihen, të hedhin armët, të bashkohen me revisionistët dhe tok me ta të mos luftojnë Tregun e Përbashkët, as «Evropën e Bashkuar».

Të ndihmohen këta organizma, me qëllim që të krijohet një barrierë kundër socialimperializmit sovjetik, do të thotë të kërkosh nga proletariati botëror dhe nga partitë e reja marksiste-leniniste të botës dhe të Evropës që ato të vihen në një bllok me imperialistët e Evropës Perëndimore dhe me imperializmin amerikan. Mirëpo të mbash një pozitë të tillë, do të thotë të largohesh nga marksizëm-leninizmi. Në qoftë se ka marksistë-leninistë me pikëpamje të tillë dhe predikojnë për t'i vënë këto në zbatim, nuk janë veçse anëtarë të partisë socialdemokrate, që u përqjasin partive të

Internacionales së Dytë, si dhe partive të sotme të Zhorzh Marshesë dhe të Berlinguerit.

Në qoftë se dikush mbron unitetin ushtarak, politik dhe ekonomik të një «Evrope të Bashkuar» bën gabim të madh, pse kjo është një ide reaksionare që nuk mund të arrihet, por edhe po të arrihet, është në dëm të proletariatit dhe të revolucionit. Vetë faktet tregojnë se, aktualisht si Tregu i Përbashkët, ashtu dhe «Evropa e Bashkuar» janë përpara krizës së madhe dhe divergjencave të panumërtë e po dobësohen. Kontradikta të mëdha janë krijuar midis vendeve që bëjnë pjesë në to dhe, pikërisht në këtë kohë, kur ato duhen luftuar me forcën më të madhe, ka shtete dhe parti që i mbrojnë, duke u hedhur kështu në veprime antimarksiste dhe antiproletare. Partia jonë nuk mund të pranojë teza të tillë. Ajo kurdoherë ka qenë dhe do të jetë kundër imperializmit amerikan, kundër socialimperializmit sovjetik, si dhe kundër borgjezisë reaksionare të të gjitha vendeve, në çdo formë që ato të paraqiten dhe ajo do të mbështetë me vendosmëri proletariatin botëror, partitë marksiste-leniniste dhe gjithë popujt e botës që kërkojnë dhe luftojnë për lirinë e tyre e për demokracinë e vërtetë.

Në koniunkturat aktuale botërore Republika Popullore e Shqipërisë ka mbajtur qëndrim konsekuent: miq dhe aleatë ajo ka konsideruar ata që luftojnë kundër të gjitha forcave të së keqes dhe të tmerrit. Politika e Partisë së Punës të Shqipërisë ka qenë e gjiltër, ajo ka pasur dhe do të ketë edhe në të ardhmen kundërshtime në të gjitha këto çështje që u trajtuan dhe me të gjitha ato shtete e parti që nuk janë dakord

me politikën e Partisë sonë. Çdo shtet ka të drejtë të mendojë dhe të përcaktojë qëndrimin e vet ndaj një problemi dhe ngjarjeje. Këtë të drejtë e kanë, si të gjithë, edhe Partia jonë, edhe shteti ynë i diktaturës së proletariatit. Ne nuk jemi tërhequr dhe nuk do të tërhiqemi kurrë nga pozitat tona, të cilat i konsiderojmë të drejta, revolucionare, marksiste-leniniste.

Për Partinë tonë marksizëm-leninizmi nuk është vjetruar, përkundrazi ai është kurdoherë i ri dhe Shqipëria socialiste e tregon vitalitetin e teorisë marksiste-leniniste jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Partinë dhe popullin tonë nuk i tremb asgjë se çfarë do të thotë njëri apo tjetri.

Ndihmën dhe përkrahjen politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake të miqve Partia jonë e konsideron si një ndihmë internacionliste, që këta janë të detyruar të na e japin, ashtu sikurse jemi të detyruar dhe ne t'u japim të tilla ndihma miqve tanë, kur këta kanë nevcjë. Kurrë Partia dhe shteti ynë nuk mund të fshehin ndjenjat dhe mendimin e vet marksist-leninist në çështje politike dhe ideologjike, pse një shtet tjetër u jep ndihmë. Në mes vendeve të vërteta socialiste ndihma është e natyrshme, por ajo është një faktor i jashtëm, që natyrisht, ka rëndësinë e vet, kurse faktori vendimtar në ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e fitoreve është faktori i brendshëm. Politika e Partisë sonë bazohet, në radhë të parë, në faktorin e brendshëm; ne me forcat tona ndërtojmë socializmin; ne mbështetemi në forcat tona, në idetë tona gjallëruese, në unitetin e çeliktë të Partisë e të popullit tonë.

Ne dëshirojmë dhe luftojmë që miqësia e gjithë popujve të botës me Shqipërinë të forcohet, dhe mendimi ynë është se vetëm në sinqueritetin dhe në dashurinë e hapët mund të ekzistojë një miqësi dhe dashuri e vërtetë. Në hipokrizi nuk ka ekzistuar dhe nuk mund të ekzistojë kurrë dashuri dhe miqësi. Politika e Partisë sonë qëndron në atë që për çdo problem, në çdo anë të botës që mund të lindë, ajo përpinqet të japë mendimin e vet, i pëlqen ose nuk i pëlqen ndokujt. Partia jonë synon që pikëpamjet e politikës së saj t'u pëlqeijnë popujve përparimtarë liridashës, forcave progresive revolucionare, marksistë-leninistëve të vërtetë. Ky është qëllimi ynë kryesor i vetëm dhe këtë ne nuk e fshehim, ashtu sikurse nuk fshehim luftën tonë ideologjike dhe politike. Ne nuk ndërhyjmë në punët e shteteve të tjera, por, ashtu siç kanë të drejtë qeveritë e vendeve të tjera, gazetat dhe të gjitha botimet e tyre të flasin dhe të jalin gjithfarë mendimesh, herë të drejta dhe herë shpifëse kundër vendit tonë, edhe ne, Partia, Qeveria dhe shtypi ynë, kemi të drejtë të themi të vërtetën për çdo shtet dhe qeveri të botës, të bazuar në fakte, në realitetin dhe jo në shpifje. Ky, mendojmë ne, është një rast që qeveritë e çdo vendi të dinë se çfarë mendojmë ne për atë vend dhe ne të dimë, gjithashtu, çfarë mendojnë ata për vendin tonë.

Këto qëndrime, mendojmë ne, nuk duhet të dobësojnë marrëdhëniet ekonomike, kulturore dhe politike përmjaft probleme që mund të jenë dhe mund të gjykojen të përbashkëta, pse këto shërbejnë në miqësimin e popujve, por, për sa na përket neve, deklarojmë se do t'i zhvillojmë vetëm nën prizmin e marksizëm-leni-

nizmit. Këtë gjë ne e bëjmë se kemi respekt të madh për popujt, për proletariatin botëror, për njerëzit përparimtarë, për shkencën dhe për shkencëtarët përparimtarë të botës dhe kësaj ndjenje të pastër nuk mund t'i vihen kufij artificialë ose kërcënues.

Ne jemi të bindur se qëndrimet tonë kanë qenë kurdoherë të drejta, kemi folur dhe do të flasim për shumë gjëra, ka dhe të tjerë që duan të flasin, po nuk i lejojnë. Ne dëshirojmë të flasin, në radhë të parë, proletariati botëror, marksistë-leninistët, njerëzit që janë për përparimin, por ka që nuk mundën, se i shtyp diktatura e kapitalit, ua mbyt e ua deformon shtypi borgjezo-kapitalist mendimet e tyre. Ne do të flasim për ata që nuk janë dakord me ne, bile që janë në kundërshtim me ne, por ne u flasim edhe atyre për mjaft gjëra që vetë nuk i thonë dot. Gjuha jonë e drejtë dhe e mprehtë është një balsam dhe një ilaç shëruar për plagët e tyre të shkaktuara nga imperializmi amerikan dhe nga socialimperializmi sovjetik, të cilët u kanë shkaktuar mjerime të mëdha dhe u kanë imponeuar aleanca skillavëruesc. Ne nuk jemi një vend, një popull, një parti që dëshiron të nxitë luftëra botërore, ne jemi kundër luftërave grabitqare imperialiste, por kemi qenë, jemi dhe do të jemi pro luftërave të drejta çlirimtare. Vendi ynë, Shqipëria socialiste, do të gjenet në çdo moment përkrah gjithë atyre popujve që u merren apo u shkelen të drejtat. Këtë qëndrim tonin ne e kemi deklaruar vazhdimisht. Edhe në kohë të rrezikshme popujt e botës të jenë të sigurt se Shqipëria socialiste do të jetë me ta dhc nuk u trembet sakrificave. Armiqtë të jenë të sigurt se nuk do t'i lejojmë

të bëjnë as dredhi, as të abuzojnë në vijën tonë konsekutive, të hapët. Ne nuk lejojmë të akuzohemi nga askush se ndërmarrim disa vepprime që gjoja s'janë të drejta. Përkundrazi, veprimet tona janë të drejta, por atyre nuk u leverdis, se janë në rrugë të gabuar, prandaj shpisin kundër nesh. Këto janë manovra dhe shpisje për të fshehur politikën oportuniste dhe tradhtare të tyre ndaj popujve të tjera. Kjo është një politikë revisioniste, një politikë e shitur tek ai që u ofron më shumë.

Ne deklarojmë se jemi për miqësi me të gjithë popujt, por dihet se qëndrimet tona si kurdoherë do të bazohen në marksizëm-leninizmin. Ne jemi një popull që nuk i trembemi kurrikujt, nuk u trembemi as sulmeve të armiqve, pa lëre shpisjeve, pse jemi të bindur për vijën tonë të drejtë dhe jemi të vendosur ta mbrojmë këtë vijë. Ne edhe për lufthë, në rast se sulmohemi, pushkën e kemi gati, po edhe kundër shpisjeve të armiqve gjuhën e kemi në vend.

Miqësinë mes nesh dhe shitetevc, qofshin këto sqinje, qofshin shtete të largëta, ne e konsiderojmë të domosdoshme në interes të të dyja palëve dhe jo në shërbim apo në interes të njërit apo të tjetrit. Ne kurdoherë kemi qenë dhe do të jemi kundër një politike të tillë, do të jemi pro një politike të unitit me vendet e tjera, të cilave do t'u turret rreziku. Ne jemi e do të jemi kurdoherë për një politikë të hapët dhe të singertë.

Shtetet borgjeze e revizioniste thonë se ne jemi një vend i izoluar. Ky është një shikim me syrin kapitalist-revizionist pse këta e quajnë të izoluar atë vend që nuk lejon invadimin me kredi skllavëruese, me turistë dhe spiunë, me kulturën dekadente dhe degjenerimin. Duke e parë çështjen në këtë prizëm ne jemi vërtet dhe do të mbetemi me vetëdije një vend i izoluar, nga kjo vetëm të mirë kemi: Vendi ynë përparon dhe lulëzon, populli te ne jeton shumë mirë. Të vepronim ndryshe, do të bëheshim skllevër. Ne e kemi njohur skllavërinë fashiste dhe presionet e sulmet revizioniste dhe kollaj nuk na gënjejnë me parullat dhe me mënyrat e tyre të jetesës. Ne nuk lejojmë të hyjnë në vendin tonë njerëz agjentë, spiunë, njerëz që duan të futin degjenerimin. Ne lejojmë dhe gjëzohemi të na vijnë këtu njerëz të ndershëm e korrektë, dashamirë të Shqipërisë, të popullit tonë, miq, qofshin këta edhe me mendime të ndryshme nga tonat, por ne respektojmë ndjenjat e tyre ndaj vendit tonë, qëndrimin e tyre dashamirës ndaj popullit shqiptar. Të gjithë këta që përsaqësojnë shumicën e njerëzimit ne i pranojmë dhe, pikërisht me këta, ne jemi në miqësi, pra nuk jemi të izoluar. Me ata që dëshirojnë të skllavërojnë e të shtypin popujt dhe idetë e tyre përparimitare, ne nuk bëhem miq.

Vendet kapitaliste, izolimin e masin me tregtinë. Tregti ne kemi bërë dhe bëjmë me vendet kapitaliste, me përjashtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Sovjetik dhe të ndonjë tjetri. Por edhe tregtia është me leverdi reciproke. Kapitalistët kanë nevojë për mallrat tona, siç kemi edhe ne nevojë për disa mallra të tyre. Kështu mundet:

«Më jep, të të jap, nuk më jep, nuk të jap». Në qoftë se dikush mendon se Shqipëria do të vdesë nëse ndonjë shtet me qëllime të këqija nuk i jep këto mallra, ai gabohet. Sovjetikët i bënë bllokadë. Shqipërisë, por prapë Shqipëria nuk pësoi gjë, ajo jeton e përparon, me gjithë bllokadën e tyre.

Ne dëshirojmë dhc bëjmë tregti të kulturuar me respekt për blerësin, por edhe blerësi duhet të ketë respekt për ne, shitësin. Reciprokisht të jemi korrektë, po asnjëherë të mos mendohet për vartësi nga njëri-tjetri. Ne e kuptojmë tregtinë politikisht. Edhe partnerët tanë bëjnë politikë, por edhe ne bëjmë politikë në tregli, në rast se ata vënë kufizime, edhe ne do të vümë kufizime në marrëdhëni me ta. Interesat janë reciprokë; këta janë interesa ekonomikë, por janë edhe politikë. Në qoftë se ndonjë shtet borgjez kapitalist ka interes të bëjë tregti me ne, edhe ne kemi, gjithashtu, interes të bëjmë tregti me të, por të jetë e qartë se interesat tanë nuk u përngjasin interesave të tyre, megjithëkotë interesat ekzistojnë nga të dyja anët.

Shkëmbimet kulturore me vende të ndryshme janë një gjë shumë e mirë dhe këtë ne, gjithashtu, e kemi praktikuar dhe dëshirojmë ta praktikojmë edhe në të ardhmen, por në barazi me njëri-tjetrin. Por të dihet, në Shqipëri nuk pranohet kultura dekadente. Edhe të tjerët kanë të drejtë të pranojnë nga ne ato shfaqje, ata filma e libra që u duken të arsyeshëm për vendin e tyre. Edhe kjo është një çështje reciproke. Ne e zbatojmë këtë praktikë me shumë shtete. Ne kemi miqësi dhe i zhvillojmë marrëdhëni kulturore me shumë shtete, si me Kinën, Vietnamin e Korenë, por edhe me

Francën, me Turqinë, me Vendet Skandinave, me Egjiptin dhe me shumë vende të tjera.

Ne duam t'i zhvillojmë më tej këto marrëdhënie dhe çdo vit që kalon krijojen mundësi për t'i zgjeruar ato më shumë. Natyrisht, ne kemi artin, muzikën, literaturën, traditat dhe kulturën tonë, të cilat duam t'i njobin edhe popujt e tjerë. Por ne kemi admirim edhe për kulturën botërore përparimtare, marrim prej saj dhe përhapim në vendin tonë atë që na shërben. Edhe kjo është e duhet të jetë reciproke.

Pikëpamjet tona marksiste-leniniste nuk janë vetëm parime teorike. Këto parime Partia jonë i zbaton me këmbëngulje në jetë. Ajo mendon se ky zbatim duhet të jetë konsekuent dhe kurdoherë në vazhdimësi e në ngjitje, pa marrë parasysh vështirësitet e shumta që u dalin përpara popujve, luftërave të tyre nacionalçlirimtare, partive komuniste dhe punëtore marksiste-leniniste dhc njerëzve përparimtarë kudo që janë, në përpjekjet që bëjnë për realizimin e aspiratave të tyre.

Në rrugën e vet Partia jonë asnjëherë nuk ka ecur dhe nuk do të ecë symbyllur. Pa lëshuar në parime, ajo nuk do të lërë pa marrë parasysh edhe koniunkturat që krijojen në botë nga luftërat dhe nga përpjekjet e popujve dhe nga shtete të ndryshme e me ideologji të ndryshme. Këto jo vetëm që do t'i ketë parasysh, por edhe do t'i shfrytëzojë racionalisht në interes të popujve përparimtarë dhe të revolucionit.

Në bazë të lidhjeve tona tradicionale me popujt arabë, kudo që janë, jetojnë dhe veprojnë, ekziston një miqësi e sinqertë dhe e hapët nga ana e Shqipërisë socialiste. Ata, brenda mundësive tona, do të kenë kur-

doherë mbështetjen e gjithanshme të vendit tonë. Kjo është një çështje parimore, por edhe praktike për t'u zbatuar. Zbatimi i plotë i këtij parimi të madh, natyrisht, mund të hasë edhe në vështirësi, për shkak të qëndrimeve politike dhe ideologjike të mjaft udhëheqësve të këtyre vendeve. Por Partia jonë nuk do të konfondojë asnjëherë miqësinë që ushqen për popujt arabë me çfarëdo politikë që ndjekin disa nga udhëheqësit e tyre.

Në këto shtete mundet dhe ka udhëheqës që mendojnë dhe veprojnë në kundërshtim me pikëpamjet dhe me veprimet tona për të njëtin problem. Kjo, natyrisht, është punë e tyre, ashtu sikurse është puna jonë mënyra se si mendojmë dhe veprojmë. Por, ashtu sikurse i gjykojnë udhëheqjet e këtyre shteteve pikëpamjet dhe veprimet tona, me dashamirësi ose jo, ashtu i gjykojmë edhe ne pikëpamjet dhe veprimet e tyre, veçse ne mendojmë se nuk bëjmë keq, kur mbështetim të gjitha ato anë të mira të ndonjë udhëheqësi të një vendi mik e vëlla arab. Nga ana tjetër, ne nuk do të lëmë pa shfaqur mendimin tonë objektiv dhe për ndonjë qëndrim, që e gjykojmë se është jo vetëm në dëm të interesit të një populli vëlla arab, por që është sidomos në dëm të interesit të përgjithshëm. Në këtë gjykim, natyrisht, ndërhyjnë çështje politike të shikuara nga prizma të ndryshëm dhe nga pozita klasore të ndryshme.

Vendi ynë, si një vend socialist, nuk mund të mbylli sytë përpara atyre veprimeve, që disave prej këtyre udhëheqjeve u duken të parëndësishme, por që në të vërtetë janë antipopullore dhe antisociale dhe

në fakt çojnë ujë në mullirin e imperializmit amerikan e të socialimperializmit sovjetik.

Dikush mund të priret nga vendosja e marrëdhënieve gjoja të mira dhe të sigurta me udhëheqës antipullorë, për t'u infiltruar ose për të krijuar mundësi, të cilat do t'i lejojnë të marrë kontakte me masat e gjera të popujve të këtyre vendeve. Një qëndrim i tillë neve nuk na duket as serioz, as i singertë. Partia jonë nuk mund as të mburrë, por as të lërë në harresë, pa kritikuar ata që sulmojnë idetë përparimtare, marksizëm-leninizmin dhe shtetet socialiste dhe që synojnë t'i futin nën flamurin e tyre.

Shumë djallëzi, mënyra dhe sjellje false, lajka e qëndrime hipokrite përdorin në përshtatje me koniunkturat që krijojen në situatën botërore politikanët borgjezë dhe revisionistë. Të gjithë këta përpinqen të krijojnë dhe deri në njëfarë shkalle kanë krijuar pikëpamjen se duhet të ndiqet një rrugë e tillë, pasi kështu bëhet «politika». Sipas tyre të bësh «politikë» do të thotë të ndërrosh flamurin në çdo kohë e në çdo rast, ta kesh mirë me njërin dhe me tjetrin, jo për t'i bërë mirë, por për t'ia hedhur tjetrit, për t'i fshehur qëllimin e vërtetë, duke e mbuluar këtë me buzëqeshje. Këta lloj politikanësh krijojnë pikëpamjen e rremë e shumë dëmprurëse se ata që sillen në mënyrë korrekte, të singertë dhe të hapur ndaj popujve, ndaj shteteve dhe ndaj udhëheqjeve të tyre, nuk janë politikanë të shkathët, po njerëz mendjeshkurtër e sektarë! Mendime e qëndrime të tillë janë pa përgjegjësi. Këta njerëz që flasin kështu, pandehin se bëjnë një «politikë të madhe» dhe këtë ia atribuojnë vetes së tyre, pavarsisht

se një qëndrim i tillë, pa përgjegjësi, u shkakton vuajtje të mëdha popujve.

Partia e Punës e Shqipërisë është kundër vuajtjeve që u shkaktohen popujve, qoftë nga imperializmi amerikan, ashtu edhe nga socialimperializmi sovjetik e nga borgjezia reaksionare vendase. Ajo, me sa mundet, i mbron me të gjitha forcat e veta këta popuj fatkeqë, duke luftuar pa hezitim e pa frikë në favorin e tyre. Mundet që një politikë e tillë e drejtë nuk u pëlqen disa udhëheqësve të shteteve të ndryshme, që janë nën ndikimin e dollarit amerikan osc të rublës sovjetike dhe mbjellin armiqësi kundër Shqipërisë. Por nevo. shqiptarëve, na ka mësuar Partia jonë marksiste-leniniste se një qëndrim i tillë armiqësor nuk është diçka e re, por një metodë denigrimi dhe lufte e pamëshirshme që ndjekin kundër nesh kapitali dhe kapitalistët. Ne duhet të përdorim po ashtu kundërmетодën tonë: në qoftë se të tillë udhëheqës na urrejnë një herë, ne t'i urrejmë një mijë herë, kurse ata që na respektojnë për idetë tona çlirimtarë, ne, gjithashitu, siç bëjmë vazhdimisht, do t'i respektojmë me singjeritet.

Ka udhëheqës të shteteve borgjeze, të cilët dëshirojnë që Partia jonë marksiste-leniniste të mos i mbështesë dëshirat dhe aspiratat e popujve të vendeve të tyre dhe as të ndihmojë partitë marksiste-leniniste të këtyre vendeve. Partia jonë u thotë atyre se kjo do të mbetet deri në fund vetëm një dëshirë dhe utopi përt. Pse, ashtu siç ka menduar kurdoherë, edhe tash, ajo mendon se për lirinë e një populli, për revolucionin, për mposhtjen e borgjezisë, të imperializmit dhe të socialimperializmit, ndihma e jashtme internacionale

është një detyrë me rëndësi. Këtë na e kanë mësuar Marks dhe Lenini dhe ky mësim qëndron në ballë të luftës së Partisë sonë. Ashtu siç na kanë ndihmuar në të kaluarën neve njerëzit përparimtarë kudo në botë dhe partitë marksiste-leniniste për çlirimin tonë nacional dhe për vendosjen e diktaturës së proletariatit, edhe ne e kemi për detyrë të ndihmojmë proletariatin si dhe partitë marksiste-leniniste dhe ato përparimtare që edhe popujt e tyre të fitojnë lirinë politike dhe të vendosin demokracinë. Kjo nuk është aspak një ndërhyrje në punët e brendshme të shteteve të tjera dhe as eksportim i revolucionit, siç duan ta shpjegojnë këtë imperialistët, socialimperialistët dhe tok me ta gjithë shërbëtorët e borgjezisë. Por ne e dimë përsë e bëjnë ata këtë. Ata duan të jenë vetë të lirë që të shtypin proletariatin dhe popujt e tyre, t'i mbajnë këta nën zgjedhë, t'i pengojnë që të mos organizohen dot e të mos zbatojnë si duhet, në kushtet e vendeve të tyre, teorinë e pavdekshme të marksizëmi-leninizmit.

Këta zotérinj që na akuzojnë ne për një ndihmë dhe bashkëpunim të ngushtë në fushën ndërkombëtare me proletariatin botëror dhe me pararojat e tij marksiste-leniniste në këtë formë, nga ana e tyre pa pikë turpi ndërhyjnë brutalisht dhe me të gjitha mjetet e propagandës, të spiunazhit, të diversionit, të organizimeve sekrete e, më në fund, edhe me ndërhyrje ushtarake në punët e brendshme të vendeve të tjera. As që mund të barazohen mendimet tona, veprimet tona, kuptimi i drejtë i ndihmës sonë me veprimet agresive imperialiste e revisioniste dhe të borgjezisë reaksionare në drejtim të popujve që luftojnë për çlirim dhe të

partive marksiste-leniniste, si dhe të atyre përparimtare e revolucionare. Veprimet tona janë një bashkëpunim i drejtë internacionalist, veprimet e tyre janë sulme brutale agresive kolonialiste.

Në këtë kuptim të drejtë, Partia e Punës e Shqipërisë është plotësisht solidare me partitë e reja marksiste-leniniste që janë krijuar dhe janë forcuar e po forcohen dita-ditës në të gjithë botën, si rezultat i tradhëtisë së çështjes së revolucionit, të diktaturës së proletariatit dhe të socializmit nga ana e ish-partive komuniste e punëtore të të gjitha kontinenteve. Këto parti të reja tashmë janë në mëkëmbje e sipër. Revisionistët dhe borgjezia reaksionare në pamjen e jashtme përpinqen të duken sikur i nënvleftësojnë këto parti dhe vënë përpara tyre «forcën e buallit», por të një bualli të krimbur dhe të kalbur.

Ajo që mendon dhe synon borgjezia reaksionare e çdo vendi nuk korrespondon me qëllimin e pastër dhe të lartë të partive komuniste e punëtore marksiste-leniniste që janë krijuar, të cilat nuk kanë asnjë iluzion në pseudodemokracinë e shtetit të tyre borgjez dhe të partive të ndryshme që ekzistojnë atje, duke inkluduar në to edhe partinë revisioniste. Çdo parti marksiste-leniniste mbështetet, në radhë të parë, në proletariatin dhe në masat e gjera popullore të vendit të vet, por ajo gjëzon edhe mbështetjen e proletariatit të gjithë botës, mbështetjen e solidaritetin e partive të vërteta marksiste-leniniste të vendeve të ndryshme. Por që ta ketë vazhdimisht e pa kursim këtë mbështetje derisa të korrë fitoren përfundimlare, është e domosdoshme që çdo parti të udhëhiqet me konsekuençë

nga marksizëm-leninizmi, nga ideologjia e proletariatit.

Partitë e reja marksiste-leniniste të vendeve të ndryshme e dinë se janë në shenjën e policisë së hapët dhe të fshehtë të borgjezisë kapitaliste e revisioniste, armiqve të tyre tradicionalë. Prandaj ato duhet të marrin të gjitha masat për të përballuar goditjet, të cilat, në mos u kanë ardhur deri tash, do t'u vijnë nga çdo drejtësim dhe në format më të ndryshme. Prandaj partitë e reja komuniste dhe punëtore marksiste-leniniste kurrë nuk duhet të ushqejnë as iluzionin më të vogël në «demokracinë borgjeze» dhe në pseudoliritë sindikale të vendeve kapitaliste etj.

Kjo nuk do të thotë që këto parti të mos shfrytëzojnë kushtet legale, atje ku këto ekzistojnë. Kushtet legale duhet të shfrytëzohen, ashtu sikurse na mësojnë Marks, Engels, Lenini dhe Stalini, duke pasur kurdoherë parasysh që parimet tona të mos cirren nëpër ferrat që ka mbjellë borgjezia në rrugën e revolucionit. Kjo të mos harrohet në asnjë rast, por të bëhet mishi dhe gjaku i komunistëve, pse vetëm kështu partitë e reja marksiste-leniniste do të mund të udhëheqin me sukses luftën e tyre e të proletariatit që nuk është as e lehtë, as pa vuajtje e sakrifica.

Sakrificat e mëdha janë dhe do të janë në rendin e ditës për anëtarët e partive të vërteta marksiste-leniniste dhe këta janë të vëtëdijshëm se i bëjnë këto sakrifica për hir të interesave të lartë të revolucionit dhe të socializmit. Pa këto sakrifica, pa luftuar me vetëmohim të lartë revolucionar, nuk mund të arrihet fitorja. Në shembullin e sakrificave të çdo partie të re-

marksiste-leniniste ecën përparrë proletariati i çdo vendi, po kështu edhe proletariati ndërkombëtar. Kjo bën që proletariatit t'i rrënjoset besimi në marksizëm-leninizmin dhe në pararojën e vet, partinë komuniste marksiste-leniniste. Në beteja dhe në luftëra të pandërrësira kalitet partia derisa të arrijë fitoren përfundimtare.

Arniqtë borgjezë kapitalistë i kanë frikë organizime të tillë revolucionare të proletariatit dhe të pararojës së tij. Ata hiqen sikur tregojnë mospërfillje për partiitë e reja marksiste-leniniste, por ky qëndrim nuk është aspak real. Ata ua kanë frikën revolucionarëve, prandaj në heshtje ose hapur ata përgatitin goditjen. Udhëheqësit e mëdhenj të revolucionit na kanë mësuar që, krahas luftës legale, duhet të organizojmë edhe luftën ilegale. Partia jonë ka menduar dhe mendon se ky organizim i dytë, lufta ilegale, është garancia më e madhe për sigurimin e fitores. Pa këtë organizim, forca e madhe goditëse e diktaturës borgjeze, në momentet që ajo e gjen të përshtatshme, bën kërdinë dhe shuan çdo rezistencë të proletariatit të udhëhequr nga pararoja e tij.

Shumë ligje ka shpallur dhe vazhdiniشت shpall borgjezia për të marrë masa kundër këtij organizimi. Ajo, përvç vëzhgimit të vazhdueshlëm dhe goditjeve që u bën marksistë-leninistëve dhe revolucionarëve, përkrah kriminalitetin, luftën anarkike e banditeske, përgatit, përkrah dhe vë në lëvizje bandat e fashistëve që vrasin, sulmojnë e grabisin masat nëpër rrugë, dhe këtë e bëjnë për të mbajtur nën terror popullin punonjës, për t'i kallur atij frikën. Këto aksione e veprime

banditeske çojnë më në fund deri në vendosjen e diktaturës fashiste në këtë ose në atë vend kapitalist. Por me gjithë këto organizime e veprime banditeske, borgjezia përpinqet të krijojë konfuzion në masat dhc nga ana tjetër, veprimet fashiste kundër proletariatit e mësive punonjëse, t'i paraqesë, me qëllim diskreditimi, si veprime të komunistëve dhe të proletariatit revolucionar. Prandaj partitë komuniste dhe punëtore marksiste-leniniste të reja duhet absolutisht t'i kenë parasysh këto manovra e dredhi të armiqve të klasës dhe të luftojnë për t'i demaskuar e për t'i shkatërruar ato.

Sigurisht, këto parti po ndeshen dita-ditës kudo me një propagandë shurdhucse demagogjike, pseudodemokratike, profashiste, që bën borgjezia reaksionare në çdo vend kapitalist. Mund të ketë shokë revolucionarë të paformuar dhe të pakalitur akoma sa duhet, të cilët armiqtë synojnë t'i çorientojnë. Armiqtë e revolucionit mendojnë se nga një propagandë kaq e madhe demagogjike, gradualisht e si pa u kuptuar, mund të krijohen iluzione të rrezikshme në radhët e partive marksiste-leniniste që të ulin tempin e tyre revolucionar dhe të ecin drojt dobësimit, dogjenerimit dhe likuidimit të tyre.

Për t'u bërë ballë gjithë këtyre sulmeve e manovrave të shumanshme të armiqve është e domosdoshme dhë jetike që partitë e raja marksiste-leniniste të forcohen pandërprerë, duke synuar kurdoherë më shumë cilësinë sesa sasinë në shtimin e radhëve të veta. Në situata të tillë të turbullta, kur socialimperializmi sovjetik me demagogjinë e tij pseudomarksiste, kur

partitë tradhtare revizioniste të Evropës dhe të vendeve të tjera, kur imperializmi amerikan me fuqinë e vet politike, ekonomike dhe ushtarake e në aleancë me borgjezinë reaksionare të vendeve të ndryshme përpinqen të përgatitin luftën e tretë botërore dhe për këtë mbajnë në terror e nën zgjedhë masat e proletariatit e të popullit punonjës, që t'i kenë këto si mish për top, partitë marksiste-leniniste duhet t'i vënë rëndësi edukimit teorik të anëtarëve të tyre me marksizëm-leninizmin, kalitjes së tyre të vazhdueshme në veprimtarinë revolucionare të përditshme, për t'i bërë luftëtarë të papërkultur në çdo rrëthanë. Ato e kanë parasysh se, po nuk forcuan radhët e tyre me anëtarë të një cilësie të veçantë, armiqtë, që janë stërvitur dhe kanë shumë eksperiencë në minimin e partive revolucionare marksiste-leniniste, do të futin brenda në organizata agjentë të tyre, do të krijojnë përçarje e fraksione në to dhe krahas trillimeve e veprimeve përçarëse të kryera nga njerëzit e tyre në radhët e partisë, edhe militanti të më revolucionarë të partisë do t'ia dorëzojnë policië dhe do të shkohet kështu drejt dobësimit dhe likuidimit të partisë.

Duke pasur parasysh mësimet e Leninit e të Stalinit, udhëheqjet e vërteta revolucionare nuk duhet të bazojnë vlerësimin e njerëzve që do të pranohen në radhët e partisë vetëm nga fjalët, por ata duhet të shinë, të provohen e të kaliten në aksione e në veprime konkrete, ku kërkohet edhe pjekuri, po edhe trimëri dhe frymë e lartë sakrifice e vetëmohimi. Të tillë kualitetë të mira gjenden, në radhë të parë, në elementët më të mirë të klasës punëtore, të fshatarësisë së varfér,

të shtypur e të mjeruar, në radhët e rinasë së pastör, të kulluar e revolucionare.

Sigurisht partitë komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme kanë të njëjtët armiq dhe bëjnë të njëjtën luftë, duke u mbështetur në të njëjtat parime bazë të marksizëm-leninizmit. Por lufta e tyre nuk mund të jetë e njëllojtë nga potenciali dhe nga zhvillimi i saj, ajo nuk mund të bëhet jashtë kushteve e rrethanave të çdo vendi. Receta, se si duhet vepruar në situatat e shumëlojshme e të ndërlikuara që krijoen e që nuk mund të parashikohen, oshtë e pamundur të jepen dhe ato nuk sjellin kurdoherë dobi. Përkundrazi, disa herë, duke u përpjekur për të zbatuar një vijë të ngurtë, që nuk i përshtalet as marksizëm-leninizmit, por as edhe kushteve konkrete të secilit vend, ku zhvillojnë aktivitetin e vet partitë marksiste-leniniste dhe punëtore, mund të sjellin edhe dëm e rrezik.

Në kohën e vet Kominterni ka kryer një veprimtari të madhe e shumë të dobishme. Ai u krijuar atëherë kur ishte e domosdoshme që marksizëm-leninizmi të hynte thellë si teori shkencore në masën e proletariatit botëror, të sqaronte elementin revolucionar të infektuar nga idetë oportuniste të socialdemokracisë së Internacionales së Dytë dhe ta bënte këtë të ndërgjegjshëm në luftërat për zbatimin me konsekuençë të ideve të Marksit dhe të Engelsit. Duke krijuar partitë e reja marksiste-leniniste e punëtore në botë, Kominterni përpinqej t'i ndihmonte këto të bëheshin të pavarura nga partitë borgjeze, t'i hidhte edhe në luftë kundër tyre dhe kundër padronëve kapitalistë. Kështu, në kohën e Leninit dhe të Stalinit u mëkëmbën dhe u for-

cuan partitë marksiste-leniniste, por, natyrisht, në filim kur ishin akoma të pamëkëmbura ato kaluan nga një stad, si me thënë, foshnjor, në një stad më të lartë pjekurie dhe organizimi revolucionar.

Revisionistët e sulmojnë egërsisht veprën e madhe të Kominternit, pikërisht pse ai krijoj dhe zhvilloi partitë komuniste në botë, me anën e të cilave u edukuan milionat e proletariatit si të luftonin kundër borgjezisë së vendit të vet, që kjo të mos mundte ta përjetësonte pushtetin e saj. Është për këtë arsyе që revisionistët modernë, dhe bashkë me ta edhe borgjezia, e sulmojnë pa pushim Kominternin dhe shpifin se gjoja ai ishte bërë një vegël e Bashkimit Sovjetik dhe e Stalinit. Por Kominterni ishte një organizëm i domosdoshëm në atë kohë, që dha një kontribut të madh përfuqizimin e revolucionit, përfitoren e socializmit. Proletariati botëror pati satin e madh që Bashkimi Sovjetik, i kohës së Leninit dhe të Stalinit, u bë një mbështetje e fuqishme e luftës proletare në të gjithë botën. Kjo situatë ishte e padëshirueshme nga borgjezia ndërkombëtare.

Tradhtarët e marksizëm-leninizmit nuk munguan të thonë se Kominterni paska bërë gabime. Gabime nuk eksludohet që të janë kryer, po gabime në shkeljen e parimeve të mëdha nuk janë bërë. Pastaj duhet kuptuar se, edhe ato gabime që mund të janë vërtetuar, janë kryer ose me ndërgjegje nga elementë deviatorë që kishin arritur të depërtonin në lëvizjen komuniste botërore, ose, disa, edhe nga ana e revolucionarëve pa eksperiencë, të cilët raportonin në qendër gabim dhe që me dashje ose pa dashje bënин që, duke mos informuar

drejt, të merreshin në disa raste edhe vendime të gabuara nga ana e Kominternit. Të mos harrohen, gjithashtu, kushtet e rënda të terrorit borgjezo-fashist, në të cilat ushtronin veprimtarinë e tyre partitë komuniste dhe punëtore me seksionet e tyre në Komintern. Kritikuesit aktualë të Kominternit nuk kuptojnë se partitë komuniste dhe punëtore të asaj kohe jo vetëm duhet të gjenin dhe të krijonin aleanca me elementë ose grupime përparimtare që edhe i ndryshonin pozitat e tyre, por Kominterni jepte direktiva që ishin të dobishme për atë kohë, ndërsa më vonë, kur krijo-heshin koniunktura të reja, ato e humbisnin vlerën e tyre.

Këtu unë nuk kam ndër mend të analizoj veprimtarinë e Kominternit, por dëshiroj të theksoj se aktualisht nuk mund as të ekzistojë dhe as të krijohet një organ i tillë në shkallë ndërkombëtare, sepse nuk është i përshtatshëm pér kohën dhe nuk do të sillte fitimet që priten nga luftërat revolucionare që zhvillojnë e do të zhvillojnë partitë marksiste-leniniste kudo në botë. Revisionistët sovjetikë, që e luftojnë aq shumë Kominternin, në forma nga më të ndryshmet, nuk lënë përpjekje pa bërë pér t'i drejtar vëtë të gjitha partitë revisioniste, duke u bërë kështu «shkopi i dirigjentit». Natyrisht, siç e analizuam këtë synim edhe më lart, ata nuk ia arritën dot këtij qëllimi. Kurse ne, partitë marksiste-leniniste dhe punëtore, duke kuptuar drejt rolin e madh të dikurshëm të Kominternit në kohën e Leninit dhe të Stalinit, na vihet detyrë ta forcojmë e ta kalitim vazhdimisht bashkëpunimin e ngushtë mes partive tonë, natyrisht, pa qenë aspak të varura

nga njëra-tjetra dhe pa marrë urdhër nga njëra ose nga tjetra. Ne e shohim si të nevojshme, gjithashtu, që si komunistë internacionalistë të shkëmbëjmë eksperiençën midis nesh dhe, në kushtet e çdo vendi, secili të veprojë në bazë të marksizëm-lininizmit. Kjo, natyrtisht është e domosdoshme të bëhet, pse edhe borgjezia nga ana e saj, edhe revisionistët e zhvillojnë bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe këtë e bëjnë në shumë forma dhe në shumë mënyra deri edhe në mbledhje të rregullta të quajtura «internationale». Qëllimi i tyre për ne është i qartë. Në radhë të parë ata luftojnë të ruajnë pushicelin e vet në kurriz të popullit dhe me intrigë të shumta, të kurdisura nga ana e tyre, të luftojnë proletariatin që të mos organizohet dhe të mos vendosë me lufthë socializmin dhe komunizmin.

Neve, partive marksiste-leniniste, na vihet detyrë që ta thellojmë bashkëpunimin tonë në rrugën e vërtetë revolucionare. Ky bashkëpunim, mendojmë nc, duhet të jetë i shumanshëm. Shkëmbimi i eksperiencës mund të bëhet, gjithashtu, mes partive tona në formë dy-palëshe ose shumëpalëshe. Mund të piqen edhe situata që të arrihet edhe në një mbledhje të madhe të përfaqësuesve të të gjitha partive komuniste dhe punëtore marksiste-leniniste. Këtë çështje të rëndësishme ka kohë që e ka shtruar Partia jonë në Kongresin e saj të 5-të dhe ajo qëndron e vendosur në imbrojtjen dhe në zbatimin e këtij parimi të madh të bashkëpunit revolucionar midis partive marksiste-leniniste.

Partitë marksiste-leniniste të çdo vendi kanë një përgjegjësi të madhe përpëra popujve të tyre dhe përpëra gjithë proletariatit botëror për qëndrimet që

mbajnë ndaj armikut të egër që paraqitet me shumë sylinder, që përpinqet të depërtojë me çdo mënyrë në radhët tona. Në veprimet e tyre ato duhet të udhëhiqen nga interesat e përgjithshëm të revolucionit dhe jo nga interesa vetjakë të disa udhëheqësve ose udhëheqjeve të prira nga pikëpamje subjektiviste ose shoqërorë të sëmura, të fryra nga një megalomani e huaj për proletariatin.

Partitë tona nuk mund të harrojnë për asnjë moment se përgatitin revolucionin, se janë në luftë me imperializmin amerikan, me socialimperializmin sovjetik dhe me borgjezinë reaksionare. Kësaj luftë ato nuk kanë si i shpëtojnë. Lufta mund të jetë e pjesshme, por mund të jetë edhe një luftë botërore. Në luftërat që janë zhvilluar përpara dhe në kohën e tyre Marks, Engels, Lenin dhe Stalini na kanë lënë neve një trashëgim të madh, duke na mësuar strategjinë dhe takтика e përshtatshme. Këto mësime të tyre ne duhet t'i thellojmë në kushtet e epokës që jetojmë dhe të mos gjenjehemi nga parullat pacifiste, nga parlamentarizmi dhe nga elektoralizmi, me të cilat borgjezia kurdoherë është përpjekur dhe përpinqet të gënjejë proletariatin.

Partitë marksiste-leniniste përgatitin revolucionin. Këtë revolucion nuk mund ta përgatitin vetëm, por me proletariatin dhe me gjithë popujt e botës. Në këtë çështje kaq jetike, partitë marksiste-leniniste dha punëtore jo vetëm që kanë përpara një luftë të madhe për të bërë, për arritjen e krijimit të këtij fronti dhe të këtij uniteti, por ato duhet të njojin dhe të bëhen të ndërgjegjshme se kjo nuk është një luftë e lehtë, përkundrazi është shumë e vështirë dhe e ndërlikuar.

Pikërisht partive marksiste-leniniste u bie barra, në këto rrethana, që të bëjnë sqarimin politik e ideologjik të punonjësve, të bëjnë demaskimin e atavizmit, të rutinës politike dhe të kurtheve që u ka ngritur dhe u ngre vazhdimisht revolucionarëve borgjezia kapitaliste, siç janë prirjet e rehatisë dhe shumë të këqija e dobësi të tjera që ekzistojnë në vetë komunistët, në proletariatin dhe në masat e gjera të popullit.

Prandaj çështja e unitetit dhe e alcancave në fronte e në organizime të ndryshme, ku partitë marksiste-leniniste dhe punëtore kurrë nuk duhet të fshehin personalitetin e tyre, çshtë një problem i dorës së parë e shumë delikat, pse një gabim në vijë, një qëndrim jo i drejtë dhe joelastik, një mospërfillje e mendimeve përparimi tare për këlë miqësi e këtë unitet që krijohet në luftë, sjell rrezikun e izolimit të tyre.

Borgjezia, në luftën e saj kundër proletariatit, kurdoherë është udhëhequr nga parulla e njohur «përçaj e sundo». Ajo ca më shumë sot, në fazën e kalbëzimit të saj, vëzhgon, vepron për të përçarë radhët e proletariatit dhe të pararojave të tij, me sa mundet. Ne, nga ana jonë, duhet të bëjmë të kundërtën, të sqarojmë dhe të lidhim me një program minimal masat e gjera të popullit, në luftë e sipër të krijojmë unitetin e radhiёve tonë dhe gradualisht nga fitorja në fitore të shkojmë përpara, duke kapur pozitat më të avancuara për revolucionin.

Shteti shqiptar ka politikën e vet të pavarur. Ai ndjek një politikë të jashtme të tillë që u përgjigjet interesave të tij dhe puqet me interesat e gjithë popujve dhe të atyre shteteve të botës, që kanë respekt

për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë, pavarësisht nga ndryshimet në rendin ekonomiko-shoqëror të njëri-tjetrit. Me politikën që ndjek, shteti ynë nuk ndërhyr në punët e brendshme të asnjë vendi tjetër, me të cilin ka lidhje të ndryshme politike, ekonomike e kulturore. Kjo nuk do të thotë që shteti shqiptar, për hir të këtyre marrëdhënieve me shtetet e tjera apo për hir të fqinjësisë së mirë me shtetet kusitare dhe të politikës së mosndërhyrjes në punët e brendshme të tyre, të mos shprehë mendimet e tij për politikën ndërkombëtare në përgjithësi, si dhe për qëndrimet ideologjike dhe politike të të gjitha këtyre shteteve, ashtu siç kanë dhe ato të drejtën të shprehin pikëpamjet e tyre për qëndrimet ideologjike dhe politike të shtetit shqiptar.

Republika Popullore e Shqipërisë mendon se në këtë mënyrë duhet të zhvillohen marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me shtetet pranë saj, si dhe me shtetet e tjera, me të cilat mban marrëdhënie të ndryshme. Por udhëheqësit e disa shteteve mendojnë, dhe kjo rrjedh nga pikëpamjet politike dhe ideologjike që kanë, se të kesh marrëdhënie të fqinjësisë së mirë, në format që shpjegova, nga të dyja anët duhet të mbyllët goja për vijën ideologjike që ndjek secili shtet. Këta drejtues shtetesh mendojnë se të bësh tregti me një vend, do të thotë të shuash polemikën, të mos shprehësh pikëpamjet që ke për politikën dhe për ideologjinë që ndjek ai vend. Nga ana jonë, polemika që bëjmë është kurdoherë e bazuar dhe e matur. Ajo vë në dukje në mënyrë kritike ato qëndrime dhe ato veprime që marrin një karakter ndërkombëtar, pra që ndikojnë

negativisht në botë ose që dëmtojnë edhe interesat e shtetit tonë.

Dihet se midis vendeve të ndryshme zhvillohen dhe dalin në dritë vazhdimisht kontradikta me karakter politik e ideologjik bile dhe shumë të thella. Pavarësisht nga këto, midis vendit tonë dhe një vargu shtetesh mbahen marrëdhënie të fqinjësisë së mirë, si dhe marrëdhënie ekonomike, tregtare e kulturore dhe pikëpamjet e ndryshme politike e ideologjike nuk pengojnë në këtë drejtim.

Imperialistët e socialimperialistët mendojnë se shteteve të vogla nuk duhet t'u lejohet të ngrenë zërin aq lart për problemet e ndryshme sa dhe shtetet e mëdha. Shteti shqiptar është vërtet një shtet i vogël, por ai nuk mund ta pranojë një pikëpamje të tillë. Ai e hedh poshi të këtë pikëpamje diskriminuese dhe shpreh lirisht e me guxim pikëpamjet e tij për çdo problem, nuk pranon që politika të jetë një monopol vetëm i shteteve të mëdha. Këto shtete këtë monopol e mbështesin në forcën e tyre ekonomike, në forcën ushtarake dhe në mjetet e fuqishme të propagandës që disponojnë, me të cilat duan të krijojnë bindjen dhe psikozën se bota nuk mund të gjejë kurrë stabilitet, përveçse nën ombrellën e tyre. Kjo me fjalë të tjera do të thotë se, kush dëshiron të rrojë (natyrisht kuptohet në skllavëri), duhet të mos flasë, po të jetë gojëmbël dhe të qëndrojë buzëqeshur përpara krimeve, shantazheve, rrave dhe dallavereve të fuqive të mëdha ose të mesme imperialiste e revizioniste. Këto pretendime ata i shoqërojnë me psikozën e luftës dhe të kërcënimit direkt ose indirekt që i bëjnë njërit ose tjetrit shtet, me kë-

cënimin dhe prerjen e ndonjë kredie që i kanë premtuar. Duke vendosur marrëdhëniet ndërkombe të mbi këto baza, është e vërtetë se gjendja në botë, dhe sidomos midis këtyre shteteve, nuk mund të gjejë kurrë stabilitet në rrugën e lirisë dhe të pavarësisë që ato aspirojnë dhe për të cilat luftojnë. Ato shtete, të mëdha ose të mesme qofshin, që u nënshtrohen shantazheve politike dhe frikësohen nga lufta, janë vazhdimisht në ethe dhe, në mos plotësisht, e humbasin shumë besimin në foreat e veta, në mundësitë e sigurimit dhe të kri-jimit të mjeteve të jetesës për popullin dhe atdheun e tyre. Ato kanë frikë nga çdo veprim i masave popullore të vendeve të tyre që frysmezojnë nga ndjenjat e lirisë dhe të së drejtës se mos pësojnë ndonjë goditje ose mos sulmohen nga supersfuqitë që duan t'i nënshtrojnë gjithnjë e më shumë.

Është e vërtetë se imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, si imperialistë grabitqarë dhe agresorë që janë, dëshirojnë të ndajnë midis tyre zonat e influencës, të ndajnë tregjet, dhe këtë politikë këto fuqi luftojnë dhe e vënë kudo që mundin në zbatim. Po përsë e vënë në zbatim? Sepse këtë gjë e lejojnë vetë shtetet dhe popujt që vuajnë pasojat e politikës së tyre të shantazhit, të presionit dhe të frikësimit, sepse këto shtete dhe popujt nuk marrin guximin dhe, pse të mos e themi hapur, kanë frikë t'u kundërshtojnë atyre deri edhe me armë.

Luftha e Dytë Botërore, me hyrjen në të të Bashkimt Sovjetik, të udhëhequr nga Partia Bolshevikë dhe nga Stalini, u kthye nga një luftë imperialiste, grabitqare që kishte filluar, në një luftë të drejtë nacional-

çlirimtare. Ajo ishte një provë e madhe që tregoi se gjatë zhvillimit të saj popujt luftuan heroikisht dhe shumë prej tyre fituan lirinë dhe pavarësinë. Bile vendi ynë e fitoi lirinë dhe pavarësinë pa ndërhyrjen e asnje ushtrie të huaj në territorin shqiptar. Liria dhe pavarësia e atdheut varen kryesisht nga qëndrimi nëse vendos të rrosh i lirë e në këmbë, apo skllav e i gjunjëzuar. Në qoftë se je i vendosur të rrosh i lirë dhe në këmbë, atëherë sprapset shantazhi, ringjallen forcat, rritet trimëria e popullit dhe fuqia agresore e ka të vështirë të të sulmojë. Kështu mendon populli ynë, dhe e bën të qartë këtë mendim për cilindë armik që kujton se do të mund të bëjë «një shëtitje» edhe në truallin shqiptar. Është e vërtetë se revisionistët sovjetikë e bënë një të tillë «shëtitje» në Çekoslovakia, por duhet thënë se populli çekoslovak nuk u ngrit në luftë kundër invadorëve sovjetikë, por i lejoi ata të shëtisin lirisht në vendin e vet.

Ngjarjet e vitit 1968 në Çekoslovakia dhe shantazhet e körcënimet e tjera të shumta të kurdisura nga imperializmi amerikan, nga socialimperializmi sovjetik ose nga shtetet e tjera borgjeze dhe kapitaliste, kanë krijuar mendimin se lufta e ardhshme që po përgatitet dhe që mund të shpërthejë qoftë nga njëra superfuqi, qoftë nga tjetra, qoftë kjo një luftë e përgjithshme apo e pjesëshme do të jetë një luftë rrufe, e shkurtër, saqë brenda tri-katër ditëve socialimperialistët sovjetikë do të arrijnë të zaptojnë gjithë Jugosllavinë (psc sa për Shqipërinë, siç mendojnë ata, këtë «e kanë vetëm një kafshatë goje!!») dhe brenda dhjetë ditëve tanket sovjetike do të gjendeshin në bregdetin

lindor të Atlantikut, në Portugali! Një psikozë e tillë e rrème po ushqehet përditë nga propaganda e superfuqive pér të frikësuar shtetet dhe popujt, pér të dobësuar mbrojtjen e tyre, pér të ulur vigjilencën, moralin dhe rezistencën e masave popullore, pér të nga-dalësuar hovin përparimtar kudo dhe në të gjithë sektorët e jetës. Me fjalë të tjera e gjithë kjo propagandë bëhet që popujt të rrojnë me psikozën dhe frikën e luftës dhe të krijohet tek ata një frymë pesimiste pér kotësinë e çdo rezistence, pra pér të dobësuar e pér të mposhtur frymën e tyre luftarake revolucionare në mbrojtje të lirisë dhe të pavarësisë së tyre.

Politika e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e shtetit shqiptar i demaskon me të gjitha forcat këtë propagandë dhe këto pikëpamje thellësishët armiqësore pér popujt. Për sa i përket popullit shqiptar, dihet që ai kurrë nuk ka pasur dhe nuk ka frikë nga cilado fuqi e madhe osc e mesme qoftë dhe sado e armatosur që të jetë, që do të guxojë të sulmojë vendin tonë. Populli shqiptar do t'i kundërshtojë me trimëri, me zgjuarsi dhe me të gjitha mjetet që disponon dhe është i bindur se do t'i mundë agresorët, cilëtdo qofshin ata. Një qëndrim i tillë nuk është aspak një qëndrim megaloman, por bazohet në realitetin e fortë të vendit tonë, në unitetin e çeliktë të popullit tonë, në qëllimin e lartë të mbrojtjes me çdo kusht të lirisë, të pavarësisë së atdheut dhe të fitoreve të mëdha në ndërtimin socialist, që i janë rrënjosur nga Partia çdo njeriu, të madh e të vogël në vendin tonë, bazohet në përgatitjen intensive ushtarake të të gjithë popullit ushtar dhe në konfiguracionin tokësor të truallit shqiptar. Ta kenë

të qartë se «shëtitje» agresorët nuk do të bëjnë dot në Shqipëri, por në çdo pëllëmbë tokë shqiptare ata do të gjejnë vdekjen. Mund që ata të arrijnë të na djegin qytete e fshatra, të na djegin grurin, por këmbë nuk do të vënë dot në tokën tonë. Edhe avionëve të tyre, me aq sa mundemi, ne do t'u bëjmë ballë, por të jenë për një gjë të sigurt se armët dhe bombat e tyre nuk do të përkulin dot kurrë rezistencën e madhe, shpirtin e heroizmit dhe ndjenjat e zjarra të patriotike të popullit shqiptar.

Të njëjtin mendim kemi ne dhe për popujt e Jugosllavisë, pavarësisht se në ideologji dhe në politikë me shtetin jugosllav dhe me Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë jemi në kontradikta të papajtueshme dhe për këto çështje as kemi mbyllur gojën dhe as që do ta mbyllim edhe në të ardhmen. Vlerësimet e mira që kemi bërë për popujt e Jugosllavisë ne i përsërisim dhe u përbahemi me respekt, por edhe ato që kemi thënë dhe themi për politikën e udhëheqjes së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe të shtetit jugosllav, ne i përsërisim, gjithashtu, dhe nuk heqim asnjë presje prej tyre. Kjo bëhet në bazë të atyre parimeve që përmenda më lart.

Populli shqiptar asnjëherë nuk u ka bërë ndonjë të keqë popujve të Jugosllavisë, përkundrazi, ndaj tij ai ka dhënë prova të një internacionalizmi të pashoq, kurse shteti jugosllav, i çfarëdo kohe, ndaj Shqipërisë ka mbajtur kurdoherë qëndrime armiqësore. Nga Jugoslavia erdhi në vitin 1924 xhelati i popullit shqiptar, Ahmet Zogu, me ushtrinë e rusëve të bardhë të Vangelit, të stërvitur në kazermat e car Aleksandrit, kur-

se populli shqiptar gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dërgoi divizione me partizanë për të ndihmuar në çlirimin e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Bosnjës.

Ne nuk dëshirojmë të futemi me këtë rast në historitë e njohura të ndërhyrjeve brutale e antimark-siste të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në punët e brendshme të Shqipërisë, se ato njihen, por, me gjithë këto që janë bërë ndaj vendit dhe popullit tonë, të vazhdohet të bëhen insinuata keqdashëse dhe të mbahen fjalime antishqiptare pa baza, kur shteti ynë vazhdon normalisht të ndjekë një politikë të fqinjësisë së mirë, të bëjë tregti dhe të bashkëpunojë në sferën e kulturës me të, këto, natyrisht, e dobësojnë këtë fqinjësi. Janë fare të kota dhe s'bindin asnjeri ato që pretendojnë udhëheqësit jugosllavë me qëndrime të tillë të shëmtuara, derisa të invokojnë sikur gjoja jemi ne që me veprimet tona favorizojmë një fuqi të tretë të madhe që kërcënon të dy shtetet tona.

Ajo që ka deklaruar Partia e Punës e Shqipërisë në lidhje me ndonjë sulm eventual të Bashkimit Sovjetik ose të ndonjë fuqie tjeter kundër Jugosllavisë, se në një rast të tillë ne do t'u qëndrojmë pranë popujve të Jugosllavisë, është një deklaratë e pashlyeshme. Por një qëndrimi të tillë i duhet përgjigjur nga pala jugosllave me veprime të drejta dhe korrekte ndaj nesh, si dhe me qëndrime të forta e joopportuniste ndaj kësaj ose asaj fuqie imperialiste që kërcënon pavarësinë dhe lirinë e Jugosllavisë. Në qoftë se qeveria jugosllave i buzëqesh njërit ose tjetrit imperialist, merr kredi nga njëri ose nga tjetri, i bën koncesione njërit

ose tjetrit, kjo, natyrisht, është punë e saj. Por të tilla veprime nuk mund të mbeten vetëm punë e saj, pse ato u interesojnë edhe Shqipërisë, dhe vendeve të tjera ballkanike, si dhe të gjitha vendeve të tjera të Mës-dheut, pse janë pikërisht qëndrime të tillë që shkaktojnë rrezikun që një shtet i tretë i madh, të sulmojë vendet tona!

Shteti jugosllav, natyrisht, ka të drejtë të bëjë vetë atë politikë që ai e gjen më të arsyeshme, por edhe shteti shqiptar, gjithashlu, ka të drejtën e vet të kritikojë veprimet që i sjellin dëme fqinjësisë së mirë midis dy vendeve tona. Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë dhe shteti jugosllav luftojnë kundër Stalinit, dhe pretendojnë se gjoja ai u paskësh bërë të këqija. Partia e Punës e Shqipërisë e do dhe e respekton Stalinin, se e di që ai nuk i ka bërë kurrikujt të keqë, veçse të mira dhe se ishte një marksist-leninist i madh. Në këtë çështje as nuk kemi qenë dhe as nuk do të jemi kurrë dakord me Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë. Gjithashtu, ne nuk do të jemi kurrë dakord me kritikat që ata i bëjnë Informbyrosë, kundër Stalinit.

Por ajo që është edhe më e rrezikshme dhe e parpranueshme nga populli dhe nga shteti shqiptar është se disa elementë armiq, me funksione e me përgjegjësi në regjimin e sotëm në Jugosllavi, kundërshtarët e regjimit të tyre të organizuar, të kurdisur dhe të nxitur nga Moska, nga satelitët e saj dhe nga imperializmi amerikan i quajnë «informbyroistë», «neostalinistë» dhe qëndrimet e drejta të vëllezërve shqiptarë që jetojnë në Jugosllavi i quajnë «irredentiste». Ata le t'i quajnë çfarë të duan këto qëndrime, nc nuk do të

pranojmë kurrë që, për të balancuar veprimtarinë antititiste të serbëve, të kroatëve etj., të shkaktojnë me këtë shpifje konfuzion në popullsinë shqiptare që banon në Kosovë, në Maqedoni e në Malin e Zi dhe të marrin masa persekuimi. Partia janë, si parti e vërtetë marksiste-leniniste, ka mbajtur kurdoherë qëndrime të drejta për sa u përket vëllezërve tanë shqiptarë që jetojnë në tokat e tyre, në Jugosllavi. Janë të kota dhe shumë të dëmshme orvatjet e autoriteteve jugosllave për të armiqësuar shqiptarët e Jugosllavisë me Republikën Popullore të Shqipërisë. Me këtë ata po i nxjerrin ngatërresa të rënda vetes së tyre. Shqipërisë ata nuk kanë çfarë t'i bëjnë, ajo është e parrekshme nga çdo pikëpamje dhe zhvillohet në rrugën e përparimit të saj të vrullshëm e të drejtë marksiste-leniniste të socializmit, në të gjitha fushat.

Të gjitha këto janë një dëshmi e madhe, që dashka ose nuk dashka Jugosllavia, u bëhen si shembull edhe popujve të Jugosllavisë, por, në mënyrë të veçantë, shqiptarëve që banojnë në Jugosllavi. Dhe një gjë e tillë nuk mund të quhet aspak një punë subversive, por është një realitet i pamohueshëm i Shqipërisë socialiste, që udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste. Nëse e pëlqejnë shqiptarët e Jugosllavisë këtë realitet, as ne, as shteti jugosllav nuk mund ta pengojë. Në të kundërtën fjali me të tilla, si ato të Minicit e të ndonjë tjetri, me siguri që do t'i acarojnë ndjenjat e shqiptarëve që banojnë në Jugosllavi, mbasi shpifet ndaj tyre, dhe, në fakt, atyre u bëhet një diskriminim i madh në krahasim me popujt e tjerë të Jugosllavisë, kur shohin se Kosova dhe krahinat e tjera

ku banojnë shqiptarë janë lënë në një varfëri të dukshme.

Këto që themi ne, shovinistët jugosllavë mund t'i quajnë ndërhyrje në punët e brendshme të tyre nga ana jonë. Por kjo nuk është aspak e vërtetë. Ata që pretendojnë aq shumë se janë «komunistë» le t'i kthehen historisë së hidhur dhe grabitqare të reaksionit serbomadh dhe do të shikojnë se kush ka ndërhyrë në punët e njëri-tjetrit dhe kush i ka shkaktuar falkeqësi tjetrit.

Ne, kur ka qenë rasti, pa frikë nga kurrkush, i kemi mbrojtur vëllezërit shqiptarë të Jugosllavisë nga të këqijat e mëdha që u janë bërë atyre në kohën e Rankoviçit. Kemi menduar dhe mendojmë, dhe natyrisht kjo është dëshira jonë, që të mos përsëriten më në formë të ndryshme të tillë qëndrime e veprime të shëmtuara, që gjoja u përshtaten kohëve të reja. Ne, shqiptarët, jemi po ata që kemi qenë më parë dhe ashtu si kemi mbajtur, mbajmë e do të mbajmë kurdoherë një qëndrim marksist-leninist ndaj popujve vëllezërit të Jugosllavisë, si dhe ndaj çështjes së popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Kush përpinqet t'i hedhë benzinë zjarrit, ne shqiptarët mendojmë se do të digjet me siguri në flakët e tij.

Popullsia shqiptare e Jugosllavisë ka të drejtën të gëzojë të gjitha liritë dhe avantazhet që gëzojnë atje edhe popujt e tjera. Ne mendojmë se kjo popullsi nuk mund të trajtohet ashtu siç po veprohet ndaj tyre në Jugosllavi.

Një politikë të drejtë, marksiste-leniniste, mbajmë ne ndaj minoritetit të vogël grek që ndodhet në

Shqipëri, i cili gjëzon të gjitha të drejtat njëloj si edhe shqiptarët. As burgje dhe as kampe nuk ka për minoritetin, as irredentistë e as vorioepirotë nuk ekzistojnë në minoritetin grek që jeton në Shqipëri, me gjithë propagandën e shfrenuar, të poshtër dhe krejt pa bazë që reaksiuni grek i megaloidesë po trumbeton çdo ditë në shtypin e tij. Pse ndodh kjo te ne? Kjo ndodh se popullsia minoritare greke në vendin tonë është e lidhur si mishi me thein me atdheun socialist, me Partinë marksiste-leniniste të Punës të Shqipërisë, me popullin shqiptar, pse ajo gjëzon të gjitha të drejtat. Kjo nuk bëhet për reklamë, por sepse kështu na mëson Partia jonë. Në Shqipëri nuk bëhet asnjë dallim midis shqiptarëve dhe minoritarëve grekë. Për ç'arsye nuk ngjet një gjë e tillë në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi me shqiptarët o atjeshëm? Këtë Jugosllavia të mos e kërkojë nga ne, por ta kërkojë në qëndrimet e udhëheqësve të saj, si dhe në ato të «miqve», me të cilët ajo bën allishverishe në kurrit të të gjithë popujve të Jugosllavisë.

Si konkluzion, politika jonë ndaj Jugosllavisë nuk ka ndryshuar asnjë presje dhe as që do të ndryshojë. Ne sigurojmë se çdo qëndrim që kemi shpallur dhe që njihet botërisht, do ta mbajmë. Popujt e Jugosllavisë ne i konsiderojmë popuj vëllezër dhe jemi të bindur se nga ata, qoftë tanë me qenien e Titos ose më vonë pas vdekjes së tij, nuk do të lejojnë që trualli i atdheut të tyre të bëhet si Çekoslovakia. Ata nuk do të pranojnë zgjedhën e kujtdo qoftë, nuk do të lejojnë as tanket e Jakubovskit, as ata të imperializmit amerikan «të shëtitin» lirisht në tokën jugosllave. Këtë respekt dhe be-

sim ne e kemi te popujt e Jugosllavisë, pse historia tre-gon që ata janë popuj trima.

Shumë fjalë thuhen e shumë shkruhet se Jugosllavia qenka në rrezik të madh. Ne mendojmë se nuk ekskludohet një sulm kundër Jugosllavisë fqinje, qoftë nga Bashkimi Sovjetik, qoftë nga ndonjë fuqi tjeter. Por populli ynë ka një shprehje plot kuptim, sipas së cilës duhet më parë të marroset kundërshtari, pastaj t'i bjerë murit me kokë. Sidoqoftë një sulm kundër Jugosllavisë ne do ta konsiderojmë si një sulm kundër Shqipërisë. Prandaj kemi të drejtë të kritikojmë veprimet e qeverisë jugosllave, që tregohet gjoja si e pangazhuar, si gjoja antiimperialiste, por, në fakt, koncesionet e shumta të saj ndaj të dyja superfuqive, e bëjnë atë shumë të angazhuar, gjë që krijon rreziqe të mëdha për të dhe për fqinjët e saj. Pavarësisht nga mosmarrëveshjet ideologjike që kemi ne me udhëheqjen jugosllave, këto kritika i bëjmë pse Lidhja e Komunistëve gënjen se ndërton socializmin, i bëjmë që të përmirësohet një gjendje e tillë e rrezikshme e punëve në këtë vend fqinj sa nuk është akoma tepër vonë.

Për sa u përket marrëdhënieve tona me Greqinë, nga ana jonë ato bazohen në politikën e fqinjësisë së mirë, të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit, të përfitimit në baza të drejta reciproke etj. Ne kemi kërkuar dhë dëshirojmë të rrojmë në miqësi me popullin vëlla grek dhe për këtë qëllim kemi bërë dhe vazhdojmë të bëjmë të gjitha përpjekjet që këto lidhje midis dy vendeve tona të forcohen vazhdimisht. Qeveria aktuale greke ka kërkuar dhe vazhdon të mbajë qëndrime miqësore ndaj vendit tonë. Edhe ne i për-

gjigjemi pozitivisht këtij qëndrimi, sepse është në interesin e dy vendeve tona dhe në dëm të armiqve tanë të përbashkët. Qeveria greke, e kuqtojmë se është një qeveri koalicioni partish dhe se në opozitë ajo ka shumë kundërshtarë. Kjo, natyrisht, është një çështje e bërendshme e grekëve. Secila nga këto parti ka qëndrimet e veta të ndryshme. Megjithatë, ne mendojmë dhe dëshirojmë që miqësia, bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë midis Greqisë dhe Shqipërisë nga të gjitha këto parti të konsiderohet si një gjë e mirë edhe për Greqinë vetë, por edhe për Shqipërinë.

Të kesh pretendime territoriale ndaj Shqipërisë, të bësh shpifje, të falsifikosh realitetin, gjendjen, jetën, zhvillimin e madh të begatisë të minoritetit grek në Shqipëri në çdo fushë, kjo jo vetëm e minon këtë bashkëpunim dhe fqinjësi të mirë, por krijon edhe një atmosferë të acaruar. Ashtu sikundër kanë të drejtë politikanët dhe çdo lloj partie në Greqi të thonë mendimin e tyre dhe të cirren për pretendimet absurdë ndaj «Vorio-Epirit», edhe ne kemi të drejtën t'i kundërshtojmë e t'i hedhim poshtë me faktë shpifjet e tyre pa baza.

Politikën tonë me shtetin grek, ne, shqiptarët, e duam që të mos jetë një politikë e përkohshme koniunkturale, por një politikë realiste, miqësore dhe e vazhdueshme midis dy popujve. Sa për monarko-fashistët dhe të ashtuquajturit vorioepirotë të marrë ne dëshirojmë t'u tregojmë se klithmat e tyre kanë shkaktuar të qeshura të mëdha në njerëzit e minoritetit grek që jeton i lumtur në Shqipëri. Popullsia e minoritetit grek tallet me ata që përpilen më kot të errësojnë diellin

dhe që rrojnë me ëndrrat e vjetra të Zografëve, të Venizellosve, të Metaksait, të Calderëve e shovinistëve të tjerë si këta, që në kohën e tyre as vëtë populli grek nuk pa një ditë të lirë, të lumtur e të qetë, të punonte tokën e vet dhe të mbushte barkun me bukë. Ne prapë u themi pasuesve të tyre: vazhdoni po të doni zanatin tuaj të vjetër të të qenit «vorioepirotë», se frikën s'ua kemi, as ne, as minoriteti grek në Shqipëri, pasi shqiptarë e minoritarë grekë janë të lidhur ngushtë e si vëllezër me njëri-tjetrin dhe karvani ynë ecën vazhdimisht përpara.

Ne kemi bindjen se, pavarësisht nga megalomanët e megaloidesë, në Greqi ka politikanë të arsyeshëm që i shikojnë problemet realisht dhe mendojnë se nga Shqipëria socialiste nuk do t'u vijë kurrë ndonjë e keqe dhe se miqësia e shqiptarëve ka vlerë të madhe për ta, ashtu sikurse ka vlerë edhe miqësia e popullit grek për ne.

Për sa i përket fqinjës së përtcjdetit, Italisë, ne vëtëm të këqija kemi parë nga qarqet drejtuese të këtij vendi, që e kanë çuar sot Italinë në një kaos të papershkuar dhe e kanë kthyer në një plasdarm të imperializmit amerikan, i cili bën atje ligjin, luan fijet në partitë e ndryshme, kërëve të të cilëve u mbushi duart me çeqe nëpërmjet koncerneve të mëdha monopoliste si «Lokhidi» dhe të tjera.

Neve na vjen shumë keq për popullin liridashës që punëtor italian, i cili ka rënë në kthetrat e shumë partive të shitura te kapitali i huaj. Ne kemi simpati për popullin italian që për komunistët e vërtetë marksistë-leninistë të Italisë, që luftojnë në një situatë

shumë të rëndë pér ta. Ne, kemi qenë dhe do të vazhdojmë të jemi vigjilentë ndaj Italisë, pa penguar dhe pa errësuar aspak ndjenjat e miqësisë që ushqejmë pér popullin e saj.

Me Italinë kemi marrëdhënien diplomatike, pérpiqemi të zhvillojmë marrëdhënien tregtare dhe kulturore, por është e kuptueshme se zhvillimi i këtyre marrëdhënieve nuk varet vetëm nga ne. Qeveritë e këtij vendi, që rrëzohen gati nga dy në çdo vit, janë qeveri formale, antipopullore, anëtarët e të cilave nuk dinë ku kanë kokën, pa le të jenë në gjendje të ruajnë, siç e kanë pér detyrë, Ambasadën e Republikës Popullore të Shqipërisë, ku banditët venë si pa të keq dhe depozitojnë bomba pér të vrarë punonjësit e përsaqësisë sonë atje. Duke prekur këto çështje, ne nuk mendojmë të ndërhyjmë në punët e brendshme të Italisë, çdo parti dhe çdo qeveri e Italisë le të bëjë politikën e vet, por ne dëshirojmë t'u themi atyre se nga ana jonë pérpiqemi si kurdoherë të jemi në miqësi me popullin italian dhe bashkë me këtë dëshirojmë të shtojmë se kjo që ju themi është një dëshirë e sinqertë që rrjedh nga ndjenjat e pastra të popullit shqiptar dhe nga politika e drejtë e shtelit tonë socialist. Miqësia me Shqipërinë nga ana e Italisë është shumë e rëndësishme pér Italinë dhe shpresojmë se kështu mendon çdo italian e çdo politikan italian, që gjykon me kokë të flohtë dhe realisht. Por askush nuk duhet të mendojë më se miqësia me Shqipërinë «është me të vërtetë e vlefshme pér Italinë, por pasi të okupohet prej saj», siç është bërë dy herë gjatë historisë moderne. Një pikëpamje e tillë fashiste, imperialiste, sot të çon në llogari të

gabuara, të shëmtuara, me rrjedhime të këqija, në radhë të parë, për vetë Italinë. Shqipëria, ka vendosur, dhe këtë vendim të saj nuk e luan as topi, që t'i bëjë ballë çdo sulmi, nga cilado anë që t'i vijë, qoftë veç e veç ose përnjëhorësh nga disa anë. Me fatin e popujve sot është vështirë të luajë njëri ose tjetri. Për sa na përket neve, fatin e kanë vetë në dorë populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë që e udhëheq atë.

Si konkluzion, me të tria këto vende të afërta fqinje ne dëshirojmë të kemi miqësi, të rrojnië në fqinjësi të mirë, në bashkëpunim të hapët, pa ndërhyrë në punët e brendshme të njëri-tjetrit dhe pa bërë përpjekje nga askush për t'u imponuar në një mënyrë ose në një tjetër pikëpamjet e tyre. Ne mendojmë se llogaritë e hapura bëjnë miqtë e mirë. Të rrimë drejt dhe të flasim shtrembër nuk është zakon i shqiptarëve, por ne duam që dhe të tjerët të rrinë drejt dhe të flasin e të veprojnë kurdoherë drejt dhe hapur me ne. Ka në botë njerëz që e pëlqejnë këtë qëndrim tonin, por ka edhe që nuk e pëlqejnë dhe, natyrisht, kjo është punë e tyre, siç janë punë për ne qëndrimet që mbajmë.

Edhe Turqia është një vend ballkanik. Ne nuk kthehem i në historitë e osmanëve, pse është një epokë që ka kaluar në historinë mesjetare, por sot me Republikën Turke nuk kemi gjëra që na ndajnë dhe të na pengojnë që popujt tanë të janë kurdoherë miq dhe të jetojnë në fqinjësi të mirë midis tyre. Këtë ua urojmë ta kenë gjithë popujt e Ballkanit.

Për popullin vëlla bullgar vazhdojmë të ushqejmë miqësi të singertë. Por, theksojmë se te udhëheqja e

partisë dhe e shtetit bullgar nuk kemi as besimin më të vogël, për arsyen se ajo është treguar armiqësore ndaj vendit tonë dhe është bërë vegël në duart e socialimperialistëve sovjetikë. Bullgaria është kthyer në një plasdarm sovjetik, në një vend që kurd ishte intrigë. Nga këto pozita u bën shantazhe vendeve fqinje, Jugosllavisë, Turqisë etj. Në një moment të përshtatshëm Bullgaria është gati të kapë Dardanelet dhe të përsëritë kështu Traktatin e Shën-Stefanit. Për këto arsyen ne dëshirojmë që marrëdhëniet mes Turqisë dhe Greqisë të gjejnë rrugën e zgjidhjes më të mirë dhe më të përshtatshme për të dy popujt dhe të dy shtetet ballkanike, në bisedime të hapëta dhe të singerta midis të dyja palëve. Kjo do të ishte një fitore e madhe edhe për ne, vendet e tjera ballkanike.

Ne i jemi mirënjosës dhe e falënderojmë Republikën e Turqisë që ka pranuar në truallin e saj një numër shumë të madh shqiptarësh, të cilët grapi serb i Rankoviçit i dëboi nga toka amtare e gjyshërvës dhe e stërgjyshërvës të vet. Turqia u ka dhënë bashkëpatriotëve tanë strehë, i ka futur në punë, u ka besuar detyra dhe kurrë nuk është orvatur që t'i asimilojë dhe t'u zhdukë kombësinë e tyre shqiptare. Ky qëndrim është në vazhdim të traditës demokrate të Qemal Ataturkut, i cili në kohën e vet, kur ndodhej në Selanik, kishte miqësi të ngushtë vëllazërore dhe politike me revolucionarët shqiptarë të Rilindjes, pse e lidhte me ta gjaku. Dhe bijtë e nipërit e tij nuk i harruan bijtë e Shqipërisë dhe ata po vazhdojnë të ecin në traditat përparimitare të këtij burri shteti të madh, për të cilin kishte respekt edhe Lenini.

Për popujt arabë ne ushqejmë një dashuri e miqësi të singertë që do të vazhdojmë ta zhvillojmë sa më shumë, pse janë popuj përparimtarë që kanë dhënë një kontribut të shumanshëm e jashtëzakonisht të çmuar në kulturën botërore, me zhvillimin e shkencave të matematikës, të astronomisë, të mjekësisë, të arkitekturës, të filozofisë, të letërsisë e në shumië drejtime të tjera të jetës dhe të diturisë. Asgjë nuk na ndan me këta popuj. Çështjen e besimeve ata që nuk na e duan të mirën, përpilen ta shfrytëzojnë si një mjet përcarjeje. Por, sipas nesh, popujt arabë janë të lirë të ndjekin dhe të besojnë në fenë e Muhamedit, ashtu sikurse është i lirë populli shqiptar të mos besojë as në fenë e Muhamedit, as në atë të Krishtit, as në atë të Jehovahut çifut, as në budizëm, as në brahmanizëm.

Ne kemi besim në çlirimin e plotë të popujve arabë nga zgjedha e kapitalit të huaj dhe e imperialistëve gjakpirës, të cilët e kanë bërë Lindjen e Mesme dhe të Afërt një fushë lufte për interesat e tyre grabitqarë. Gjaku i popujve arabë ka vite me radhë që po derdhet në fushat e betejave. Izraeli është bërë një shtet reaksionar agresor që Shtetet e Bashkuara të Amerikës e përdorin për të futur zënkat mes vendeve arabe, gjë që u shkakton këtyre gjakderdhje të shumta. Popujt arabë kërkojnë me të drejtë çlirimin e tokave të tyre të okupuara nga izraelitët, të përkrahur nga sionizmi ndërkombëtar, nga imperializmi amerikan dhe nga socialimperializmi sovjetik. Intrigat e njëpasnjëshme dhe shitja e armëve njërit apo tjetrit vend dhe komplotet që kurdisin njëri pas tjetrit këto dy superfuqi në Lindjen e Afërt dhe të Mesme e bëjnë mjaft

të vështirë çlirimin e popujve arabë, sidomos të tokave të tyre nga izraelitët dhe nga influenca keqbërëse e superfuqive.

Palestinezët luftojnë për një çështje të drejtë, ata luftojnë për t'u çliruar dhe për t'u kthyer në vatrat e tyre që u ka grabitur Izraeli. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik janë kundër palestinezëve dhe punojnë për të forcuar shtetin sionist të Izraelit, me anën e të cilit duan të mbajnë nën presion të vazhdueshëm dhe në grindje me njëri-tjetrin popujt arabë.

Popujt arabë janë përparimtarë. Ata kurrë nuk kanë qenë dhe nuk janë racistë. Racizmin do ta gjesh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër zezakëve, racizëm gjen sot në Bashkimin Sovjetik me qëndrimin diskriminues që mbahet kundër kombësive të ndryshme, duke përfshirë dhe izraclitët, racizëm gjejmë në vende të tjera, por në asnjë rast nuk kemi dëgjuar të ekzistojë racizëm në popujt arabë. Në këto vende të huajt priten me kënaqësi e dashuri si miq.

Prandaj me këta popuj përparimtarë, paqedashës, të zgjuar e të zotë, populli shqiptar e ndien veten të afërt dhe ushqen një respekt të madh dhe miqësia jonë bazohet në ndjenjat reciproke nga më të pastrat të popullit tonë.

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## KËTO MASA SYNOJNE PËRMIRËSIMIN E JETESËS NË FSHAT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

26 prill 1976

Natyrisht, këto ndryshime që propozohen për t'u bërë në Ligjin mbi Sigurimet Shoqërore Shtetërore, si edhe në atë të pensioneve për anëtarët e kooperativave bujqësore kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve që kemi marrë më parë dhe me përmirësimin e jetesës në fshat. Në parim besoj se jemi dakord me to.

Për propozimin që bëhet, lidhur me shpërblimin për lejen e barrës të grave kooperativiste, jam dakord që të njësohet me atë të grave punëtorë e nëpunëse të qytetit. Gratë e qytetit bëjnë një jetë e punë më komode nga ato të fshatit, prandaj, në qoftë se i ulim nga shpërblimi i menjëherëshëm 80 lekë gruas së qy-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth relacionit: «Mbi projektdekretin për disa ndryshime në Ligjin mbi Sigurimet Shoqërore Shtetërore dhe në Ligjin mbi pensionet për anëtarët e kooperativave bujqësore».

tetit, për ta barazuar me atë të fshatit, nuk është ndonjë gjë e madhe. Ne duhet të kemi parasysh edhe faktin që lindjet në fshat janë më të shumta. Po kështu edhe pjesa më e madhe e popullsisë është në fshat.

Dhënia e pagës plus pensionit për vjetërsi shërbimi atyre që punojnë edhe pasi të arrijnë moshën për pension, nuk mund të bëhet për të gjithë, prandaj të jetë e kufizuar vetëm për disa persona të veçantë, kurse të tjerët të dalin në pension. Se jo çdo njeri do të vazhdojë të punojë pasi ka mbushur moshën për pension pleqërie.

Mendoj se caktimi i pensionit më të lartë të pleqërisë në shumën 700 lekë nuk është pak, po të marrim parasysh edhe mesataren që kemi. Pensionisti mund të jetojë shumë mirë me pensionin që do të marrë, se fëmijët e tij, në kohën kur ai mbush moshën, në përgjithësi, janë në marrëdhënie pune ose kanë krijuar familje më vete.

Për çështjen e shpërblimit mbi maksimalen e pensionit, kur pensionisti punon, unë mendoj ta lëmë vetëm 200 lekë, pra, pensioni bashkë me pagën të mos kalojë 900 lekët.

Nuk e kuptova mirë propozimin që bëhet në material për fëmijët jetimë që janë në ngarkim të plotë të shtetit. Fëmija, pensionin që i takon nga prindërit e vdekur, e merr vetëm për sa kohë që është i mitur. Kur rritet dhe futet në punë, pensioni i ndërpritet. Në qoftë se ka motra ose vëllezër të vegjël, atëherë, ndryshon puna: këta vazhdojnë të marrin pensionin derisa të hyjnë në marrëdhënie pune. Sigurisht, kufizimet që mendohet të bëhen nuk duhet të jenë edhe

për kalamanët e çerdheve e të shtëpisë së fëmijës që janë të vegjël. Si mund t'ua presim këtyre pensionin? Është tjetër gjë t'ua presësh pensionin krejtësisht dhc tjetër gjë t'ua depozitosh në librezën e kursimit që t'ua ruash për t'i pasur kur të rriten, ashtu siç u tha me të drejtë këtu, prandaj, mendoj që këtë problem, ta lëmë ta gjykojë vetë ministria, duke pasur parasysh këto kritere për të cilat ramë dakord. Marzhi i caktuar prej 25 apo 30 për qind mund të jetë edhe pak më i madh.

Lidhur me propozimin për shpenzimet e ushqimit që duhet të përballojë shteti në kopshtet e çerdhet e kooperativave bujqësore, në parim, unë jam i mendimit që, për shumë arsy, në fshat duhet të jepet më shumë subvencion se në qytet. Në fshat ka më shumë fëmijë se në qytet dhe, përveç kësaj, qyteti është më i përparuar dhe interesimi i prindërve për fëmijët aty është më i madh se në fshat. Shumica e nënave fshatare fëmijën ia japid për ta mbajtur ndonjë plake, ose e lënë të luajë me fëmijët e tjera. Por të mos harrojmë se fëmijët e fshatit janë nga më të gjallët, që merren me punë që kur mbushin moshën 12 ose 13 vjeç, kurse moshatarët e tyre këtu në qytet nuk e bëjnë një gjë të tillë. Kur fëmija është i vogël, 3-4 vjeç, do kujdesin e duhur, prandaj nuk duhet të kursejmë asgjë në këtë drejtim. Për këto arsy me mua më duket se duhet të japid më shumë subvencion për fshatin dhe të zgjedhim variantin e dytë, sipas të cilit 20-25 për qind të shpenzimeve t'i përballojë shteti. Këtë duhet ta bëjmë, jo vetëm se ka ndryshim midis çerdheve e kopshteve të qytetit dhe atyre të fshatit, por edhe me qëllim që

t'i nxitim gratë fshatare për t'i çuar fëmijët e tyre  
në çerdhe e në kopshte.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosoë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# **NDËRTIMET QË BËJME TANI, DO T'I TRASHËGOJNË DHE BREZAT E ARDHISHËM**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**26 prill 1976**

Pas diskutimit që bëni<sup>2</sup> në mars të vitit të kaluar, unë reflektova pak për këtë çështje dhe kam disa mendime e ide.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe ajo e Tregtisë së Jashtme, mund të jenë bashkë. Po kështu, edhe ndërtesa e shtypit mund të vendoset këtej nga ministritë. Në vendin e parashikuar për këto ministri të ndërtohen shtëpi banimi, duke e zgjidhur me kujdes vendin e nderjes së rrobave.

**SHOKU SOKRAT MOSKO<sup>3</sup>:** Këtyre shtëpive të banimit mund t'u ndërlohet edhe një dhomë e vogël për tharjen e rrobave dhe shmangim kështu nderjen e tyre në ballkon ose në dritare. Në fillim, në këto rrugë, ne

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe studimi urbanistik i qendrës së Tiranës me parashtresën dhe maketin përkatës.

2. Shih: Enver Hoxha, Vepra, v. II, f. 245.

3. Në atë kohë, kryearkitekt në Komitetin Ekzekutiv të KP të Rrethit të Tiranës.

kishim parashikuar që të ndërtoheshin të gjitha banesa.

Për sa u përket ndërtimeve të rrugës «Luigj Gurakuqi», këto janë banesa të cilat, në katin përdhes, do të jenë me dyqane, kështu që ruhet edhe karakteri tregtar i kësaj rruge. Pra, kjo rrugë bëhet edhe shëtitore, dhe me dyqane, meqenëse e ka atë traditë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kjo pjesë ka një perspektivë të mirë. Busti i Avni Rustemit është këtu; aty monumenti i Partizanit; atje ai i Skënderbeut. Do të dalë një gjë e bukur.

Sa shtëpi të ulëta përdhese kemi ne! Po t'i prishësh e në vend të tyre të ndërtosh pallate, fiton shumë banesa. Po t'i bëjmë pallatet pesëkatëshe, ato do të merrnin trefishin e popullsisë që kemi sot në Tiranë.

Jam dakord me mendimin që u shfaq këtu, se në qendër, përkrah hotelit, në të majtë të bulevardit «Stalin», të mos ndërtohet as Pallati i Kongreseve, as godina e Presidiumit të Kuvendit Popullor, por ndonjëri nga muzetë<sup>1</sup>, sepse frekuentohen shumë nga populli. Këto të kenë një vazhdimësi lidhjeje me Monumentin e Lirisë. Është menduar shumë mirë që ndërtesa e Komitetit Ekzekutiv të ngrihet më tutje Monumentit të Lirisë, pra të qëndrojë në sheshin qendor.

Pallati i Kongreseve mendoj të ndërtohet në fund të bulevardit «Dëshmorët e Kombit», përballë selisë së Presidiumit të Kuvendit Popullor<sup>2</sup>. Ky mund të bëhet

1. Në këtë vend u ndërtua Muzeu Historik Kombëtar, i cili u përua më 28 tetor 1981, në prag të çeljes së Kongresit të 8-të të PPSH.

2. Pallati i Kongreseve u ndërtua pikërisht aty dhe u pë-

edhe në një vijë me godinën e Kryeministrisë, që është organi kryesor i administratës shtetërore. Pra, të qëndrojnë afër me njëri-tjetrin, Kryeministria, Komiteti Qendror i Partisë dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor. Kështu evitojmë edhe blokimet e rrugëve sepse, po të ndërtohen këto në sheshin qendror, rrugët do të blokohen.

Pallati i Kongreseve nuk ka pse të jetë i përbashlikët me atë të Kuvendit Popullor. Ky i fundit është tjetër gjë dhe do të ketë brenda, përveç zyrave të ndryshme, edhe salla për punë e një sallon për ceremonitë e pritjeve kredenciale. Dhoma pune për punonjësit, nuk do shumë se administrata e këtij pallati do të jetë e vogël.

Duhet të mendohet mirë çështja e arkitekturës. Për projektimin e Pallatit të Kongreseve duhet të punojnë arkitektët më të zotë e më të talentuar, që të jenë të ngritur, në radhë të parë, nga ana ideologjike. Ata të kuptojnë mirë rëndësinë e objektit dhe të gjejnë zgjidhjen më të drejtë, duke ruajtur formën kombëtare dhe duke e harmonizuar atë me ambientet përreth. Salla e kongreseve do të jetë e madhe. Madhësinë e saj do ta caktojë Komiteti Qendror. Të kihet parasysh që atje të parashikohen edhe salla pune për komisionet e ndryshme të kongresit; të ketë edhe bufe e vende çlodhjeje për delegatët gjatë pushimeve. Në sallën e madhe të kongreseve do të bëhen të gjitha mbledhjet. Në të mund të jepen edhe shfaqje artistike, por, për këto kemi edhe Teatrin e Operas. Veç kongreseve aty, mund

të zhvillohen edhe mitingje të mëdha ose mbrëmje solleme.

Gjelbërimi i territorit do të bëhet, natyrisht, në përshtatje të arkitekturës, duke e harmonizuar sa më bukur me ndërtesat e tjera që ka pranë. Hiç të mos jemi pishman për gjelbërimet. Po të duan, ata që do të vijnë pas nesh, le të bëjnë ndërtime të tjera. Po të mendojmë që t'i bëjmë të gjitha ne, nuk do t'u lëmë vend pasardhësve që edhe ata të ndërtojnë. Dhe për atë gjë është menduar, por gjelbërimi ka rëndësi.

Për të gjitha këto arsyen, unë them që Pallatin e Kongreseve dhe atë të Kuvendit Popullor t'i heqim nga sheshi qendror dhe t'i vendosim në fund të bulevardit «Dëshmorët e Kombit», matanë Kryeministrisë. Për një nga variantet e projektit të sheshit qendror kam një vërejtje. Monumenti i Lirisë vjen në një vijë me muzeun, kurse në variantin tjetër jo. Nuk e di po unë mendoj që ky monument më mirë të jetë veç e të mos jetë i lidhur me muzeun.

Monumenti i Lirisë duhet të dalë një gjë shumë e bukur, prandaj të mos rrethohet me pemë shumë të larta. Ai të jetë një sintezë e gjithë luftërave për liri që ka bërë populli ynë. Pra, në të të pasqyrohen gjeneratat e kaluara, të dalë, si të thuash, Shqipëria në sulm me shpatë në dorë, në dinamizmin e saj; të mos jetë statike, por në lëvizje.

*SHOKU SOKRAT MOSKO:* Monumenti do të dalë mirë. Edhe ana e ndriçimit është parashikuar të zgjidhet sa më drejt. Skulptorët janë shumë entuziastë për atë vend: dielli do ta kapë që në lindje e deri në perëndim, pra, vazhdimisht ka ndriçim.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Monumentit të Vlorës, dielli i bie në drejtim anësor.

Kurse xhaminë do ta mbajmë, nuk do ta prishim, se është monument i vjetër. Prania e saj nuk na e prish të qenurit laikë.

Kur diskutojmë problemet e urbanistikës, të mos harrojmë se zgjidhjet që propozojmë e realizojmë tani, do t'i trashëgojnë edhe brezat e ardhshëm. Proj këtej del vlera e madhe e punës së arkitektëve. Arkitektura është një problem me rëndësi jo vetëm për qytetet, në tërësi, por edhe për çdo objekt në veçanti. Prandaj është e domosdoshme që ne të kemi një ide të përgjithshme se si do të dalin këto dhe ato objekte, pastaj çdo gjë do të ketë dhe karakteristikat e veta individuale. Këto ne prapë do t'i shikojmë.

Tani nuk na mbetet gjë tjetër veçse t'u japim dorën këtyre shokëve. Atëherë, jemi dakord që ta aprovojmë, duke përfshirë edhe këto vërejtje që u bënë? (Të gjithë shokët qenë dakord.)

*Etohet për herë të parë, sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## **EKSPEKJENCA E FITUAR NË BAZË TË RREZATOHET NË TË GJITHË VENDIN**

*Nga biseda me kuadrot kryesorë të Ministrisë  
së Bujqësisë<sup>1</sup>*

**27 prill 1976**

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë se erdhët shoqja ministre! Si jeni me shëndet?

**SHOQJA THEMIZE THOMAI:** Ju faleminderit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si të erdhi kur ta komunikuan detyrën e re, shoqja Themije?

**SHOQJA THEMIZE THOMAI:** Nuk e prisja një gjë të tillë! Më njoftuan se më kërkon në Komitetin Qendror të Partisë shoku Haki Toska, por mendja më shkoi se mos do të më pyeste për kubikët, për ta informuar se ku ndodhemi me këtë punë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Vendimi që mori Byroja Politike për të gjithë ju, shtabin drejtues të Mi-

---

1. Shoku Enver Hoxha priti në zyrën e tij shoqen Themije Thomai, ministren e re të Bujqësisë, si dhe tre zëvendësministrat e rinj të Bujqësisë, shokët Spiro Lengo, Muho Asllani, Kristaq Kule. Në këtë takim ndodheshin dhe shokët Hysni Kapo e Haki Toska.

nistrisë së Bujqësisë, besojmë se është i drejtë. Ne u përpoqëm të zgjedhim si ministër një njeri me partishmëri, në radhë të parë, që i kupton problemet politikisht e ideologjikisht, por që ka treguar e vazhdon të tregojë zotësi edhe në zbatimin e detyrave të mëdha të bujqësisë. Kjo masë ishte e domosdoshme të merrej për dikasterin e Bujqësisë, se atje, duke filluar nga vetë ish-ministri, Pirro Dodbiba, janë vërtetuar punë të këqija. Pirro Dodbiba ka pasur koncepte revizioniste. Megjithatë punët në këtë sektor kanë ecur përpara, natyrisht jo në sajë të Pirro Dodbibës dhe të shokëve të tij, por në sajë të punës së kooperativistëve tanë, të drejtuesve e të gjithë punonjësve të tjerë të bujqësisë. Vëmë re se të gjitha kooperativat tonë bujqësore, veçanërisht ato të Lushnjës dhe të Dropullit, janë treguar në lartësinë e duhur, duke arritur rezultate të mira në realizimin e planit, në mobilizimin e masës fshatare, në kuptimin e drejtë të agroteknikës. Ato kanë arritur rezultate të atilla që janë bërë shembull për gjithë bujqësinë e vendit tonë. Por ish-drejtuesit në Ministrinë e Bujqësisë, duke shtrembëruar vijën e Partisë, kanë sjellë dëme në zhvillimin e bujqësisë socialiste, ashtu siç kanë dëmtuar me qëllim armiqtë në sektorë nga më të rëndësishëm e jetikë të vendit. Kjo e detyroi Byronë Politike ta spastrojë tërë këtë situatë dhe të vendosë për të sjellë në vend të tyre kuadro besnikë të Partisë e të popullit, që kanë dhënë prova në punë dhe është e bindur se ju do ta kryeni mirë punën e re që ju ngarkohet.

Mundet që juve, shoqja Themije, shoku Spiro Lengo dhe juve shokë të tjerë, t'ju vijë pak si i papritur cakti-

mi në këtë detyrë, por Partia me kohë na ka mësuar që asgjë të mos na duket e papritur. Vija e saj për përgatitjen e kuadrove të rinj është e njohur nga të gjithë. Ju ju cakton ajo në këto detyra me rëndësi jo tñjesht pse jeni të rinj e me eksperiencë, por se jeni edhe të ditur, plot forcë e dinamizëm. Partia kurdoherë ka këshilluar që kuadrot e rinj të bashkojnë forcat me më të moshuarit. Në qoftë se ajo nuk e bën vazhdimisht këtë, atëherë Partia plaket. Në kongreset është theksuar vazhdimisht se, që Partia të jetë kurdoherë e re, duhet të futë në gjirin e vet gjak të ri c' t'u japë përgjegjësi edhe të rinjve. Kjo nuk do të thotë se të vjetrit nuk kanë më vlerë për Partinë, çështja është të vlerësohen edhe të rinjtë, të cilët nga ana e tyre i respektojnë të vjetrit për eksperiencën që kanë, natyrisht, kur këta e meritojnë këtë respekt, pse, po të mos e meritojnë, Partia i zëvendëson me të rinj, dhe këta të fundit që t'i njohë populli, ngarkohen edhe me detyra e përgjegjësi.

Që të katër ju e dini se bujqësia ka rëndësi të madhe për ne. Ti, shoqja ministre dhe ju shokët e tjerë, zëvendësit e saj, tanj në fillim mos u hutoni, as mos u trembni, sepse së bashku do të formoni një ekip të shëndoshë, pasi vini nga arat, nga toka, ku zbatohet politika e Partisë për sektorin e bujqësisë. Ju jeni rritur në fshat dhe atje, ku keni punuar e keni drejtuar e keni ngritur bujqësinë në një nivel të kënaqshëm. Me këtë dua të them se nuk jeni njerëz pa eksperiencë dhc me horizont të ngushtë, se edhe shkollë keni. Vetëm duhet të jeni kurdoherë të thjeshtë, ashtu siç keni qenë e jeni edhe tanë. Këtë po jua them jo për t'ju rritur mendjen, po fakt është se horizonti juaj është i gjerë.

Pastaj te ju nuk ekziston fryma e burokratizmit e intelektualizmit dhe e shkencës për shkencë, përkundrazi keni forcë dhe vullnet që këtë shkencë ta vini në jetë, duke mobilizuar njerëzit në punë për të kryer detyra të mëdha.

Derisa ti, shoqja ministre, tok me Partinë, me shokët dhe me shoqet e tua keni arritur deri sot në kooperativën e Këmishtajt rezultate të mira, tash kur me detyrën e re të hapet një horizont më i gjerë, Partia kërkon që këtë eksperiencë të fituar ta shfrytëzosh në platformën e madhe të të gjithë Shqipërisë. Të njëjtën kërkesë e kam edhe për ndihmësit e tu. Këni mundësi ta bëni këtë? Ne jemi të bindur se do ta bëni, sepse të gjithë ju keni punuar në ndërmarrje bujqësore dhe në kooperativa dhe eksperiencia e mirë që keni zbatuar atje, duhet të vlejë për të rrezatuar në shkallë republike veprimtarinë dhe eksperiencën tuaj pozitive. Tash si do të bëni ju? Ashtu siç keni bërë edhe në kooperativë. Një oficer, që sot komandon një nënrepart, kur të vijë dita që Partia t'i japë në dorë një njësi ushtarake të tërë, në bazë të eksperiencës që ka fituar në drejtimin e nënrepartit, duhet të mendojë dhe të gjejë format më të përshtatshme për ta drejtuar mirë njësinë që iu besua, që nesër, në rast rreziku, të fitojë pa shumë humbje mbi armikun. Kështu është edhe me punën tuaj. Unë kam besim se ju do të dini ta çoni punën përpëra në bujqësi, se me të jeni marrë vazhdimisht dhe keni dhënë prova.

Partia ty, shoqja Themije, të bëri sot ministre dhe ju të tjerët zëvendësministra. Tani ju zotësinë tuaj duhet ta vini në jetë, me qëllim që në Ministrinë e Bujqësisë të sigurohet një drejtim i fortë marksist-leninist i

çeliktë që vija e drejtë e Partisë për çështjen e madhe të bujqësisë të zbatohet e të gërshetohet si duhet me shkencën dhe me praktikën. Këto, shokë, mund të realizohen duke pasur të qartë qëllimin e madh që synon bujqësia jonë socialiste. Ne kemi bindjen se çdo direktivë të Partisë ju do të dini ta zbatoni. Por, siç thotë Stalini, çdo direktivë e drejtë e partisë, pasi të zbërthehet e të kuptohet, duhen marrë masa për të organizuuar zbatimin e saj. Po nuk u morën të tilla masa, ajoz nuk ka si të zbatohet, pra, nuk do të ketë rezultate. Ju tani po viheni në krye të punëve në bujqësi, edhe ne do t'ju ndihmojnë që të kryeni sa më mirë detyrën, por shikoni se veç atyre që po zëvendësoni, mund të spastrohen edhe të tjerë në mënyrë që të sillen në ministri, njerëz me të vërtetë të shkencës dhe të praktikës.

Ju duhet të bashkëpunoni shumë ngushtë me njëri-tjetrin, sepse së bashku keni përgjegjësi të madhe, kolektive, por edhe personale. Për çështjet kryesore që janë vendimtare, merrni përgjegjësi kolektive. Kjo do të thotë të këshilloheni me njëri-tjetrin për zgjidhjen dhe përrugët e zbatimit të tyre, të gjykonit së bashku çdo problem me rëndësi në rrugën marksiste-leniniste, në rrugë të drejtë, duke ndihmuar njëri-tjetrin edhe me kritika, në rast se te ndonjëri ka ndonjë shfaqje jo të drejtë dhe ai ta konsiderojë vërejtjen tuaj të vlefshme. Por, kur ju të bëni, gjithashtu, ndonjë gabim, edhe ai duhet t'ju kritikojë. Ka rëndësi që ju të shkoni në harmoni me njëri-tjetrin, po në harmoni marksiste-leniniste. Me këtë dua të them që të mos bini në familjaritet, sepse ky e dobëson dhe e dëmton shumë punën. Ata që vuajnë nga familjariteti duket sikur duhen më shumë

me njëri-tjetrin, por, në fakt, familjariteti dëmton interesin e përgjithshëm. Ne jemi kundër kultit të personit, të cilin e kanë dënuar Marks, Lenin dhe Stalini. Kjo çështje nuk duhet kuptuar si diçka formale dhe vetëm ndaj meje, por ndaj çdo personi. Kur kemi vërejtje për të bërë, duhet të flasim, se druajtja të merr në qafë. Për shembull, fliste si fliste Abdyl Këllezi ose thoshin ç'thoshin Beqir Balluku me shokë, që ishin edhe anëtarë të udhëheqjes, por, kur köta gabonin, ata që i dëgjonin apo i shikonin, nuk u bënин vërejtje. Partia na mëson ta gjykojmë secilin nga fjalët dhe nga puna dhe, kur e ka gabim, atëherë ky i duhet vënë në dukje. Kushdo, kur shikon se një nga udhëheqësit gabon dhe nuk vepron drejt, pse të mos i dërgojë letër Byrosë Politike dhe t'i thotë se nuk është dakord me këtë apo me atë veprim të tij? Të jeni të bindur, shokë, që anëtarëve të Byrosë Politike dhe gjithë shokëve të tjera të udhëheqjes nuk do t'u mbetet qejfi. Këtë duhet ta kuptojnë mirë të gjithë. Por në Ministrinë e Bujqësisë, ashtu si edhe në disa dikastere të tjera ka ekzistuar një frymë e tillë.

Ju do të keni kurdoherë ndihmën e shokëve të Byrosë Politike, të shokëve sekretarë të Komitetit Qendror të Partisë, ndihmën e Qeverisë, si dhe ndihmën time, natyrisht, me aq sa mund t'jua jap, me ato që di, se unë specialist për bujqësinë nuk jam. Ç't'ju them unë për rëndësinë e drithit, të bimëve industriale, të bagëtive, për rëndësinë e drurëve frutorë apo se sa prodhim duhet nxjerrë nga toka dhe si duhet nxjerrë ai? Të gjitha këto ju i dini shumë më mirë se unë. Prandaj

mbështetuni në përvojën organizative që keni fituar në kooperativat që keni drejtuar, se ato kanë qenë të përparuara. Kjo do të thotë se atje ju keni qenë në rrugën e Partisë, edhe këtu duhet të vazhdoni të jeni në rrugën e Partisë, duke luftuar për tejkalimin e planeve.

Kini parasysh që në punët tuaja të shfrytëzoni edhe kapacitetin e gjithë shkencëtarëve, që në sektorin e bujqësisë nuk janë pak, po që deri tani nuk janë përdorur mirë. Pirro Dodbiba dhe shokët e tij, në dukje, hiqeshin sikur interesoheshin shumë për shkencëtarët e këtij sektori, për agronomët, zooteknikët, veterinerët etj., por në praktikë niseshin nga pikëpamja e gabuar se Ministria e Bujqësisë ishte një «këshilltar». Në kohën e njëfarë Maqo Çomoje, ish-ministër i Bujqësisë, u përhap një teori tjetër, sipas së cilës ai thoshte për vete se ishte «ministër i fermave e i kooperativave dhe jo ministër i fshatit». Të tilla, po edhe më të stërholluara, janë disa pikëpamje dhe praktika të vetadministrimit të Pirro Dodbibës. Ai donte të hiqte nga drejtimi i centralizuar edhe ndërmarrjet bujqësore e kooperativat e tipit të lartë, u orvat të shpërndante edhe SMT-të që këto të ishin të kooperativave, kurse marksizëm-lininizmi na mëson që ato duhet të janë të shtetit. Në ndërmarrjet bujqësore ishte për krijimin e hozrashoteve të shumta dhe jo të brendshme, por që mbajnë lidhje drejtpërdrejt me bankën, e të tjera veprime si këto që i bënte pa dijeninë e Byrosë Politike.

Këta elementë, për të vënë në jetë idetë e tyre revolucioniste, kur shkonin në bazë gënjenin shokët atje, duke u thënë se «kështu janë udhëzimet e Byrosë Politike», «këto na i ka rekonduar shoku Enver, shoku

Hysni», ndërsa kur ktheheteshin në qendër na thoshin neve se «këto gjëra na i ka propozuar baza».

Ish-drejtuesit e Ministrisë së Bujqësisë kanë nën-vleftësuar misrin, hapjen e tokave të reja, ata kanë neglighuar bonifikimet, kanë harxhuar në drejtime të tjera jo frytëdhënëse fondet për hapjen e kanaleve. Ata kanë bërë edhe shumë veprime të tjera, të parregullta, një pjesë të të cilave duhet t'i dini dhe për një pjesë tjeter do të njiheni nëpërmjet shokut Haki dhe shokut Xhafer [Spahiu]. Në Ministrinë e Bujqësisë u bënë përpjekje të shpërndajahej mekanika bujqësore, duke synuar që me këto masa ta çonin bujqësinë tonë në rrugën revisioniste, në vetadministrim. Të gjitha këto që janë bërë, të mos ju trembin shoqja ministre, rëndësi ka të kuptoni qëllimet e këtyre njerëzve.

Tani ne do ta ndreqim gjendjen që është krijuar në sektorin e bujqësisë dhe këtë do ta bëjë Partia, në radhë të parë. Ne do të marrim masa për të ndryshuar mjaft gjëra për sa u përket ndërmarrjeve bujqësore dhe kooperativave të tipit të lartë.

Dëshirojmë t'ju këshillojmë që puna juaj në ministri të mos jetë vetëm një punë thjesht praktike, por praktika të gërshetohet e të kombinohet sa më mirë me teorinë. Rëndësi t'i vihet çështjes që njerëzit e shkencës, organizatorët, ekonomistët e të tjera t'i lidhni me tokën, të mos qëndrojnë nëpër zyra. Shoqja ministre dhe ju shokë zëvendësinistra, ndani më mirë punët midis jush, gjykoni dhe bëni planin bashkë me shokët e Qeverisë se si të punohet më mirë për realizimin e tij, si do të drejtohet gjithë kjo mori specialistësh, si duhet punuar që në kooperativat njerëzit e shkencës të lidhen

me praktikën, se nuk janë të lidhur si duhet e në mënyrë të kënaqshme. Prandaj këtë frysme përpinquni të çoni në ministri.

Natyrisht, ju nuk mund të jeni nga të katër anët, por me mjetet që ka caktuar Partia, të keni syrin, veshin, kontrollin kudo në bujqësi. Për këto keni forca të mëdha në dispozicion, keni kontrollin punëtor e fshatar. Në qoftë se Partia në bazë e kupton mirë këtë, kjo përbën një forcë të madhe për ju, për arsimin, për kulturën dhe për gjithë sektorët e tjerë, ku janë vërtetuar gabime të rënda. Dhe në këtë drejtim një ndihmë të madhe do t'ju japë Partia. Për një sërë orientimesh Komiteti Qendror ka ngarkuar Ministrinë e Bujqësisë t'i studiojë, t'i kuptojë, t'i zbërthejë, t'i vërë në zbatim. Ju duhet t'i merrni e t'i shikoni të gjitha me radhë e një nga një këto orientime të Partisë, pastaj ndërtoni konkretisht punën për zbërthimin dhe për realizimin e tyre në jetë. Të marrim, fjala vjen, eksperiencën e kooperativës së tipit të lartë të Plasës. Është thënë se kjo eksperiencë duhet të bëhet shembull për ta përhapur në gjithë Shqipërinë, po deri tash s'është vënë në jetë kjo porosi.

Me këto dua të them që të shfrytëzohen si duhet dhe kur duhet mundësitë që na jasin bujqësia, toka, klima dhe të gjitha ato mundësi të tjera të mëdha që ka krijuar shteti ynë, si: bonifikimet, kanalet ujitëse, mekanika bujqësore, farërat, kuadrot etj. Bujqësia jonë është një bujqësi moderne e planifikuar. Mund të jesh mangët në një produkt bujqësor, po një tjetër do të të japë mundësi ta plotësosh boshllékun e së parës. Veçse ne nuk mund të ecim, siç bën Kicho Ngjela me Pi-

rro Dodbibën, që vinin interesin, fitimin, përpara nevojave të atdheut. «Domate, domate, domate», thërrisnin Kiço Ngjela e Pirro Dodbiba dhe linin bukën, se synonin vetëm fitimin. Po bukën ku ta gjenim? Dhe detyroheshim të sillnim çdo vit drithë nga jashtë. Kështu veprohej edhe për disa artikuj të tjera, që ne duhet t'i prodhojmë në vend, si: oriz, vaj, pambuk. Tash me këto prodhime jemi më mirë, por çështja është që të jemi akoma më mirë. Prandaj t'i shikojmë më thellë këto orientime, t'i vëmë në zbatim, natyrisht mundet jo përnjëherë, por t'i marrim me radhi e t'i zgjidhim një nga një.

Natyrisht, si këto ka edhe probleme të tjera në bujqësi. Studimi i tokave që kemi bërë, është një ndërma rrje shumë e madhe shkencore. Populli thotë «çfarë të mbjellësh, do të korrësh». Toka është mëma, nga ajo del «fëmija». Në qoftë se mëmës nuk i bëjmë shërbimet e duhura, nuk e ushqejmë, nuk e ruajmë nga sëmundjet, ajo nuk mund të lindë fëmijë të shëndoshë. Kështu është edhe me tokën. Prandaj në këtë drejtim të ecim edhe më përpara. Po në ç'menyrë? Unë mendoj që, kur të bëhen planet në çdo kooperativë, atje të venë edhe specialistë pedologë, me qëllim që, kur kryetari i koo perativës të propozojë, ta zëmë, që të mbillet pambuk, të japë edhe pedologu mendimin e tij për këtë çështje, duke kërkuar të bëjë më parë analizën kimike të tokës, në menyrë që në bazë të të dhënave që do të sigurojë nga studimi, të merret një vendim i bazuar real dhe shkençor. Në qoftë se del që toka është gjysmë e përshtatshme për këtë ose atë bimë, kur të vijë çështja te plehu, të dijë sa plehra duhet t'i hidhen kësaj parcele. Kjo pu-

në duhet të bëhet efektivisht në të gjitha kooperativat.

Një çështje tjetër që duhet parë me kujdes është ana ekonomiko-financiare e çdo veprimi. I thashë edhe shloqes Lenka Çuko, kur e takova para disa ditësh<sup>1</sup>, që kudo t'i vihet rëndësi sektorit ekonomiko-financiar, llogarisë. Kjo ka qenë dhe është një nga anët më të rëndësishme të zhvillimit të ekonomisë socialiste të planifikuar e të centralizuar. Kur themi të prodhojmë shumë dhe me cilësi të mirë, kjo është një çështje ekonomike me rëndësi të madhe, por çdo njësi prodhimi duhet të na kushtojë sa më lirë. Prandaj kur bëhet plani në çdo ndërmarrje apo kooperativë bujqësore, krahas kryetarit, sekretarit të organizatës së Partisë dhe ndonjë tjetri, të jenë medoemos dhe të thonë fjalën e tyre edhe ekonomisti e llogaritari. Specialistët e bujqësisë e të blegtorisë duhet të kenë dhe kanë mendimin e tyre, por edhe ekonomisti duhet të japë mendimin për çdo veprim që kryhet dhe me ç'shpenzime do të bëhet. Kur udhëheqja vendos një masë, ekonomisti duhet të bëjë llogaritë dhe t'i thotë drejtorit të ndërmarrjes apo kryesisë së kooperativës që kjo apo ajo bimë nuk është rentabël nga ana ekonomike, jo vetëm për kooperativën, por edhe për shtetin. Abdyl Këllezi hiqej si ekonomist, por ai edhe bankës bujqësore nuk i vinte rëndësinë e duhur, e kishte lënë në hall të madh. Prandaj llogarinë në kooperativat e në ndërmarrjet bujqësore duhet ta keni në rregull, se ka rëndësi të madhe; djersa e derdhur nga kooperativistët duhet të shpërblehet me të ardhura maksimale. Se ç'ndodh? Porsa u mbollën 40 hektarë me vre-

---

1. Shih në këtë vëllim, f. 88.

shta në ndërmarrjen bujqësore të Tepelenës, dha urdhër Pirro Dodbiba që të shkuleshin, mbasi ishin të infektuara. Kur ishte kështu, atëherë përse dërgoi ai jashtë shtetit fidanë të mirë hardhish dhe la të infektuarat në vend? Kjo do të thotë se ato qenë jashtë standardit! Por atë nuk e preokupoi sa shpenzime u bënë për këtë punë të kotë, kurse ana ekonomiko-financiare është e domosdoshme të kihet vazhdimisht parasysh.

Ndërmarrjet bujqësore sidomos duhet t'i forcojmë shumë nga kjo anë, se udhëheqja e miëparshme e ministrisë as që ka menduar në këtë drejtim. Ndërmarrjet bujqësore, jo vetëm që nuk duhet të financohen më nga shteti, por, për sa u përket të ardhurave, ato t'ua kalojnë edhe kooperativave të tipit të lartë, siç është ajo e Këmishtajt, e Dropullit dhe të tjera si këto, sepse i kanë mundësitë më të mëdha nga kooperativat, ato janë të siguruara më mirë me mekanizma, me farëra të zgjedhura, me suqi punëtore e kuadro, me ujitje etj. Prandaj drejtuesve të ndërmarrjeve bujqësore t'u kërkohet llogari deri në një. Nuk ka vend këtu për lëshime apo sentimentalizma. Është shok i vjetër me eksperiençë, për shembull, Sulejman Gallaj në ndërmarrjen e Sukthit apo ndonjë tjetër, ne e respektojmë për eksperiencën që ka dhe për punën që bën, megjithëkëtë edhe shokëve të tillë, në ndërmarrjet që drejtojnë, t'u kërkojmë të marrin rendimente më të larta dhe këtë t'ua argumentojmë shkencërisht. Natyrisht kjo do të kërkojë përpjekje.

Të njëjtën rëndësi t'u vëmë dhe kooperativave bujqësore. Ne e dimë mirë si ishin përpjekur Çlirimt fshatrat e Dropullit, po si u bënë dhe ç'rendimente të larta me-

rren tani në tokat e tyre?! Këto u bënë se njerëzit atje janë të lidhur me Partinë; deri dje ata ishin të shtypur, të uritur, dinin të punonin, të ujilnin dhe të bënин të gjitha shërbimet e tjera, po këto mundësi, që ka krijuar Partia sot, nuk i kishin. Tani që u krijuan, shikoni ç'rezultate kanë arritur! Më përpara Korça mbahej për më e mira në republikë në punët e bujqësisë, por ju në Këmishtaj e në Dropull e keni kapërcyer Korçën. Për këtë aspak të mos u rritet mendja, por fakti kështu është. Por, siç thashë, krahas përpjekjeve për rritjen e prodhimit, kudo në bujqësi të drejtohen sytë edhe nga kostoja, që çdo punim të realizohet me sa më pak shpenzime. Këtë e kërkon ekonomia socialiste.

Prandaj për zgjidhjen e një sërë problemeve kyç duhet punuar më mirë. Për këtë qëllim, në radhë të parë, duhen pastruar kokat e njerëzve dhe fryma e sëmurë që kanë përhapur ata që qëruain nga aparat i ministrisë. Ju mund të hasni në punë e sipër edhe njerëz që kanë njësarë «krenarie» dhe t'ju thonë: «Kush je ti, Themije Thomai? Ti një kryetare kooperative ke qenë në Këmishtaj, prandaj ti do të më mësosh mua?!». Në raste të tilla ti mos u dëshpëro, po i trego me punën tënde se kush je. Ose ndonjë tjeter mund të thotë: «More po kush je ti, Spiro Lengo?! Kurse unë jam specialist për blektorinë e gjithë Shqipërisë». «E di, e di», thuaji ti, «por nuk ka punuar mirë, prandaj vihu një herë në brazdë, se unë të kërkoj llogari!».

Ju i dini të gjitha këto gjëra më mirë se unë, që nuk jam specialist dhe këtë nuk e them për modesti.

**SHOQJA THEMIJE THOMAI:** Ju, shoku Enver, i njihni shumë mirë këto probleme, saqë ne, punonjësit

e bujqësisë, kemi mësuar shumë nga këshillat tuaja të vlefshme që dhatë vjet në rrethet e Korçës dhe të Pogradecit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** E kam fjalën që ju jeni trima, njerëz të guximshëm, revolucionarë, po edhe me njohuri agroteknike të mira dhe me një eksperiencë jo të vogël.

Kështu janë situatat, shokë, dhe kështu t'i gjykonit njerëzit. U kërkonit atyre llogari deri më një, se edhe ne do t'ju kërkojmë llogari juve. Ju na kritikoni edhe po të japim ndonjë udhëzim jo të drejtë. Duke ndihmuar kështu reciprokisht njëri-tjetrin, kemi bindjen se puna do të na ecë më mirë.

Ne zgjodhëm si ministër për bujqësinë një shoqe. Siç e kam thënë edhe kur vendosëm, këtë e bëmë për meritat e saj, për punën e saj, për prejardhjen e saj, se ajo ka ardhur nga balta e arave ku është rritur e kallitur. Ajo tok me organizatën e Partisë dhe me koooperativistët e ngriti kooperativën në atë nivel që u bë shembull.

Arsyeja tjetër që e ngritëm, është se kemi të bëjmë me një grua. Gruaja sot te ne punon kudo, prandaj, kur të shikojnë gratë punëtore të bujqësisë dhe kooperativistët që në krye të dikasterit të Bujqësisë ka ardhur një grua, do të ketë një entuziazëm të madh në radhët e tyre. Këlë rast që nga gjiri i baltës së Myzeqesë doli e para ministre e Bujqësisë së vendit tonë, duhet ta shfrytëzojë mirë Partia. Këlë e them se di që ti, shoqja Themije, je një grua e thjeshtë. Edhe ndihmësministrat, që caktuam, kanë ardhur, gjithashtu, nga balta e arave. Partia e Punës e Shqipërisë nuk bën asnjë dallim në

ngritjen e kuadrove qoftë nga minoriteti, ashtu dhe nga të gjitha krahinat e tjera të vendit. E tillë është vija e Partisë, e cila është e lidhur njëloj me të gjithë dhe të tërë te ne janë të lidhur si mishi me kockën me Partinë. Këto janë aspektet e mëdha politike të këtij problemi të madh që vërteton drejtësinë e vijës së Partisë. Këto gjëra duhet t'i vëmë mirë në dukje.

Ngarkoni njerëzit me punë, shokë, merrni mendimet e tyre, gjykon me kujdes mbi raportet e tyre dhe i vërtetoni, se kjo ka rëndësi. T'i thuash atij që nuk paraqet drejt situatën të të mos raportojë më shtrembër, jo realisht, dhe këtë ta ketë vazhdimisht parasysh, ndryshe, po nuk u ndreq, merren masa. Në qoftë se një kuadër është i mirë dhe punon si duhet, mbajeni, në qoftë se vepron keq, hiqeni, gjeni një tjetër, pse ka përgatitur plot të tjerë Partia. Shikojini dhe vlerësojini njerëzit nga puna. Gruri bëhet mirë, në rast se njerëzit punojnë mirë. Në qoftë se brigadierin e zgjedh mbledhja e brigadës, anëtarët e kësaj brigade t'i bëjnë sylë katër dhe, kur shohin që ai nuk punon mirë, ta këshillojnë një herë, dy, pastaj të kërkojnë që të hiqet, nuk ka pse të rrrijë më atje, po të vihet në vend të tij një tjetër. Kur të veprohet kështu, atëherë njerëzit do të hapin gojët. Mbyllja e gojës nuk është gjë e mirë. Dhe kur njerëzit flasin kjo bëhet për të mirë, por ka raste edhe për të keq. Mirëpo kur është Partia në këmbë, ajo ditë gjykojë, të veprojë dhe të marrë masa të drejta.

Më falni se ju mbajta shumë.

*SHOKU SPIRO LENGO:* Përkundrazi, ne do të kishim dëshirë të rrinim akoma dhe të dëgjonim këshillat shumë të vlefshme që po na jepni, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Tani, me të dalë këtej shkoni në shtëpi, pastaj kthehuni të filloni nga puna e re.

Unë kam pyetur për ty, shoqja Themije dhe më kanë thënë se ke dy fëmijë, ke edhe burrë të mirë, mjek stomatolog. Mund të ketë dhe do të ketë njerëz që do të thonë se nuk e bën dot një grua këtë detyrë, se bujqësia është punë e rëndë. Kjo, natyrisht do të ishte e vështirë për një grua nga qyteti, kurse ti tërë jetën ke qenë në fshat, ke lindur, je rritur dhe atje ke punuar e ke jetuar duke u marrë me punët e bujqësisë. Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha këto që ju thashë, ne të zgjodhëm ty në krye të Ministrisë së Bujqësisë.

Ashtu siç ju thashë më parë, ne kemi besim që ju do ta kryeni me ndër detyrën që ju caktoi Partia. Ju uroj suksese në punë! Dalshi faqe bardhë! Tani jemi përpara detyrave të mëdha në bujqësi, koha nuk po na bën keq, çështja është të vazhdojmë mbjelljet dhe t'i përfundojmë.

Edhe një herë ju uroj sukses!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## MBI GJENDJEN SHUMË SHQETËSUESE NË ITALI

Shënim

27 prill 1976

Gjendja në Itali po bëhet shumë shqetësuese, jo vetëm për vetë vendin, por edhe për sqinjtë e saj. Ne shqiptarët jemi shumë të interesuar për çfarë po ngjet atje dhe për rrjedhimet e këqija që ngjarjet në Itali mund të kenë edhe në qëndrimin e këtij vendi ndaj vendit tonë.

Dihet se qarqe të ndryshme drejtuese italiane pas Luftës së Dytë Botërore, për të mos folur për periudhën e fashizmit musolinian, hapur osc në mënyrë të maskuar, kanë mbajtur vazhdimisht qëndrim armiqësor ndaj Shqipërisë. Në vitet e para pas Çlirimit marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve tona u karakterizuan nga lufta e pamëshirshme nga ana jonë kundër diversantëve që na dërgoheshin nga Italia nëpërmjet detit dhe ajrit. Reaksiuni tradhtar shqiptar, që u largua me anijet angleze, u grumbullua në Itali, u organizua dhe u stërvit të vepronte kundër Shqipërisë së re. Pa humbur kohë ai filloi veprimet e veta dhe të gjitha këto veprime organi-

zoheshin nga disa qarqe të caktuara italiane të pasluftës, si edhe nga armiku i përhershëm i Shqipërisë, Vatikani, dhe nga anglosaksonët.

Një pjesë e tradhtarëve shqiptarë të arratisur mbeten në Itali, të tjerët u shpërndanë edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Francë, në Belgjikë, në Britaninë e Madhe dhe në vende të tjera, ku i hodhi era e spiunazhit. Qarqe drejtuese italiane e ruajtën armiqësinë kundër Shqipërisë së re socialiste. Ato e panë se me aktet diversioniste s'mund t'i bënин dot gjë Shqipërisë, atëherë filluan të mbanin qëndrim politik «menefregist» ndaj shtetit të ri shqiptar.

Midis dy shteteve tona u lidhën marrëdhëniet diplomatike, por këto kanë qenë dhe mbeten krejt formale. Vendosja e këtyre marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, nga ana e Italisë, u arrit, se këtë ia diktonin asaj interesat e vet të brendshëm dhe ndërkombëtarë.

Asnjëherë, asnjë qeveri dhe asnjë zyrtar italian nuk njohu veprën barbare të Musolinit kundër Shqipërisë, por u interesuan që të nxirrnin nga varret mijëra ushtarët e vrarë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

Qarqet drejtuese qeveritare italiane nuk deshën kurrë të bënин tregti të vërtetë me Shqipërinë, duke menduar se kështu do të na dëmonin ekonomikisht. Disa shkëmbime të vogla tregtare të këtyre viteve të fundit janë bërë pse ne blnim me devizë plugje ose disa makineri. Tregu me shkëmbime gati nuk ekziston. Njëfarë tregtie që po bëhet, është e njëanshme. Gjithë shtypi italian, pa përjashtim, duke përfshirë edhe atë të revisionistëve të këtij vendi, nuk ka botuar kurrë diçka pozitive për Shqipërinë, veçse kundër.

Por në Itali ne kemi pasur edhe miq, edhe dashamirë që nuk bënин pjesë në qeveri e në pushtet. Ata, kur gjenin rastin, flitnin mirë për Shqipërinë socialiste. Megjithëse me vështirësi, ata përpinqeshin dhe kallonin në ndonjë revistë disa opinione të drejta dhe reale për vendin tonë.

Italia, qëkurse «u çlirua», mbeti nën ndikimin e imperializmit amerikan. Në këtë vend mbretëruan dhe vazhdojnë të mbretërojnë kaosi dhe degjencrimi moral, politik, ekonomik dhe ideologjik. Jo vetëm përsaqësuesit e vjetër të partisë fashiste dhe pjella e tyre rrojnë, grabitin dhe janë shpërndarë në të gjitha partitë e borgjezisë, por janë 'shtuar edhe të tjerë që kanë marrë në dorë frenat e Italisë dhe pasuritë e këlij vendi, të cilat i ndajnë mes tyre dhe me kapitalin botëror, veçanërisht me atë amerikan.

«Çlirimi» i Italisë solli krijimin e një numri të tërë partish me tituj «demokratike», «socialiste», «socialdemokrate», «komuniste» etj., etj. Të gjitha këto kishin dhe ruajnë etiketa false, pse, në fakt, që të gjitha i shërbejnë borgjezisë reaksionare. Natyrisht, veprimtarinë e tyre të grabitjes dhe të shitjes së Italisë tek të huajt e kanë rregulluar me «ligje» dhe me «kushtetutë». në hartimin e së cilës, të këtij «xhevahiri demokratik», morën pjesë aktive edhe «komunistët» me Toliatin në krye.

Partia Komuniste Italiane nuk bënte dallim nga partitë e tjera të borgjezisë, veçse nga emri. Vetë politika dhe veprimet e saj tregojnë se ajo ka qenë e është një parti antimarksiste dhe revizioniste.

Është e vërtetë që nü kohën e regjimit fashist ki-

shte në njërgjim komunistë italianë, por, po të kemi parasysh forcën që kishte Partia Komuniste Italiane, brenda nuk është ndier aq sa duhet organizimi klandestin ose veprimitaria ilegale e saj. Një shumicë e komunistëve të dalluar gjendeshin të internuar në ishujt. Gramshi, udhëheqësi kryesor i kësaj partie, u burgos dhe vdiq në burg.

Shumë krerë të «komunizmit» italian në ishuj ishin intelektualë të sëmurë. Ai marksizëm që kishin mësuar ata në seminaret e ishujve Lipari, binte më tepër erë nga teoria e Trockit, e Bernshtajnit dhe e komunizmit mëngjérash që e pati kritikuar posaçërisht Lenini në veprën «Sëmundja foshnjore e «majtizmit» në komunizëm». Këta elementë e treguan pas kapitullimit musolinian se çfarë «komunistësh» ishin.

Udhëheqësi i tyre, Toliati, gjatë gjithë kësaj kohe rronte në Moskë. Ai ishte në udhëheqjen e Kominternit. Në këtë post të rëndësishëm Toliati diti të maskonte idetë e tij antimarksiste liberale. Seksioni italian që drejtonte ai nuk ndriti. Toliati u dërgua edhe në Spanjë, ku, është e drejtë të thuhet, se brigadat «Garibaldi» të organizuara me luftëtarë antisashistë italianë, në të cilat bënин pjesë dhe shokët tanë shqiptarë, qëndruan fort dhe luftuan trimërisht. Kjo tregon se Partia Komuniste Italiane kishte brumë, me të cilin mund të bëhej një bukë e mirë, po të mbruhej me kujdes. Por «sara», udhëheqja e saj, ishte socialdemokrate.

Këta «komunistë», me Toliatin në krye, që ishte një intelektual i zgjuar, ambicioz, dinak, por aspak marksist, zunë kreun dhe e organizuan partinë me forma organizative liberale, oportuniste. Ata e janë krejt pas

dore edukimin revolucionar të klasës punëtore dhe të anëtarëve të partisë. Klasa punëtore italiane ishte e madhe, e vuajtur nga fashizmi e nga lufta, por edhe e çoroditur politikisht dhe ideologjikisht. Shumë prej punëtorëve, në ditët e mjerimit të luftës dhe të pasluftës, kujtonin të paktën «koromanen» që hanin në kohën e regjimit musolinian.

Me çlirimin nga fashizmi punëtoria italiane mendoi dhe shpresoi në një drejtësi të thellë shoqërore; ajo mendoi se do ta thoshte më në fund fjalën e saj. Por s'ngjau kështu dhe për këtë fajin e patën «kushtetuta» e famshme që e reklamojnë çdo ditë revisionistët, organizimi i jetës dhe i drejtimit të partive të ndryshme borgjeze, në mes të të cilave edhe ajo «komuniste», që rregulluan jetën borgjeze parlamentare të partive, të shumicës dhe të pakicës, të partive në fuqi e të atyre në opozitë dhe të gjitha lodrat, dredhitë, gjenjeshtrat e demagogjitet etj.

Partia Komuniste Italiane mori në fillim disa dikastere të parëndësishme, që borgjezia e madhe duhej t'uajpte komunistëve brenda lojës «demokratike», por derisa të arrinte të forconte pozitat, të rimëkëmbte fabrikat, të krijonte ushtrinë e saj, policinë dhe të gjithë rrjetin shtypës. Si i arriti këta objektiva, borgjezia i hodhi jashtë qeverisë ministrat komunistë. Rreziku eventual i sulmit të klasës punëtore u evitua, kjo hyri «në radhë», u inkuadrua në sindikata të ndryshme, sipas ngjyrave të partive dhe filloi kështu loja dhe jo lufta sindikale, filloi lufta përvota, lufta parlamentare.

Në Italinë e pasluftës nuk dëgjohej të flitej veçse përvotë «demokraci», përvotë «liri shtypi dhe fjale», përvotë «re-

forma», ndërsa prapa të gjitha këtyre formulave konsolidoheshin shteti kapitalist, aparati i tij shtypës, koncernet dhe ndërmarrjet e mëdha private ekonomike. Padronët dhe pronarët e këtyre koncerneve e të ndërmarrjeve të mëdha private dërgonin në parlament, për të ligjëruar dëshirat dhe planet e tyre, deputetët e vet të inkuadruar në parti të ndryshme borgjeze e socialdemokrate. Kuptohet se këto parti të ashtuquajtura demokratike kishin një vijë të përgjithshme në sipërsaqe, por brendapërbrenda tyre kishte korrente të shumta dhe çdo korrent përfaqësonc një padron ose dy padronë. Kriyat qeveritare, aq të shpeshta në Itali, janë pasqyrë e kontradiktave të thella brenda çdo partie dhe midis partive të ndryshme. Këtë pasqyrë e jep partia demokristiane, e cila dominon si partia më e madhe, por me plot korrente brenda, që përfaqësojnë padronë të ndryshëm. Këtë pasqyrë e japin edhe partitë e ashtuquajtura *centro sinistra* (e majta e qendrës), që lëvizin sipas dividendëve që u jepen nga shteti kapitalist. Të gjitha këto parti ekzistojnë dhe mbrojnë këtë shtet kapitalist, pse ky u siguron edhe atyre qenien dhe fushën e grabitjes.

Edhe Partia Komuniste Italiane ka hyrë me kohë në këtë valle «demokratike». Ajo nuk ka qenë kurrë për revolucionin, ajo ka qenë vazhdimisht një parti që ka qëndruar në pozita reformiste e oportuniste. Partia Komuniste Italiane luftoi dhe lufton që të zhdukë nga anëtarët e saj dhe nga proletariati italian frymën revolucionare, të zhdukë luftën e klasave dhe mendinin e marrjes së pushletit me violencë nga duart e kapitalisteve. Kështu ajo nuk është veçse një parti socialdemokratik.

kratë si të gjitha të tjerat, që e kanë lënë në opozitë dhe nuk e qasin në valle, për arsyet e qenies, më parë, në Internacionalen e Tretë. Përveç kësaj, përsë të rishkojë borgjezia, kur nuk shëh ndonjë rrezik prej saj, sido që ajo ka një fuqi votash të madhe, më të madhen pas demokristianëve?

Bernshtajni në kohën e tij predikonte se nuk është e nevojshme të prishet shteti borgjez; organet e kapitalit, thoshte ai, nuk duhen prishur. Me anën e votës, predikonte Bernshtajni, mund të triumfojë socializmi. Është e njobur lufta e ashpër që i bënë Engelsi dhe Lenini këtij renegati dhe gjithë pasuesve të tij, si Kautskit, Trockit e të tjerëve.

Revizionizmi u bë një fenomen ndërkombëtar, qëllimi i të cilit ishte: luftë kundër marksizëm-leninizmit, shuarja e luftës së klasave, për të penguar revolucionin dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit, për mbrojtjen e kapitalit. Revizionizmi, duke pasur këto synime bazë, merrte, natyrisht, forma të ndryshme, përdorte metoda të ndryshme dhe sillte nga një variant specifik për l'iu adaptuar kapitalit të çdo vendi me anë reformash të ndryshme.

Revizionizmi klasik sot është inkuadruar plotësisht në revizionizmin modern. Teoritë e Bernshtajnit dhe të Kautskit i gjemjë në forma të ndryshme të revizionisti Brauder, të austriaku Bauer e të tjerë dhë të revizionizmi modern, për të cilin bota gjoja ka ndryshuar, kapitalizmi, po ashtu; i gjemjë në revizionizmin titist, në revizionizmin hruščovian, në revizionizmin francez dhë në revizionizmin italian toliatist. Por tanë në këtë shkrim na intereson revizionizmi italian.

Kongresi i 10-të i Partisë Komuniste Italiane, që u mbajt në vitin 1962, shpalli si rrugë të saj për të shkuar në socializëm «rrugën italiane për në socializëm». Cila ishte kjo rrugë? «Reformat e strukturës», domethënë rruga e reformave strukturore, rruga revizioniste, oportunitiste, e adoptuar mbi gjendjen e kapitalit monopolist italian. Sipas «reformës së strukturës» toliatiste nuk do të ccej drejt revolucionit, por, në rrugë parlamentare, do të ccej me reforma graduale, nëpërmjet të cilave, në mënyrë paqësore, do t'i shkëputeshin lëshime kapitalit monopolist. Këto reforma graduale do të bëhen në rrugën e planifikimit dhe vetëm me armën e parlamentarizmit, me fuqinë e votës, pavarësisht se monopolet kapitaliste kishin në dorë të tyre edhe pasuritë e vendit, edhe armët, edhe drejtimin parlementar e administrativ.

Me fjalë të tjera, revisionistët italianë mendojnë se mund të integrojnë kapitalizmin në socializëm, pa e shkatërruar aparatin e shtetit borgjez. Ç'do të thotë e gjithë kjo teori «marksiste-leniniste» e «reformave të strukturës»? Kjo do të thotë të mos jesh marksist, po antimarksist, socialdemokrat.

Kurrë dhe asnjëherë disa forma të kapitalit monopolist nuk mund të kthehen në socializëm, pse format e kapitalit shtetëror janë suquia e shtetit borgjez. Kush mbron pikëpamjen e kundërt, është revizionist dhe teoria e tij revizioniste i adaptohet kapitalit të vendit jo për ta minuar, por për ta forcuar atë dhe për të minuar luftën revolucionare.

Partia Komuniste Italiane që pas vdekjes së Stalinit filloj të bëhej një qeder për revisionistët hrushovianë,

por jo në atë shkallë dhe në ato forma që u bë qeder për Hrushovin Partia Komuniste Franceze. Toliati dhe pasuesit e tij ishin me hrushovianët, ata i ndiqnin me simpati dhe pa i kundërshtuar veprimet e Hrushovit në fushën e brendshme dhe në arenën ndërkomëtare. Toliatistët e pëlqyen kursin revizionist të destalinizimit, ata e duartrokitën hedhjen baltë mbi Stalinin dhe bolshevizmin, duartrokitën kursin hrushovian drejt shkattërrimit të formave socialiste të shtetit sovjetik, ishin pro reformave revizioniste të hapjes drejt shteteve kapitaliste dhe veçanërisht drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Toliatistët, si revizionistë, ishin plotësisht dakord për «bashkekzistencën paqësore» hrushoviane. Kjo ishte ëndrra e tyre e vetme e bashkëpunimit me borgjezinë në planin kombëtar dhe ndërkomëtar. Vendosja e socialistët me anën e votës dhe në rrugën parlamentare ka qenë gjithë dëshira e revizionistëve italianë. Sa për tezën hrushoviane të «partisë së të gjithë popullit», këtë toliatistët e kishin realizuar me kohë, partia e tyre s'kishte asgjë leniniste, revolucionare.

Në rrugën ku kishte hyrë partia revizioniste hrushoviane, duheshin «uniteti dhe miqësia» sidomos me Partinë Komuniste Italiane dhe me atë Franceze. Për këtë arsyе «nderet» që u bëhen nga hrushovianët këlyre dy partive ishin të dukshme dhe, tok me «nderet», vinin edhe subvencionet e mëdha nën dorë dhe përqindjet e majme që merrnin «përsaqësuesit tregtarë» (njerëz që punonin për llogari të këtyre dy partive revizioniste), në tregtinë zyrtare që bënte Bashkimi Sovjetik me Italinë dhe me Francën.

Mirëpo, ashtu siç shpejtonin hrushovianët ta kthenin Bashkimin Sovjetik në një vend kapitalist, ashtu shpejtonin dhe toliatistët të integroheshin në rrëthim kapitalist italian. Prandaj Toliati, për t'ia arritur këtij qëllimi të madh, filloi të hidhte vicka të rënda, që kishin për qëllim shpejtimin e degjenerimit të Bashkimit Sovjetik, shpejtimin e zhdukjes së frysës revolucionare jo vetëm në brendi, por edhe në forma, shpejtimin e hapjes së plotë të portave të Bashkimit Sovjetik për kapitalizmin botëror.

Partia Komuniste Italiane dhe Toliati, më parë dhe me forcë, e dënuan Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik si «udhëheqëse kryesore» të komunizmit ndërkombëtar. Ata nuk pranuan më që Moska të ishte «qendra», po predikuan haptazi «policentrizmin». Policentrizmi i Toliatit kishte për qëllim krijimin e një bloku të ri revizionist, me Partinë Komuniste Italiane në krye, i cili të vihej përballë blokut revizionist sovjetik, dhe rritjen e autoritetit të Partisë Komuniste Italiane në sytë e kapitalit italian dhe botëror. Vetëm kështu Tolati mendonte se do të fitonte besimin e kapitalistëve monopolistë italianë, për të hyrë në vallen e këtyre.

Hrushovi e pa rrezikun dhe u përpoq të ruante «unitetin» që shkonte drejt pavarësisë së partive revizioniste, si jashtë dhe brenda Traktatit të Varshavës. Sidoqoftë, stohja e Partisë Komuniste Italiane me partinë hrushoviane dhe me atë të Torezit u bë e akullt, por toliatistët nuk fituan gjë nga ato që dëshironin. «Policentrizmi» toliatist dhe «uniteti» hrushovian ishin gjëra irealec. Revizionizmi përcan dhe nuk bashkon.

Toliatistët e vazhduan rrugën e tyre të tradhtisë.

Berlingueri lëshoi parullën e «kompromisit historik», natyrisht, me borgjezinë. Ky është vazhdimi dhe varianti «filozofik» i «reformave të strukturës». Me këtë parullë torolitet udhëheqja revizioniste italiane. Kjo parullë vazhdon të hidhet edhe tash kur shteti borgjez kapitalist italian është në salimentim. A do ta pranojë kapitali monopolist italian dorën që po i ndër Partia Komuniste Italiane? «Pse jo?», thotë Anjeli, president i Konsfederatës së Përgjithshme të Industrisë Italiane. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, padronë të Italisë, u shprehën se nuk janë dakord për praninë e revizionisteve evropianë në qeveritë e NATO-s. Por Berlingueri, ky latifondist, i madh, po i lutet fshehurazi Kisingerit për këtë çështje. Do të shohim tradhtinë e mëtejshme që do të zhvillohet dhe tragjedinë e popullit italian.

Aktualisht ne shohim dy vija të njëllojta, si atë të Partisë Komuniste (revizioniste) Italiane, ashtu edhe atë të Partisë Komuniste (revizioniste) Franceze. Partia Komuniste Italiane vërtet nuk flet aq hapur, siç foli Marshëja, i cili hodhi poshtë «diktaturën e proletariatit dhe luftën e klasave», por Berlingueri, ca kohë më parë, në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste Italiane (revizioniste), shtjelloi po atë vijë. Duhet thënë se vija e «reformave të strukturës», që janë thelbi i «kompromisit historik», të cilat i predikon Berlingueri, është një vijë e njëjtë me atë të Marshesë, por e përpunuar më parë nga Partia Komuniste Italiane.

Partia Komuniste revizioniste Italiane, para zgjedhjeve të qershorit, është në një dilemë të madhe. Ç'do të bëjë ajo në rast se në vota do të ketë një numër më të madh se demokristianët? Berlingueri, i frikësuar, tha

në plenumi se «ne duhet të formojmë një qeveri të gjerrë, me të gjitha partitë e harkut demokratik, të bëjmë disa reforma të nevojshme, natyrisht në një demokraci të gjerë, dhe të mos dalim nga NATO-ja».

Pse e shtron këtë perspektivë Berlingueri? Pse kjo është vija revizioniste e Partisë Komuniste Italiane, e cila ka frikë të marrë përgjegjësi përpara krizës dhe falimentimit, që nuk mund të zhduken me reforma, por duke e marrë pushtetin me dhunë klasa punëtore. Partia Komuniste (revizioniste) Italiane, jo vetëm nuk e do këtë zgjidhje, por ua ka frikën masës së punëtorëve dhe punonjësve të Italisë, të cilët, në rast se kjo parti fiton, do të kërkojnë jo bashkëpunim me padronin, por marrjen e pushtetit. Këtë situatë nuk e do dhe nuk do ta lejojë Partia Komuniste (revizioniste) Italiane, por nuk do ta lërë aspak as borgjezia kapitaliste amerikane dhe ajo italiane. Një kompromis antihistorik mund të bëhet në fillim pas zgjedhjeve, në rast se Partia Komuniste (revizioniste) Italiane fiton në vota, por ky «kompromis» do të jetë efemer, i paqenë, për të qetësuar opinionin, derisa të shtrëngohen vidhat. Kapitali nuk i dorëzon kurrë armët, në qoftë se këto nuk ia rrëmben me forcë. Partia Komuniste Italiane nuk është nga ato parti që shkojnë në revolucion. Për tradhtinë e saj, për Toliatin dhe toliatistët kam folur e kam shkruar. Ky variant revizionist toliatist është demaskuar me kohë nga Partia jonë, siç janë demaskuar edhe revizionizmi titist, ai hrushovian, si dhe ai i Partisë Komuniste revizioniste Franceze e i partive të tjera revizioniste të Evropës, të Azisë dhe të Amerikës Latine.

Në situatat aktuale, kur shtetet kapitaliste, imperia-

lizmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe aleatët e tyre, janë kredhur thellë në një krizë të madhe ekonomike dhe ushtarake, kriza politike dhe ideologjike shkon paralel me të parat dhe konfondohet e dominon krizën. Për këtë arsyre këto fuqi dhe partitë borgjeze, revisioniste e fashiste bëjnë përpjekje t'i shpëtojnë krisës, e cila i detyron të gjithë të hedhin maskën, të lajnë hesapet me njëri-tjetrin, duke u përpjekur gjithsejli në favorin e tij dhe, kuptohet, në kurrizin e popujve e në favorin e klikave kapitaliste e revisioniste.

Bashkimi Sovjetik revisionist përpinqet të ruajë aparenat e një shteti «socialist» dhe të një partie «marksiste-leniniste», përpinqet të ruajë «unitetin» qesharak politiko-ideologjik, përpinqet të ruajë «ekuilibrin dhe statukuonë» në Evropë tok dhe në ujdi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për këtë arsyre Bashkimi Sovjetik dhe partia e tij revisioniste përpinqen të organizojnë një mbledhje të partive revisioniste të Evropës, në pamundësi të thérresin një mbledhje të partive komuniste dhe punëtore (revisioniste) të botës. Mirëpo u ka hasur sharra në gozhdë. Revisionistët e ndryshëm, titistë, italianë, francezë, spanjollë e të tjerrë duan që fundi i fundit, mbledhja të bëhet, por të mos vendosë asgjë, ajo të tregojë vetëm se ekziston një përcarje e plotë në politikë, në ideologji etj., etj. Kështu që nuk këtë mbledhje, edhe në qoftë se bëhet, rusët gjoja mbulojnë fytyrën e ndotur dhe revisionistët e tjerrë forcojnë pozitat e tyre antimarksiste, largohen përfundimisht nga teoria e marksizëm-leninizmit dhe i thonë borgjezisë që «ne nuk jemi ata që mund të mendosh

ti, ne mendojmë me kokën tonë dhe i shohim situatat e reja ashtu siç i shikon ti».

Imperializmi amerikan, nga ana e tij, edhe mble-dhje bën me aleatët e vet, edhe shantazhe me kredi, por edhe me skandalin «Lokhid» demaskon krerët aktualë të partisë demokristiane deri te Leonia<sup>1</sup>, të partisë socialdemokrate deri te Saragati, të cilët akuzohen se kanë marrë bakshishe të majme në çeqe. Imperializmi amerikan do t'i ndërrojë kuajt e vjetër të këtyre partive kapitaliste dhe përpinqet të sjellë hajdutë të rinj. Me këtë metodë ai gënjen opinionin se gjoja të vjetërve u kaloi koha dhe të rintjtë do ta rregullojnë gjendjen.

Në këtë rrëmujë, në Itali po përgatitet fushata e zgjedhjeve, po bëhen kongrese në seri, po shpalosen programe «të bukura», në mes të të cilave edhe ai i Partisë Komuniste (revizioniste) Italiane, i shpallur nga Berlingueri. Ç'premiton Berlingueri në «qiellin e kaltër» ku sundojnë mafia, politika ekonomike, ushtarake dhe banditeske? As më pak dhe as më shumë, por, «në qoftë se Partia Komuniste Italiane fiton në zgjedhje», atëherë ajo «do të rregullojë ekonominë, do të sulmojë kundër taksave dhe teprimeve burokratike, deficitit i bilancit të pagesave do të pakësohet, si duke shkurtuar importin, ashtu edhe me anën e investimeve, për të rritur prodhimin në bujqësi dhe në industri». «Program ëndërrues madhështor» në një Itali ku sundon kapitali, që ka zënë të gjitha poret e trupit italian. Revizionistët italianë, pa çak pa bamb, me dëshirë dhe me

---

1. Xhovani Leone, në atë kohë president i Republikës së Italisë.

reforma, «do të pakësojnë importin», domethënë do të prishin ekuilibrin e Tregut të Përbashkët Evropian që mban në këmbë: Anjelöt, Enët dhe Montedisonët, «do të shtojnë prodhimet», që të mos ua marrë kush, derisa është prishur ekuilibri i koncerneve dhe këtë do ta prishë Berlingueri me programet e tij, «do të zhvillojnë bujqësinë», «do të shtojnë agrumet», të cilat edhe tash s'ua blejnë e kështu me radhë gjithë problemet e tjera! «Program gjenial» reformist ky i Partisë Komuniste Italiane, i cili synon jo vetëm «ndryshimin rrënjesor» në Itali, por ai «do të shkaktojë edhe krizën e madhe botërore kapitaliste të të gjitha shteteve perëndimore». «Mrekullia e shekullit» revizionist modern, zhdukja e kapitalizmit vetëm me anë të votës, të reformave dhe të parlamentarizmit!

S'i duhet botës shumë mend të kuptojë tradhitinë e këtyre partive revizioniste, shërbëtore të kapitalit, që ndihmojnë kapitalin të dalë nga kriza, duke u hequr si antikapitaliste. Qëllimi është të marrin një pjesë nga byreku dhe të shpartallojnë revolucionin proletar në të gjithë botën e, në veçanti, në çdo vend ku ka të tilla parti.

*Marrë nga libri: Enver Hoxha,  
«Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm),  
nr. 8, f. 327*

**PA NJË KTHESE NË KOKËN E NJERËZVE  
NUK BËHET DOT KTHESA NË PRODIHMİN  
E ULLIRIT**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

28 prill 1976

Për problemin e ullinjve që po shqyrtojmë sot, kemi thirrur shokë nga tri rrethe: Saranda, Elbasani dhe Tirana. Ne bëjmë mirë që e marrim në analizë këtë problem, se është me shumë rëndësi për ekonominë tonë.

Kisha disa pyetje në adresë të shokëve të rretheve për këtë problem. Po qe se keni dhe ju të tjerët, mund t'ua bëni.

Ku qenka Pëllumb Çipi? Ai merret me këtë problem në aparatin e Komitetit Qendror, prandaj duhej lajmëruar të vinte këtu<sup>2</sup>, si specialist ai është më kom-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për gjendjen dhe për zhvillimin e ullirit për vitet 1976-1980.

2. Mbas këtij sugjerimi të shokut Enver Hoxha, shoku Pëllumb Çipi u thirr e mori pjesë në mbledhje.

petent për këtë çështje. Në mbledhjet tona, sipas rasteve duhet të stojmë edhe specialistë për çështjet që shqyrtojmë.

Keni kërkuar ndonjëherë shokë të komiteteve të Partisë, ose të komiteteve ekzekutive ndihmë nga Ministria e Bujqësisë për zhvillimin e ullirit? E ka marrë në studim ndonjëherë Ministria e Bujqësisë këtë problem? Po Këshilli i Ministrave ose Kryesia e tij është ndalur ndonjëherë në këtë çështje?

Ne kemi vendosur të krijohen fidanishte për mllët dhe për fiftë dhe në disa rrethe janë krijuar. Kuptohet se edhe në vendet ku bëhet ulliri duhet të jenë krijuar medoëmos fidanishtet. Desha të di nëse janë krijuar apo jo? Të tilla fidanishte mund të krijohen edhe në Tiranë, sepse edhe këtu rritet ulliri. Çështja është që Ministria e Bujqësisë, pavarësisht nga të metat që po zbulohen, duhet ta përcaktojë se ku do t'i bëjë këto fidanishte. Sigurisht që ato nuk ka pse të jenë në të gjitha rrethet e Shqipërisë.

Le të marrim një çikë lapsin dhe të llogaritim se sa kile qumësht marrim nga një dhi në vit. Po nga një rrënëjë ulli, të cilat i bëhet shërbimi i nevojshëm, ashtu siç u bëhet dhe dhive, sa kilogramë ullinj merren në vit? Atëherë, pse për dhitë bëjmë kaq kujdes dhe për ullirin jo? A nuk bëhen hesapet, duke llogaritur edhe shpenzimet për dhinë që ha përditë? Në qoftë se themi që marrim mishin, qumështin e plehun nga dhia, atëherë duhet të marrim parasysh edhe të ardhurat që marrim çdo vit nga ulliri, i cili rrон me shekuj, kurse dhia rrон shtatë-tetë vjet.

Bëjmë llogari apo nuk bëjmë llogari? Vërtet dhia

na shërbën për ushqimin e popullit, por edhe ulliri për të njëjtën gjë na shërben. Për dhinë të kujdesemi edhe më shumë, por jo të lëmë pas dore ullirin, sepse nuk ka shpirt. Mirëpo, duhet ditur se si dhia, edhe ulliri janë krijesa të gjalla që i shërbejnë njeriut. Prandaj edhe pyes nëse është marrë ndonjëherë në shqyrtim, në komitetet ekzekutive ky problem apo jo. Nëse është marrë, çfarë rëndësie i është dhënë ullirit në këtë diskulim? Dua të më thoni jo në përgjithësi, por konkretisht: thirrët atje kooperativistë që merren me ullirin, për të përcaktuar bashkërisht shërbimet që i duhen bërë? Edhe unë, që nuk merrem me ullirin, i di këto, por veç këtyre di edhe diçka tjeter që, për të bërë shërbimin e ullirit, fidanishtja duhet të jetë tamam fidanishtë. Kjo është e para.

E dyta: Që të bëhet si duhet fidanishtja, kërkohet që për të të zgjidhet një vend sa më i përshtatshëm e të punohet mirë, të kontrollohet, të plehërohet, të prashitet e të ujitet me kujdes, të luftohet sëmundja e fidanit që në lindje, të merret bima dhe të vihet në vende të posaçme, të përgatitura sipas agroteknikës. Fidanët lypset të kontrollohen dhe të jepen udhëzime që të mbillen në sipërfaqe prej kaq metrash, t'i hidhet kaq pleh, të ujiten kaq herë, të krasiten etj., etj. Të përcaktuara janë edhe shërbimet për plehun etj., por, kur vjen puna, nuk bëhen. Kur i caktojmë shërbimet, duhet të kontrollojmë edhe zbatimin e tyre. Për shembull, kur caktojmë për Lukovën ose për një kooperativë tjeter bujqësore, që ka agrume, por mbjell edhe grurë e misër, një sasi plehu për ullinjtë, atëherë këtë duhet t'ia japim medocmos. Kur themi se duhet të va-

dilen këto bimë, këto të vaditen pa diskutim. Të zbatojmë ato që vendosim e pastaj të flasim për stimulin.

Ne nuk mund t'i themi Bankës së Shtetit: «Oburra, nxirr para edhe sikur kooperativa të mos na japë ullinj, se vetëm duke zbatuar këto metoda mund të marrim më shumë prodhim!». Jo, ne do ta praktikojmë stimulin, por kur të marrim ullinj me shumicë e jo si tanë që blejmë vaj në tregun e jashtëm. Ne jemi një shtet me ekonomi socialiste të organizuar. Prandaj s'mund të përcemi drejt nxitjes së fitimeve, por drejt zhvillimit sa më të madh të prodhimit dhe ky zhvillim, në kooperativat tona, arrihet me punë, me masa propagandistike, organizative, shkencore etj. Po të orientojmë përdorimin vetëm të stimulit material, atëherë do të kishim të tjera pasoja negative. Kjo nuk do të thotë se duhet stimuluar vetëm ulliri, por edhe gruri, misri e bimët e tjera. Secila prej tyre ka rëndësinë e vet. Por, po të llogaritim se çfarë punc bën kooperativa për të gjitha këto, del se ajo shpeshherë është e pamjaftueshme. Kjo vjen ngaqë mungon interesimi i nevojshëm.

Atëherë, le t'i lëmë shokët e fuar nga rrethet të na flasin, po të kenë ndonjë gjë tjetër për të shtuar, përveç këtyre që na kanë shkruar në raporte. Nuk është e thënë të na përsëritni këto që keni shkruar këtu, se këto ne i keni lexuar. Është e vërtetë që është bërë edhe punë e mirë për zhvillimin e ullirit, por marrja e këtij problemi në shqyrtim nga Sekretariati ka për synim kryesor që të zhduken të metat, neglizhencat dhe mospërfillja ndaj këtij druri vajor me traditë të lashtë dhc me rëndësi të madhe për vendin tonë. Prandaj duhet të vëmë në dukje të metat, shkaqet e tyre dhe të

marrim masat e duhura për t'i zhdukur ato. Në këtë drejtim, mendoj unë, t'i ngremë çështjet, pa i errësuar sukseset. Besoj se rrethi i Tiranës është më keq nga gjithë rrethet e tjera ku kultivohet ulliri.

*Mbasi iu dha përgjigje pyetjeve të bëra, dhe mbasi folën edhe pjesëmarrës të tjerë të mbledhjes, shoku Enver Hoxha tha:*

Pas diskutimeve që bënë shoku Hysni [Kapo] dhe Miti Bozo<sup>1</sup>, mendoj se s'është nevoja të zgjatem, se pse çështjet që shtruan ata i konsideroj të mjaftueshme.

Nuk është hera e parë që Komiteti Qendror i Partisë jep këshilla për zhvillimin e ullirit. Edhe më përpalla Qeveria, ministritë, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, ndërmarrjet e kooperativat bujqësore kanë marrë porosi se si duhet ta trajtojnë atë. Por me keqardhje vërejmë se kjo pemë kaq e nevojshme dhe me vlerë të madhe për ushqimin e popullit është nënvlejtësuar shumë.

Në sektorin e bujqësisë janë vërtetuar gabime të rënda, që janë rrjedhim i pikëpamjeve të shtrembra të Pirro Dodbibës dhe të disa bashkëpunëtorëve të tij, ish-kuadro drejtues të Ministrisë së Bujqësisë. Këta kishin prirje ta braktisin bujqësinë socialiste, sikurse e braktisen në fakt. Por bujqësinë socialiste, shokë, nuk e kanë braktisur Partia dhe masat punonjëse, punëtorët e ndërmarrjeve dhe të kooperativave bujqësore me kuadrot e tyre, që u kanë qëndruar punëve mbi kokë. Për këtë arsyen bujqësia jonë nuk ka bërë hapa prapa, përkundrazi, ajo ka ecur përpara. Disa ish-drejtues të

---

1. Në atë kohë punonjës i aparatit të KQ të PPSH.

ministrisë, që përmenda më lart, me sa kanë mundur, kanë sabotuar. Megjithëse puna e tyre ishte nën kontrollin e vazhdueshëm e të rreptë të Partisë dhe të Qeverisë, ata prapëseprapë kanë sabotuar. Devijimet e këtyre elementëve kishin arritur deri aty sa, siç thotë në autokritikën që i ka drejtuar me shkrim udhëheqjes së Partisë një nga këta ish-drejtues, zëvendësministrat dhe drejtorët e drejtorive në dikasterin e Bujqësisë qenë ndaluar nga Pirro Dodbiba që të merrnin në telefon pa dijeninë e tij shefat e seksioneve të bujqësisë të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve. Kjo është e habitshme! Ose ky që e thotë këtë gjë e thotë për të larë veten, ose kjo është e vërtetë dhe atëherë kemi të bëjmë me një urdhër monstruoz. Për ne tash është e qartë që kuadrot drejtues të Ministrisë së Bujqësisë e kishin lënë veten në rolin e «këshilltarit». Këtë Pirroja e ka pohuar me gojën e tij, por që mosinteresimi i kuadrove për problemet jetike të bujqësisë të arrinte deri në këtë shkallë, kjo është me të vërtetë skandaloze!

Me ullirin duhet të merren të gjithë, por për gjendjen dhe për zhvillimin e tij, ashtu si për çdo punë tjetër, ka përgjegjësi partie, ka edhe përgjegjësi shtetërore. Si kurdoherë, për çdo problem Partia qëndron në krye, ajo punon pa u lodhur ditë e natë dhe nuk është vetëm «këshilltare» që jep porosi, këshilla dhe udhëzime, por të jetë e qartë për të gjithë se ajo, si në çdo sektor tjetër, edhe në bujqësi, merret me probleme konkrete, si për punimin e tokës, për farën, për përgalitjen, për mirëmbajtjen e shfrytëzimin e mekanizmave, për shërbimet ndaj bimëve, pra edhe për kultivi-

min e ullirit. Është fakt se sot, në bazë të direktivave të Partisë, shunica dërrmuese e komunistëve punojnë në prodhim. Në këtë drejtim kemi arritur rezultate shumë të mira. Meqenëse nuk janë akoma të paktë komunistët që punojnë nëpër zyra, për ata, krahas kryesës së detyrave në vendet ku janë, është caktuar që një pjesë kohe të merren me punë drejtëpërdrejt në prodhim.

Ka shumë rëndësi që Partia ta kuptojë mirë problemin e të udhëhequrit dhe të jetë shumë e rreptë në kontrollin e zbatimit të direktivave që jep, në ndjejkjen e formave të organizimit që praktikohen dhe në mënyrën e drejimit të punëve nga baza deri në ministritë dhe në Qeveri. Kjo do të thotë që ministritë të ndihmojnë dhe të kontrollojnë me përgjegjësi ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat që kanë në vartësi të tyre, pra të mos jenë këshilltare të lëheshta, siç e mendonte Ministrinë e Bujqësisë Pirro Dodbiba.

Që t'i marrë në analizë problemin e ullirit apo problemet e tjera të bujqësisë ose të blegtorisë komiteti i Partisë i rrethit një herë në vit, kjo do të ishte një punë shumë e mirë, por del pyetja: Po komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit, i cili ka një seksion posaçërisht për bujqësinë me 10-15 kuadro dhe specialistë, me se merret? Unë kam pyetur herë pas here për punën e këtij seksioni, me se merren gjithë këta specialistë të bujqësisë pranë komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe akoma nuk e kam të qartë se ç'bëjnë dhe si e organizojnë punën ata për t'i ardhur në ndihmë sektorit kaq të gjerë të bujqësisë. Punojnë vallë këta kuadro e specialistë me plan pune? Jam i bindur se ata nuk punojnë si duhet, por me si-

guri kënaqen vetëm me grumbullimin e disa të dhënave, me ndonjë vajtje rruse në bazë për të marrë kontakt me kuadrot e ndërmarrjeve dhe të kooperativave bujqësore, për t'u dhënë atyre ndonjë këshillë të rastit sa për të kaluar radhën. Kjo duhet të jetë e gjithë puna e tyre?

Mendoj se, po të kishte një ndarje të drejtë pune dhe një shqetësim serioz nga gjithë specialistët e sekzionit të bujqësisë në rreth, të cilët si në rrugë partie, ashtu edhe nga ana shtetërore kanë përgjegjësi për drejtimin e bujqësisë, punët nuk do të na shkonin siç kanë shkuar deri më sot, por shumë më mirë. Përse do të na shkonin më mirë? Sepse në qoftë se këta kuadro, tok me specialistët dhe me mjeshtrit e ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore të rrethit, do të hartonin një plan të detajuar një për një përtë gjitha prodhimet dhe do të tregonin vazhdimisht kujdesin e duhur për secilin prej tyre, mendoj se bimët e arave, blegtoria, pemëtaria, duke përfshirë këtu edhe ullirin që po marrim në shqyrtim, dhe të gjithë sektorët e bujqësisë do të paraqiteshin shumë më mirë nga ç'janë sot.

Shoku Miti Bozo tha se edhe ata pesë specialistë të vjetër që kanë qenë përgatitur përpara për ullirin, sot janë larguar për arsyë se kanë dalë në pension. Me këtë fakt nxirret konkluzioni që si nga ana e komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë, edhe nga ana e komiteteve të Partisë në rrethe, problemi i ullirit është lënë krejt pas dore. Përse shokët e rretheve kanë treguar një interesim më të madh për përgatitjen e agromëve, të veterinerëve, të zooteknikëve e nuk kanë

vepruar kështu edhe për specialistët e ullirit? Përse tregojnë ata interesim vetëm për drithërat e bukës dhe nuk kanë të njëtin kujdes dhe për pemëtarinë në përgjithësi dhe për ullirin në mënyrë të veçantë? A nuk ka orientuar vazhdimisht Partia se është e domosdoshme të ndryshojë raporti i të ardhurave ndërmjet prodhimit të arave, nga njëra anë, dhe i atyre të blegtorisë e të pemëtarisë, nga ana tjetër? Statistikat që na dërgohen tregojnë se ndryshimi drejt zhvillimit të mëtejshëm të blegtorisë dhe pemëtarisë është fare i vogël, sepse tërë kujdesi i drejtuesve është përqendruar kryesisht në bimët e arave. Me këtë nuk dua të them që në të ardhmen të mos tregohet i njëjtë kujdes për bimët e arave, përkundrazi, për këto, që kanë të bëjnë me sigurimin e bukës së popullit, kujdesi duhet të jetë akoma më i madh se deri tash, por në asnje mënyrë nuk duhen neglizhuar blegtoria, si dhe drufrutorët që kanë rëndësi të madhe për ushqimin e popullit.

Për gjendjen që është krijuar në të gjitha këto drejtime mbajnë përgjegjësi të rëndë edhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, të cilat, me sa duket, nuk kanë qenë nën drejtimin e kontrollin e rreptë e të vazhdueshëm të komiteteve të Partisë. Kërkimi i llogarisë nga ana e komiteve të Partisë për zbatimin e planeve (që janë të aprovuara nga Qeveria dhe bëjnë pjesë në planin e përgjithshëm të shtetit) e të detyrave në bujqësi nuk është bërë në mënyrë të tillë që komiteti ekzekutiv i rrethit të mbahej në tension të vazhdueshëm dhe të vihej në kohë para përgjegjësisë për çdo mosrealizim. Prandaj në të ardhmen

kërkohet që plani të ndiqet vazhdimisht më mirë e të bëhen përpjekje që të plotësohet deri në një nga çdo ndërmarrje dhe kooperativë bujqësore, në të gjitha drejtimet, për çdo kulturë dhe për çdo zë.

Po e përsëris atë gjë që kemi thënë edhe herë tjetër: komunislët, sidomos drejtuesit, kanë dy përgjegjësi — përgjegjësi partie dhe përgjegjësi shtetërore. Të dyja këto përgjegjësi nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra. Në qoftë se një komunist nuk e kryen detyrën si revolucionar, Partia, sipas shkallës së përgjegjësisë, merr masë ndaj tij deri në përfjashtimin nga radhët e saj, kurse nga ana shtetërore përdoren sanksione të tjera, që shkojnë deri në vënien e sajlorit para përgjegjësisë pénale. Nevojën e zbatimit të masave si mjet edukimi për ata që kryejnë faje e gabime duhet ta kemi kurdoherë parasysh në punën tonë, po qe se e quajmë velen revolucionarë. Në qoftë se komitetet e Partisë të rretheve ose organizatat-bazë të Partisë në kooperativat bujqësore mbikëqyrin, ndihmojnë dhe kërkojnë zbatimin e vendimeve që merren për realizimin e planeve të aprovuara, me siguri që punët do të na shkojnë kudo më mirë, duke filluar që nga rrëthi deri në bazë, ndryshtë planet nuk mund të realizohen. Por mendoj se të gjilha këto punë duhet të bashkërendohen mirë edhe nga ana e Komitetit Qendror të Partisë, edhe nga ana e Qeverisë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH ka marrë disa vendime bazë edhe për ullirin. Qeveria, e në mënyrë të veçantë Ministria e Bujqësisë, e kanë për detyrë t'i zbërthejnë direktivat që janë dhënë. Kjo e fundit, pasi të bëjë zbërthimin e direktivës, ta drej-

tojë vëmendjen në ndihmën që duhet t'u japë komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe këtyre të fundit t'u kërkohet që të ndihmojnë më nga afër kooperativat e ndërmarrjet bujqësore me kuadrot dhe me specialistët që kanë në dispozicion. Këtë ndihmë ministria duhet ta japë pavarësisht nëse kooperativat ose ndërnarrjet bujqësore varen nga ministria apo nga rrethi etj., etj. Në gjithë këtë gamë detyrash e problemesh rëndësi kryesore ka të kuptuarit drejt të tyre nga komitetet e Partisë, nga komunistët dhe nga gjithë punonjësit që janë ngarkuar me punë në aparate, në mënyrë që secili të kryejë detyrën që i takon dhe të mos thuhet më që fajin e ka ky apo ai. «Faji bëhet qyrk dhe nuk e vesh njeri», por neve nuk na lejohet të ecim kështu pa i përcaktuar mirë ata që i krycijnë detyrat me ndërgjegje dhe ata që bëjnë llafe.

Për fajet e rënda të vërtetuara e pastruam ish-udhëheqjen e Ministrisë së Bujqësisë dhe në krye të këtij dikasteri sollëm një kuadër të ri, shoqen Themije Thomai, ish-kryetare e Kooperativës Bujqësore të Tipit të Lartë të Këmishtajt në rrëthin e Lushnjës. Pse u vu ajo në këtë detyrë me kaq përgjegjësi? U caktua në këtë vend të rëndësishëm se ajo ka dalë nga balta e arave, ka kulturë të lartë, është energjikë dhe organizatore e zonja. Duke qenë kryetare e kooperativës bujqësore, ajo punoi në mënyrë krijuese, nën udhëheqjen e organizatës-bazë të Partisë, dhe në Këmishtaj u arritën rezultatet që dihen, të cilat duhet t'i arrijnë tanë me të njëjtat përpjekje të gjitha kooperativat e tjera të vendit tonë. Edhe zëvendësministrat që caktuan

në Ministrinë e Bujqësisë të tillë shokë janë. Si këta do të sjellim edhe të rinj të tjerë në vendet drejtuese të këtij dikasteri.

Shokët e vjetër duhet t'i kuptojnë drejt këto masa. Kudo që të jenë ata duhet të japid ndihmën e tyre maksimale në përgatitjen e kuadrove të rinj jo vetëm nga ana teorike, por edhe praktike. Ata t'i ndihmojnë shumë shokët e rinj me eksperiencën e tyre të gjatë e të pasur, me qëllim që këta të përgatiten sa më shpejt dhc të jenë kështu në gjendje të marrin në dorë statetën që do t'u lëmë. T'i mësojmë e t'i përgatitimi kuadrot e rinj që të mund t'i studiojnë e t'i zgjidhin drejt e një nga një problemet që do të marrin në dorë, që të njojin mirë e në detaje gjendjen e sektorit që do të drejtojnë e të bëhen të astë që të marrin masa urgjente për të përmirësuar punën dhc, po të jetë nevoja, të dinë të vënë përpara përgjegjësisë të gjithë ata që nuk i kanë kryer detyrat, sidomos specialistët.

Shokët e vjetër ta kuptojnë mirë atë mësim të madh të Partisë, sipas të cilit, derisa t'u punojë truri dhc të kenë fuqi fizike, e kanë për detyrë të përpilen sa të mundin që t'i kryejnë detyrat si duhet. Në rast se midis tyre ka njerëz që nuk i kryejnë mirë detyrat, pavarësisht nga meritat e së kaluarës së tyre apo nga vjetërsia në punë, të dërgohen të punojnë në vende të tjera me më pak përgjegjësi dhe atje të ndihmohen që të përtërihen. Partia do të bënte gabimin më të madh që, për sentimentalizëm apo për ndonjë arsyе tjetër, t'i linte këta kuadro që të flinin mbi dafina. As vetë ata nuk duhet t'ia lejojnë vetës një qëndrim të tillë. Prandaj shokët e vjetër ose duhet të vazhdojnë ta

kryejnë si duhet detyrën që u ka ngarkuar Partia, ose tē ulen nē përgjegjësi. Nuk i lejohet asnjërit prej tyre që tē mos ecë me vrullin e kohës dhe, pér tē justifi-kuar rënien pa asnjë arsyé tē tempit nē punë, tē mbüshtetet vetëm tek e kaluara e tij e mirë. E kaluara është një anë shumë e rëndësishme, ajo patjetër mbahet parasysh nga Partia, por shokët duhet tē ecin me konsekuencë nē rrugën e Partisë, tū vazhdojnë tē punojnë pa u lodhur deri nē fund, duke qenë tē lidhur vazhdimit me problemet nē zhvillim, dhe tē mos mbeten prapa. Partia, natyrishët, duhet tē ketë parasysh edhe fuqinë fizike tē shokëve tē vjetër, pér arsyé se mosha bën tē sajën, ajo sjell njëfarë uljeje dhe ngadalësimi tē vrullit nē punë, por kur pleqëria bëhet pengesë pér punën, atëherë edhe vetë shokët e vjetër duhet tē kërkojnë tē zëvendësohen nga tē tjerë më tē rinj, që ta çojnë punën mirë përpara.

Ka kuadro tē vjetër që mendojnë sikur janë tē pazëvendësueshëm ose tē palëvizshëm, sikur, po tē mos janë ata, puna nuk u bëka! Ky është një koncept shumë i gabuar. I palëvizshëm dhe i pazëvendësueshëm nuk është asnje, prandaj secili tē luftojë që t'i kryejë më së miri dhe në kohë detyrat që i janë ngarkuar. Në tē njëjtën kohë tē punojë me perspektivë që tē përgatitë edhe kuadrot e rinj që do ta zëvendësojnë.

Si kudo, edhe nē sektorin shumë tē gjerë tē bujqësisë, Partia ka përgatitur kuadro me shumicë, që janë nē gjendje tē vijnë tē punojnë, bile shumë mirë edhe nē një organ qendror, siç është Ministria e Bujqësisë. Kuadrot e rinj që sollëm në këtë dikaster, me siguri do t'i shkundin specialistët e këtij dikasteri dhe do tē

shkojnë të ndihmojnë më mirë bazën, atje ku realizohet prodhimi, pra në ndërmarrjet dhe në kooperativat bujqësore, për t'i vënë në shërbim të prodhimit gjithë diturinë, aftësitë dhe eksperiencën e tyre. Dituria dhe eksperienca që kanë ata, nuk janë qëllim në vetvete. Partia dhe populli i bënë kuadro që të shërbejnë për të mirën e atdheut, për begatinë e tij, për lumbturinë e njerëzve tanë.

Partia duhet të luftojë fryshtë shumë të sëmurë që ekziston te disa njerëz të inteligjencies sonë, të cilët kanë një megalomani të tillë, sa i shkojnë nga lart me mosbesim të rinxjtë, sidomos ata që tregojnë zotësi të madhe. Ky nuk është një qëndrim i drejtë. Komiteti Qendror solli njerëz të rinj të zotë edhe në udhëheqjen e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës, ku vetë ministri, dy nga zëvendësministrat e ndonjë nga kuadrot me përgjegjësi kishin bërë gabime të mëdha dhe faje politike<sup>1</sup>. Prandaj edhe në këtë dikaster, në vend të këtyre kuadrove, sollëm elementë të rinj d'he vumë ministre shoqen Tefta Cami, një shoqe e pjekur, e astë dhe me kulturë pedagogjike. Kështu në dy dikastere kryesore Partia solli në udhëheqje dy shoqe.

Problemi i gruas është një çështje serioze dhe më rendësi parimore, prandaj Partia e ka ngritur vazhdëmisht me forcë të madhe. Këtyre dy ministreve të reja Partia do t'u japë gjithë ndihmën e nevojshme, por kemi bindjen se edhe ato vetë, duke qenë të zonjat,

---

1. Për këto gabime dhe faje Plenumi i 9-të i KQ të PPSH e përjashtoi ish-ministrin Thoma Deliana nga Komiteti Qendror i Partisë. Më vonë ai u përjashtua edhe nga Partia.

do t'i kryejnë mirë detyrat që u besoi Komiteti Qendror, sepse, në radhë të parë, janë shoqe me partishmëri të lartë dhe, si të tilla, do të punojnë që kudo t'i japid punës një shtytje përpara.

Me masat që morëm për të vënë gra në vende drejtuese nuk duhet kuptuar sikur burrat tash nuk duhet të punojnë më në vende me përgjegjësi dhe të lidhin duart. Jo! Por kjo do të thotë se në asnjë mënyrë nuk lejohet nga Partia që të nënvleftësohen fuqitë mendore dhe fizike të grave, të cilat jo vetëm marrin pjesë kudo në punë nga më të rëndat, po edhe i kryejnë ato me sukses, pa u tërhequr kurrë nga frontet e vëشتira. Për këto arsyen shoqet duhet që edhe të drejtojnë, sepse i kanë të gjitha cilësitë që kërkohen, sidomos në ata sektorë ku punojnë shumë gra.

Të kthehem tash përsëri te çështja e ullirit. Pa një kthesë në kokën e njerëzve dhe, në radhë të parë, në kokën e gjithë komunistëve dhe të punonjësve të paorganizuar në Parti që punojnë me të, nuk bëhet dot kthesa në zhvillimin e ullirit.

Problemet që ngriti për ullirin shoku Hysni duhet të zgjidhen, por ka rëndësi që ato të kuptohen drejt dhe të fshihen të gjitha teorizimet që bëhen për të justifikuar shkaqet e mosrealizimeve në këtë kulturë. Këto teorizime të fshihen jo me fjalë, por me punë. Është turp i madh që u lejua një punë kaq e keqe sa gjatë 15 apo 20 vjetëve, megjithëse janë mbjellë mbi tre milionë rrënje ullinj, sot kemi prej tyre në prodhim vetëm 400 apo 500 mijë rrënje! T'i vrasë ndërgjegjja tërë ata që kanë përgjegjësi për gjithë këtë mundim, djersë e fonde, që i kanë shkuar kot ekonomisë sonë.

Mendoj që organizatat-bazë të Partisë në ndërmarrjet dhe në kooperativat bujqësore, çdo prodhim, por veçanërisht ullirin, duhet ta shikojnë me kujdesin më të madh. Për këtë qëllim punonjësve u duhen caktuar detyra konkrete, duke u mësuar format e punës e të drejtimit dhe përdorimin e metodave agroteknike. Për arritjen e rezultateve që dëshirojmë, duhen bërë llogari të sakta e shkencore për numrin e punonjësve që nevojiten, për sasinë e plehrave kimike dhe organike që duhet të përdoren etj.

Ndaj të gjithë atyre shokëve komunistë apo kooperativistë të paorganizuar në Parti që shkelin vendimet e mbledhjes së përgjithshme të kooperativës bujqësore, të përsaqësisë, të kryesisë ose të çdo forumi që përcakton masa dhe plane për një prodhim ose për një tjetër, duhet të mbahet qëndrim. Të mos lejohet që planet t'i hartojnë vetëm kryetari i kooperativës bujqësore me dy-tre veta, por ato të bëhen në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë specialistët, duke marrë edhe mendimin e masës kooperativiste. Planet e aprovuara të zbatohen me rreptësi deri në fund. Nuk i lejohet askujt, kushdo qoftë ai, që, pasi të jetë bërë planifikimi i shpërndarjes së plehut, ta zëmë për ullirin, ta marrë sasinë e planifikuar për këtë pemë dhe t'ia hedhë grurit. Kur ndodh një gjë e tillë, skuadra, brigada, organizata e Partisë duhet të vënë dorë dhe ta bëjnë problem.

Për çështjet e bujqësisë nuk kanë përgjegjësi vetëm Ministria e Bujqësisë dhe seksioni i bujqësisë në komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, por edhe sektorë të tjera që lidhen me to. Kur themi që bujqësia është baza e ekonomisë sonë, a lejohet që Mi-

nistria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore të qëndrojë indiferente dhe të presë sa t'i vijnë nga kooperativat apo nga ndërmarrjet bujqësore në fabrikat e përpunimit ftonjtë, kumbullat apo ullinjtë? Edhe punonjësit e kësaj ministrie apo ata të seksioneve të industrisë pranë komiteteve ekzekutive të rretheve, të ngrihen të gjithë në këmbë, të venë edhe vetë në kohë dhe të ndjekin e të kontrollojnë herë pas here në kooperativat apo në ndërmarrjet bujqësore se si po u bëhen shërbimet drurëve frutorë etj., nga të cilët do të sigurohet lënda e parë për industrinë ushqimore. Pavarësisht se kjo është një detyrë, në radhë të parë, e sektorit të bujqësisë, industria nuk duhet të qëndrojë duarlidhur. Shokët e industrisë duhet ta bëjnë këtë punë për arsyen se midis tyre dhe bujqësisë, pra, midis blerësit dhe prodhuesit, janë nënshkruar kontrata, ku është përcaktuar sa tonë kumbulla, mollë, ullinj, perime etj. duhet t'i dorëzojë ndërmarrja apo kooperativa kësaj apo asaj fabrike konservimi. Mbi këtë bazë punonjësit e industrisë së lehtë, që kanë për detyrë të ndjekin realizimin e detyrimeve kontraktore, duhet të shkojnë në terren dhe të kontrollojnë si u bëhen shërbimet bimëve e pemëve nga të cilat do të sigurojnë produhimin për ndërmarrjet e tyre.

Të mos ecet më si deri sot që palët kontraktuese vetëm sa nënshkruajnë kontratën, pastaj, edhe në qoftë se kooperativa ose ndërmarrja bujqësore nuk e zbaton këtë, duke mos siguruar sasinë e parashikuar të lëndës së parë, ndërmarrjes industriale aq i bën. Punojmë apo nuk punojmë në unitet? Do të vazhdojmë t'ia varim në qafë vetëm një dikasteri ose një personi kontrollin

për zbatimin e detyrave të planit? Ku është këtu bashkëpunimi ndërdikasterial? Nuk them që për problemin e pemëtarisë të kujdesen punonjësit e metalurgjisë, por ata të Ministrisë së Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, që janë drejtpërdrejt të interesuar për këto probleme, e kanë për detyrë të venë të kontrollojnë, sepse andej do ta marrin lëndën e parë për industrinë e tyre. Mua më duket se nuk ekziston aq sa duhet një fryshtë e tillë bashkëpunimi, nuk ekziston një kuptim i drejtë për disiplinën e planit dhe disiplinën kontraktore, bile disave as që u shkon fare në mendje kjo që përmenda.

Nuk jam në dijeni nëse lidhen apo jo kontrata midis ndërmarrjeve e kooperativave bujqësore, nga njëra anë, dhe ndërmarrjeve të industrisë së lehtë dhe ushqimore, nga ana tjetër. Mendoj se ato duhet të lidhen për zbatimin e detyrave të planit dhe të luftohet me përgjegjësi nga të gjithë që të realizohen detyrat kontraktore. Aktualisht kur njëra palë shkel kërkuesat e kontratës, problemi i kalohet lehtë arbitrazhit dhe, si pas vendimit të këtij organi, pala përgjegjëse detyrohet të paguajë dëmin. Mirëpo në fakt duhet ngulur këmbë që të zbatohet ligji për gjabitjen e drejtuesve të institucioneve, ndërmarrjeve, organizatave dhe kooperativave bujqësore ose të personave të tjera që kanë penguar realizimin e kontratave.

Ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore ankohen shpesh dhe me të drejtë se atyre nuk u merret prodhimi kur ky është i bollshëm dhe nbi planin, si për shembull, spinaqi dhe qepët e njoma. Edhe në këtë rast duket qartë që, megjithëse këto janë çështje të përbashkëta, nuk ka një interesim të gjithanshëm revolucionar

dhe një bashkërendim të mirë të punës për të tëra problemet midis dikastereve. Prandaj, në qoftë se nuk vëmë rregull, disiplinë dhe kontroll dhe në qoftë se nuk marrim masat e duhura në të gjitha këto drejtime që përmenda, puna do të na çalojë.

Përse kooperativat bujqësore të planifikojnë 0,2 ose 0,6 ditë-punë për t'u shërbyer ullinjve? Edhe për këtë pemë me kaq leverdi ekonomike duhet të caktojmë një mesatare të arsyeshme, duke u mbështetur në numrin e krahëve të punës që kemi dhe të mekanikës bujqësore, të cilat duhet t'i llogaritim mirë. Deri dje thuhej, po dhe tash ankohen, se kultivatorët dhe shumë mekanizma të tjera vazhdojnë të mos përdoren, mbanhen mbyllur nëpër depo, ku po na prishen. Duke mos i shfsrytëzuar ata në kushtet tona, ku do t'i gjejmë gjithë këta njerëz për shërbimin që duhet t'u bëjmë ullinjve, drurëve frutorë, bagëtive, bimëve foragjere, perimeve, deri misrit e bimëve industriale? Ata do të gjenden me siguri, po të bëjmë një llogari të saktë në çdo drejtim dhe të organizojmë mirë punët.

Qështjen e llogarisë, megjithëse e kam ngritur shpesh, do ta përsëris edhe një herë. Aktivizimi si duhet i ekonomistëve dhe i financierëve ka një rëndësi shumë të madhe, sepse për çdo punë duhen bërë llogari të sakta. Partia porosit vazhdimisht që kudo të ecim me llogari dhe jo vetëm me parulla e propagandë. Këshlu është e nevojshme të veprohet kur aprovohet plani, ku caktohet sa fuqi punëtore do të merret, që kjo do të paguhet me kaq ditë-punë etj. Atëherë, në rast se kryesia ose brigada do të kërkojë më tepër, punonjësi i llogarisë nuk do të lejojë të merret asnje punëtor më

shumë. Ai, gjithashtu, mban parasysh se vetëm këto forma që janë caktuar do t'i jepen për t'u bërë shërbimet bimëve të ndryshme, si ullirit, bimëve industriale, drithërave, blegorisë e kështu për të gjitha të tjera me radhë. Në qoftë se dikush përpinqet ta ndryshojë me kokën e vet planin, ekonomisti ose illogaritari i ndërmarrjes apo i kooperativës bujqësore le ta denoncojë atë në Parti dhe në pushtet, sepse kjo është një shkelje arbitrale e planit të vendosur shkencërisht.

Siq e përmenda në fillim, gjendja e ullirit e ka shqetësuar prej kohësh Byronë Politike, e cila e ka bërë problem të Komitetit Qendror. Ne e kemi marrë në shqyrtim dhe e'kemi diskutuar disa herë atë edhe në Sekretariat. Tash këtë problem duhet ta marrë në dorë Këshilli i Ministrave ose Kryesia e tij e në mënyrë të veçantë Ministria e Bujqësisë dhe, si rrjedhim, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve. Ashtu si gjithë problemet e tjera, edhe ullirin organet shtetërore ta kenë kurdoherë parasysh që të ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm për ta vënë çështjen e zhvillimit të tij në rrugën e një zgjidhjeje të drejtë në bazë të vendimeve që kemi marrë.

*Botuar për herë të parë, me pak shkurtime, në librin:  
Enver Hoxha, «Raporte e  
fjalime 1976-1977», f. 86*

*Botohet i plotë sipas tekstit  
të nxjerrë nga procesverbali  
i mbledhjes së Sekretariatit  
të KQ të PPSH, që gjendet  
në AQP*

**TE PUNOJMË, TE PRODHQJMË E TE FORCOJMË  
MBROJTIEN QË KUFIJTË TANË TE JENE  
GJITHMONE TE PAKAPERCYESHËM**

*Nga biseda në takimin<sup>1</sup> me një grup punonjësish  
e specialistësh të kombinatit metalurgjik  
«Çeliku i Partisë» në Elbasan*

29 prill 1976

*Shoku Enver Hoxha, duke u shprehur punëtorëve  
e specialistëve falënderimin dhe gjëzimin që po takohet  
me ta, vazhdoi:*

Inaugurimi i linjës së gizë-koksit në Kombinatin Metalurgjik është një sukses i madh politik dhe ekonomik, që e forcon Shqipërinë socialiste. Ky është sihariq e fryshtësim i madh për popullin tonë me rastin e ditës së 1 Majit, ditës së solidaritetit ndërkombëtar të punëtorëve. Me këtë sukses ne i tregojmë proletariatit botëror q'është socializmi, q'është diktatura e

---

1. Ky takim që u zhvillua në selinë e Komitetit Qendror të Partisë, u bë me kërkesën e shokut Enver Hoxha, i cili dëshironte të përgjzonë punëtorët e Kombinatit Metalurgjik përsuksesin që arritën me prodhimin e gizës së parë të markës shqiptare.

proletariatit, i tregojmë se, kur lufta e klasave zhvillohet me konsekuençë si brenda vendit, ashtu edhe në arenëndërkombëtare, rezultatet janë të shkëlqyera.

Në emër të Komitetit Qendror dëshiroj t'ju përgëzozoj nxchtësisht, ju, punëtorë e specialistë të Kombinatit Metalurgjik për këtë fitore. Kombinati Metalurgjik është vepra më e rëndësishme që po ndërton klasa punëtore e vendit tonë nën udhëheqjen e Partisë e që shënon një etapë vendimtare në zhvillimin e industrisë sonë. Ai është vepra ku do të prodhohet «buka» e industrisë sonë mekanike. Të gjithë ne e vlerësojmë lart punën tuaj të palodhur e vetëmohuese, sepse e dimë që ngritja e këtij kombinati, proceset e tij teknologjike dhe eksperimentet e shumta që janë bërë, nuk kanë qenë të thjeshta. Këto nuk ishin eksperimente të një pirometalurgje klasike, se hekuri ynë përmban edhe nikel e kobalt, pra, nuk mund të shkrihej dhe të ndahej në bazë të kësaj pirometalurgje.

Për ndërtimin e Kombinatit Metalurgjik në Elbasan, përveç punëtorëve dhe specialistëve shqiptarë kanë ndihmuar edhe specialistë kinezë. Për vënien në shfrytëzim të linjës së gizë-koksit u desh të bëheshin eksperimente të ndërlikuara e të shumta, të ndërtohej furnalta, bateria e koksit e sektorë të tjera. Dhe mundi u kurorëzua me sukses: U prodhua giza e parë e metalurgjisë sonë. Tashti, të dashur shokë, ju i jeni përveshur punës me forca akoma më të mëdha dhe po ecni me hapa akoma më të sigurt në rrugën tuaj përfundimin e plotë të veprës, sepse ju tanë keni fituar një eksperiencë të pasur teknike. Shprerë besimin se, duke u bazuar në një organizim të mirë e në fryshtë

tuaj revolucionare, në vijën marksiste-leniniste që ju ka frysmeuar e ju frysmezon në këtë punë të madhe, do ta përfundoni veprën në afatin e caktuar e do të prodhoni çliqe të ndryshme, nikel e kobalt. Natyrishit, që kjo detyrë të realizohet, duhet të punoni dhe të mësoni. Për këtë duhet të shfrytëzoni edhe eksperiencën e madhe që keni fituar deri më sot.

Proceset e punës në metalurgji nuk janë të thjeshta. Unë nuk kam shumë njohuri për metalurgjinë, me gjithatë, e kuptoj se procesi i përpunimit të hekur-nikelit është me shumë rëndësi dhe shumë delikat, është proces pirometalurgjik ku veprojnë ligje fizike e kimike, të cilat duhen kuptuar në thellësinë e tyre shkençore dhe jo vetëm nga ana praktike. Nuk është e lehtë të mënjanosh oksidin e karbonit dhe të zvogëlosh sasinë e karbonit fillimisht nga giza dhe pastaj nga çeliqet. Nuk është aq e lehtë, gjithashtu, të mësohet trajtimi i qymyreve për prodhim koksi.

Te ne po ndërtohen bateritë e koksit. Rreth 34 shekuj e ca më parë, siç dihet, hititët<sup>1</sup> zëvendësuan bronzin me hekurin që e shkrinin duke përdorur qymyre vegjete, por këtë punë ata nuk e bënin dot siç duhej. Nga ajo kohë e gjer më sot shkenca ka shkuar shumë-shumë përpara. Në qoftë se krahasojmë të tashmen me të shkuarën, para 34 shekujve, në këtë fushë për të cilën po bisedojmë, mund të themi se ndryshimi është aq i madh sa ç'është, për shembull, aktualisht, diferenca

1. Popull i lashtë që ka banuar në pjesën qendrore dhe lindore të Azisë së Vogël dhe në Sirinë Veriore nga shkulli i 20-të deri në shekullin e 12-të para erës së re.

e një predhe të zakonshme nga predha e raketës. Prandaj në çdo proces, pra edhe në funksionimin e furrnaltës, ka një teknikë të lartë për të cilën nuk dua t'ju bëj leksion, se ju vetë e keni ndërtuar.

Ju i njihni proceset që zhvillohen në furrnaltë, por ato duhet t'i dinë mirë të gjithë punëtorët e metalurgjisë, të cilëve t'u bëhet e qartë se ajo furrë e lartë, ku hidhet materiali i parë, nuk është furrë e thjeshtë. Ajo ka disa shtresa, ka forma konike të ndryshme dhe të posaçme, ka vendin ku futen lëndët, duke filluar që nga materiali i parë e deri te koksi, te silicet, te gëlqerja e tek ajri. Të gjitha këto procese kanë rëndësinë dhe regjimin e tyre shkencor. Në qoftë se nuk ruhen përpjesëtimet e duhura të lëndës së parë, të koksit, të ajrit, të gëlqeres e të materialeve të tjera, atëherë nuk mund të merret giza që duhet. Nga këto materiale me shumë rëndësi është koksi, që disa e kuptojnë thjesht si qymyr. Koksi vërtet qymyr është, por është i një lloji të veçantë me disa cilësi që nuk i ka qomyri i zakonshëm. Ai është rezistent sa mund të mbajë gjithë kolonën e materialit të parë, është poroz që të mund të futet ajri për ta mbajtur furrën të ndezur. Pa koks nuk ka metalurgji. Këto nocione elementare të metalurgjisë i përmenda për shokët tanë të rinj që nuk kanë njoħuri në këtë fushë.

Këtë xhevahir për vendin tonë, këtë metalurgji të fuqishme me të ardhme të madhe, duhet ta shfrytëzojmë si duhet, me zotësi, me mjeshtëri, me disiplinë shkencore e organizim të mirë. Këtu nuk ka vend për diskutime nëse diçka duhet bërë kështu ose ash-

tu, sepse gjithçka është përcaktuar shkencërisht. Në këtë vepër, tërë procesi teknologjik duhet të respektohet rigorozisht, pa u cenuar. Kjo bën të domosdoshme që, çka keni mësuar, ta thelloni, ta vini në zbatim si duhet. Mësuesit e marksizëm-leninizmit na porositin që sa më shuni të mësojmë, aq më pak të themi se kemi mësuar. Këto porosi vlejnë jo vetëm për punëtorët e specialistët, por për secilin nga ne. Prandaj, shokë, duhet të mësojmë çdo ditë.

Tashti dora-dorës, të vazhdojmë të përfundojmë së ndërtuari të gjitha fabrikat, të cilat të punojnë normalisht, sipas normave të caktuara, sipas proceseve shkençore, teknologjike dhe të nxjerrim jo vetëm çeliqet e ato produkte që janë caktuar, por ta zgjerojmë gamën e tyre. Këtë punë duhet ta bëjmë për të mirën e atdheut tonë, të revolucionit e të socializmit, për rritjen e fuqisë ekonomike e për forcimin e mëtejshëm të aftësisë mbrojtëse të vendit, sepse armiqtë tanë dhe të të gjithë popujve, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, i kanë dhëmbët akoma të mprehtë. Ata vazhdojnë të nxitin luftërat lokale në zona të ndryshme të botës dhe të përgatitit luftën botërore, megjithëse lufta e popujve ua ka dobësuar e ua ka tronditur pozitat. Tronditja e pozitave të tyre është rrjedhim i vetë zhvillimit historik. Shkatërrimi i superfuqive, si rezultat i kontradiktave të thella e të papajtueshme që kanë me proletariatin dhe me popujt, është proces dialektik, që nuk varet nga vullneti i tyre. Në botë po ndodhin «tërmëte». Këto «tërmëte» do të vijnë gjithnjë duke u shtuar në dëm të armiqve. Natyrisht, lufta

e proletariatit do të kalojë akoma vështirësi të mëdha, derisa të kurorëzohet me fitore, prandaj duhet të punojmë, të prodrojmë, të organizojmë, të armatosemi, të forcojmë prapavijat, të forcojmë mbrojtjen, që kufijtë tanë të jenë gjithmonë të pakapërcyeshëm nga armiqjtë, sepse kështu ndihmojmë edhe popujt që kërkojnë të bëjnë revolucion.

Në rrugën e industrializimit socialist të vendit në të gjitha fushat, veçanërisht në përpunimin e hekur-nikelit, Partia e Punës e Shqipërisë është ndeshur me punën armiqësore të revizionistëve sovjetikë dhe të satelitëve të tyre. Për një kohë ata u përpoqën të na gjenjenin. Më në fund arritën në konkluzionin kolonialist se në Shqipëri nuk mund të ndërtohej kombinat përmetalurgjinë e zezë mbi bazën e mineralit tonë. Sipas tyre, këtë duhej ta çonim në Çekoslovaki, sepse vetom atje mund të ngrihej një kombinat i tillë.

Pra, në Çekoslovaki mund të ndërtohej kombinati mbi bazën e mineralit tonë, të cilin duhej ta shitnim me çmimet që do të na impononin ata, kurse në vendin tonë një i tillë kombinat nuk mund të ndërtohej! Çekët nuk na e kanë paguar as kobaltin, që nxirrin nga minerali ynë.

E përmenda këtë fakt si për shokët shqiptarë, ashtu dhe për shokët kinezë, për të theksuar se sa armiq të egër kanë qenë dhe janë revizionistët sovjetikë dhe revizionistët e tjerë modernë.

Propozoj të ngremë një dolli për shëndetin tuaj, për shëndetin e të gjithë shokëve punëtorë, teknikë, specialistë e kuadro drejtues për këtë punë të madhe që

keni kryer! U jepni të falat e Komitetit Qendror të Partisë, të Byrosë Politike, të Qeverisë e të miat personalisht të gjithë shokëve, që nga punëtori e deri te drejtuesi i kombinatit! Ju uroj suksese edhe në të ardhmen! Të na rrojë Partia! Të rrojë atdheu ynë socialist!

Në prag të festës së 1 Majit kemi marrë odhe lajme të tjera të gëzuara. Përfundoi së ndërtuari dhe do të vihet në shfrytëzim Fabrika e Uresë, por edhe veprat e tjera të parashikuara në plan do të realizohen, me gjithëse armiqtë na kanë dëmtuar.

Në sektorin e industrisë së naftës dhe në zbulimin e vendburimeve të gazit kemi shenja të mira. Ne kemi qenë të bindur se Shqipëria është vend naftë dhe gazmbajtës, por armiqtë na kanë sabotuar, duke na fshehur të vërtetën. Por ne i zbuluam sabotatorët. Tashti kuadrot, inxhinierët dhe specialistët tanë, me Partinë në krye, i kanë gjetur pasuritë e nëntokës që armiqtë na i fshihnin.

Sikurse mund të jeni në dijeni, ditët e fundit Partia shkarkoi nga funksionet e tyre ministrin e Bujqësisë dhe atë të Arsimit e të Kulturës. Ata kanë bërë faje të rënda në vijën e Partisë dhe në kryerjen e detyrës. A e dini cilët caktoi Komiteti Qendror në këto poste? Shoqja Themije Thomai, një grua që ka ardhur nga balta e arave, u emërua ministre e Bujqësisë. Në fillim ajo ishte punëtore e thjeshtë, pastaj brigadiere, kryetare e kooperativës bujqësore në Këmishtaj, agronome me shkollë të lartë.

Sigurisht, gratë kooperativiste ndiejnë gjëzim të madh dhe inkurajohen kur shohin që një shoqe e tyre

meriton të drejtojë për herë të parë në historinë e Shqipërisë një dikaster të tillë, siç është Ministria e Bujqësisë, një sektor kaq jetik për ekonominë e vendit tonë. Në këtë ministri kanë ardhur edhe kuadro të tjercë, që dikur kanë qenë brigadierë nö fushë, njerëz që rrojnë me problemet e bujqësisë. Shoqja Themije Thomai do të ndihmohet nga Partia në mënyrë që bujqësia jonë socialiste të përparojë e të zhvillohet më tej. Në këtë drejtim, do të ndihmojë edhe puna e vetë kooperativistëve.

Edhe në arsim Komiteti Qendror i Partisë caktoi si ministre një shoqe, Tefta Camin, e cila, gjithashtu, ka ardhur nga fshati. Ajo ka mbaruar universitetin, ka qenë mësuese e lëheshtë, drejtore shkolle e pastaj sekretare e komitetit të Partisë në rreth. Dy shoqe të reja nga mosha, por të pjekura dhe të afra. Kjo është fitore e politikës së Partisë në emancipimin e plotë të gruas. Gratë janë forcë e madhe, pa to shoqëria nuk ecën, pa to nuk ka socializëm. Partia mëson që të tërë duhet të kryejnë detyrat e ngarkuara. Kush nuk punon mirë të vejë në bazë dhe njerëzit nga baza, që punojnë e drejtojnë si duhet, ajo i ngre në poste drejtuese.

Në sajë të punës së bërë nga Partia dhe nga punonjësit e bujqësisë në bazë, ne kemi arritur suksese në bujqësi. Planin në industri dhe në bujqësi do ta realizojmë. Në unitet rreth Partisë, të mësojnë sa më shumë nga eksperienca e njëri-tjetrit dhe nga teoria e marksizëm-leninizmit që të bëhem akoma më të fortë politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht.

Mbeti ndonjë pa e takuar? A, po! Mbeta pa u takuar me punëtorët, me ata që janë atje në kombinat. Kur

të ktheheni, ju lutem shumë t'i përqafoni të gjithë nga ana ime. Ju uroj suksese dhe fitore. Të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

## TË NDJEKIM ME KUJDES GJENDJEN NDËRKOMBËTARE

Shënimë

19 maj 1976

Në vazhdim të shënimeve për raportin e Kongresit, dëshiroj të tërheq vëmendjen e shokëve të Partisë që të ndjekin me kujdes gjendjen ndërkombëtare, situatat politike, ekonomike dhe zhvillimin e ndërlikuar të tyre. Një gjë e tillë nuk është as e lehtë, por as e pamundur, në rast se, të armatosur me teorinë marksiste-leniniste dhe me mësimet e Partisë, ndjekim në shtypin e përditshëm ose periodik të vendit tonë, ose dëgjojmë me kujdes në radio e televizor evenimentet që ndodhin në botë. Kur them të ndjekim gjendjen ndërkombëtare, me këtë unë kuptoj thellimin në ngjarjet politike të zhvillimit botëror dhe, në dritën e analizave të Partisë sonë, çdo komunist të dijë të nxjerrë konkluzione dhe domethënje prej tyre, të zbulojë arsyet e lidhjet që kanë këto evenimente me njëra-tjetrën dhe ç'konsekuenca mund të kenë në përgjithësi në botë dhe mbi vendin tonë.

Kjo gjë, kjo analizë dhe këto konkluzione nuk

mund të bëhen pa i ndjekur ngjarjet në zhvillimin e tyre.

Interesimi për to nuk duhet të jetë i rrallë, pasi atëherë do të gjendemi përpara të papriturave që të çorientojnë, të habitin dhe të çojnë edhe në luhatje të mendimeve politike.

Shtypi i Partisë çdo ditë përmban shkrime me shpjegime dhe nc orientime të qarta, të cilat komunistët nuk duhet t'i lënë pas dore, por t'i ndjekin dhe t'i zhvillojnë më tej me logjikën e tyre, me njohjen teorike që kanë dhe me shkallën e kulturës së tyre.

Me keqardhje mund të themi se ka mjaft komunistë që nuk e përbushin mirë si duhet këtë detyrë të rëndësishme, por ka edhe të tjerë që e neglizhojnë fare. Natyrisht, qëndrimi i këtyre të fundit është shumë i dënueshëm.

Ekziston një pikëpanje e gabuar sikur është një kohë e humbur të interesohesh për zhvillimin politik në arenën ndërkombëtare dhe duke menduar kështu dillet në disa rrugë të padrejta:

1. Disa thonë: «Ka kush mendon për këto probleme, që mendon drejt dhe vepron drejt e në kohë».

2. Disa të tjerë kënaqen duke përdorur disa sloganë, duke përdorur disa formulime të dala nga analiza të drejta të Partisë, por nuk bëjnë përpjekjet e duhura t'i thellojnë e t'i zbérthejnë këto formulime nga ana politike, ekonomike, kulturore, ushtarake, t'i lidhin këto me zhvillimet që ngjasin në botë dhe t'u japid interpretimin e duhur këtyre zhvillimeve.

Shumë herë përdoren fjalot imperializmi, revizionizmi modern, luftërat e drejta dhe luftërat grabitqare,

krizat botërore të kapitalizmit, «bota e parë», «e dytë», «e trefë» etj., etj., por këta terma kanë një përmbajtje, një kuptim të thellë teorik dhe praktik, politik dhe ekonomik, që janë në bazë të ngjarjeve që zhvillohen në botë. Janë këto kuptime e shumë si këto që krijojnë antagonizma dhe luftëra lokale në botë.

Në qoftë se njerëzit tanë nuk u vihen këtyre çësh-tjeve t'i kuptojnë thellë, atëherë ecet me sy mbyllur në një botë që zien dhe do të ketë nga ata që do të kënaqen në një eufori të rrezikshme, pikërisht se nuk i parashikojnë këto rreziqe, sepse nuk i kuptojnë, sepse nuk i studiojnë dhe kështu do të gjenden të çarmatosur.

3. Ka disa komunistë e kuadro që merren më shumë me problemet ekonomike, të cilat u zënë këmbët dhe nuk dinë të programojnë si duhet kohën. Këto probleme, natyrisht, janë të rëndësishme dhe kërkojnë kujdes të madh në ndjekjen në anën teoriko-shkencore dhe praktike të tyre, por ato dhe të tjera si këto nuk janë të shkëputura nga politika dhc ideologjia jonë, përkundrazi janë të lidhura ngushtë. Natyrisht, Partia jonë, duke qenë një parti politike, këtë çështje, domethënë, kthjellimin e mendimit politik dhe ideologjik të anëtarëve të saj, nuk e ka lënë kurrë pas dore dhe kjo gjë është në bazë të sukseseve të socializmit në vendin tonë.

Por në qoftë se problemet e politikës dhe të ideologjisë zhvillohen më mirë, më thellë e më gjerë, rezultatet dhe fitoret do të jenë shumë më të mëdha. E kam theksuar shumë herë se në Shkollën e Partisë, në kurset e saj, në rrethet e studimit, në seminare etj.,

teoria jonë, kur shpjegohet, duhet të shoqërohet me eksperiencën e Partisë sonë, të lidhet me kushtet e vendit tonë dhe të mos lëmë kurrë pa shpjeguar dhe pa bërë krahasime se si imperializmi, socialimperializmi, revizionizmi modern dhe kapitalistët në përgjithësi i luftojnë dhe i shtrembürojnë mendimin teorik dhe veprimin praktik revolucionar të Partisë sonë. Ky shpjegim të bëhet konkret, me shembuj dhe me zërthimë politike, ideologjike dhe ekonomike: përse tek ata ka kriza dhe përse te ne s'ka; përse tek ata ka inflacion dhe te ne s'ka; përse te ne ka stabilitet ekonomik, prodhimi shtohet dhe çmimet nuk ngrihen, por ulen, përse te ne nuk ekziston ngritje çmimesh dhe ulje rrogash ose ai fenomen që në botën kapitaliste quhet *cycle infernal*<sup>1</sup>?

Të gjitha këto e të tjera, që komunistët i mësojnë në institucionet që përmenda më lart, nuk kanë asnjë vlerë dhe harrohen, në qoftë se nuk i udhëheqin në punën e përditshme ekonomike, politike, kulturore. Këto na bëjnë të kuptojmë më mirë ç'janë rendimentet, ç'është kostoja, ç'është disiplina shtetërore dhe ajo teknike, ç'përfaqësojnë çmimet, akumulimi e shumë probleme të tjera.

E gjithë kjo njohuri, e gjithë kjo dituri nuk mund të ndahet dhe të shkëputet nga politika e brendshme dhe e jashtme e shtetit tonë të diktaturës së proletariatit, i cili nuk është i izoluar.

Formula «rrojmë në rrethim dhe duhet të punojmë e të luftojmë si në rrethim» nuk është një formulë e kotë. Ky rrethim ekziston dhe duhet njohur e luftu-

---

1. Frëngjisht — cikël i tmerrshëm, i padurueshëm.

ar. Ekziston edhe «presioni i armikut të brendshëm e të jashtëni», edhe ky duhet njojur që të luftohet, ekziston edhe «agresioni ideologjik që i përgatit terrenin agresionit të armatosur», prandaj duhen njojur variantet, format dhe metodat e tyre dhe të armatosen të gjithë njerëzit tanë me armën tonë ideologjike, politike, ekonomike dhe ushtarake për t'i përballuar e për t'i luttuar këto rreziqe derisa t'i shpartallojmë.

Partia porosit të bëhet rregullisht leximi i shtypit, pa solur për studimin individual që duhet ta bëjë cilido. Por, pavarësisht se tash ne kemi kudo kuadro shumë të ngritur, kemi sekretarë të organizatave-bazë që kanë mbaruar jo vetëm kurse partie, por edhe shkollën e Partisë «Vladimir Iliç Lenin», leximi i shtypit dhe studimi individual lë shumë për të dëshiruar. Më parë në organizatat-bazë flitej për ngjarjet ndërkombëtare, diskutohej për to dhe nxirreshin edhe konkluzione për të forcuar luftën politike brenda vendit, kurse tash, me keqardhje, konstatoj se një praktikë, një detyrë e tillë me rëndësi është lënë pas dore, se ka nënveftësim të saj. Dhe ky nënveftësim vihet re edhe te vetë kuadrot e udhëheqjes së Partisë në rrethe dhe në bazë. Gati në asnjë raport, në asnjë mbledhje e aktiv partie nuk gjen që krahas trajtimit të problemeve të tjera, të trajtohen edhe probleme politike të gjendjes ndërkombëtare. Jo, kjo s'bëhet. Në këto mbledhje mund të gjesh të flitet për thekër, deri dhe për koçullat, por për ngjarjet e mëdha ndërkombëtare që ngjasin, për luftërat e armatosura, që po zhvillohen dhe ku derdhet gjaku i popujve, flitet fare pak ose aspak.

Botën kapitaliste e ka mbuluar një nga krizat më

të mëdha që ka parë bota. A shpjegohet nga ana teorike natyra e kësaj krize, goftë në mënyrë të thjeshtë? Jo. Anëtari i Partisë sonë duhet të dijë që sistemi kapitalist kalon vazhdimisht nga një cikël krizash ekonomike, që janë karakteristika të vjetë sistemit. Por nuk mjafton që anëtari i Partisë vetëm të njohë ekzistençën e këtyre fenomeneve ciklike, por duhet të dijë edhe shkaqet ekonomike, politike etj., që janë në bazën e këtyre krizave të sistenit kapitalist dhe që i shkaktejnë këto. Kjo anë teorike dhe njohja e saj janë të domosdoshme. Këto mësolen në shkollat tona dhe në kurse teorike të Partisë, mësohen kur studiohen ekonomia politike e socializmit dhe ajo e kapitalizmit. Por rëndësi ka që njerëzit tanë të kuptojnë esencën e procesusit të krizave të sistemit kapitalist. Për këtë çështë e domosdoshme të bëhen sqarime, sepse një gjë e tillë nuk arrihet vetëm nga studimi libresk dhe dogmatik që shërbën pak për t'u orientuar në situatat e krizave botërore ose pariale të botës kapitaliste. Ky studim duhet ilustruar me ndodhitë konkrete, me luhatjet dhe me zinxhirin e krizave në shumë vende kapitaliste.

Komunistët dhe mbarë punonjësit duhet të dinë se kriyat përbëjnë një dezkuilibër të ekonomisë kapitaliste. Në këto periudha prodhimi i zgjeruar kapitalist pëson një rënje, një çarje ose, si me thënë, një dezkuilibër në mes nivelit të prodhimit dhe atij të kërkesës blerëse. Kjo quhet kriza e superprodhimit.

Kur themi se kapitalizmi e ka si gjënë e vet krizen, kjo do të thotë se ai nuk mund t'i shpëtojë vargut të depresionit që quhet kriza dhe që zakonisht vijnë

në kohë të caktuara, pas një shtimi të prodhimit dhe ngritjes së çmimive.

Prodhuesit kapitalistë, për të rritur fitimet, nxitin prodhimin dhe ngrenë çmimet e mallrave në treg. Ata mendojnë se duke e bërë këtë, në një kohë kur tregu ka gjetur një farë stabiliteti relativ, çmimet ngrihen njëkohësisht me shtimin e prodhimit, i cili është rezultat i futjes në eficiencë të makinave më moderne dhe të një teknologje më të përparuar.

Mirëpo nga një proces i tillë krijohet ai dezekuilibër në mes ofertës dhe kërkesës. Çmimet e mallrave të prodhimit, pavarësisht se këto shtohen, ngrihen dhe pagat reale të punonjësve ulen vazhdimisht. Kështu që kërkesa zvogëlohet, pse s'ka mundësi të tjerqen mallrat nga konsumatorët. Prodhuesi përpinqet të gjejë kredi ose të tjera ekspediente financiare shumë të kushtueshme për të realizuar fitimet pa një ulje çmimesh. Në këtë rast kriza shpërthen. Gjatë kësaj periudhe krize shumië ndërmarrje prodhuese falimentojnë, duke mos marrë dot kredi bankare, kurse të tjerat bëjnë përpjekje të ulin pak çmimet për t'i shpëtuar likuidimit të tyre.

Kriza, pra, krijon ngritjen e çmimeve, inflacione, papunësi e shumë të këqija të tjera për punonjësit. Shteti kapitalist nuk mund t'u huajë dot ndërmarrjeve kapitaliste që ato të ruajnë superfitimet, duke ruajtur çmimet e larta, pse ndryshe shtohet inflacioni. Një situatë e tillë krize shifikton rënien, shumë herë katastrofale, të aksioneve të ndërmarrjeve në bursa dhe krijon shtimin e stoqeve të mallrave, në pamundësi të likuidohen pa ulur çmimet. Ç'shkakton kjo? Kjo shka-

kton rënien e prodhimit, papunësi dhe e detyron kapitalistin të zbrazë depot e stokazheve të mallrave të prodhuara. Kur kapitalisti është i detyruar të ulë çmimet, kërkesa shtohet, mallrat evadohen më lehtë. Kësaj periudhe krize i vjen një periudhë relativisht e shkurtër ristabilizimi, ndryshon raporti në mes fuqisë blerëse dhe ofertës, ku e para ngrihet. Në këtë periudhë likuidohen stoqet, shtohet prodhimi, vihen në lëvizje fabrika dhe metoda të reja, bankat japin kredi dhe vjen përsëri periudha kur superprodhimi ngrihet, ngrihen çmimet, blerësi varfërohet, tregu nuk ecën etj. dhe risillon kriza. Ky fenomen quhet cikli i krizave. Në periudhën e krizës punëtorët dhe punonjësit vuajnë pa masë. Kur fillon gjendja që quhet e rimëkëmbjes, si me thënë, atëherë diçka përmirësohet jeta e punonjësve, për të rënë më pas përsëri në varfëri dhe në fatkeqësi të panumërtë. Këto janë shkaqet kryesore të krizave të sistemit kapitalist, që i ka shpjeguar, i ka evidentuar e i ka parashikuar me aq gjenialitet Marksii në «Kapitalin» e tij dhe në veprat e tjera ekonomike dhe politike. Por nuk janë vetëm këto shkaqet e krizave të sistemit kapitalist, ka edhe mjaft të tjera, një nga të cilat është dhe rotacioni i kapitalit fiks dhe degreja e akumulacionit të krijuar nga mbivlera.

Aktualisht, kriza botërore ekonomike, financiare, politike ka përfshirë të gjitha shtetet e botës kapitaliste, me në krye SHBA dhe BS. Rruga e vetme për të shpëtuar nga këto kriza është lufta dhe zhdukja e sistemit kapitalist që i prodhon vazhdimisht e pa pushim krizat.

Ky është një shpjegim i thjeshtë që unë po i bëj

krizës së kapitalizmit. Këtë e bëj në këtë formë, sepse si ky problem i rëndësishëm ka një sërë problemesh të tjera që organet e propagandës së Partisë duhet t'i trajtojnë më qartë, në mënyrë precize dhe të kuptueshme.

Komunistëve, duke marrë parasysh nivelin e diferençuar kulturor të tyre, duhet që shumë probleme teoreike, ekonomike dhe të politikës t'ua thjeshtësojmë në fillim që të mund të kapin mirë esencën, gjë që do t'i nxitë të lexojnë klasikot tanë të marksizëm-leninizmit dhe të rritin e të shtojnë njohuritë e tyre aq shumë të nevojshme dhe të domosdoshme për punën dhe përlustën tonë revolucionare.

*Botohet për herë të parë si-  
pas originalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## TEKSTET TË HARTOHEN NË PRIZMIN MARKSIST-LENINIST

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

21 maj 1976

*Para disa ditësh shoku Ramiz Alia kishte marrë pjesë në mbledhjen që u bë në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës për tekstet shkollore. Lidhur me problemet që dolën në të, që në fillim të takimit fjalën e mori*

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Me gjithë punën e bërë për rishikimin e teksteve pas vërcjtjeve e kritikave që u bënë në Sekretariatin e Komitetit Qendror, disa tekste kanë dobësi ideologjike, prandaj duhen ndryshuar. Për shembull, aty u fol për tekstin e gjeografisë ekonomike të shteteve të ndryshme të botës. Është interesante të dihet se lënda e gjeografisë ekonomike bëhet nü klasën e gjashtë të tetëvjeçares, por bëhet prapë edhe në shkollën e mesme. Çfarë ka në tekstet e kësaj lënde? Në tekstin e gjeografisë ekonomike është ruajtur struktura e programeve të vjetra. Dhe çfarë ndodh? Për Bashkimin Sovjetik jepet tërë potenciali

ekonomik, resurset ku zë vendin e parë, ku vendin e dytë etj. Megjithëse në tekst thuhet se atje janë në fuqi revizionistët, që janë kundër marksizëm-le-ninizmit dhe vendit tonë, prapëseprapë jepet një pas-qyrë e plotë e zhvillimit ekonomik të këtij vendi. Nuk mbahet parasysh psikologjia e fëmijëve dhe aftësia e tyre, se sa janë në gjendje të arrijnë në deduksione kur u thua të tëra këto gjëra. Pra, ky tekst me këto të dhëna, nuk vlen. Ne nuk jemi të detyruar të japim gjëra të tilla në shkollë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Jo vetëm që nuk jemi të detyruar, por nuk është as e domosdoshme të japim ato formulime që kanë bërë ata. Ne mund të japim në tekst formulime të përgjithshme për shtetet e huaja, që nxënësit të kenë një ide, por jo në atë formë, siç e kanë dhënë ata. E ç'i duhet dymbëdhjetëvjeçarit ta dijë hollësishët potencialin ekonomik të Bashkimit Sovjetik ose të Jugosllavisë? As i hyn gjë në punë! Ai mjafton të dijë që Jugosllavia është një vend fqinj, revizionist, me një bujqësi të prapambetur, që koo-perativizmi nuk ekziston. Mund të thuhet, gjithashtu, se cilat janë mineralet që nxjerr e që ka dhe një industri, që kanë marrë e marrin nga të huajt kredi etj.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Sidomos për klasat e ulëta të tetëvjeçares nuk ka ç'duhen fare këto gjëra.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Kur isha në Shkollën e Partisë, në lëndën e gjografisë ekonomike të shteteve jepeshin deri edhe numri i lopëve, i dhenvc, i derrave etj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Atëherë duhen spastruar tekstet nga këto gjëra, se, veç të tjera, hu-

mbasim edhe kohën e nxënësit. Në fund të fundit, edhe sikur të nisemi nga dëshira për t'u dhënë nxënësve njohuri një çikë më të gjera, këto që thamë nuk janë të nevojshme për një të ri. Përveç kësaj, ai do të këndoje edhe libra e gazeta e do të mund të formojë një ide, në mos për të tëra, të paklën për disa shtete.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Veç këtij teksti, dobësi kanë edhe tekstet e letërsisë, të estetikës etj. Në veçanti përmbledhja që kanë bërë, materialet që janë grumbulluar në to, janë mjaft të dobëta, edhe nga pikëpamja e përbajtjes, edhe si formulim.

E para, në tekstin e teorisë së letërsisë konceptet e Partisë për letërsinë janë trajtuar dobët; në tekst nuk pasqyrohet si duhet mendimi i Partisë për çështjet e letërsisë dhe të arteve.

E dyta, në antologjitet që janë përgatitur ka shumë subjektivizëm. Zgjedhja e materialeve për to bëhet gjoja që të jetë tematike, të ketë tema edhe për klasën punëtore, edhe për fshatarësinë, edhe për pionierët, edhe për rininë, por nën këtë pretekst kalohet në subjektivizëm sa, ngadonjëherë, futen edhe krijime pa asnjë vlerë të autorëve fare të rëndomtë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kjo ka rëndësi shumë të madhe.

E para, baza është historia e literaturës shqiptare. Në qoftë se kjo nuk paraqitet si duhet, objektivisht, në fryshtë markiste-leniniste, nuk mund të quhet histori e letërsisë shqipe. Unë nuk e di se si e kanë vënë në program, por atë duhet ta mësojnë në disa klasa në shkollat e mesme. Kjo lëndë ka periudhat e veta.

Ajo duhet të formulohet mirë dhe të ruhemë nga tendencat jo të drejta. Këtë e them edhe sepse kur unë kam mbaruar shkollën e mesme, kanë ekzistuar prirje të tillë, bie fjala, për literaturën franceze, për të cilën, natyrisht, ka pasur shumë koncepte dhe opinione. Në Francë, si një shtet borgjez kapitalist që është, në periudha të ndryshme janë imponuar tekste të hartuara nga formulues të kësaj lënde me pikëpamje jo të njëlllojta. Mund të them se vetëm në Liceun e Korçës kishte pedagogë që vinin me idetë e Brunetierit<sup>1</sup>, të tjerë me ato të Lansonit<sup>2</sup> e kështu me radhë, me gjithfarë idesh. Por të tërë këta ishin autoritete dhe idetë e tyre qarkullonin në libra. Një nxënës mund t'i thoshte pedagogut që unë këtë ide mbi romantizmin e kam lexuar nga filan autor; një i dytë që kishte kënduar një autor tjetër, kundërshtonte se nuk ishte dakord me teorinë e Brunetierit, por me të Lansonit etj. Prandaj them që ne ta shikojmë zhvillimin e literaturës sonë në prizmin marksist-leninist. Kjo është kryesorja.

Pastaj, historia e literaturës shqipc, qoftë në shkollat e mesme, qoftë në universitet (dhe këtë e them nga eksperienca), duhet t'i përshtatet ciklit të shkollës sipas qëllimit që i kemi caktuar, duke u mbështetur në teorinë marksiste-leniniste. Për pionierët mund të mos flasim me «teorira» të mëdha, se nuk janë në gjendje t'i kapin. Këtu kryesore është të vëmë në dukje idetë që përshkojnë veprën, qofshin këto ide borgjeze, demokratike apo patriotike të kohës, domethënë, të atij

---

1, 2. Ferdinand Brunetier (1849-1906); Gustav Lanson (1857-1934) — kritikë letrarë francezë.

drejtimi politik që ka qenë sundues në atë periudhë.

I rëndësishëm është edhe arti i të shkruarit. Edhe këtu duhet të zgjidhen drejt shumë gjëra; jo vetëm bukuria e frazave e ndërtimi i tyre, por edhe gjerësia e leksikut, pastërtia e gjuhës etj. Kjo punë nuk mund të bëhet shkel e shko, duke lënë të kalojnë shumë gjëra, pra, nuk mund të lejojmë subjektivizëm, duhen bërë vazhdimisht përmirësinë. Ç'dua të them me këtë? Ismail Kadareja, fjala vjen, është shkrimtar i madh, ndaj në tekste zgjedhim pjesë nga më të mirat e veprave të tij. Krahas tij zgjedhim pjesë edhe nga veprat e shkrimtarëve të tjerë më pak të dëgjuar se ai, pra, jo të vëmë për të vënë, por pikërisht ato pjesë të atyre autorëve që kanë sjellë diçka të re në letërsinë shqiptare, në të gjitha gjinitë.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* E drejtë, shoku Enver. Pra, veçanërisht teksti i antologjisë nuk është parë në këtë këndvështrim, siç e shikoni ju, sepse, siç thashë, ai është hartuar kryesisht sipas kriterit tematik dhe jo që t'i përgjigjet plotësisht historisë së letërsisë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në historinë e literaturës shqipe nuk mund të futet, ta zëmë, Faik Konica. Ne të gjithë nuk jemi aspak dakord me sa thuhet përkëtë autor, lidhur me gjuhën. Ajo që ka mbetur nga shkrimet e tij, mund të themi se sot përbën një mënyrë shkrimi arkaikë.

Ose të marrim Fan Nolin. Për të shohim të bota-hen libra, ku vlerësohet si shkrimtari më i madh i Shqipërisë. Ai është marrë edhe me politikë, por dihet se në këtë fushë ai edhe ka gabuar. Noli ka mbajtur qëndrim të gabuar edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtata-

re. Këto gjëra dihen për të<sup>1</sup>. Megjithatë, po ta krahasojmë Fan Nolin, si nga ana e kontributit që ka dhënë në fushën e letërsisë shqipe, ashtu edhe në zhvillimin e gjuhës sonë, ai nuk mund të vihet në një nivel me Faik Konicën. Dihet se një kontribut të mirë ka dhënë Fan Noli edhe në përkthime.

Të gjitha këto rryma të zhvillimit gjuhësor e letrar mendoj se duhet të figurojnë në antologjitet tonë, por, natyrisht, në mënyrë të sintetizuar dhe duke e bërë në to çdo gjë të qartë, sepse, në botimet që kanë dalë, ka pasur pikëpamje të ndryshme qoftë edhe për të njëjtin autor. Ka pasur shkrimtarë e kritikë që kanë simpatizuar Nolin, të tjerë Konicën; disa janë admirues të Naimit e kështu me radhë mund të flitet për autorë të ndryshëm. Të gjithë këta janë frymëzuar nga këto figura. Natyrisht, secili prej tyre ka kontribuar në zhvillimin dinamik të gjuhës dhe të letërsisë sonë. Ata përfaqësojnë rryma, të cilat duhet të pasqyrohen drejt në tekstin e ri të historisë së literaturës shqipe. Natyrisht, ky pasqyrim duhet të paraqitet shumë më thjesht, kur është sfala për klasat më të ulëta të shkollave dhe ndryshe për klasat e larta të shkollës së mesme e për universitetin, duke e parë, si kurdoherë, çdo vlerësim për secilin nën prizmin marksist-leninist.

Kur flasin per historinë e letërsisë të çdo vendi, kemi parasysh se kjo nuk qëndron jashtë politikës. Kështu ndodh edhe me historinë e letërsisë së bor-

---

1. Më hollësish për këtë shih: Enver Hoxha, «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë» — Kujtime, f. 251-252.

gjezisë. Çdo prodhim letrar ruan karakterin politik të klasës që përsaqëson. Të marrim, për shembull, Viktor Hygojn. Ky, gjatë jetës, ka kaluar gati nëpër të gjitha idetë sunduese të kohës së vet. Që kur filloi të botojë në moshë të re, në veprat e tij ai ka përsaqësuar idetë korrente. Këto ide, te ky autor, kanë qenë vazhdimesht në lëvizje, në ngritje. Te Hygoi do të gjesh, për një kohë, pikëpamje e qëndrime pro Napoleonit të madh; pastaj, në veprat e tij ai del si mbrojtës i Napoleonit III; më vonë, hidhet në luftë për vdekje me këtë. Ca kohë Viktor Hygoi simpatizoi Lui Filipin; pastaj hyri në luftë edhe me këtë e u bë me Versajën; më vonë hyri në luftë me Versajën dhe u bashkua me komunarët. Pra, ai ka bërë një evolucion të madh me idetë e veta. Por, në të gjitha etapat e zhvillimit të këtyre ideve, Hygoi kurdoherë ka qenë progresist. Këtë evolucion e shikojmë tek ai edhe në çështjet fetare. Këto evolucionc të tij janë pasqyruar edhe në historinë e letërsisë. Ai flet edhe për të pasurit etj., por flet më shumë për njerëzit e varfër dhe shkruan aq bukur, sa mallengjehesh kur e lexon. Hygoi flet me simpati për luftërat nacionalçirimi të dha për revolucionin grek. Edhe në parlament (sc ka qenë deputet) diskutimet e tij janë jashtëzakonisht interesante; në to ai shpreh pikëpamjet e veta politike.

Me një fjalë, ne, marksistët, nuk duhet t'i lëmë këto gjëra të na i servirin si i dashka qejfi njërit apo tjetrit, që mund të jetë i apasionuar për këtë apo atë autor.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Edhe tekstet e shkollave bujqësore janë të prapambetura e nuk pasqyrojnë as.

përvojën tonë dhe as zhvillimin tonë, me një fjalë nuk përfaqësojnë realitetin. Në to flitet edhe për gjëra që janë kapërcyer. Ka edhe tekste të lëndëve të tjera të shkollave profesionale që duhen parë, si ato për makineritë e ndryshme, ku flitet edhe për makineri të cilat ne nuk i përdorim. Kështu del nevoja që t'u bëhet një përpunim rrënjosor gjithë këtyre teksteve.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Unë nuk e kuptoj pse duhet folur për lloj-lloj makinerish të veçanta në shkollat e mesme? Në këto shkolla mund të vihen në dukje parimet themelore shkencore të zhvillimit të mehani-kës, për shembull, pse parimet kryesore nuk ndryshojnë, duke filluar që nga makinat me djegie të brendshme apo makinat me avull e deri te raketa. Të gjitha këto janë ndërtuar mbi parime të njohura të zhvillimit të teknikës. Prandaj, të flitet, në këto tekste, fjala vjen, për makineritë e tekstilit që janë ndërtuar kështu apo ashtu, më duket se nuk e vlen.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Ashtu është, siç thoni ju, shoku Enver, por këtu ishte sjala për shkollat profesionale, për ato të karakterit ngushtësisht profesional. Për shembull, në tekstet e shkollës së tekstilit duhet të vihen edhe këto gjëra.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Por, ama, shkollat e përgjithshme nuk mund t'i kenë tekstet të mbushura me këto. të bëjnë historira të gjata për lloj-lloj makinerish. Në to, siç thashë, duhet të pasqyrohen ligjet e përgjithshme, por edhe perspektivat e tyre, sepse ka edhe makineri moderne. Do të vijë koha edhe të ne, në qoftë se nuk ka ardhur akoma, që t'i zëvendësojmë këto makineri që kemi me të tjera që punojnë me një

teknologji të re, shumë më të avancuar, prandaj në tekste duhet të flitet për këto që kemi, por edhe për parimet e teknikës e të teknologjive të reja bashkëko-hore.

Kjo është një punë shumë e komplikuar. Vërejtje ne mund të bëjmë, por për zbatim kërkohen studime të veçanta, të thella. Me këto tekste mësojnë qindra e mijëra nxënës e studentë. Ne shpesh nuk i organizojmë e nuk i planifikojmë mirë këto punë kaq të rëndësish-me. Për shembull, i themi një pedagogu: «Shko të ja-pësh katër orë mësim në universitet!». Por atij nja katër orë të tjera i duhen për t'u përgatitur dhe i venë kështu tetë orë. «Por ti, i themi atij, do të më bësh edhe një libër për llojet e makinerive që kemi në Shqipëri!» Përveç kësaj, ai do të vejë edhe një muaj në punë fizike; do të vejë edhe në përgatitje ushtarake; ai mund të merret edhe me punë shkencore. Dhe ky, duke mos pasur kohë të mjaftueshme për të gjitha këto, do të marrë andej e do të marrë këtej, sepse është e pamundur t'i bëjë të gjitha sa i kërkohen brenda vtitit. Që t'i bëjë ato siç duhet, siç e kërkojnë nevoja dhe shkenca marksiste-leniniste, duhet t'i lësh një kohë të mjaftueshme. Kështu edhe për tekstet shkollore. Dikur, në një kohë, shteti ka pasur të drejtë të kërkonte një punë tepër intensive e t'i ngarkonte shumë njerëzit se ka pasur nevojë. Por tash që shteti është në një situatë më të mirë, duhet të marrë një çikë rrugë më të drejtë kjo punë dhe ta kapërcejmi këtë praktikë të nxituar.

Kemi bërë zakon që nxjerrim në pension edhe njerëz me një eksperiencë të madhe. Mbrëmë ma thanë këtë për një doktor të njohur. Po është e drejtë dhe na

leverdis kjo? E kemi thënë dhe kemi vendosur që njerëzit, kur u vjen koha, të dalin në pension. Por, nuk është e drejtë për të tillë njerëz, që janë në fazën më të kartë të diturisë e të pjekurisë së tyre. Pikërisht tani ma nxjerr në pension dhe e zbaton shablon ligjin?! A nuk mund të interpretohet kështu fakti që ti nxjerr në pension një nga mjekët në të shqar në fushën e tij?! Dhe ç'do të bëjë ai tashti? Të pushojë? Jo, atë ne mund ta thërresim të na bëjë konsulta. Ne mund ta heqim nga shef katedre, sepse atje do të sjellim të rinj, por ai është shkencëtar. Edhe 80 vjeç të vejë shkençëtar, ku ta gjesh, bile ta mbash me nderim e me respekt.

Si ky duhet të ketë edhe të tjerë. Ja, të tillë njerëz mund të jenë autorët dhe projektuesit e këtyre librave që folëm, ndryshe nuk ka si bëhet një gjë e tillë.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Njerëz të tillë, të moshuar, nuk është e thënë që të jenë të ngarkuar me nga 24 orë mësim në javë. Sikur edhe disa leksione në vit të venë të jepin ata, prapë kjo është një gjë e madhe.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po si nuk është gjë e madhe?! Jo vetëm të jepin disa leksione, por edhe ndihma të tjera duhet të marrim nga këta njerëz. Të bëjë profesor Preza një libër, siç ka bërë deri sot, kjo ka rëndësi të madhe për ne. Prandaj, këto që bëhen, nuk janë të drejta, nuk shikohen mirë. Na fal shoku Ramiz, se e kapërcyem temën e bisedës.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Për të gjitha këto tekste që folëm, në mbledhje u vendos që të ripunohen dhe një pjesë kanë filluar të ripunohen.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të paktën këto që do të ribotohen, të korrigohen.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Për këtë çështje kjo porosi u dha edhe në mbledhje.

Aty u ngrit edhe problemi lidhur me tekstin e «Historisë së Partisë», që e studiojnë në shkollat e mesme. U tha se teksti është shumë i rëndë dhe nxënësit e kësaj moshe ndeshen me nacione që i kanë vështirë t'i kuptojnë, se kanë të bëjnë me probleme të karakterit ideologjik. U dha mendimi nëse mund të bëhet një tekst më i shkurtër nga ai aktuali për qëllime shkollore.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po edhe mund të bëhet, pse të mos bëhet? Si thua ti Hysni?

**SHOKU HYSNI KAFO:** Edhe unë kështu mendoj, shoku Enver, të bëhet një tekst më i lichtë, ku të dalin gjërat më esenciale, që t'u mbeten në kokë nxënësve. Pastaj, kur të rriten, do ta kenë këtë bazë për të ecur më përpara. Kështu do të jetë më e drejtë.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Unë do ta diskutoj këtë problem me shokët e Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste, sepse ky tekst mendoj të punohet nën udhëheqjen e institutit tonë.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Tekstet e shkollave është e domosdoshme të dalin me emra autorësh?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Edhe mund të dalin. Po ata që punojnë në degën e teksteve në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës, çfarë njerëzish janë?

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Janë specialistë të lëndëve të ndryshme, kryesisht të rinj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Por këta, që të bëhen

specialistë, duhet të jenë njerëz të njohur, që të kenë njëfarë përvoje.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Pikërisht edhe unë e ngri-  
ta në mbledhje këtë çështje që aty duhet të jenë njerë-  
zit më të zotë dhe me eksperiencë të madhe, po më  
thanë që nga pikëpamja profesionale janë të aftë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* E di pse e them këtë?  
Le të vijmë prapë tek trajtimi i kuadrit që del në  
pension. Unë nuk e di tani gjendjen shëndetësore të  
Lele [Vangjel] Gjikondit.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Ai është i sëmurë, në  
shtëpi, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mirë, por të supozoj-  
më sikur Lele Gjikondi të ishte në gjendje të mirë,  
megjithëse i kaluar nga mosha, në pension, se është  
edhe më i vjetër nga unë. Por, ta zëmë se ai ka forca  
e kapacitet fizik aq sa kam edhe unë, për shembull.  
Ky mund të thotë fjalët më të mira për matematikën  
dhe të japë mendime të çmuara. Ai mund të thotë  
sjala vjen: «More djema, unë e di zhvillimin e arsimit  
në vendin tonë, mbasi kam qenë vetë pedagog mate-  
matike. E marr me mend se dijet tona tash kanë bërë  
një hop, por ju duhet ta kapërceni këtë hop, prandaj,  
në këtë tekst, mendoj se nuk duhet të vihet kjo, kur-  
se kjo tjetra duhet vënë». Mirëpo, për aktivizimin e  
njerëzve të tillë nuk interesohet njeri. Këtë e them me  
kompetencë, sepse kam pyetur për disa nga këta dhe  
jam revoltuar me qëndrimet që mbahen ndaj tyre. Pu-  
na ka arritur deri atje sa të më shkruajë mun Shaban  
Arra nga Shkodra, një nga pjesëtarët e vjetër të Luftës  
Nacionalçlirimitare në atë rrëth, dhe më qahet: «Shoku

Enver, të lutem, ma kanë lënë vajzën pa punë!». E po kjo?! Çfarë kuptimi kanë këta shokë që punojnë atje? Në qoftë se nuk e njeh njëri nga sekretarët e komitetit të Partisë, që nuk është shkodran, po tjetri nuk e di kush është Shaban Arra, që ka qenë 35 vjet profesor?

**SHOKU HAKI TOSKA:** Atë e njohim edhe ne më larg, jo shokët e Shkodrës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** E njohim sigurisht, se ai ka qenë në Këshillin e Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimitar. E kam fjalën këtu që këta njerëz, lëre që nuk ua vënë veshin fare, por i nxjerrin edhe në pension dhe hiqen sikur të kenë bërë një punë të madhe duke i barazuar ata me njerëz të zakonshëm. Pra, ne nuk mund t'i përmirësojmë tekstet e shkollave pa aktivizuar të gjithë, duke përfshirë edhe këta njerëz me një eksperiencë të madhe.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Tekstet, veçanërisht ato të lëndëve speciale, në shkollat profesionale e kanë një të metë që shpesh me to bëhet një punë e imbyllur, në ministri apo edhe në fakultetet. Tekstet e inxhinierisë së ndërtimit, për shembull, nuk mund t'i bëjnë vetëm dy inxhinierë që janë pedagogë; për këto duhet të aktivizohen edhe punonjës nga Ministria e Ndërtimit, e cila duhet të jetë e interesuar direkt për to. Çdo dikaster duhet të jetë i interesuar për tekstet e profilit të vet.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Për të ilustruar këtë që the ti, tipik është rasti me hidrocentralin e Smokthinës. Fajin për gabimet që dolën atje ia hedhin universitetit. Po pse? Dekani e shefi i katedrës edhe mësime jepnin, edhe fakultetin e katedrën e drejtontin,

edhe projektin e këtij hidrocentrali e bënë, edho plot punë të tjera kryenin. Po të tjerët, që projektojnë hidrocentrale, ç'bëjnë? «Po ja, këtë hidrocentral ua dharmë atyre», thonë ata të ndërtimit. Mirë bëtë që ua dhatë, por ta studioni atë, se dhe ata kanë bërë vërejtje, por këta tuajt nuk kanë marrë pjesë në diskutimin e tij. Osc, në qoftë se kanë marrë pjesë, atëherë janë edhe ata përgjegjës. Atëherë mos bëni fajtorë vetëm këta të universitetit. Pra, duhet bashkëpunim e lidhje e ngushtë.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Për të ilustruar idenë e shokut Hysni: edhe në mbledhjen e ministrisë u theksua që për hërtimin e teksteve të lëndëve profesionale, veçanërisht për ato të universitetit dhe të specialiteteve të veçanta, duhen tërhequr më shumë bashkëpunëtorë të jashtëm, jo pedagogë, por specialistë të prodhimit, të cilët e njojin mirë praktikën, jetën. Këta, duke marrë pjesë në përpunimin e teksteve, do të sjellin aty edhe përvojën tonë, realitetin tonë konkret, duke mbushur kështu një boshllék të madh, veçanërisht në punën e fakulteteve të universitetit ku në mjaft raste shkencat jepen të shkëputura ngajeta, nga përvoja e ndërtimit tonë socialist.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Çështja e shfrytëzimit të përvojës dhe të aftësive të kuadrove të vjetër e të zotë ka një rëndësi të madhe, veçanërisht për kuadrot e rinj. Për shembull, sikur t'i rekomandonim Teftës<sup>1</sup> që në punën e saj t'i rezervojë një kohë, çdo javë, kon-

---

1. Tefta Cami.

takteve me njerëz, me kapacitete të arsimit, për probleme të ndryshme. Ajo nuk ka mundësi t'i njohë të gjitha fushat, se nuk mund të jetë enciklopediste. Për disa problemi, për shembull, thërret dhë njerëz nga më kompetentët e nga më të mirët, të rinj ose të vjetër, dhe bisedon me ta dy-tri orë të tëra. Me modesti u kërkon ndihmë në këtë ose në atë çështje, dëgjon mendimet e tyre se çfarë duhet bërë për këtë ose atë problem dhe se ç'masa mund të merren për përmirësimin e gjendjes.

Sikur ta bëjnë këtë Tefta dhe Thenija [Thomai], si dhe ministrat e tjerë, do të ketë shumë vlerë. Në këtë mënyrë do të aktivizohet një masë e madhe njerëzish me përvojë e me kulturë; këta do të shohin e do të binden konkretisht se kanë mundësi të japid dituritë e tyre dhe të ndihmojnë për çuarjen përpara të punës. Kur të shikojnë se mendimet e tyre po zbatohen, tek ata do të ngjallet edhe besimi se po pyjet nga ministri, pra, po vlerësohen për përvojën e astësitë që kanë.

Mendoj se këtë gjë duhet t'ua rekmandojmë ministrave. E di që këtë e bën Pali [Miskaj], por dyshoj nëse bëjnë kështu ministrat e tjerë, sidomos ai i Shëndetësisë, për shembull, kur mendon që në këtë sektor kemi gjithë këto kapacitete, jo vetëm këtu në Tiranë, por edhe në qytete të tjera. Në Korçë, për shembull, ka akoma tre a katër mjekë të vjetër, të cilët kanë mbaruar universitetin që më 1936, domethënë, kanë plot 40 vjet eksperiencë. Dhe ata nuk kanë qenë mjekë të dobët.

Të marrim si shembull Taqi Skëndin e Shefqet Ndroqin që janë marrë për një kohë të gjatë me së-

mundjen e tuberkulozit. Këta njerëz jo vetëm duhen aktivizuar për t'i pyetur dhe për konsulta, por të nxitten edhe për të shkruar, sepse, pavarësisht se kanë qenë patologë, për disa sëmundje, ata mund të janë thelluar, sidomos kur vendi, para Çlirimit, ka kaluar momente krize në disa sëmundje. Në këto fusha ata mund të kontribuojnë shumë. Pra në këtë drejtim, ne duhet të ndjekim një politikë shumë më të gjerë dhe kjo të mos jetë një politikë formale, burokratike, por efektive.

Për një problem të tillë të rëndësishëm, siç është ai i teksteve shkolllore, duhet të interesohen e të preokupohen më shumë shokët e ministrisë e sidomos zëvendësministrat e rinj.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Mos duhet parë struktura e Ministrisë së Arsimit e të Kulturës apo edhe e ministrive të tjera?

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Ata të Ministrisë së Arsimit e të Kulturës i kemi ngarkuar ta shikojnë këtë çështje dhe po e studiojnë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duhet, si nuk duhet! Atje kishim njerëz që i kanë deformuar edhe strukturat duke e ndërtuar punën sipas koncepteve të tyre. Njëkohësisht, edhe vetë zhvillimi i punëve kërkon të bëhen ndryshime që t'u përgjigjen situatave të reja. Tani jemi në një etapë tjetër. Duhet parë mirë kjo çështje në organizimin e punës në ministri. Çështjen e teksteve shkolllore, për shembull, të mos ia lëmë vetëm një zëvendësministri dhe zëvendësministrat e tjerë të mos interesohen, se tekstet janë si buka, baza e punës për shkollat.

*Pastaj biseda vazhdoi rreth problemeve që ngriti*

*shoku Hysni Kapo, duke informuar për bisedën që kishte zhvilluar me ministren e Bujqësisë, Themije Thomain, lidhur me fushatën e korrije-shirjeve dhe me organizimin e strukturës së ministrisë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pasi të vendosim organizimin e ri, që mendohet, të bëhet kujdes që në çdo drejtori të Ministrisë së Bujqësisë të vihet nga një drejtor i mirë. Për këtë të merret në analizë çështja e disa kuadrove që punojnë tani atje nëpër drejtoritë.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Me aprovinin e strukturës së re mendoj se duhet të bëhen medoemos ndryshimet përkatëse edhe në kuadrot. Unë i dhashë porosi Themijes që të sjellin në aparatin e ministrisë kuadro nga baza, si kryetarë kooperativash, agronomë e zooteknikë, pra, njerëz të tillë që nuk kanë punuar në aparate, por që vijnë drcjtpërdrejt nga prodhimi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Dakord, nga prodhimi të vijnë. Në këtë çështje duhen pasur parasysh dy gjëra:

E para, të bëhet kujdes mbi mënyrën se si do të gjenden kuadrot e mirë. Në qoftë se lihet në dorë të drejtorit të ndërmarrjes bujqësore për të gjetur dy agronomë ose një veteriner etj., ai, në bashkëpunim me sekretarin e Partisë, ka të ngjarë të të japë nga kuadrot më të dobët. Këtë ta keni mirë parasysh se ata nuk duan që të dobësojnë sektorin e tyre, pra, ata e shikojnë problemin nga ana sektoriale.

E dyta, duhet pasur parasysh që sektorët e kuadrit në rrethe shpesh janë prekur nga një frysni zyrtare e burokratike, prandaj dokumentet që ata kanë nüpër zyra nuk i përgjigjen gjithmonë realitetit. Në dokumentet e Partisë të një rrethi një njeri mund të figu-

rojë shumë i mirë; shumë i zoti dhe aktiv, por, në fakt, ai mund të mos jetë i tillë. Pra, në qoftë se do të bazohej vetëm në letrat, nuk do të vijnë njerëz të përsh-tatshëm. Natyrisht, edhe ato duhet të merren në kon-sideratë, por, po të mos mbahen parasysh këto të dy gjëra, do të pengojë fryma që ekziston e që duhet luf-tuar. Prandaj Miti Bozoja, Themija dhe katër zëve-ndësministrat e Bujqësisë të bëjnë një kalim në tërë Sinqipërinë, të venë për të parë njerëzit, për të biseduar, për të folur e për të dhënë mendime për strukturën e ministrisë dhe si e kanë organizuar fushatën e kor-je-shirjeve, masat që kanë marrë për këto apo për ato probleme dhe t'i lënë të flasin; t'u bëjnë pyetje që të shohin e të njohin se ç'është ky apo ai dhe pastaj të vijnë këtu e të bëjnë bilancin; të raportojnë kush u ka bërë përshtypje. Pas kësaj të pycsin kryetarin dhe se-kretarin e Partisë të kooperativës apo të ndërmarrjes bujqësore, për secilin. E kam fjalën që kuadri të njihet mirë.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Edhe unë këto u thashë, shoku Enver, se këto çështje duhen zgjidhur shpejt. Të térheqim kryesisht nga rrëthet e mëdha, se ato kanë më shumë kuadro.

**SHOKU HAKI TOSKA:** Edhe nga kooperativat bujqësore të përparuara.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Posi, edhe nga koope-rativat e përparuara dhe pikërisht në ato që kanë më të vërtetë potencial ekonomik dhe që e kanë treguar me prova se kanë dhiënë rezultate. Atje ta vënë gishtin.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Themija më foli për përshtypjet e saj të para nga mbledhja e byrosë dhe e

organizatës së Partisë së dikasterit. Më bëri përshtypje, tregoi ajo, se më tepër diskutohet se si punojnë të tjerrët dhe nuk shikojnë veten. Për të tjerrët, thiksoi Themija, gjuha u pret, e kanë brisk, por nuk shikojnë më parë punën e tyre.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kjo üshtë pasojë e konceptit të «rolit të këshilltarit», që dominonte në Ministrinë e Bujqësisë. Sipas këtij koncepti, i dërguari i ministrisë vete poshtë, shikon, kontrollon, këshillon, vetëm kritikon dhe kthehet e mendon se nuk ka përgjegjësi për ato që ndodhin. Prandaj duhet të vendoset sa më parë struktura e re, se kjo ka rëndësi. Të zgjidhen menjëherë kuadrot më të mirë për drejtorë. Të vendoset edhe për kompetencat. Secili të mbajë përgjegjësi për ato që i takojnë dhe të mos vejë më për çdo problem te ministri ose zëvendësministri. Udhëzimet që jep secili, do të dalë më vonë nëse janë dhënë drejt apo gabim, nga informacionet që do t'i vijnë ministrisë. Atëherë ajo do t'i kërkojë drejtorit se çfarë udhëzimi ka dhënë. Në rast se drejtori ka gabuar, do ta mësojë si ta korrigjojë udhëzimin.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i takimit ditor të sekretarëve të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

## **MBLEDILJET TË JENË TË ORGANIZUARA MIRË DHE LUFTARAKE**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**24 maj 1976**

**SHOKU HYSNI KAPO:** Pardje ishte mbledhja e aktivit të punonjësve të prapavijave të ushtrisë. Në këtë aktiv u mbajtën dy referate: një për çështjet ekonomiko-financiare e administrimin material në ushtri dhe tje tëri për armatimin, municionet dhe mirëmbajtjen e teknikës ushtarake. Në këto dy referate bëhej një analizë e mirë, kishte frymë kritike dhe vlerësohej drejt puna.

Në aktiv doli se kuadrot e sektorit të llogarisë të prapavijës nuk janë të kualifikuar e se për punën e tyre nuk interesohen komandat dhe Partia, ashtu siç bëjnë për stërvitjet dhe për problemet e tjera.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ky është një qëndrim i gabuar, shumë i gabuar, që komandanti, komisari ose shtabi të mos interesohen për çështjet financiare, për ushqimet, për veshmbathjen apo për gjendjen materiale të repartit. Ata që nuk tregojnë kujdes për këto, nuk janë komandantë e komisarë të rregullt.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Ata prapavijën nuk e quajnë si një pjesë përbërëse dhe të pandashme të gatishmërisë luftarake.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Komanda duhet të interesohet, më falni, deri edhe për ambientet higjenike të ushtrisë; të vejë t'i kontrollojë ato për t'i parë si janë ndërtuar dhe a janë të përshtatshme apo jo dhe jo më pör prapavijën!

Kjo ka rëndësi shumë të madhe se ka të bëjë me shëndetin e ushtarakeve. Po të shikohen me kujdes, edhe ambientet e hoteleve, që janë hotele, vëren se ka papastërti. Po në ushtri?!

Po që se ushtarit nuk i venë në rregull sot, në kohë paqejc, buka, mishi ose zarzavatet, në kohë lufte ato mund të mos i venë fare. Pra, na rrofshin depot që kemi! Furnizimi duhet t'i vejë ushtrisë në rregull jo vetëm sot, por edhe nesër në luftë, në breshërinë e plumbave e në shpërthimin e bombave.

A u bë mbledhje pune me shokët e prapavijës të njësisë, para se të bëhej në shkallë ushtrie, ku të mos merrnin pjesë të gjithë kuadrot dhe ata që nuk janë të këtij sektori? Se po vajtën të gjithë, atëherë ndodh që ata që nuk kanë lidhje me këtë sektor, të venë në mbledhje sa për të qenë e të myllin sytë ose të gogësijnë. Nuk na duhet një punë e tillë. Në këto mbledhje të venë ata shokë që duhet të venë, si sekretarët e Partisë, komisarët, komandantët dhe përgjegjësit e prapavijave pör të dhënë llogari.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Mbledhjet e gjera, sikurse e theksuat edhe ju, shoku Enver, nuk na japin rezultat. Në mbledhje të tilla shpesh gjen disa kuadro

që u është bërë si profesion puna e mbledhjeve, duke shkuar nga një mbledhje në tjetrën dhe nuk vijnë ata kuadro që merren direkt me problemin, që e njojin atë e mbajnë dhe përgjegjësi. Pra, në këto raste ka formalizëm.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mbledhje të zgjeruara, mendoj unë, duhen bërë vetëm në ato raste kur jepet një orientim apo direktivë, ndërsa mbledhjet e punës duhet të janë të ngushta dhe në to të bëhet një analizë e thellë ku të djersijnë njerëzit. Me një fjalë, kur shokët të vijnë në këto mbledhje, të sjellin aty eksperiençën e punës së tyre, me tërë të mirat dhë të këqijat, si në rastin konkret që ishte një aktiv i ushtrisë ku u diskutua për prapavijat e saj.

Këto mbledhje janë si puna e lojërave ushtarake; që t'ia arrijnë qëllimit, duhet të fillojnë nga më të voglat për të vajtur në më të mëdhatë. Domethënë, duhet më parë të dimë se si i kemi vendosur gjërat në qilarin e shtëpisë sonë që, pastaj, të mund të vemi në mbledhje dhë të raportojnë e të kritikojmë edhe për qilarët e të tjerve. Kur unë nuk di gjendjen e qilarit tim, domethënë nuk di se ç'bëhet atje, patjetër që nuk kam se ç'li sjell në mbledhje, por do të them disa gjëra të përgjithshme, se ka dhë të meta etj. Pra, duke mos e njojur mirë gjendjen e sektorit që drejtojmë, nuk jemi të zotët as të nxjerrim konkluzionet e nevojshme përsë na dolën këto gjëra: pse kemi vjedhje në repart, nga cilët na janë bërë ato, cilët janë këta njerëz që kanë vjedhur, ç'origjinë kanë, ç'edukatë kanë marrë, ç'kontrolle kemi ushtruar ne mbi ta, në ç'drejtime kanë vje-

dhur etj., me qëllim që, siç thotë një fjalë popullore, t'i nxjerrim ujin këtij problemi.

Pasi ta keni analizuar thellë çështjen, pastaj ve-  
mi edhe në mbledhjen e aktivit e diskutojmë. Në këtë  
mbledhje nuk mjaftohemi vetëm me dy raportet, por  
i themi të gjitha ato që kemi nxjerrë për punën në  
njësitë tona. Aty u themi shokëve se çfarë na kanë  
ndodhur në punën tonë dhe q'masa kemi marrë.

Kështu, mendoj unë, nga sa më raportohet, shoh që  
«mbledhjet e mëdha» janë pa bukë.

Duhet parë edhe organizimi i këtyre mbledhjeve,  
sa japid, si japid dhe të nxjerrim eksperiencë. Të lar-  
gohem nga rutina e tö mendohemi mirë se kur duhet  
bërë dhe kur nuk duhet bërë mbledhje e zgjeruar.  
Këto mbledhje, në përgjithësi, ndiqen me vëmendje  
nga pjesëmarrësit, por ka raste që edhe nuk ndiqen.  
Kur në këto mbledhje marrin pjesë përgjegjësit dhe  
vartësit e tyre, këta të fundit presin të flasin eprorët,  
duke menduar se ata marrin pjesë në to vetëm për të  
dëgjuar se çfarë do të thotë përgjegjësi i tyre. Por çfa-  
rë mund të thotë ky përgjegjës? Ai mund të diskutojë  
edhe disa orë po të dojë, por do të flasë në vija të për-  
gjithshme.

Disa bëhen edhe kuriozë se mos thotë ai ndonjë  
gjë të re. Kështu, ngaqë nuk vijnë të përgatitur, ndoch  
që kur flasim për rrëthimin kapitalist disa herë vëmë  
re se nuk e njojin sa duhet dhe nuk lufthet siç duhet  
kundër këtij rreziku. Prandaj them se duhet punuar me  
kujdes me njerëzit. Kur të vijnë në mbledhje, nëpërmjet  
eksperiencës sonë, t'u japim mundësinë që ata

të mund të arrijnë të bëjnë drejt konkluzionet e nevojshme.

Mund të ndodhë, për shembull, që disa nga ata që marrin pjesë në mbledhje të jenë pak a shumë në korent të problemit që po diskutohet, por mund të ketë aty edhe nga ata që nuk janë në korent. Këta të fundit do ta dëgjojnë me kujdes atë që referon, me qëllim që të njihen me problemin. Por, që të arrijnë një konkluzion sa më të drejtë, ai që referon duhet të tërheqë vëmendjen e tyre në problemet më kryesore. Vëtëm atëherë, të tjerët do të reflektojnë e do të dinë ku të përqendrohen në diskutimet e tyre, ndryshtë do të flasin për gjëra të përgjithshme. Prandaj thashë se ka shumë rëndësi që t'i mësojmë njerëzit për të bërë vëtë konkluzione në mbledhje dhe të vijnë aty me probleme sa më konkrete. Kështu, kur këta të ngrihen e të diskutojnë, të tjerët do t'i dëgjojnë me kujdes e do të mbajnë edhe shënimë. Ne duhet t'i mësojmë njerëzit se, kur venë në mbledhje me diskutimin në xhep, të përgatitur që më parë, mund të ndodhë që ai diskutim të rrëzohet dhe nuk e vlen të lexohet, mbasi aty problemi u trajtua ndryshtë. Megjithatë, ata që janë përgatitur më parë, përsëri mund të ngrihen të diskutojnë, por duke u mbështetur në ato drejtime që tërroqi vëmendjen mbledhja. Ndonjëri mund t'i kishte të shënuara në diskutimin e tij këto probleme, por vetë zhvillimi i mbledhjes bëri që t'i formulojë ato ndryshtë, duke marrë shembull nga shokët e tjerë, të cilët sollën një eksperiencë shumë të mirë.

Çështjen e kam këtu që, po të organizohen në këtë formë mbledhjet, do të jenë me të vërtetë me bukë dhe

luftarake dhe jo si disa të tjera ku flitet në mënyrë të përgjithshme. Të mos ndodhë, si në ndonjë mbledhje, ku ngrihet e diskuton shefi i njësisë me fjalë të përgjithshme, duke grirë si mulliri pa kokrra, megjithëse problemi që po diskutohet, për shembull, i prapavijave të ushtrisë, ka rëndësi të jashtëzakonshme edhe tanë, në kohë paqeje, por rëndësia e tij irritet njëqind dhe një mijë herë në kohë lufte. Duhet të mos harrohet fakti që edhe dyqani ose magazina e shtetit në rrethështë nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e gjithë popullit, i cili kërkon llogari: «Pse nuk e ke këtë send ose ç'ë bëre atë; pse e ke sheqerin të lagur ose pse buka është e djegur ose e papjekur mirë?» etj. Jo vetëm kaq, por për këto konstatime, i vete edhe një kontroll punëtor etj. Me një fjalë, kur dyqani apo magazina e shtetit është nën «predhat» e nën kontrollin e popullit, aq më tepër prapavija në ushtri duhet të jetë nën një kontroll shumë më të rreptë. Por, në qoftë se komandanti, komisari apo sekretari i Partisë i lajnë duart dhe organizata-bazë nuk e shen të domosdoshme që t'i vëré rëndësi këtij problemi kaq të madh, atëherë prapavija na mbetet në dorën e të paaftëve apo të pandërgjegjshmëve, të cilët edhe mund të vjedhin apo të bëjnë matrapazllëqe.

Pa dyshim, përmirësime ka, por duhet të ketë edhe më shumë. E gjithë puna e Partisë që është bërë në ushtri dhe zbulimi e shpartallimi i veprimitarisë armiqësore i ka shkundur njerëzit, i ka bërë më të ndërgjegjshëm, të gatshëm për të kryer çdo detyrë, se tashti perspektivën e shohin më të qartë: në ushtri jemi për t'u stërvitur e për t'u organizuar vetë, por për të për-

gatitur edhe gjithë popullin tonë për mbrojtje. Kjo pune aktualisht bëhet në një shkallë më të kualifikuar dhe, sa më tepër që të kalojë koha, aq më shumë do të forcohet. Por që të forcohet, duhen marrë masa të gjithanshme.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Më parë, shkelja e rregullave dhe e ligjeve në ushtri bëhej duke filluar që nga titullarët e Ministrisë së Mbrojtjes e drejtoritë e saj e deri te komandat e njësive, duke vënë dorë si patë keq në shpërdorimin e pasurisë së popullit. Kurset tani u është prerë rruga veprimeve të tillë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në qoftë se dikush bën nga këto veprimet, ai vihet para përgjegjësisë. Për këtë, si kudo, edhe në ushtri duhet të ketë administrim të mirë dhe kontroll të madh, ndryshe mund të ndodhin përsëri shpërdorime.

*Batohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verball i takimit ditor të sekretarëve të KQ të PPSH, që pëndet në AQP*

# DREJTUESIT E RRETHIT T'I SHOHIN PROBLEMET SA MË KONKRETISHT DHE T'I ZGJIDHIN DREJT E NË KOHË

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH<sup>1</sup>*

25 maj 1976

Në këtë raport shuhet se si punojnë, si mobilizohen këshilltarët etj. Kemi parë edhe raporte të tjera për këto probleme, por unë do të dëshiroja të na thotë konkretisht shoku kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Korçës si e organizojnë punën drejtuesit e komitetit në marrëdhënie me sektionet dhe këto të fundit me bazën. Si paraqiten raportet, si merren vendimet dhe si zbatohen. Unë, shoku Jani [Miho]<sup>2</sup> nuk e dua përgjigjen në vija të përgjithshme, nuk kërkoj të na flasësh për problemet ekono-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi punën që bëhet në rrethin e Korçës për aktivizimin e këshilltarëve».

2. Në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Korçës, i ftuar në këtë mbledhje.

mike, për të cilat je specialist, por dëshiroj të na tregosh diçka sidomos si punon seksioni i arsimit, si raporton ai te ju dhe si vepron për çështjet që përfshihen në kompetencën e tij. Si punojnë shefi i sektionit të arsimit dhe inspektorët e këtij sezioni me këshilltarët, me mësuesit, me drejtoret e shkollave të fshatrave e me të tjera? Pra, nuk pyes vetëm për marrëdhëniet e punonjësve të sektionit të arsimit me këshilltarët, se me këta, megjithëse e ka për detyrë, të siguroj unë që ky sektion s'punon fare.

*Pas përgjigjeve rreth këtyre pyetjeve, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Këto që po' na thua këtu janë parime, të shprehura edhe në ligjet, që unë dhe shokët i dimë. E përsëris që duam të na thoni si punohet konkretisht. Për shembull, të na thoni ç'bëhet përpara se të shkojë shefi i sektionit në mbledhjen e analizës së çdo viti shkollor. Nga ato që na the ti, nënkuptohet se shefi i sektionit merr të dhënat nga shkollat, i analizon, i sintetizon dhe nxjerr vetë konkluzione në shkallë rrethi, pra nuk ju pyet fare ju. Përse komiteti ekzekutiv nuk i shqyrton të tëra çështjet arsimore në fund të çdo viti shkollor? Kur është fjala për bujqësinë, keni analizuar probleme të vecanta gjatë vitit dhe përsëri e analizoni bujqësinë në fund të çdo viti. Ti thua që nuk i analizoni çdo vit problemet arsimore. Mund të na thuash, cilat probleme të vecanta arsimore keni analizuar në komitet? Po na thuaj konkretisht, si e analizuat ju në komitet, për shembull, çështjen e edukimit nëpërmjet procesit mësimor.

Në këtë analizë duhet të shikoni jo vetëm eduki-

min ideologjik e politik, por edhe atë teknik dhe këto t'i shikonit rregullisht e jo vetëm një herë në hënë! Pra, si udhëheq seksioni si organ bazë i specializuar i administratës shtetërore? Si e organizojnë punën ata 11 inspektorë që ka ai? Të mos zgjatemi shumë, po të flasim konkretisht. Ti thua se ata kanë ndarje pune sipas dy kritereve: në bazë të profilit dhe të zonës. Atëherë si e përballojnë punën për arsimin në gjithë rrëthin e Korçës këta inspektorë? Flasim vetëm për punën e inspektorit. A e bëjnë me të vërtetë aktivizimin e drejtuesve të shkollave e të aktivistëve të tjera, ashtu siç the ti? Këtë pyes unë, se në teori mund të thuhen shumë gjëra se si mund të bëhet puna më mirë. Mund të na thuash konkretisht sa drejtorë shkolle dhe mësues të zonës së tij ka thirrur në mbledhje ose në takim një inspektor arsimi dhe për ç'probleme i ka thirrur? Je interesuar ndonjëherë për këtë çështje? A e ke ndjekur ti problemi nëse venë inspektorët e arsimit për inspektim në zonë, sa rrinë, si e organizojnë punën atje?

Për këto çështje interesohem edhe unë e jo më ti. Mua më preokupon çështja se ç'bën inspektori gjatë atyre ditëve që shkon në bazë. Ti duhet të dish çfarë bën ai atje, si e organizon punën etj. Ja, për shembull, ke vajtur ti shumi herë në mbledhje me punonjësit e bujqësisë, kur ishte shoku Ilo Prifti drejtor i ndërmarrjes bujqësore? Sigurisht, ke vajtur. Po në mbledhje të ndonjë sektori të kësaj ndërmarrjeje ke vajtur? Siç thua dhe vetë, ke vajtur. Edhe kur agronomi ka shtruar ndonjë çështje për panxharin, jam i bindur që ti ke vajtur për ta dëgjuar. Po pse nuk ke vajtur ndonjëherë

në ndonjë zonë, ku inspektori i arsimit shkon e punon ta zëmë 4 ditë, që të shikosh se ç'punë bën ky? Pse për problemet e bujqësisë ke vajtur në bazë dhe për ato të arsimit jo? A raportojnë inspektorët përsë shkojnë në zonë? Ti thua se raportojnë në seksion dhe te zë-vendeskryetari i komitetit që mbulon arsimin. Po këta vijnë e të raportojnë ty? Ti duhet të shohësh si punojnë shokët inspektorë të arsimit që ka vënë shteti, të shikosh edhe çfarë problemesh ngrihen në shkolla, qofshin këto teknike, të asimilimit të lëndëve mësimore nga nxënësit apo ankesa për tekstet që duhen përmirësuar etj. Për këto interesohemi ne, kurse ato që na the ti janë gjëra të përgjithshme. A mund të na thuash konkretisht: Ka probleme lidhur me tekstet e reja? Ka mësues që thonë se ky apo ai tekst është i gabuar, nuk është i plotë, ose është i rëndë për nivelin e nxënësit? Këto duam të na thuash këtu.

Ti thua se e ke të vështirë të përgjigjesh për këtë. Po unë për këtë çështje interesohemi dhe mund të them se veçanërisht për lëndën e matematikës ka mjaft ankesa, se mësuesit nuk marrin parasysh nivelin e nxënësve dhe qysh në klasën e tetë i ngarkojnë këta me «matematikë speciale»!

Unë, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, kam të dhëna për disa çështje që ti duhet t'i dish më mirë, se je atje në bazë. Ka akoma tekste që bëjnë shumë fjalë për potencialin ekonomik të Bashkimit Sovjetik, të Ingliterrës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Që nga klasa e tetë deri në klasën e dhjetë shpjegohen këto gjëra! A thua se neve na u prishka puna sikur të mos dinë nxënësit tanë se cili është po-

tenciali amerikan për derdhjen e çelikut! Ç'rëndësi ka kjo për nxënësit tanë? Ka dhe shumë probleme të tjera që duhen parë në arsim, por që unë nuk dua t'i përsëris këtu.

Këto çështje duhet që komiteti ekzekutiv, kryetari dhe zëvendësit e tij t'i ndjekin, se ndryshe pastaj një mëngjes do të dalë, sikurse doli, që ish-ministri i Arsimit dhe i Kulturës, Thoma Deliana, nuk çante kokën fare për këto dobësi. Po pse nuk çanin kokën Thoma Deliana, Koço Theodhosi ose ai tjetri për këto punë? Sepse kishin gjetur shesh dhe bënин përshesh, se shefat dhe inspektorët e seksioneve përkatëse bënин sipas kokës së tyre, si donin e qysh donin. Bëhen mbledhje me qindra veta dhe thuhen fraza. Kur inspektohen shkollat, kalohet përciptas, shikohen regjistrat dhe pyeten mësuesit deri ku e kanë zhvilluar temën, sa e kanë përqindjen e nxënësve kalues dhe pastaj bëjnë vërejtje të njohura në këto drejtime.

Në qoftë se nuk mbahen nën kontroll këta njerëz, që të japid llogari deri më një për problemet konkrete, duke sqaruar si i kanë kryer detyrat, a merren me problemet kryesore apo me probleme anësore e parçiale, drejtimi i punëve nuk është i mirë. Prandaj kësaj çështjeje duhet t'i vini më tepër kujdes, të evitohen mbledhjet për mbledhje, të evitohen mbledhjet pa bukë. Mbledhje revolucionare të bëhen, por mbledhje pune të gjera, ku marrin pjesë me qindra veta, janë pa bukë.

Mbledhjet e gjera, sipas mendimit tim, bëhen kur shtrohet një direktivë, pastaj për zbërthimin e kësaj direktive dhe për marrje vendimi organizohen mbledh-

je të veçanta, ku mund të diskutohet e të jepet mendimi i masës për vetë direktivat e dhëna, kur mendohet se ato mund të korrigjohen, të përmirësohen etj. Të arrihet zgjidhja e shumë problemeve në një mbledhje prej disa orësh dhe me 200 veta, është e kotë. Në raste të tilla, siç tregon eksperienca, disa i zë gjumi, ca të tjerë mërziten e nuk mbajnë shënimë. Pse? Sepse mendohet që «raporti i përgatitur me shkrim nga referuesi do të na vijë».

Që të jetë në gjendje komiteti ekzekutiv të kontrollojë, duhet të jetë në dijeni të problemeve që rrihen në seksionin e arsimit e të kulturës, që morëm si shembull. Kështu komiteti do të jetë në gjendje t'i thotë seksionit: Ç'na ke sjellë këtë raport, ku ka vëtëm fraza? Ç'na duhen frazat, kur nuk është shtruar asnjë problem?

E kupton tani, shoku Jani, pse nuk të pycta as për punën e seksionit të ekonomisë komunale, as për atë të seksionit të bujqësisë? Se e di unë që për punën e këtyre seksioneve interesohen të gjithë kryetarët e komiteteve. Por ka edhe disa sektorë të tillë pune, si ai i arsimit, që kryetarët, pa të drejtë, i lënë pas dore. Të lësh pas dore një punë të tillë me kaq rëndësi, që ka të bëjë me edukimin e brezave, kjo gjë nuk është e drejtë.

Në lidhje me ato që tha shoku Pilo [Peristeri] se në raportin e paraqitur kishte mjaft gjëra të dhëna për bujë, si dhe me ato që thashë unë më parë, desha të shtoj diçka. Unë thashë që ka interesim për bujqësinë, për industrinë etj. Kjo është e vërtetë duke e krasuar gjendjen me arsimin, por kemi raporte që edhe

në këta sektorë ka çështje që nuk shkojnë mirë. S'ka shumë kohë që kam lexuar një raport për Ndërmarrjen e Rritjes së Gjedhit në Maliq. Atje ka të meta dhe bile të meta serioze. Interesoheni ju për ndërmarrje bujqësore, apo nuk pyetni për to? E dini ju që rrithi i Korçës e ka për detyrë të mbajë bagëti të mira e jo të ngordhura? Në qoftë se punon mirë pushteti për përmirësimin e kushteve të gjësë së gjallë dhe e konsideron Ndërmarrjen e Rritjes së Gjedhit në Maliq si shumë të rëndësishme për furnizimin e popullit e sidomos të qytetarëve me mish, punët atje do të shkojnë mirë. Veçanërisht komiteti ekzekutiv i këshillit populor të rrithet duhet të interesohet për këtë problem dhe jo t'u lihet përgjegjësia vetëm ministrisë dhe ndërmarrjes. Nuk üshtë aspak e drejtë të thuhet se fajin për mosrealizimet e ka vetëm organizata-bazë e Partisë në ndërmarrje. Komunistët kanë përgjegjësi partie, por edhe drejtuesit e ndërmarrjes kanë përgjegjësi shtetërore, bile edhe penale, po të jetë rasti.

Partia ka vënë detyrë që kjo ndërmarrje të ecë përpara. Natyrisht, përparimi do të arrihet nën udhëheqjen e Partisë, por edhe nën drejtimin e pushtetit. Komunistët dhc punonjësit e organeve të pushtetit, bashkërisht, të mobilizohen fort që të zbatojnë me përpikëri direktivat e Partisë dhe vendimet që ka marrë Qeveria.

Në qoftë se në Ndërmarrjen Bujqësore të Maliqit puna ka vajtur mirë, kjo ka ndodhur jo për «përpjekjet» që ka bërë Ministria e Bujqësisë, por nga puna e mirë e organizatës-bazë të Partisë, e drejtorisë dhe e punonjësve të kësaj ndërmarrjeje.

Unë nuk mund të them që Korça ka vetëm bujë, se

atje bëhet edhe punë. Në Korçë ka një klasë punëtore të ndërgjegjshme dhe një fshatarësi përparimtare. Njerëzit që udhëheqin në këtë rreth kanë eksperiencë pune të mirë, por çështja është që sa më konkretisht të shikohen problemet, sa më drejt e më shpejt të zgjidhen ato, sa më mirë dhe pa luslör të na raportohet neve këtu, aq më mirë do të shkojë rrethi.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor do ta respektojnë atë kuadër që vjen e thotë sinqerisht: «Nuk e kam bërë punën mirë, se këtu nuk kemi vepruar si duhet». Për një kuadër të tillë ne do të themi: «Ky shok është sekretar i mirë, ai tjetri është kryetar i mirë, se i njeh të metat dhe do t'i ndreqë patjetër».

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Presidiumit të Kuvendit Popullor, që gjendet në AQP*

## TË MOS KRIJOJMË HALLKA TË TEPERTA, BUROKRATIKE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH<sup>1</sup>*

25 maj 1976

Ligji në fuqi «Mbi këshillat popullorë» nuk e ka parashikuar funksionimin e kryesisë së komitetit ekzekutiv. Prandaj me ç'të drejtë krijoka Këshilli i Ministrave një organ që ligji nuk e ka lënë në kompetencën e tij?!

Jo, nuk mund të krijohet me vendim të Qeverisë një organizëm që duhet vendosur me ligj nga Kuvendi Popullor ose me dekret nga Presidiumi i tij. Për këtë çështje, mbaj mend, që kemi diskutuar edhe më përpara, bile edhe në Komitetin Qendror të Partisë dhe

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për miratimin e një projektdëkreti të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH mbi disa ndryshime në ligjin «Mbi këshillat popullorë». Ky projektdekret, me propozimin e shokut Enver Hoxha, nuk u mirataua.

kemi arritur në përfundimin që kryesia e komitetit ekzekutiv nuk duhet krijuar, se kështu, kryetari, nën-kryetari dhe sekretari do të marrin vendime që janë në kompetencë të komitetit. Në favor të tezës për krijimin e kryesisë ishte paraqitur arsyetimi se «Kryesia do të ketë kompetenca të kufizuara dhe vendimet e saj do t'i miratojë komiteti», por ky arsyetim nuk u pranua, sepse miratimi i pretenduar do të bëhej në kalendat greke dhe kryesia, brenda një ore, do të vinte në korent komitetin se këto gjëra u zgjidhën kështu dhe vetëm kaq. Prandaj nuk është pranuar ideja e krijimit dhe e funksionimit të kryesisë së komitetit ekzekutiv dhe Komiteti Qendror ka porositur që të mos ketë një organ të tillë.

*Mbas disa diskutimeve të anëtarëve të Presidiumit, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Për shkeljet e ndryshme që ndodhin nëpër ndërmarrjet e rrethit a duhet të mblidhet komiteti ekzekutiv? Kush e zgjidh çështjen e përgjegjësisë për ata që kanë bërë, për shembull, shkelje financiare? Nuk e kam fjalën vetëm të sanksionet që janë parashikuar në ligj. Por a ushtrohet kontroll nga punonjësit e aparatit të komitetit ekzekutiv në ndërmarrje? Kush vete e kontrollon atje? Ja, fjalë vjen, a ka kompetenca seksioni i financës për raste të tillë? Derisa ka kompetencë të kontrollojë, atëherë shefi i seksionit të financeës apo ai i kontroll-revisionit ka të drejtë edhe t'i kërkojë llogari atij që ka shkelur ligjin dhe kështu e ndalon atë që të vazhdojë shkeljen. Dhe jo vetëm e ndalon, por, kur mendohet se është kryer krim, c denoncon në hetuesi

keqbërësin pér ta dërguar në gjyq që tē përgjigjet edhe ligjërisht.

Sigurisht, jo tē gjitha shkeljet duhet tē shkojnë nē gjyq, por pér rastet që vendos komiteti, duam tē dimë cilat shikohen nē komitet dhe cilat nō këshill. Këtu është gjithë puna e përcaktimit tē drejtë tē kompetencave. Tē mos ndodhë që kur jepet gishti, tē kapendora dhe koka, domethënë, që, kur jepet një kompetencë, tē merren edhe disa tē tjera që u takojnë forumeve më eprore. Ja, pér shembull, ka kompetanca drejtori që tē marrë masa ligjore ndaj një punonjësi që shkel ligjin dhe çfarë kompetencash ka? Ju thatë se ai ka kompetencë tē caktojë zhëmtimin. Por pér sa i pérket zhëmtimit, kur s'üshtë dakord me urdhrin e drejtorit, është punëtori ose nëpunësi ai që mund ta çojë çështjen pér shqyrtim nē gjykatë. Vetëm kur ka tē dhëna tē jetë kryer ndonjë krim, çështja dërgohet pér ndjekje penale. Kështu më duket se përcaktohet nē ligj. Sipas Kodit tē Punës zhëmtimi caktohet me urdhër tē drejtuesit tē ndërmarrjes, tē institucionit, tē organizatës etj. Kur dëmi është shkaktuar nga vetë drejtuesi, zhëmtimi duhet tē caktohet me urdhër tē organit më tē lartë. Vetëm kur dëmi konstatohet nga organet e kontroll-revizionit financiar tē komitetit ekzekutiv tē këshillit popullor tē rrethit, atëherë caktohet zhëmtimi nga komiteti ekzekutiv i rrethit. Është kështu apo jo? Por nē qoftë se funksionon kryesia e komitetit ekzekutiv, atëherë dhe ajo do tē ushtrojë tē drejtat që do t'i jepen.

Por mendini im është që ne nuk duhet ta ndryshojmë ligjin ekzistues «Mbi këshillat popullorë», pra,

të mos ketë kryesi të komitetit ekzekutiv të rrëthit. Këshilli i Ministrave, siç thashë, nuk duhej të vendoste vetë për krijimin e kryesive të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, sepse krijimi i organeve lokale të pushtetit dhe të administratës shtetërore është çështje konstitucionale.

Unë them se nuk duhet të bëjmë analogji, duke argumentuar se megjë u krijuar Kryesia e Këshillit të Ministrave, të krijohen edhe kryesitë e komiteteve ekzekutive në rrethe. Kryesia e Këshillit të Ministrave, së cilës i kemi dhënë kompetenca për të ndjekur, për të kontrolluar dhe për të marrë masa lidhur me zbatimin e detyrave të caktuara nga Këshilli i Ministrave, shikon probleme të rëndësishme që nuk i ka rrathi. Po të mos marrë në analizë disa probleme të rëndësishme kjo Kryesi, atëherë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave do të shqyrtoheshin shumë probleme përnjëherë ose do të duhej të bëheshin çdo ditë mbledhje. Kurse anëtarët e kryesisë së komitetit ekzekutiv të rrëthit dhe kryetari nuk kanë ndonjë pengesë që të konsultohen kur të duan për të marrë një masë. Në mbledhjen e komitetit ata raportojnë për veprimet që kanë kryer. Unë propozoj që ky projektdekret të kthehet edhe një herë pa u miratuar. Në qoftë se Këshilli i Ministrave ka përsëri mendim tjetër, atëherë mund të na e shtrojë problemin për ta diskutuar në Sekretariatin e Komitetit Qendror. Ky është mendimi im.

Të nisemi, shokë, nga parimi që të mos krijojmë hallka burokratike, hallka të tepërtë, që na krijojnë një mijë probleme. Këtu nuk ka nevojë për një zgjidhje

imediate, të shpejtë. Edhe vendimet që na vijnë nga lart duhet të shikohen me kujdes që të mos bëhem automatë në zbatimin e tyre.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Presidiumit të Kuvendit Popullor, që gjendet në AQP*

# T'I JAPIM RËNDËSI MË TË MADHE ZBULIMIT TË MINERALEVE TË DOBISHME

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

27 maj 1976

Ky studim që morëm në shqyrtim sot trajton disa çështje, për të cilat ne kemi qenë në dijeni edhe më përpara, por, me gjithëkëtë, ai na freskon njojuritë tonë mbi perspektivën e zhvillimit të punimeve gjeologjike për zbulimin e mineraleve të dobishme. Por unë dua të di çfarë bëhet me rezervat që nuk janë industriale? Ju thoni se dendësoni rrjetin e shpimeve dhe vërtetoni se këto rezerva ekzistojnë. Mirëpo ne kemi kaq vjet që nxjerrim bakër dhe kemi hasur në shumë nga këto miniera, ku ka rezerva industriale dhe rezerva gjeologjike. Pra, për rezervat gjeologjike që kanë ekzistuar më përpara për 25, 20 apo 15 vjet a është ndjekur kjo procedurë që thoni ju, apo i lëmë këto që kemi pasur dhe vemi në një vendburim tjetër?

---

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua studimi «Mbi perspektivat e zhvillimit të punimeve gjeologjike për zbulimin e mineraleve të dobishme», i bërë nga drejtoria e gjeologjisë e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave.

Unë mendoj se edhe në vendburimin e Dervenit, që përmendët ju, mund të na jenë bërë sabotime. Të thuash se kjo është rezerva Cl, kjo tjetra është Bl, dhe i dini vendet se ku janë, kurse për të tjerat nuk i dini, kjo do të thotë të bëjmë vëtëm fjalë, siç është vepruar me naftën. Shtrohet pyetja: Gjatë gjithë këtyre vjetëve a keni atakuar rezerva gjeologjike? Unë e kam fjalën këtu: ne, natyrisht, shfrytëzojmë dhe atakojmë për të gjetur mineralin e bakrit, gjemë rezerva industriale dhe fillojmö të nxjerrim mineral, se kemi nevojë për të, por çështja është që rezervat gjeologjike nuk duhet t'i konsiderojmë si një gjë që i kemi në dorë. Duke realizuar planin atje ku janë rezervat industriale, ne duhet të kemi edhe një plan për përgatitjen e rezervave gjeologjike. Pra, gjatë kësaj kohe, edhe plani i nxjerrjes së mineralit realizohet dhe krahas kësaj bëjmë një organizim tū mirë të sondave, që rezervat gjeologjike të mos mbeten vëtëm në kartë, por të kthehen në rezerva industriale, që këto të shtohen në të njëjtin vendburim, pa ekskluduar që të shkohet edhe në ndonjë vendburim tjetër. Na është thënë që nën Bulqizë ekziston një shtresë e madhe mineral kromi. Në pesëvjeçarin aktual, që po shqyrtojmë, ju i keni parashikuar shpimet, apo s'i keni parashikuar? Do të shkojmë poshtë në galeri për t'i shfrytëzuar këto shtresa, apo nuk do të shkojmë në këtë pesëvjeçar?

Parashikimet që paraqiten në studim duhet të figurojnë në planin tonë pesëvjeçar në rrugën më të arsyeshme, më të drejtë dhe më të mundshme. Dëshirat tona mund të jenë shumë të mëdha, por mundësitetë reale duhet t'i matim duke parë fuqinë monetare dhe

materiale, gjendjen e kuadrit etj. Duhet pasur parasysh kurdoherë se mineralet janë një burim i madh dhe kryesor ekonomik për vendin tonë. Mineralet që kemi zbuluar aktualisht nuk janë të pakta as si numër, as nga pikëpamja e rëndësisë së tyre, prandaj, në këtë gamë dhe brenda këtyre mundësive që thashë, duhet t'u japim rëndësinë më të madhe zbulimit të mineraleve, që t'i shfrytëzojmë dhe t'i pasurojmë më tepër. Unë nuk dua të them që zbulimet të mos i zhvillojmë më tepër, përkundrazi, por më duket se proporcionet që përmenden këtu janë pak a shumë të drejta. Për sa i përkct mendimit që të mbulojmë të gjithë vendin tonë me ekspedita gjeologjike, çështja duhet studiuar. Për këtë çështje duhet ecur me një program të qartë për të parë nëse nevojitet të përgatiten akoma kuadro për këtë sektor.

Unë jam dakord me diskutimet që u bënë këtu, me gjithëse duhet ta them që disa prej tyre ishin ose të përgjithshme, ose me shumë hollësira. Për të dy drejtimet, në qoftë se jemi me të vërtetë kompetentë, mendimet që kemi duhet t'ia japim bazës. T'i shtrojmë çështjet me kaq hollësi këtu në Byro, më duket se nuk është me vend. Këto që dimë, për disa nga problemet që analizohen, nuk i kemi mësuar në një vit, por gjatë 10-15 vjetëve, i kemi mësuar nga specialistët, nga gjithë ata njerëz të zotë që kanë përgatitur Partia dhe pushteti popullor. Në radhët e këtyre njerëzve, ka edhe nga ata që kanë bërë gabime, që janë të mëfshtë, ose që nuk kanë kurajë. Ne duhet të dimë që këta t'i ngremë, t'i inkurajojmë, t'i futimi në punë në mënyrë të organizuar e të disiplinuar. Në radhë

të parë köta njerëz duhen ngritur ideologjikisht dhe politikisht. Kjo detyrë të mos mbetet vetëm një slogan, por të vihet me të vërtetë në jetë, që njerëzit të bëhen të ndërgjegjshëm për detyrat e tyre.

Edukimi i punonjësve të minierave e të gjeologjisë ka rëndësi të madhe, prandaj duhet të na raportohet si punojnë organizatat e bashkimeve profesionale në këtë drejtim. Nuk mund të shkohet përpara duke gjykuar e duke folur në mënyrë të përgjithshme, prandaj unë bëra një ndërhyrje kur foli shoku Rita [Marko]<sup>1</sup>, të cilin e pyeta: «Si e ndihmoni ju konkretisht bazën? Amblidhen gjeologët, se, siç doli edhe këtu, ata janë të shkëputur e të shpërndarë? Si organizohet edukimi i tyre? Kë dërgoni ju të Bashkimeve Profesionale atje, çfarë masash keni marrë për edukimin e grupit gjeologjik në Alpet e Veriut, që kërkonte boksite? Sa herë janë dërguar atje shokë dhe ç'lema politike kanë zhvilluar? Si janë shtruar me këta punonjës, që punojnë në thellësi të vendit, vendimet e kohëve të fundit të Partisë, ato të Plenomit të 7-të të Komitetit Qendror?». Janë bërë këto apo jo? Se unë kam vërejtur vetë që atje, në Alpet tona, as gazeta nuk u shkonte gjeologëve, pa lëre pastaj të punohen me ta tema politike, gjë për të cilën nuk kujtohej njeri. Kjo punë ndoshta ka filluar të bëhet pasi jam interesuar unë, kur u ktheva nga vizita që bëra në Shqipërinë e Veriut.

Këtu u përmend se ndodh që në ndonjë sondë punojnë bashkë dy-tre vëllezër dhe se ka familjaritet

---

1. Në atë kohë president i Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.

e mungesë të kërkesës së llogarisë. Unë mendoj se kjo jo vetëm që nuk është karakteristike, por, në qoftë se flasim për këtë, vaj halli se si na vete puna në kooperativat bujqësore, ku në një skuadër mund të kesh kushëri, motër e vëlla, atëherë si do të bëjmë? Do t'i ndajmë këta ne? Këtë gjë do ta rregullojmë me punën edukuese të Partisë. Nuk them që t'i mbledhim apostafat në një sondë punëtorët nga një familje, por nuk është edhe ndonjë gjë pse ndodh në një rast që të jenë dy të afërt osc nga një familje. Më duket se kjo duhet të zgjidhet në sajë të një pune të shëndoshë ideopolitike që duhet të bëjmë, sepse këtë fenomen në fshat do ta kemi, veçanërisht në skuadra, bile edhe në brigada nganjëherë. Puna është si punohet për edukimin e tyre, ç'bëhet me ta në këtë drejtim. Forcimi dhe kalitja e ndërgjegjes së specialistëve dhe e të gjithëve nuk mund të arrihet me një leksion për leksion, por me punë të vazhdueshme.

Gjithë çështja është të kuptohet se duhet të punohet që secili të bëjë shpimin në kushte shkencore, duke zbatuar rreptësisht rregullat teknike. Me ata gjeologë që nuk kanë koncepte të drejta gjeologjike për një vendburim të caktuar dhe që nuk janë të bindur, duhet të punoni që t'i bindni politikisht dhe shkencërisht. Ata kanë formuluar disa mendime dhe u është mbushur mendja top se janë të zotë dhe specialistë të përkryer. Kujtojnë se mendimet e të tjerëve nuk kanë shumë vlerë. Pra, në këtë drejtim, ekziston ndër ta një ndjenjë e theksuar mikroborgjeze që i bën të shikojnë shumë «superioritetin» e mendimeve të tyre. Këtu duhet punuar me takt, me urtësi dhe me argumente që

ata të binden e, në radhë të parë, të dëgjojnë dhe mendimet e të tjerëve. Këto mendime të vërtetohen si të drejta e reale, se vërtetimi është kryesorja. Të supozosh që në zonën e Rubikut kemi të bëjmë me një «pullë» gjeologjike dhe jo me shtresa të tëra minerali, nuk është e drejtë. Duhet parë se kjo «pullë» mund të zgjerohet e të bëhet e madhe. Çështja e amurproprit, e reklamimit të zotësisë së vetvetes, duhet të gjerryhet nga ndërgjegjja e punonjësve tanë.

Siq u tha këtu, në përgjithësi specialistët e bakrit janë në pozita të drejta politike dhe me ngritje teknike të mirë, kanë eksperiencë. Gjithashtu, duhet parë edhe problemi tjetër që u ngrit me të drejtë që, për në Fakultetin e Gjeologjisë të zgjidhen mirë ata që duhet të ndjekin këtë degë, sepse është një gjë me rëndësi përgatitja e specialistëve të mirë të minierave.

Në punimet gjeologjike një rol të veçantë luan disiplina shkencore. Si e kanë këtë disiplinë shokët gjeologë? A ndihmohen këta njerëz? Ç'bën Institut i Gjeologjisë? Vërtet instituti nuk mund të ketë shumë njerëz. Ne e luftuam prirjen e grumbullimit të shumë njerëzve në institut, një pjesë e të cilëve ishin mbledhur me qëllime të këqija. Puna atje të organizohet në mënyrë të tillë që ai njeri ose ata dy njerëz që janë në institut, për shembull, për bakrin, duhet medoemos që, përveç diplomës së universitetit të kenë edhe eksperiencën e bazës për disa probleme kyç. Duhet që herë pas here, nga instituti të organizohen në mënyrë të planifikuar, qoftë në Rubik, qoftë në Bulqizë e gjetkë, jo mbledhje për mbledhje me 100 veta, por mbledhje për punë shkencore me 10-15 punonjës kryesorë, ku

të hidhet në diskutim një eksperiencë e fituar në kërkime, në vlerësimë, në mirëmbajtjen e sondave, në respektimin e përpiktë të disiplinës shkencore etj. Në këto mbledhje njerëzit të mos i zërë gjumi, por të bëhen debate. Po të veprohet kështu, ky është një organizim i efektshëm i punës së institutit, i cili jep mësime, po merr nga baza disa çështje me rëndësi, i përgjithëson dhe vjen e i ngre probleme ministrit, duke i vënë në dukje që situata këtu apo aty nuk paraqitet e shëndoshë dhe se u morën këto e ato masa. Prandaj përdorimi i një njeriu ose i dy njerëzve për probleme të veçanta në institut duhet të bëhet në mënyrë të organizuar e jo pët një mijë e një probleme. Çdo punonjës i institutit duhet të ngarkohet me probleme të caktuara, konkrete dhe t'u vejë deri në fund çështjeve. Secili të raportojë e prapë të shkojë të interesohet për probleme që dalin nga diskutimet.

Këtë metodë pune duhet ta zbatoni jo vetëm ju, por të gjithë, nga lart e deri poshtë. Në një mbledhje të Presidiumit të Kuvendit Popullor që bëmë para disa ditësh, dëgjova diskutimin e kryetarit të komitetit ekzekutiv të një rrathi. Meqë po na fliste në mënyrë të përgjithshme, duke vënë në dukje që «këshilltarët punojnë kështu e ashtu, nuk kemi bërë shumë punë me këshilltarët etj.» unë e pyeta kryetarin në fjalë: «Mund të na thuash si punon ti me shefin e seksionit të arsimit?». Nuk e pyeta për lidhjet me shefin e bujqësisë, me atë të industriisë ose të komunales, se e di që ai është specialist për ekonominë, por e pyeta për problemet e arsimit. Duke u gjendur ngushtë, ai nuk më përgjigjej dot dhe filloi t'i vinte rrotull problemit. I thashë se

këto parime që më përmend ti, ne i dimë, por duam të na thuash konkretisht, kë asistuar apo jo në ndonjë mbledhje të seksionit të arsimit? Po në zonën ku vete për punë një inspektor i arsimit kë vajtur ndonjëherë për problemet që i dalin këtij? Ai nuk dinte ç'të thoshte. Pra, e kam fjalën që të interesohemi në mënyrë të organizuar për shokët në bazë, t'i ndihmojmë nga aför ata.

Duhet pasur parasysh edhe forcimi i disiplinës shtetërore në Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave, sepse kjo disiplinë nuk ka ekzistuar më parë në këtë dikaster në masën që kërkohet. Aty ishte krijuar një frysma jo e shëndoshë, mbeturinat e së cilës ekzistonjë edhe sot, prandaj në këtë drejtim të mos kemi zhgënji me. Për këto arsyen Partia duhet t'i ndihmojë ministrinë dhe drejtore të e saj me kuadro. Ku do t'i gjejë Partia këta kuadro? Rruga e vetme, më duket mua, është përgatitja e tyre nëpërmjet edukimit dhe punës.

Në krye të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave tashti kemi vënë shokun Pali Miska, të cilit nuk dëshiroj t'i bëj komplimente, por dua të theksoj rae kënaqësi se që kur ky u bë ministër, po shikojmë një kthesë, një disiplinë më të ndërgjegjshme dhe një kontroll më të fortë në punën e ministrisë. Kjo gjende nuk duhet të na vlefkenaqë sa të mos përpinqemi më tej, përkundrazi, shoku Pali duhet të vazhdojë punën që e ka filluar mirë.

Partia dhc pushteti, organizatat-bazë dhe ndërmarrjet duhet të kenë parasysh që, në vende kryesore vihen njerëzit më të besuar e të kualifikuar, më me iniciativë, që të mund të drejtojnë dhe të tjerët për

realizimin e planeve dhe për ngritjen ideopolitike. Kjo çështje, më duket mua, duhet të merret frontalist, se, pa e marrë kështu, do të na çalojnë të gjitha detyrat e tjera. Këtë ne duhet ta bëjmë.

Aktualisht ne nuk jemi më në atë stadin e vjetër kur s'kishim shumë kuadro. Nuk është i drejtë dhe as i vërtetë mendimi sipas të cilit nga puna armiqësore e Koço Theodhosit, gjithë aparati i ministrisë ku ai drejtonte, të gjithë njerözit dhe të gjithë punëtorët paskëshin rënë në një llum. Po të ishte kështu, nuk do t'i kishim realizuar planet në industri dhe në miniera. E vërteta është se armiqëtë na kanë sabotuar perspektivën, ata kanë mbytur puset e naftës, nuk na kanë dhënë lushat e shpimit, por, me gjithë këtë veprimtari të rrezikshme armiqësore, në një kohë që janë realizuar plane të mëdha, nuk mund të arrihet në përfundimin që industria jonë ishte përtokë. I përkiste bazës të na i sinjalizonte veprimet e armiqve, por, ama, na përkiste edhe neve që t'i vinim gishtin kokës e të thoshim «Ku po shkojmë?» dhe pastaj të kontrollonim. Në këto kushte është me vend të themi se shokët duhet të kishin qenë më shumë vigjilentë ndaj veprimtarisë armiqësore.

Kontrolli ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Te ne ka pasur dhe ka kontroll, ka edhe organizim. Ne kemi pushtetin, kemi njerëz kompetentë për punën, kemi mjete dhe makineri, kemi edhe entuziazmin e madh të masave, por të gjitha këtyre duhet t'u përgjigjemi me një organizim më të mirë të punës dhe që ta organizojmë më mirë atë, është e nevojshme që Partia, në qendër e në bazë, të jetë plotësisht në rolin udhëheqës, të

ushtrojë një veprimtari të kualifikuar e të mobilizojë njerëzit për zgjidhjen e problemeve dhe për plotësimin e detyrave.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë*

*Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## KUADROT E AFTE NJIHEN NË PUNË E SIPËR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**27 maj 1976**

*Pasi shoqja Themije Thomai foli për dëmet e shkaktuara nga breshëri, për masat që janë marrë për kapërcimin e vështirësive të krijuara dhe për gjendjen e shëndoshë moralo-politike të popullit e mori sfalën*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë mirë. Ne kemi bindjen, ashtu si cdhc ju, që këto vështirësi do të kapercehen me sukses.

Gjithashtu mua më kanë raportuar se ju në dikaster po rishqyrtoni strukturën e ministrisë. Më duket se mendimet tuaja për këtë çështje janë të drejta. Analizojeni problemin dhe studimin tuaj paraqitjani Qeverisë, për të dalë me mendime sa më të pjekura, me qëllim që ministria juaj të kthehet me të vërtetë

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth studimit për problemet kryesore të zhvillimit perspektiv të bujqësisë.

në një organ sa më të aftë për të drejtuar e për të organizuar punën, si nga ana teorike, ashtu edhe nga ana praktike. Përfundojeni sa më parë këtë studim, sepse ka rëndësi të madhe. Komiteti Qendror i Partisë, Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës, si dhe komitetet e Partisë të rrëtheve të tjera duhet t'ju ndihmojnë me kuadro të shëndoshë që, ashtu siç kemi vendosur, të zhdukjet fryma e sëmurë që ka ekzistuar në njerëz të ndryshëm në këtë ministri. Njerëz të tillë duhen dërguar në bazë dhe në ministri të vijnë njerëz me përvojë nga baza, të aftë për punë dhe me kushte politike të mira. Kjo punë të përfundojë sa më parë nga ju, në mënyrë që të merret mirë situata në dorë nga ana e ministrisë.

Shumë specialistë të bujqësisë, disa prej të cilëve i përmende dhe ti këtu, tamam për stoli i bënин studimet dhe, kur ndodhë që merrej ndonjë rendiment i lartë, atëherë menjëherë thoshin: «Ne zbatuam këtë apo atë studium!». Ia kemi thënë edhe Pirro Dodbibës këtu, që studimet duhet të vihen në zbatim e jo të bëhen për t'i mbajtur vetëm në konferenca!

Kush ka për të bërë ndonjë pyetje ose për të kërkuar ndonjë shpjegim, këto mund t'u kërkojmë shokëve, shokut Petro<sup>1</sup>, se ai është më i vjetër në këto punë, por edhe shoqes Themije, se edhe ajo ka eksperiencën e saj në punët e bujqësisë.

Unë kisha këtë gjë, shoku Petro. Analiza për vitin 1975 është tjeter çështje, ndërsa, çka na jepet në stu-

---

1. Petro Dode, në atë kohë kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit.

dim për vitin 1976 është aproksimative, për arsyet se juve nuk ju kanë ardhur nga poshtë të dhënët për pesëvjeçarin. E them këtë sepse këtu, në material, na përcaktohet se sa do të arrijmë të marrim në vitin 1980. Këto janë orientimet tuaja, të Komisionit të Planit të Shtetit, pra, kjo është një paravënic në korenë për ne, se ne do ta analizojmë me hollësi këtë problem. Për sa i takon çështjes se çfarë do të vendosim, këtë do ta thotë baza.

Atëherë, më parë se të flasë shoku Petro, unë desha të di, në përgjithësi si mendon ti, shoqja ministre, për këto orientime? A janë të bazuara dhe të realizueshme? Keni ju ndonjë sugjerim apo kritikë lidhur me to? Unë nuk të kërkoj të më japësh një pasqyrë të përgjithshme të bujqësisë së vendit tonë, se për këtë ty të duhet dhe kohë në detyrën që të cakttoi Partia. Por, në qoftë se ti nuk ka atë përvojë që kanë shokët e Komisionit të Planit, ti ke përvojën e bazës. Pra, për analogji, mundet që me logjikën tënde të mendoshi se kaq kuintalë drithë janë pak ose kaq kuintalë pambuk janë shumë dhe, për të siguruar realizimin e planit, duhet të veprojmë kështu apo ashtu.

*Pasi foli shoqja Themije Thomai, lidhur me orientimet e dhëna nga Komisioni i Planit të Shtetit, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Unë mendoj (besoj se edhe shokët këtë mendim kanë) që ti, shoqja Themije, i ka përvetësuar mirë orientimet e Partisë. Tani çështja është të luftosh për t'i vënë në jetë. Natyrisht, këto janë detyra të mëdha që kërkojnë shumë mund e djersë.

Deri tani, të gjitha këto probleme që ti shtrove këtu, janë studiuar në mënyrë të përciptë, se ishin nënveftësuar nga Ministria e Bujqësisë. Mendimet e shifrat i jepeshin Qeverisë pa u thelluar fare; si themi ne në Gjirokastër, kuturu. Në Qeveri bëheshin diskutime rreth tyre dhe merreshin vendime pak a shumë të drejta. Por çështja ishte që të mbështeteshim te baza, sepse baza jepte mendime e propozime të sakta, të cilat ministria nuk i merrte në konsideratë.

Tani Ministria e Bujqësisë ka për detyrë që të dhënët për planin pesëvjeçar të mos i dërgojë në Qeveri pa i studiuar mirë. Për këtë puna duhet organizuar në mënyrë të tillë që të respektohen asfatet e caktuara nga çdo rreth. Në rrethe të punohet intensivisht, ditë dhe natë, nga të gjithë së bashku, të qendrës e të bazës. Shokët e ministrisë t'i shikojnë me kujdesin më të madh shifrat e planit duke i diskutuar e duke u konsultuar me kryetarin, shefin e seksionit të bujqësisë, krycagronomin e rrethit etj. dhe pastaj të arrihet në përfundim si duhet të jetë në të vërtetë plani pesëvjeçar. Së fundi, në Qeveri parashtrohet mendimi juaj dhe mendimi i tyre që, sipas jush, ka rezerva. Ju, sigurisht, duhet t'i argumentoni këto gjëra. Mbas marrjes së vendimit për planin nga Byroja Politike, problem i madh është zbatimi i tij në jetë. Kësaj pune ministria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë.

Në këtë rrugë duhet të zgjidhen problemet e bujqësisë nga ministria, duke luftuar për vënien në jetë të orientimeve të Partisë.

Ti do të veshi, për shembull, në Mat. Shokëve atje do t'u thuash: «Duhet vepruar në këtë rrugë për dri-

thërat; ky është vendimi i Ministrisë së Bujqësisë i aprovuar nga Qeveria dhe nga Komiteti Qendror. Detyra jonë dhe juaja është të mobilizohemi që ta zbatojmë këtë vendim duke iu përveshur punës».

Ose të marrim një rast tjetër. Kur të diskutosh, fjala vjen, me shokët e rrëthit të Pukës, për problemin e zhvillimit të dhisë, mos harro të kërkosh nga ata dhe të bësh llogari sa kooperativa kanë; sa dhi ka secila kooperativë; sa prej tyre janë pëlleja; sa është pjellshmëria etj. Pasi t'i merrni këto të dhëna, ju bashkë me ta, nxirri përfundimin se duhen blerë kaq keca për të shtuar numrin e dhive. Në qoftë se ata ngenë problemin që nuk kanë para, u thoni se mund t'u japë shteti dhe, për këtë, mbani shënim. Në të njëjtën kohë, tërhiqу vëmendjen se kjo pjellshmëri është shumë e ulët dhe se kecat që lindin duhet t'i mbajë kooperativa. Të llogaritet, për shembull, që brenda këtij pesëvjeçari do të blihen, çdo vit, ta zëmë, një mijë kokë keca dhe, në fund të pesëvjeçarit, bagëtitë e imëta do të shtohen me kaq krerë. Ky që të thashë ishte një detaj, një shembull për t'i vënë ata përpara përgjegjësisë që të mos veprohet më ashtu si deri tani.

Por, do pasur parasysh se ka edhe raste të tilla, më të guximshme. Ja, e di ti, shoqja Themije, që një brigadiere e Gorresë thotë se do të marrë që këtë vit aq kuintalë grurë për hektar sa ka caktuar Këmishtaj për vitin 1930. Pra, ndërsa ne këtu, kur thamë që në vitin 1980 do të marrim kaq kuintalë grurë menduan se mos është i ngarkuar plani, brigadierja e Gorresë e realizon këtë shifër qysh sivjet! Prandaj, të mos përdorim fjalë që i kemi përdorur gjithmonë se plani

është i ngjeshur etj. Dakord, plani mund të jetë vërtet i ngjeshur, por të mos harrojmë se tashmë ekzistojnë dhe mundësitet për realizimin e tij.

Ti, shoku Petro, ndonëse je i ri në detyrën që të ka caktuar tani Partia, e njeh punën në Komisionin e Planit, se ke punuar dhe më parë në atë organ. Atje, nga Abdyl Këllezi ishin sajuar disa formula kundërshtimi e justifikimi që vinin deri te ne këtu. Prandaj, po jua themi edhe këto që të keni mendjen.

Dëshiroj të them edhe diçka, shoqja Themije, lidhur me rekomandimet që ju jepen nga ana e sektorëve të kuadrit, qoftë nga ai i Komitetit Qendror, qoftë nga ata të rretheve. Këto rekomandime kanë një vlerë, sepse jepen në bazë të njohjes. Por tash, ti dhe shokët e tu kryesorë, kudo që veni, vëruni syrin kuadrore më të mirë, të cilët mund të janë harruar edhe nga organet qendrore.

Në përgjithësi kuadrot janë të mirë, por sa i njeh baza, ata nuk mund t'i njohë dot drejtoria e kuadrit. Edhe kartotekën ne do ta përdorim. Siç ka porositur Komiteti Qendror, ne do ta plotësojmë atë vazhdiniisht e vazhdimisht me të dhëna e karakteristika të reja. Por për fat të keq kartoteka nuk plotësohet gjithmonë si duhet.

Prandaj ju dhe shokët tuaj, që do të venë në bazë, shikojini me kujdes shokët dhe shoqet që janë të zotë të udhëheqin, të organizojnë dhe të vënë në jetë vendimet e Partisë; ia propozoni këta kuadro Komitetit Qendror dhe ai menjëherë do ta shqyrtojë me vëmendje propozimin tuaj dhe, po e pa me vend, me siguri do të ndryshojë vendimin që mund të kishte marrë më

parë. Mos ngurroni duke menduar se këtë rekomandim e ka dërguar Komiteti Qendror. Jo, po qe nevoja, ne marrim vendim tjetër për këtë gjë. E kam fjalën kötu që njerëzit duhet t'i shikojmë dhe t'i njohim në punë e sipër, gjë që nuk bëhet aq sa duhet.

*Pasi diskutuan edhe pjesëmarrësit e tjerë të mbledhjes për studimin në fjalë, duke përfunduar, shoku Enver Hoxha tha:*

Atëherë jemi dakord me studimin dhe me vërejtjet që u bënë. Vazhdoni punën që të na vijë një plan pesëvjeçar sa më i studiuar, sa më real, i guximshëm dhe revolucionar!

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# NË PARTI E KANË VENDIN NJERËZIT MË TË ZOTË, MË TË NGRITUR E MË REVOLUCIONARË

*Diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

29 maj 1976

E mira do të ishte që këto raporte që kemi nga rrëfhet të na kishin ardhur pas plenumeve të komiteve të Partisë të rretheve, që ne të kishim mundësi të diskutonim për dokumentet e shqyrtuara në to e që do të na i sillnit ju ose aparatit i Komitetit Qendror. Meqenëse raportet e paraqitura janë bërë përpara plenumeve, nuk mund t'i kenë ato të dhëna që duam ne. Në kohën kur janë hartuar këto raporte, siç u tha këtu, diheshin vetëm kuotat e planit perspektiv pesëvjeçar të bujqësisë. Por unë pyes se çfarë ka vendosur baza për planin? Kjo është një çështje me rëndësi të madhe. Në këtu nuk mund të diskutojmë ato kuota që

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth zbatimit të detyrave të shtruara nga Komiteti Qendror i PPSH për shtimin e drithit, për sigurimin e bukës në vend e të rezervave të domosdoshme për vitin 1976 e në perspektivë. Për këtë u thirrën në raport rrëthet Fier, Lushnjë dhe Durrës.

kemi vendosur vetë. Kryesorja është që të dimë se çfarë është vendosur në rreth apo edhe në kooperativë dhë, mbi këtë bazë, të mund të parashikojmë perspektivën e prodhimit të drithërave. Pra, në qoftë se këtu diskutohen kuotat, kjo nuk është pikërisht ajo që kërkohet nga ne.

Për mua, ky material i raporteve, nuk është i plotë, nuk është tamam ajo çka duam. Ky material duhej të ishte një parapërgatitje e raportit që do t'ë mbahej për pesëvjeçarin, pra, do të viente për ato çështje për të cilat biseduam edhe me shoqen ministre të Bujqësisë në mbledhjen e Byrosë Politike<sup>1</sup>.

Atëherë, të nia flasin shokët e rrelheve, se ndryshe nuk ka kuptim. Tani ju mund të keni një ide për planin pesëvjeçar që ka vendosur edhe Plenumi. Këtë ide ia keni dërguar edhe Ministrisë së Bujqësisë.

*Pastaj diskutuan me radhë pjesëmarrësit e tjere të mbledhjes. Kur ishte duke folur shoku Nimet Cani, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit, shoku Enver Hoxha i tha:*

Që është punuar keq në rrethin tuaj për misrin këtë e dimë<sup>2</sup>. Pikërisht prandaj po të ndërhyj dhë unë që të mos ngopemi me fjalë. Është punuar keq, por kini kujdes se mund të punohet prapë keq.

Përderisa janë të gjitha kushtet, si ujitja, mekanizimi, plehu, fara e të tëra, pse duhet të presim vilin

1. Shih në këtë vëllim, f. 372.

2. Në rrethin e Fierit ishte punuar keq edhe si rezultat i veprimitarësë armiqësore të Pirro Gushos, ish-sekretar i parë i Komitetit të Partisë të këtij rrethi.

1980 që të marrim 60 kuintalë për hektar dhe nuk e marrim këtë prodhim qysh në vitin 1977 ose më 1978?

Në Cakran ka më shumë popull se në Seman. Domethënë, Semani ka më pak forca pune në raport me sipërfaqen që mbjellin. Por kjo mungesë kompensohet se Semani ka më shumë mekanizime. Po atëherë, pse nuk merren rendimentet e duhura edhe në këtë ekonomi? Pse kooperativa e Cakranit ka vite që merr rendimente të larta dhe këto të tjerat jo? Si mund të thuhet se «nuk punohet mirë», «nuk ka kështu e nuk ka ashtu» e të tjera justifikime si këto?!

*SHOKU NIMET CANI:* Ne në fushë do të marrim 42 kuintalë grurë për hektar që këtë vit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* More shoku Nimet, unë nuk po e marr vesh se ç'doni të thoni kur përmendni: «fusha, mali» etj. Ju vetë thatë se 90 për qind të tokave të misrit do t'i vini nën ujë. Atëherë pse zë në gojë fushë, kodër e mal? Ju thoni se do të merrni 60 kuintali misër për hektar më 1980 dhe jo brenda vitit 1976, megjithëse 90 për qind e këtyre tokave do të vihet nën ujë qysh këtë vit! Pse atëherë të ndodhë kështu? Këtë ju duhet të na e shpjegoni.

Me të thënë nuk bëhet gjë, por me të bërë. Prandaj, këto që themi, t'i bëjmë, se, po nuk i bëmë, atëherë llafet i merr era dhe ne mbetemi pa realizuar bukën.

Kur themi se do të marrim kaq kuintalë drithë për hektar, do të mbjellim kaq hektarë me kubikë e kaq mijë hektarë me fole etj., etj., këto duhet të bëhen. Por që të realizohen të gjitha këto, ju duhet t'i keni bërë mirë llogaritë. Mos harroni se po hartojmë planin e ri pesëvjeçar ku bazojmë nevojat dhe rezervat,

për të cilat po flasim tashti. Të hartosh planin do të thotë ta diskutosh çështjen në popull e t'i bësh llogaritë bashkë me popullin, do të thotë që njerëzit të jenë të bindur se do ta realizojnë detyrën. Pastaj, mbasi të jenë bërë mirë të gjitha këto, mund të vini këtu e të na thoni se «nuk kemi forca që të mbjellim hamullorët me kubikë», për këtë apo atë arsy. Por, këto arsy duhet t'i parashikojmë qysh më parë dhe për këtë të bëjmë maksimumin, që të jeni të sigurt kur t'i shtrojmë ato. Këtu përjashtojmë vetëm fatkeqësitë e natyrës. Na kanë thënë shumë llafe, Pirro Dodbiba me shokët e tij, por nuk kanë dalë ato që na thoshin. Ata nuk kanë bërë gjë për zhvillimin e bujqësisë. Ato që janë bërë i kanë bërë Partia, komitetet ekzektive të këshillave popullore të rretheve, populli në bazë, vetë kooperativistët.

Duhet të keni parasysh që ministrja e Bujqësisë do t'i thérresë shokët e seksioneve të bujqësisë të rretheve për të paraqitur të dhënat e për të arsyetuar problemet. Atyre do t'u kërkohet llogari deri në një. Shokët e seksioneve duhet të përgatiten që të japid llogari me kujdes, se ministrja dhe zëvendësministrat e Bujqësisë i njohin mirë problemet, se janë kuadro të terrenit. Në qoftë se ju thoni që në Mallakastër, fjala vjen, do të ujiti dhe do të merrni 20 kuinalë misër për hektar, Ministria e Bujqësisë nuk do ta pranojë. Këtë mendim nuk do t'ua pranojnë as rrëthet e Gjirokastrës e të Beratit, sepse këto kanë ekonomi që marrin më shumë. Më parë nuk veprohej kështu, llogaria kërkohet kuturu dhe nuk mbahej parasysh si duhej. .

E mora si shembull rastësishët Mallakastrën, se ëshië e qartë që atje nuk do të merrni kaq. Po mund të ketë një vend ku mund të jetë caktuar për t'u marrë një prodhim shumë më i vogël, nga q'janë mundësitë.

Në qoftë se s'ka diskutime të tjera, atëherë i mbyllim diskutimet për këtë pikë, duke porositur të tria rrëthet që raportuan, si dhe shoqen ministre të Bujqësisë që, ashtu siç thamë edhe në mbledhjen e Byrosë Politike, projektplanet të bëhen sa më të drejta.

Projektplanet që kanë ardhur nga rrëthet të shqyrtohen në fryshtë që ka rekomanduar Komiteti Qendror i Partisë, pra, në bazë të nevojave që ka vindi e në kushtet e vështira të rrëthimit, duke nxjerrë në dritë të gjilha mundësitë dhe rezervat që ekzistojnë. Vetëm atëherë do të jemi në gjendje të diskutojmë më gjerë për këtë çështje dhe të konkludojmë përfundimisht për projektvendimin që do t'i paraqesim për miratim Kongresit të Partisë.

Aktualisht, në periudhën e këtyre diskutimeve, duke marrë parasysh të gjitha të metat që kanë ekzistuar dhe avantazhet që disponojmë, favoret që na krijojnë mjetet tona financiare, mekanike, njerëzore dhe klimaterike, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet dhe të merren të gjitha masat që bimëve bujqësore t'u bëhen të gjitha shërbimet në mënyrë të organizuar, për të arritur rezultatet e kërkuar. Kjo do të na japë siguri edhe për të ardhmen e, në të njëjtën kohë, me këtë do të provojmë edhe forcën tonë organizative dhe se sa është kuptuar drejt politikisht e ideologjikisht plani ynë pesëvjeçar.

Në këtë drejtim, me gjithë fatkeqësinë natyrore

që pësuam nga rënia e breshrit në Lushnjë, mund të thuhet se puna ka filluar mirë. Për pesëvjeçarin e ardhshëm nuk është vendintar vetëm plani i vitit 1976, por ky plan duhet të jetë fillimi i krijimit të mundësive më të mëdha për vitet e ardhshme, që do të jenë një bazë e sigurt ku do të mbështetemi për gjithë pesëvjeçarin. Plani i ardhshëm pesëvjeçar duhet tejkluar në mënyrë të konsiderueshme, prandaj direktivat dhe orientimet që jepen t'i kuptojnë drejt. Ne kemi bindjen se do të punohet më mirë në këtë drejtim.

Diskutimet e shokëve, më duket mua, qenë realiste, sepse trajtuan edhe anët e mira, edhe mundësitë, edhe të metat e punës në bujqësi, duke filluar nga kooperativistët e deri tek organizata-bazë e Partisë në fshat.

Forcimi i organizatave-bazë të Partisë të fshatit, që ato të arrijnë t'i kuptojnë thellë këto probleme, duhet mbajtur në qendër të vëmendjes. Jo vetëm sekretari i organizatës duhet të jetë personalisht në ballë të punës, por bashkë me të duhet të jenë edhe komunistët e tjera, të cilët të mos nxjerrin pengesa në punë dhe të mos tregohen oportunistë e sektarë ndaj mijëra e dhjetëra mijë punëtorëve e punëtoreve të bujqësisë, që kanë kapacitete të mëdha organiziimi, koncepte të drejta për punën, forca fizike e mendore të shumta. Mjaft herë vërehet që punonjësit e paorganizuar në Parti janë më përpara shumë komunistëve në qëndrimin ndaj punës. Komunistëve të tillë, që për arsyen se kanë teserën e Partisë mendojnë të konsiderohen superiorë dhe t'u jasin urdhra të tjera, edhe pse gjenden në bisht të masave, u duhet tërhequr

veshi. Raste të tilla ekzistojnë. Ka njerëz që janë fshehur prapa tesërës së Partisë. Qenia komunistë e këtyre njerëzve na shkakton disa situata të palejueshme, që i kanë shtruar mjaft herë Partia dhe Komiteti i saj Qendror.

Të gjykohet që «Meqenëse ky është komunisti, duhet të jetë edhe brigadier, kurse ai tjetri që s'është komunist, edhe pse është një luan në punë, s'duhet të jetë brigadier» nuk është aspak e drejtë. Në qoftë se komunisti, qoftë burrë, qoftë grua, është më në ballë të punës nga të tjerët që s'janë komunistë, le të jetë brigadier; por, të caktohet brigadier një njeri i mefshtë vetëm sepse është komunist, se ka teserën e Partisë, kjo gjë nuk lejohet. Partia, Komiteti i saj Qendror dhe Lenini, nga i cili frymëzohemi, na kanë mësuar se në drejtimin e punëve nuk duhet të jenë vetëm komunistë dhe të gjithë komunistë. Të tërë e kemi shtruar këtë defekt; është punuar për eliminimin e tij dhe, në shumë sektorë, situata është përmirësuar. Mirëpo nuk mungojnë raste kur thuhet: «E kemi shumë të mirë këtë shok, por nuk e vëmë dot shef seksioni në komitetin ekzekutiv, se nuk është anëtar partie». Pse të mos bëhet shef apo diçka tjetër ai që s'është komunist?! Derisa ai ka besnikérinë ndaj Partisë dhe popullit, është patriot, çshtë i ndershëm, është i hedhur në punë etj., edhe në vende të tilla mund ta vëmë.

Të gjithë nuk do të jenë në Parti, por kur një njeri bën punë jashtëzakonisht të madhe e të frytshme, të mos ketë pengesa për pranimin e tij. Puna e mirë nuk përjashton që të pranohet në Parti edhe ai që nuk është pranuar më parë. Ne kemi pranuar në

Parti edhe njerëz që, po të vërehen me kujdes, do të dalë që nuk meritojnë të jenë komunistë jo vetëm nga biografia e tyre jo shumë e pastër, por edhe nga puna e dobët që bëjnë.

Kur themi që kuadri mund të rrijë edhe tërë jetën jashtë radhëve të Partisë dhe, megjithatë mund të arri-jë edhe në pozita të larta, kjo është rrugë leniniste. Të mos kemi në Parti njerëz që nuk e kanë vendin në Parti. Njerëz që janë futur në Parti «shtymë të të shtyj», të rrinë jashtë Partisë, kurse ata që janë të ndershëm, të aftë, besnikë etj., e kanë vendin brenda në Parti. Në Parti e kanë vendin njerëzit që janë më të zotë, më të ingritur e më revolucionarë se të tjera. Kjo është viaj leniniste.

Kur e bëj këtë vërejtje, unë mbështetem në të dhënat që kam, pra nuk e shtroj çështjen vetëm në param. Njerëzit që shkëlqejnë, që janë mes masave, pikërisht këta njerëz duhen pranuar në Parti. «Si t'i futim këta në Parti, kur kanë origjinë intelektuale dhe na prishen raportet e vendosura për pranimet?» mund të thotë ndonjëri. Nga qëndrime të tillë, kuadri i ri dhe i zoti rri në vend, vegjeton dhe shefi i paaftë qëndron përherë mbi të. Atij që s'punon t'i gjendet vendi që i përket. Ata që kanë koncepte frenuese për pranimet në Parti e kanë lënë pas kuadrin e ri.

Bujqësia është një sektor i madh dhe ka njerëz shumë të zotë, me eksperiencë e me kurajë. Por, ka raste kur këtyre u gjendet një kleçkë sa për t'i penguar që të ecin përpara në punën e tyre. Ndaj këtyre prirjeve, aty ku duken, Partia duhet të luftojë me këmbëngulje.

Me kaq mendoj ta mbyllim diskutimin për këtë problem, i cili do të rimerret në analizë më gjërësisht dhe më thellësisht kur të diskutojmë planin. Jeni da-kord, shokë?

Me këtë çështje mbaruam.

Ju, shoku Miti Bozo, tashti në fillim duhet ta mbani shumë afër shoqen Themije dhe t'i jepni kësaj një ndihmë të kualifikuar. Shokët e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, si edhe shokët e aparatit të Kryeministrisë, që merren me bujqësinë, duhet të diskutojnë me Themijen për problemet kyç, për çështjet më të rëndësishme dhe jo për ato që ajo i di. Të ndihmohet shoqja ministre e Bujqësisë, me qëllim që t'i jepet eksperienca për disa probleme dhe orientime të mëdha për bujqësinë. Ajo të vihet në dijeni të përvojës së përgjithshme që ka grumbulluar Komiteti Qendror në këtë drejtin, jo në mënyrë dogmatike, por duke diskutuar hapur me të.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# NE USHTRI TE MOS VEPROHET KURRE FORMALISHT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

29 maj 1976

Kemi thirrur disa nga shokët e ushtrisë për të na raportuar për thellimin e demokracisë e forcimin e disiplinës në ushtri.

Si jeni shokë, mirë?

Do të procedojmë sikurse për pikën e parë të rendit të ditës, për të cilën kishim ftuar këtu shokët e bujqësisë. Kush dëshiron le t'u bëjë pyetje shokëve, të cilët, tok me përgjigjen mund t'u shtojnë ndonjë gjë edhe raporteve që kanë paraqitur.

Edhe ne, edhe ju, shokë, e dimë strukturën e ndryshuar të drejtimit të Partisë në ushtri. Tani komiteti i Partisë i Ministrisë së Mbrojtjes nuk ka në varësi e në drejtim organizatat e Partisë të atyre njësive që kishte më parë, por të tjera. Unë dua t'ju pyes: A

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për punën që ishte bërë dhe për detyrat që dilnin për thellimin e demokratizimit të mëtejshëm të jetës dhe forcimin e disiplinës në ushtri.

ndihet në njësitë ku shërbeni ju puna e këtij komiteti partie? Kur komandat dhe komisarët e njësive thërriten në mbledhjet e Komandës së Përgjithshme, asiston atje edhe sekretari i Komitetit të Partisë të Ministrisë së Mbrojtjes? Kur flitni për çështjet ushtarake a raportoni ju dhe për frymën e për gjendjen moralopolitike të ushtrisë, apo direktiva e Partisë zbatohet në mënyrë shabllone? A ekziston mendimi që, meqenëse nuk keni lidhje direkte me Komitetin e Partisë të Ministrisë së Mbrojtjes, atëherë të flitni në mbledhje vetëm për topin, për fortifikimet që keni bërë, për qitjet se i keni realizuar kaq për qind etj. dhe të mos thoni asgjë për gjendjen moralopolitike të ushtrisë? Për punën e Partisë vendimet nuk merren në komandë, por shokët atje vihen në korent se me kë kemi tō bëjmë në ushtri. Se, pastaj parulla që «Partia të jetë në krye» mbetet një slogan. Si mund të jetë Partia në krye kur në mbledhje të mëdha komande, fjala vjen, nuk flasin e nuk thonë mendimin e tyre edhe sekretarët e komiteteve të Partisë të njësive, për problemet e mësipërmë?! Ose, të marrim anën tjetër: Ju, që drejtoni punën e Partisë në ushtri, nuk i thërritni në mbledhje komendantët e njësive për t'i pyetur, për shembull, «pse qendra e zjarrit duhet të vihet këtu e jo gjetkë?», «a është e mjaftueshme kjo që është bërë këtu?», «ç'parashikon ti, shoku komendant i njësisë për ta përmirësuar edhe më tej stërvitjen?» etj. Diskutime të tilla strategjiko-operative keni bërë ju në mbledhje?

Ju, shokë, edhe përgjigjuni për këto pyetje, edhe na bëni ndonjë shtesë që mund të keni. Fillo më parëti, shoku i Gjirokastrës, se pashë që raporti yt është kri-

tik dhe më pëlqen, prandaj shokët nuk do të më akuzojnë mua për lokalist. Kur janë raportet kritike, vlejnë më tepër. E dimë që kemi të meta në punën tonë, jo vetëm në ushtri, por kudo, veçse duhet t'ia vëmë në dukje udhëheqjes të mirat dhe të këqijat.

*Pasi iu dhanë përgjigje pyetjeve të bëra, në myillje të diskutimeve, shoku Enver Hoxha tha:*

Jam dakord me raportet e paraqitura nga shokët e njësive ushtarake që janë ftuar në mbledhje dhe me diskutimet që u bënë sot këtu. E vërteta është se në ushtri ka përmirësimë në krahasinë me të kaluarën, vetëm se duhet të insistohet vazhdimisht për zbatimin e të gjitha direktivave që janë dhënë në plenumet e ndryshme të Komitetit Qendror, si dhe në vendimet që ka marrë Këshilli i Mbrojtjes.

Që nga ushtari e deri te komandanti e komisari më i lartë duhet të kuptohet, se ata janë thirrur në ushiri, se mësohen e stërviten dhe zbatojnë vendimet që merrin për të mbrojtur me luftë fitoret e arritura në atdheun tonë socialist. Kjo që them nuk është ndonjë gjë e re, por unë po e përsëris, se e shoh që duhet të kuptohet thelli. Ai që është ushtarak, pavarësisht nga detyra që kryen dhë nga shkalla e përgjegjësisë që i është besuar, duhet të mendojë se misioni i tij është që në së ar apo pasnesër, kur ta lypë nevoja e atdheut, do të luftojë jo duke ndenjur tërë kohën në zyrë, po duke zbatuar si duhet, në teori dhe në praktikë, në kabinet dhë në terren të gjitha detyrat e vëna, me qëllim që, në rast rreziku, kur të jepet urdhri, të jetë plotësisht i përgatitur për ndeshje në fushën e betejës.

Po të analizohen me kujdes të metat që janë vë-

tetuar dhe që ekzistojnë, do të dalë se jo të tërë shokët ushtarake e kanë kuptuar si duhet këtë qëllim të madh. Prandaj, Partia duhet të punojë në këtë drejtim për t'i bërë të ndërgjegjshëm të gjithë shokët e Ushtrisë sonë Popullore. Kur them të bëhet e ndërgjegjshme dhe të përgatitet ushtria për mbrojtjen e atdheut, kam parasysh tërë forcat e armatosura, pra, edhe rezervistët që janë të inkuadruar në Ushtrinë Popullore, në shkolat e lira ushtarake, në forcat vullnetare të vetëmbrojtjes popullore etj. Kjo ishte e para që desha të theksoj.

E dyta është ajo që asgjë në ushtri të mos mësohet sa për t'u mësuar, domethënë, të mos veprohet kurrë formalisht. Gjykimi sipas të cilit: «Këtë e kam në plan, prandaj duhet ta bëj, pavarësisht se nuk i shërben mbrojtjes», është i dëmshëm. Plani i stërvitjes, i hartuar me kujdes e me qartësi, në funksion të qëllimit për të cilin po flas, pra, për të vajtur në luftë që të mbrohet atdheu, që të mbrohet kufiri, që të mbrohet pozicioni i zënë, që të mbrohet edhe vetë luftëtarët dhe të jetë në gjendje të shkatërrjojë fuqinë e armikut, të zbatohet me përpikëri.

Fuqia e armikut nuk është diçka imagjinare, por një forcë reale dhe tepër e rrezikshme. Pa zotëruar artin tonë ushtarak, në teori dhe në praktikë, pa u stërvitur për kryerjen e veprimeve luftarake në kushtet e vështira dhe të ndryshueshme atmosferike e të terrenit dhe pa njojur strategjinë dhe taktilën e operacioneve të armikut, populli i organizuar në forcat e armatosura nuk do ta kryejë mirë detyrën për mbrojtjen ose do të pësojë humbje të mëdha. Pikërisht se nuk vlerësohen si duhet këto anë të problemit, prandaj dhe

bëhen shumë kritika në këtë drejtim. Qëndrimet neglizhuese që vërehen mendoj se janë rrjedhim i faktit që mjaft nga ushtarët dhe oficerët nuk e kuptojnë dhe nuk e ndicjnë plotësisht përse ata janë ushtarë, përse ata janë oficerë.

Ushtari dhe oficeri i mirë duhet të kenë disa kualitetë. Në radhë të parë, ata duhet të jenë të guximshëm dhe trima. Por këto virtute nuk fitohen vetëm duke i propaganduar nga zyra.

Ushtari dhe oficeri duhet të përvetësojnë Artin Ushtarak të Luftës Popullore dhe këtë art ta mësojnë jo në mënyrë shabllone, por duke u qëndruar besnikë parimevë të luftës sonë. Ushtarit dhe oficerit duhet t'u punojë mendja vazhdimisht se si do ta zbatojnë në praktikë artin ushtarak. Në qoftë se nuk mësohet si do të zbatohet në praktikë ajo që rekomandohet për ushtrinë, atëherë ato që thuhen do të jenë teori pa vlerë, e mësuar në mënyrë shabllone dhe, si e tillë, nuk do të japë rezultatet c dëshiruara në momentin e një emergjencë.

Ushtari dhe oficeri duhet të jenë me iniciativë. Në qoftë se ne, nëpërmjet përvetësimit të artit ushtarak dhe stërvitjeve luftarake nuk i mësojmë këta që të kenë iniciativë, të kenë kurajë dhe të shfaqin lirisht mendimin që kanë për veprimet që duhet të kryejnë, ne nuk do të kemi as ushtarë, as oficerë të mirë. Të mos kujtojmë, mendoj unë, se vetëm sigurimi i lidhjeve telefonike nga komanda deri në veshin e ushtarit do t'i zgjidhë problemet e sulmit e të kundërsulmit, të mësymjes e të kundërmësymjes. Jo, ndërlidhja e komandës me trupën duhet absolutisht, sepse pa ndër-

lidhje nuk ka komandë, nuk ka zbatim të urdhrave, nuk ka rregull, por duhet njohur mirë nevoja që ushtari ta përpunojë në kokën e tij urdhrin që merr dhe ta zhvillojë atë me iniciativë. Në qoftë se ushtaraku nuk e ka këtë iniciativë, ai shndërrohet në një automat dhe automati nuk mund të nxjerrë një punë të pastër, sidomos në një situatë aq kritike siç është ajo e luftës. Prandaj, oficerët e ushtarët duhet t'i mësojmë të kenë iniciativë, guxim e pjekuri, se këto cilësi bëjnë që të luftohen paniku, shabllonizmi dhe të sigurohet disiplina e hekurt. Në këtë drejtim ka të meta që duhet t'i kuptojnë sidomos kuadrot.

Kuadrot, në radhë të parë, që nga poshtë e deri lart, duhet t'u hapin rrugën dhe t'u japid shembullin kuadrore vartës për lidhjet e ngushta që duhet të mbajnë me ushtarët. Kuadrot kryesorë të kenë parasysh që kuadrot e trupës bashkë me ushtarët do të jenë ballë për ballë me armikun, prandaj, në qoftë se ndonjë komandant njësie shikon sahatin që të ikë sa më parë në shtëpi ose kërkon në mënyrë të parregullt që të hajë gjellë të gatuara posaçërisht për të në mensën e reparit, kjo nuk është e lejueshme. Shteti u ka dhënë të drejtë kuadrore që, kur është rasti, edhe këta të hanë në kazan tok me ushtarët. Komandanti i repartit ose ai i nënreparlit duhet të flejë edhe tok me ushtarët, në sjetore ose në çadër. Nuk është oficer i mirë ai që nuk e bën këtë. Çfarë punë i thonë asaj kur komandanti i nënrepartit zhvillon mësimin dhe ngrihet e ikën në shtëpi, pa qëndruar disa herë pranë ushtarëve? Më kanë raportuar për këto gjëra. Komandanti ka të drejtë të vejë në familje, por ka edhe një detyrë shumë të

madhe që të qëndrojë sa më pranë ushtarit. Qëllimi i afrimit shpirtëror të oficerit me ushtarin është shumë i madh, se i shërben drejtpërdrejt mbrojtjes së atdheut. Atdheun do ta mbrojmë me gjoks dhe gjoksi përpara armikut, në radhë të parë, janë ushtarët dhe kuadrot e trupës.

Shokët diskutantë e thanë mirë, që një oficer, i cili para pesë muajsh na paskësh qenë arrogant etj., s'ka si të bëhet kaq shpejt masovik, sikundër raportohet nga disa njësi e reparte ushtarake për kuadro të kritikuar. Edhe ne për atë luftojmë që një prepotent i kritikuar të korrigohet e të bëhet masovik, por të mos vihemë në gjumë nga llafet e bukura, se konceptet e njerëzve nuk ndryshohen me urdhra dhe aq kollaj.

Në këtë raport, por edhe në raporte të tjera kam lexuar që shefat e shtabeve dhe vartësit e tyre rrinë në zyra dhe bëjnë plane, duke e konsideruar këtë punë si të vetmen detyrë të tyre. Unë personalisht, kurdoherë kam qenë kundër adhurimit të këtyre planeve që mund të rrëzohen përnjëherë në luftë. Mund të qëndrohet motmot duke bërë një plan «të mirë», por lufta, situata që krijohet papritmas në fushën e betejës, e hedhin poshtë atë dhë, pa humbur kohë, duhet bërë plan tjetër. Këtë mendim unë nuk e them si diçka të supozuar, por kam parasysh ngjarje dhe histori të luftërave që janë zhvilluar.

Në qoftë se kuadrot tanë të shtabeve qëndrojnë nëpër zyra, atëherë mund të pësojmë atë fat që pësoi Franca, ku të gjithë djemitë e zotërinjve i kishin vënë nëpër shtabe gjoja për të bërë plane të mëdha. Ata

vazhdonin të bënин plane se si do të luftonte Gamléni<sup>1</sup>, iksi dhe ipsiloni në kufi, në një kohë, kur gjermanët ishin futur në Belgjikë e në Normandi! Kur gjermanët hynë në Francë, këta zotërinj, bashkë me planet e tyre «të mëdha», ua hipën automobilave dhe ikën. Ushtarakët tanë, natyrisht, nuk janë si ata të borgjezisë dhe unë nuk i krahasoj aspak me ata, por çështja është që shokët të mos mbyllen nëpër zyra, por të njohin bazën.

Kur oficerët e shtabeve e kuptojnë drejt këtë detyrë, puna shkon mirë. Përkundrazi, kur problemin e vënë nga komanda kërkojnë ta zgjidhin pa shkuar në bazë, pa njohur njerëzit, pa njohur kuadrot, pa njohur situatat, pa njohur terrenin etj., puna e tyre s'ka vlerë, sidom që ata mund ta dinë mirë hartën dhe leximin e saj. Njerëzit shkojnë nga parimi se në luftë do të zbatojnë planet që bëjnë shefat. Por, në qoftë se këta të fundit i bëjnë planet nga zyra, atëherë do të bëhen gabime në marrjen e vendimeve. Prandaj, shefat që nuk shkulen dot nga zyra, mendoj se duhen vënë përpara në terren e në stërvitje. Në lidhje me këtë çështje unë bëra një pyetje dhe, po të jetë vepruar ashtu siç im'u dha përgjigjja, mua më duket se është vepruar drejt.

Komitctet e Partisë dhe komandat e njësive dhe të reparteve ushtarake duhet të dinë një gjë që, atje ku janë caktuar të veprojnë, lypset të kryejnë me përpikëri, veç detyrave të tjera edhe ato që thashë më përpara.

---

1. Moris Gamlén (1872-1958), gjeneral francez.

Si shumë çështje të tjera edhe fortifikimet të mos konsiderohen sikur nuk janë sekrete, se edhe këto janë shumë sekrete. Po si do ta ruajmë ne këtë fshehtësi kur dihet se nuk është një tunel e një bunker, por janë mijëra të tillë që bëhen në të gjithë vendin dhe që i di gjithë populli? Partia duhet të punojë kudo që të mbyllen gojët dhe të ngrihet vigjilanca. Të kuptohet mirë që këto ndërtime bëhen për mbrojtjen e interesave të atdheut në rast lufte. T'u thuhet njerëzve, se po u treguan llafazanë, duke marrë nëpër gojë tunelin a bunkerin, armiku do t'i mësojë dhe, nesër, kur të futemi për të luftuar aty, ai do të na dëmtojë rëndë. Të kihet parasysh se armiku përpinqet t'i dijë objektet dhe fortifikimet tona ushtarake, prandaj për këto të mos bisedohet as me gruan, as me hallën, as me tezen. Edhe halla, kur të vejë të shikojë objektin, të mbyllë gojën, se nuk është nevoja t'ua thotë të tjerëve. Atë që di secili ta mbajë për vete. Kjo është një gjë me rëndësi të madhe.

Që të arrihen këto synime të drejta, shokë, jam dakord të bëhen edhe mbledhje, por mua më kanë raportuar, se, me gjithëqë mbledhjet janë të frytshme dhe në to janë mbajtur raporte të mira, prapëserapë mjaft pjesëmarrës në to gogësijnë. Në qoftë se disa nga oficerët vijnë në mbledhje dhe nuk i hapin veshët, nuk marrin mundimin të mbajnë shënime, atëherë ata nuk e kuptojnë nevojën e përgatitjes serioze, sistematike e të vazhdueshme për rast lufte. Oficerët, si këta për të cilët po flas, shkojnë nga mendimi që raporti i mbajtur në mbledhje do t'u shkojë të tërëve i shkruar,

prandaj nuk dëgjojnë me vëmendje. Shumë gabim mendojnë këta shokë për disa arsyen. Para së gjithash, sepse ata kanë vajtur në mbledhje pikërisht që të dëgjojnë dhe të reflektojnë mbi ato që thotë ai që po flet apo që raporton. Mundet që ndonjëri s'kishte për të diskutuar, por, kur dëgjoi me vërejtje referuesin, vuri re se disa gjëra, për shembull, nuk janë shtruar drejt. Atëherë, ai duhet të ngrihet dhe të diskutojë haptazi përparrë shokut, i cili mund ta sqarojë diskutuesin kur ky e ka kuptuar çështjen gabim, ose të korrigojë raportin apo referatin e tij në atë pjesë që nuk është shprehur saktë.

Çfarë tregon mosmbajtja e shënimive në mbledhjet e punës? Tregon edhe mungesën e një zhvillimi ideopolitik, kulturor dhe profesional të kuadrit, si dhe mungesën e iniciativës së tij për të konkluduar shpejt. Në jetë do të vijë rasti që të konkludohet në minutë nëse do të sulmohet apo nuk do të sulmohet. Në rast se do të sulmohet, duhet përcaktuar pa humbur kohë se ku dhe kur do të sulmohet, do të bëhet tërheqje apo do të vazhdohet mësymja. Kur i raportohet komandantit të repartit ose të njësisë nga vartësit, atij duhet t'i thuhet edhe mendimi rrëth problemit në fjalë. Atëherë, ai pasi dëgjon edhe mendimin e tij, do t'i thotë vartësit të tërhiqet ose të qëndrojë deri në vdekje dhe vartësi do të zbatojë urdhrin pa asnjë diskutim.

Indiferentizmi për problemet që shtrohen në mbledhje nuk përputhet me karakteristikën e vërtetë të një oficeri, i cili duhet ta dëgjojë me vërejtje diskutimin dhe të flasë, në qoftë se mund të ketë vërejtje ose të

kërkjojë shpjegime kur nuk e kupton mirë diçka që thuhet. Për gjërat që nuk i duken të drejta, oficeri të bëjë kritikë në vend. Kështu mbledhja do të jetë me të vërtetë një mbledhje punc ku jepet raport, ku bëhen debate dhe dilet me konkluzione, ku i jepet mundësi përgjegjësit kryesor të pranishëm të arrijë në përfundime të drejta. Këto mbledhje me karakter punc, nuk kanë thjesht qëllimin e shtruarjes së direktivës, sikurse mund të jetë një mbledhje që organizohet posaçërisht për këtë qëllim, për shembull, kur vjen Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, me porosi të Komitetit Qendror, dhe thërret të gjithë officerët kryesorë, të cilët, pasi marrin direktivën, e vënë menjëherë në zbatim.

Mbledhjet e punës ku disa flenë e disa nuk marrin shënimë, apo që kanë ardhur të papërgatitur për të dhënë llogari dhe diskutojnë sa për të kritikuar vartësit, nuk duhet të përsëriten. Bile, jo vetëm nuk duhet të përsëriten, por duhen gjetur shkaqet përse na ndodh ky fenomen. Për këto gjëra Partia dhe shokët e komandës lypset ta thellojnë punën për t'i analizuar si duhet këto shfaqje.

Shpeshherë shkohet me mendimin e gabuar, se ato që do të thotë ky ose ai shok, dihen; veç kësaj, edhe fjala e tij e shkruar do të vijë, por më mirë të dëgjohet se ç'konkluzione do të japë drejtuesi kryesor, pra, kanë kuriozitet që të thuhet ndonjë gjë e re, që nuk dihet. Shokët udhëheqës, natyrisht, do të flasin për çështje të rëndësishme, por ata më parë duhet të ndihmohen duke ua raportuar drejt gjendjen e punëvc.

Shokët e udhëheqjes e dinë si është situata, përgjithësisht, për problemet që shtrohen. Por, atyre u forcohet akoma më shumë besimi kur shohin konkretisht që njerëzit janë në këmbë, që kanë iniciativë, që pyesin, që diskutojnë, pra, ata inkurajohen kur shikojnë se oficerët dhe ushtarët interesohen për problemet e mbrojtjes.

Në këto drejtime mendoj se duhet të përmirësohet puna e ushtrisë. Unë dhe të gjithë shokët, sikurse thashë edhe në fillim, jemi të mendimit që ushtria ka bërë përparime. Pas zbulimit të tradhtisë së puçistëve, të mos jemi aspak pesimistë. Por, unë rekomandoj të mos jemi optimistë jashtë masës sa të mendohet se fryma aq e sëmurë, që ishte futur në ushtri dhe te disa kuadro, do të zhduket menjëherë. Duhet të udhëhiqemi nga parimi që, përgjithësisht, shumica dërrmuese e kuadrove të ushtrisë janë të vendosur, të ndershëm dhe me partishmëri, por mes tyre ka edhe disa të këqij. Pas kaq kohe të zbulimit të tradhtisë së puçistëve kanë dalë disa oficerë, të cilët, duke qenë të fshehur brenda radhëve tona, propagandonin se puçistët Beqir Balluku e Petrit Dumja gjoja na paskëshin qenë «perënditë e luftës!». Këta oficerë armiq bënин një punë komplotiste, ilegale, duke përhapur jo një parullë armiqësore, por disa të tilla me qëllim që të minonin osc të dobësonin pushtetin popullor, prandaj ndaj tyre u mbajt qëndrimi.

Të gjëzohemi që punët shkojnë mirë në ushtri, por vigjilencën revolucionare duhet ta mbajmë kurdoherë të gjallë dhe në rritje. Për të gjitha, por veçanërisht

për çështjet ushtarake duhet të jemi vigjilentë. Ka q  
kisha për këtë çështje.

Mirë. Mbaruam me ju, shokë të ushtrisë.

Ju urojmë suksese në punë dhe mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH.  
që gjendet në AQP*

T R E G U E S I T



## TREGUESI I LËNDËS

### A

*Afrika, ndërhyrjet e superfuqive në këtë kontinent dhe lufta e popujve afrikanë kundër tyre — 70, 127, 128, 154, 162, 170, 172-174.*

*Aristokracia e klasës punëtore — 125, 178-179.*

*Arkitektura, urbanistika; arkitektët — 250-253.*

*Armatimi i shteteve imperialiste e revizioniste dhe demagogjia e tyre për çarmatim — 134-135, 151-152, 170, 173-174.*

*Armiqtë; reprimitaria armiqësore dhe lufta kundër tyre — 34, 35-36, 39, 60, 89-90, 111-112, 206-207, 270-271.*

*Arsimi në RPSH — tekstet shkollore, lëndët mësimore; mësuesit, pedagogët — 323-339, 352-353.*

*Arti Ushtarak i Luftës Popullore; përvetësimi i tij — 50, 391, 392.*

*Azia, lufta e popujve të këtij kontinenti kundër ndërhyrje-*

*ve të superfuqire — 127, 128, 137, 170, 174, 281.*

### B

*Bashkëzistencë paqësore — 63, 148-149, 273.*

*Bashkimet Profesionale të Shqipërisë — roli dhe detyrat e tyre në edukimin komunist i është anëtarëve — 365.*

*Bashkimi Sovjetik (1917—1953), Partia Komuniste (b) e BS. Lufta e Madhe Patriotike e BS — 7, 3, 9, 10, 11, 43, 61, 63, 124, 132-133, 136-138, 144, 153, 221, 228-229;*

*— marrëdhëniet me Anglinë, Francën dhe Gjermaninë në prag, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore — 61-63, 190-191.*

*Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik; shkaqet e lindjes dhe ardhja në pushtet e revizionizmit. Strategjia e takatikat, agjenturë e imperializmit. Kriza e tij — 43, 70, 125, 135-136, 137, 138-145, 152-159, 194-195, 227-228, 229,*

- 243-244, 282, 309;
- degjenerimi i mëtejshëm i partisë, i pushtetit dhe i jetës ekonomiko-shoqërore; depërtimi i kapitaleve të huaja: shndërrimi i tij në një shtet socialimperialist — 72, 125-126, 140, 142-143, 144-145, 195, 200, 278, 282;
  - politika hegemoniste mbi vendet e partitë revizioniste dhe kontradiktat me to — 141, 143-144, 147-150, 154, 196-197, 198, 222, 279, 282;
  - aleanca dhe kontradiktat me ShBA dhe me shtetet kapitaliste. Keqësimi i marrëdhënieve me Kinën. Përpjekjet për të depërtuar në rajone të ndryshme të botës — 18, 19, 141, 149, 152-153, 154-155, 156-157, 170;
  - qëndrimi armiqësor ndaj RP të Shqipërisë; sabotimet e revizionistëve sovjetikë në sektorin e naftës — 89-90, 91, 209, 310.
- Blegtoria* në RPSH — zhvillimi i blegtorisë; bagëtitë e imëta, bleta — 32, 293, 376.
- Borgjezia, borgjezia e re* revizioniste — 52, 59, 86-87, 126-127, 131, 140, 160, 177, 180, 200, 214, 215, 217-218, 221, 223, 225, 274.
- Britania e Madhe. Kriza e imperializmit anglez. Marrëdhëniet me ShBA. Qëndrimi ndaj Shqipërisë* — 57, 62, 94, 128-130, 161, 166, 190, 197-198, 271.
- Bujqësia* në RPSH — politika e Partisë për zhvillimin e saj. Studimet, organizimi dhe drejtimi i punës në bujqësi — 98-99, 103-105, 265-266, 373;
- shërbimet në bujqësi: rritja e rendimenteve dhe e prodhimeve bujqësore — 45-46, 286-288, 303, 380-382;
  - toka, trajtimi shkencor i saj. Mekanika bujqësore — 263-264, 303;
  - kuadrot, specialistët e bujqësisë — 99-100, 104-105, 108, 291-293, 297-298;
  - drithërat e bukës. Pemëtaria — 293, 330-332;
  - ulliri, fidanishtet e ullinjve — 285-289, 290-293, 294, 299-300, 303, 304;
  - lufta kundër koncepteve e praktikave të dëmshkme në bujqësi dhe masat për shëndoshjen e gjendjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj — 255, 259-261, 262-266, 289-290.

**C**

- Çmimet në RPSH. Çmimet e produkteve blegtoreale — 75-76, 112.  
 Çmimet në tregun botëror — 76, 320-321.

**D**

- Dallimet në socializëm — ngushtimi i dallimere thëlbësore midis fshatit dhe qytetit; ngushtimi i dallimere midis pagave — 74-75, 111-112.

Demokracia borgjeze — 58, 178, 274-275.

Diktatura e proletariatit — 65.

Disiplina shkencore e teknike — 308-309, 366, 367-368.

**E**

Edukimi komunist; edukimi ideopolitik, njohja e gjendjes ndërkombëtare. Puna e diserencuar me njerëzit — 39-41, 314-322, 365-367.

Egjipti; agresioni anglo-frankon-izraelit kundër tij — 54-55, 71, 130-131, 155, 171-172.

Ekonomia popullore në RPSH — forcimi i llogarisë ekonomike; shfrytëzimi i burimeve dhe i mundësive të brend-

shme — 106-107, 264-265, 286-287, 300, 303;  
 — masat dhe detyrat për shëndoshjen e gjendjes në ekonomi pas shpartallimit të grupit armiqësor të A. Këllezit, K. Theodhosit, K. Ngjelës etj. — 36, 44, 103-109, 369.

Engels, Fridrik — 5, 52, 53, 56, 113, 115, 121, 137, 138, 194, 199, 216, 220, 224, 276.  
 Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 11, 16, 24, 25-26, 45, 46, 144, 146, 312-313, 326, 365.

Europa, Europa Perëndimore, «Europa e Bashkuar»; përpjekjet për të depërtuar në SS dhe në vendet e tjera revisioniste — 57-58, 60, 115-116, 150-151, 152-153, 159-160, 162-163, 169, 188, 191, 202-203.

**F**

Faktori i brendshëm dhe faktori i jashtëm; roli i tyre në jetën e shoqërisë — 204, 213-214.

Fësja, fetë e ndryshme. Qëndrimi i PPSH ndaj fesë — 1-3, 40, 243.

Financat — kontrolli finançiar — 101-103.

Franca — kriza e imperializ-

*mit francez; politika e jashtme; aleanca dhe kontradiktat me ShBA, afrimi me RF të Gjermanisë — 131-132, 161-162, 164, 166-167, 190, 197-198.*

*Fshatarësia, fshatarësia koooperativiste; fshati socialist — 46, 245-246.*

**G**

*Gruaja shqiptare — emancipimi i saj — 45, 111, 245-246, 267, 298-299, 311-312.*

*Grupet armiqësore antiparti dhe lufta për shpartallimin e tyre — 108, 353;*

- grupi armiqësor komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes, H. Çakos etj. në ushtri — 32-33, 35, 37, 50-51, 66;
- grupi armiqësor sabotues i A. Kellezit, K. Theodhosit, K. Ngjelës etj. në ekonomi, në sektorin e naftës dhe në tregti — 31, 32-34, 37, 47-48, 66, 93, 95, 108, 262-263, 311, 370, 377;

- strategjia dhe taktitat; agjentura në shërbim të shteteve të huaja; zbulimi dhe dënim i tyre — 32-34, 35, 37, 65, 66, 311.

**GJ**

*Gjeologjia, gjeologjia e naftës, kërkimet gjeologjike; gjeologët, specialistët — 29-30, 94, 95, 362-363, 364-365.*

**H**

*Historia ushtarake — 304-305.*

**I**

*Imperializmi — thelbi, karakteristikat kryesore; kontradiktat dhe kriza e tij e përgjithshme; politika grabitqare, kolonialiste dhe neokolonialiste — 120, 123-124, 126, 147, 179-180, 187-188, 227-228, 283.*

*Indiferentizmi, formalizmi, mendjemadhiësia, familjariteti — 38-39, 258-259, 298, 365-367, 391, 397-398.*

*Industria e rëndë në RPSh — industria minerale. Industria metalurgjike; metalurgët dhe specialistët e metalurgjisë — 76-77, 305-309, 362-364.*

*Interesi i përgjithshëm dhe interesi vetjak — 37-38.*

*Internacionalizmi proletar — 199, 204, 213-214.*

*Internacionalja III Komuniste (Kominterni) — 8-9, 220-222.*

*Investimet; përdorimi i tyre me efektivitet — 77, 106.*

*Italia — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme; qëndrimi ndaj Shqipërisë — 59, 162, 190, 197-198, 239-240, 270-271, 272-275, 283-284.*

**J**

*Jetesa dhe mirëqenia në shqërinë tonë socialiste — 74-75, 112, 245-248.*

*Jugosllavia, revizionizmi jugosllav; Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë; gjendja e brendshme — 231, 232, 233, 237, 324;*

— politika e jashtme demagogjike; depërtimi i kapitaleve të huaja. Qëndrimi armiqësor ndaj Shqipërisë — 33, 34, 127, 145, 168, 182-183, 231-233, 237;

— qëndrimi armiqësor ndaj Kosovës dhe popullsisë tjetër shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi — 233-234.

**K**

*Kapitalizmi — kontradiktat, krizat, papunësia, varfërimi i masave punonjëse — 58, 60, 117, 122, 124-125, 135-136, 137, 147, 168-169, 175-176, 179-180, 281-282, 318-322;*

— ligji i zhvillimit të parabarbartë. Ligji i fitimit maksimal. Kërkesa dhe oferta — 58, 163-164, 319, 320-321.

*Këshillat Popullorë. Komitetet ekzekutive, aparatet dhe kuadrot e tyre; kompetencat, metoda dhe stili në punë — 103-104, 110, 286, 287, 209, 291-294, 295, 300, 301, 304, 349-356, 357-361, 368-369, 382;*

— Komiteti Ekzekutiv i KP të Rrethit të Korçës dhe aparati i tij — 349-356.

*Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave — 34, 76, 286, 289, 304, 357, 360, 375, 387.*

*Kina — vështrim mbi historinë dhe kulturën kineze — 1-4, 8;*

— gjendja e brendshme katolike; Revolucioni Kulturor — 3-4, 14-15, 21, 22, 64-66, 69, 79-87, 113-114, 192-193;

— partia komuniste (revisioniste) e Kinës — 3, 4-10, 12, 13-14, 21-22, 64, 79-87, 113-114, 185, 188, 189;

— strategjia dhe taktikat në arenën ndërkombëtare. Shtrembërimi i marksizëm-leninizmit. Vep-

- rimtaria sabotuese kundër lëvizjes m-l dhe lëvizjeve revolucionare të popujve — 5-6, 9-13, 21-22, 121-122, 188, 189-190;
- politika e jashtme koniunkturale: përkrahanja për imperializmin dhe forcat reaksionare; acharimi i marrëdhënieve me BS dhe atrimi me ShBA — 9-10, 16-20, 72, 114-116, 117, 122-123, 185-186, 187, 188, 191-192;
  - presionet politike dhe ekonomike kundër RP të Shqipërisë — 13-14, 16, 20-21, 67-69.

*Shih edhe:* Teoritë e pikëpamjet borgjezo-revisioniste dhe kritika ndaj tyre — kritikë teorive dhe pikëpamjeve të revisionistëve kinezë. . . .

*Klasa punëtore në vendet borgjeze e revisioniste; roli i saj udhëheqës — 52-53, 55, 58-59, 74, 126, 176, 215, 221, 274.*

*Klasat dhe lufta e klasave — 39, 121-122, 128, 179, 180, 200, 306.*

*Kolonializmi, neokolonializmi; shthitura e sistemit kolonial — 123-124, 126, 127, 130, 179-180.*

*Komunisti — cilësitë, virtutet moralo-politike dhe roli*

*pararojë i tij — 37, 38, 291, 294, 300, 314-319, 334-385.*

*Kontradiktat në arenën ndërkombëtare — 123-128, 141-142, 146-147, 163-164, 187-188, 275.*

*Kontratat, kontraktimet — 301-303.*

*Kontrolli i Partisë, i shtetit, i klasës punëtore dhe i masave — 108, 109-111, 262, 301-302, 370.*

*Kooperativat bujqësore — organet drejtuese; organizimi dhe drejtimi i punës në kooperativat bujqësore; ndihma e shtetit për to — 99-100, 105, 108, 247-248, 265-266, 300-301;*

*— kooperativat bujqësore të tipit të lartë — 99-100, 101;*

*— ekonomistët e financierët dhe forcimi i llogarisë ekonomike e financiare në kooperativat bujqësore — 101-103, 264-265, 303-304.*

*Kosova, kosovarët dhe populësia tjeter shqiptare që jeton në trojet e veta në Jugosllavi — 232, 233-235.*

*Kreditë dhe ndihmat e shteteve imperialiste dhe socialistë-imperialiste — 127, 133, 145, 148-149, 150, 159-160, 192.*

*Kritika dhe autokritika; kër-*

kesa e llogarisë — 263, 293, 382, 389-390.

*Kuadrot, specialistët — politika e Partisë me kuadrin; përgatitja, zgjedhja dhe vendosja e tyre; ngritja e kuadrove të rinj — 34-35, 256, 267-268, 292-293, 339-340, 364-368, 369-370, 377-378, 385;*

- plotësimi i dokumenteve të kuadrit, sektorët e kuadrit, kartotekat — 339-340, 377-378;
- rregullimi i raportit të kuadrove të rinj dhe të vjetër; shfrytëzimi i afësive dhe i përvojës së kuadrove të vjetër — 256, 296-298, 332, 334-335, 336-338.

*Kultura, shkenca dhe letërsia botërore — 1-4, 210, 328-329.*  
*Kuvendi Popullor, Presidiumi i tij — 357.*

## L

*Lenin, Vladimir Illich — 5, 6, 7, 10, 43, 50, 52, 53, 56, 74, 115, 116, 120, 121, 122, 123, 125, 126, 136, 137, 138, 168, 188, 191, 192, 194, 196, 197, 199, 214, 216, 219, 220, 221, 222, 224, 242, 250, 273, 276, 385.*

*Letërsia, historia e letërsisë shqipe — 325-328.*

*Lëvizje marksiste-leniniste botërore. Strategjia dhe tak-*

*tikat, forcimi i unitetit në gjirin e saj — 60-63, 121-122, 159, 175-178, 187-189, 201-202, 215-219, 222-225;*

- partia marksiste-leniniste; roli udhëheqës; shtimi i radhëve të saj. Lindja dhe forcimi i partive të reja m-l — 60, 74, 113, 176, 201, 215-220;
- lufta e partive m-l kundër borgjezisë, revizionizmit dhe reaksionit — 216-217, 218, 224, 225.

*Lëvizjet dhe luftërat revolucionare e çlirimtare të klasës punëtore dhe të popujve — 58-59, 124, 126-127, 128, 172-174, 229, 309-310.*

*Lindja e Mesme dhe e Afërt — 70, 155-156, 170, 171, 243-244.*  
*Luftha e Dytë Botërore (1939-1945) — 54, 124, 128-129, 131, 132, 153, 159-160, 161-162, 228-229.*

*Luftha — teoria marksiste-leniniste për luftën; psikoza e luftës dhe shkaktarët e shpërthimit të saj — 51-52, 115, 126, 134-135, 143, 152, 153-159, 164, 170, 173-174, 188-189, 206, 224, 227, 229-230.*

## M

*Marksizëm-leninizmi — karakteri universal, busull dhe*

*udhëheqje për veprim. Studimi dhe zbatimi krijues i tij — 52, 119-122, 123, 126-127, 137-138, 189, 204, 214, 220, 224, 314, 317, 322;*

*— mbrojtja e marksizëm-leninizmit nga PPSh. Lufta kundër shtrimës së rimeve të tij — 200-201.*

*Marks, Karl — 6, 52, 53, 56, 63, 74, 113, 115, 120, 121, 122, 125, 126, 127, 138, 164, 179, 183, 194, 197, 199, 214, 215, 220, 224, 259, 321.*

*Masat popullore. Roli i mësave dhe i individit në shfaqjet. Lufta kundër kultit të individit — 5, 10-11, 12, 34-35, 105, 259.*

*Mbështetja në forcat tona — 76, 204.*

*Mbledhjet — organizimi i tyre; rritja e efektivitetit të tyre — 343, 344-347, 353-354, 357-368, 369, 396-397, 398-399.*

*Mbrojtja e atdheut — përgatitja dhe forcimi i gatishmërisë së popullit, të ushtrisë dhe të vendit për mbrojtje — 32, 49-50, 51, 230-231, 301-392, 396.*

*Metoda dhe stili në punë — 258, 261-262, 336-337, 367-368.*

*Metoda materialiste dialektike në trajtimin e fenomeneve*

*të shoqërisë: analiza klasore; kapja pas hallkës kryesore — 120-123, 146-147, 185-188, 190-191, 314-322.*

*Ministratë dhe kuadrot e tyre — 239, 291, 301-302, 337;*

*— Ministria e Mbrojtjes Popullore; Komiteti i Partisë në këtë dikaster — 303-309;*

*— Komisioni i Planit të Shtetit — 373-374, 377; — Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 94-95, 369;*

*— Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore — 300-301, 302;*

*— Ministria e Bujqësisë; masat për shëndoshjen e gjendjes në këtë dikaster — 107-108, 255, 257-258, 259-262, 266, 283, 289-290, 291, 294-296, 297-298, 300, 304, 311-312, 319, 340, 341, 372-373, 374-377, 380, 332, 303;*

*— Ministria e Arsimit dhe e Kulturës; masat për shëndoshjen e gjendjes në këtë dikaster — 293, 311, 312, 336-337, 338.*

*Minoriteti grek në Shqipëri — 235-236, 238-239.*

*Monumentet e kulturës — 29-30, 252, 253.*

Nasta dhe gazi; studimet, shpim-kërkimet dhe shpim-shfrytëzimet për naftë e gaz; kuadrot, nastëtarët, inthiniertët e naftës — 26-29, 30-31, 47-49, 89-96, 311.

Ndërmarrjet, ndërmarrjet bujqësore; organizimi dhe drejtimi i punës në to. Lufa përmënjanimin e dotacioneve — 99, 108, 265, 358, 359.

Ndërtimi në RPSH — projekuesit, preventivuesit, investitorët, zbatuesit (ndërtuesit); lidhjet dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre — 106-107.

Ndërtimi i socialistit; politika e Partisë për ndërtimin socialist të vendit — 34-35, 42, 43.

## O

Oportunizmi, liberalizmi, sakterizmi — 17, 81.

Organizata-bazë e Partisë — forcimi i unitetit dhe roli edukues i saj — 38-39, 313;

— organizatat-bazë të Partisë në kooperativat bujqësore — 99, 294, 300, 384.

Organizimi dhe drejtimi i punës — 47, 100-101, 261-262, 292, 338, 339, 349-354, 355, 367-368, 370-371, 375-376.

Paga — politika e Partisë në këtë fushë — 74-75, 111, 112. Partia e Punës e Shqipërisë — karakteristikat revolucionare m-l të saj — 37.

Partia e Punës e Shqipërisë — lufa e klasave në Parti — 36:

- qëndrimi ndaj të metave e gabimeve dhe ndaj elementeve që gabojnë e bëjnë fajc — 36-37, 43-44, 96, 258-259, 294, 311;
- masat ndëshkimore, përjashtimet nga Partia — 294.

Partia e Punës e Shqipërisë — organet udhëheqëse qendrore e lokale

- Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati i KQ — 34, 41, 44, 50, 254, 255, 288-289, 294, 298, 304, 357-358, 364, 377-378, 383, 390;
- aparati i KQ të Partisë — 285, 377, 387;
- komitetet e Partisë në rrethe, aparatet, instruktoret dhe kuadrot e tjerrë të tyre — 103, 110, 291, 292-293, 295, 373;
- organizata dhe Komiteti

- i Partisë i Rrethit të Vlorës — 23-24, 31, 39, 77-78;
  - organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Lushnjës — 93-94, 100-101, 103;
  - studimet, raportet dhe materialet për organet udhëheqëse — 379-380.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- strategjia dhe taktikat për probleme të zhvillimit botëror. Analiza klasore marksi-st-leniniste dhe qëndrimi partimor ndaj gjendjes ndërkontrolltare — 119-128, 146-147, 159, 193-196, 314-322;
  - solidariteti dhe përkrahja internacionale për partitë marksiste-leniniste — 213-214;
  - lufta për demaskimin e revizionizmit sovjetik — 141, 193-194, 201.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- vija, vendimet dhe direktivat; organizimi dhejeta e brendshme
  - roli udhëheqës dhe forcimi i Partisë — 39, 43, 100-101, 103-104, 290-291, 370-371;
  - vija, vendimet e direktivat e saj; njohja dhe zbatimi i tyre — 36-37, 74, 96, 100-101, 258, 268, 294-295;
  - uniteti në Parti dhe lufita kundër shfaqjeve të huaja që e cenojnë atë — 38-39;
  - pranimet në Parti — 36-37, 41-42, 385-386.
- Partitë borgjeze* — 178, 272, 274.
- Pensionet, pensionistët, pensionet për anëtarët e kooperativave bujqësore* — 245, 246-247, 331-332.
- Planifikimi, planet* — përsosja e metodave të planifikimit, parimet e planifikimit — 44-45, 46-47, 101-102, 375-377;
- pjesëmarrja e masave në hartimin dhe plotësimin e planeve — 300, 379-380, 381-382;
  - argumentimi i planeve me aftësi prodhuese, me burime materiale, financiare dhe njerëzore — 101-103, 263-264, 303-304, 363-364, 375-377;
  - projektplani i gjashtë pësëvjeçar (1976—1980) — 44-45, 48, 76, 363-364, 373-374, 379-380, 381-382, 383-384;
  - planifikimi, planet në kooperativat bujqësore dhe lufta për realizimin e tyre — 45-47, 101-102, 263-265, 293-294, 300, 374-375, 379-380, 383-384.

*Politika e jashtme parimore e RPSh* — 63-64, 115-116, 145, 151, 203-213, 225-227:

- demaskimi i imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit — 52, 53-54, 60-61, 66-67, 71-72, 119-120, 126-128, 159, 175-176, 203, 214-215, 230, 281;
- përkrahja internacionaleste për lëvizjen punëtore dhe luftërat çlirimtare e revolucionare të popujve. Solidariteti me popujt dhe vendet arabe — 53-54, 71, 213-215, 243-244;
- marrëdhëniet me vendet fqinje (me Jugosllavinë, Greqinë, Italinë, Bullgarinë e Turqinë) — 63, 231-235, 236-242, 271;
- qëndrimi ndaj Kinës dhe demaskimi i revizionistëve kinezë — 14, 16-17, 68-69;
- rritja e prestigjit dhe e autoritetit të RPSh në botë. Përkrahja internacionaleste e popujve, e forcave përparimtare dhe e partive marksiste-leniniste për RP të Shqipërisë. Të huajt për Shqipë-

rinë — 55-56, 116, 204, 213, 272;

— qëndrimi parimor marksist-leninist ndaj Kosovës dhe krahinave të tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi — 233-235.

*Politika — thelbë i saj; trajtimi i problemeve me syrin politik* — 47, 207, 211, 315-319;

— politika proletare dhe ajo borgjeze — 212-213, 225-227.

*Populli shqiptar — traditat patriotike, virtytet moralo-politike* — 37, 56, 207, 230.

*Prodhimi material — rritja e pandërpërprerë e tij* — 75-76, 112.

*Propaganda, agitacioni dhe shtypi në RPSh* — 117, 194, 314, 315, 318.

*Propaganda dhe shtypi borgjezo-revizionist* — 11, 13, 14, 19, 85, 218, 227, 229-230, 271, 274-275.

## R

*Revizionizmi modern — strategjia dhe taktikat; kontradiktat në gjirin e tij; roli i tij sabotues në lëvizjen punëtore: agjenturë në shërbim të borgjezisë dhe të imperializmit* — 60, 73-74, 116-117, 125.

133-139, 141-142, 179, 194-199, 200-201, 221-222, 223, 276-277, 282-283, 284;  
— partia revizioniste italiane, franceze, spanjolle dhe ajo portugeze — 72-73, 152, 200, 272-274, 275-276, 277-281, 283-284.

*Shih edhe:* Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetic... — degjenerimi i mëtejshëm i partisë...; Kina... — partia komuniste (revizioniste) e Kinës.

*Revolucionarizmi i Partisë* dhe i jetës së vendit — 44, 100.

*Revolucioni demokratik, pjesë përbërëse e revolucionit socialist* — 177-178.

*Revolucioni socialist: dialektika e zhvillimit; forcat lëvzëse të tij* — 123, 128, 170-177, 224-225.

*Rinia — bartëse e stafetës së revolucionit. Edukimi marksist-leninist dhe arsimor i saj* — 41-42.

## RR

*Rrethimi, blokada e presioni imperialisto-revizionist dhe lufta për rërvallimin e tyre* — 317-319.

## S

*Sindikatat dhe sindikalistët në vendot kapitaliste* — 60, 117, 178-179, 184.

*Socialdemokracia, socialistët* — 116-117, 125, 152, 178, 179, 202-203, 220, 272, 273.

*Specialistët e huaj në Shqipëri* — 48-49, 89-90.

*Stalin, Josif Visarionovic* — 6, 7, 8, 9, 10, 11, 13, 43, 47, 48, 52, 53, 56, 61, 62-63, 74, 89, 121, 124, 125, 134, 136, 137, 138, 139, 140, 144, 153, 190-191, 194, 199, 216, 219, 220, 221, 222, 224, 228, 233, 258, 259.

*Superfuqitë; alcancat dhe kontradiktat ndërmjet tyre, kriza; politika hegemoniste, demagogjike, e luftës dhe e diktaturit* — 52, 70, 115, 125-126, 135-136, 143, 144-145, 146, 147, 151-152, 155-156, 157-158, 169-175, 176, 228, 229-230, 243-244, 309.

## SII

*Shëndetësia në RPSH — kujdesi për shëndetin e njeriut dhe për nënën e fëmijën* — 24-25, 245-246, 247-248.

*Shkencë; studimet e kërkimeve shkencore. Punonjësit shkençorë* — 31, 49, 92-93, 307-308, 332, 373.

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës: politika e luftës dhe e agresionit, Kriza e tij, Aleanca dhe kontradiktat me reudet e Europës Perëndimore* — 70, 125-126, 129-130, 132-135, 137, 142, 143, 151-152, 158-163, 165, 167, 169-174, 226, 229, 243-244;

— politika e depërtimit në DS dhe në vendet e tjera revizioniste, Afrimi me Kinën — 17-18, 149-150, 157-158, 191-192.

### T

*Teknologjia dhe teknika e përparuar* — 306-309.

*Teoria dhe praktika: uniteti dialektik i tyre* — 261-262, 317-319.

*Teoritë e pikëpamjet borgjezo-revisioniste dhe kritika ndaj tyre* — 197-198:

- kritikë teorive e pikëpamjeve të revizionistëve italianni, francezë e spanjollë për «rrugën paqësore», «rrugën italiane për në socializëm», për «reformat e strukturës», policentrizmin dhe «kompromisin historik» — 72-73, 140, 197-198, 199-200, 275-276, 277, 279-281, 283-284;
- kritikë teorive të revizio-

nistëve kinezë për maocedunidenë, për «tri botët», për strategjinë dhe taktikën e partisë së klassës punëtore, për ekzistencën e rrymave në parti, për pikëpamjet «të lu-lëzojnë 100 lule» dhe mbi mbështetjen te një imperializëm për të luftuar tjetrin — 5, 15-16, 18-20, 53, 54-55, 61, 64-66, 79-87, 113-116, 117, 121-123, 126, 127-128, 159, 175, 180-181, 183, 184, 185-190, 201-202;

— kritikë teorive të revizionistëve sovjetikë e jugosllavë për «rrugën paqësore», «bashkekzistencën paqësore» e «sovranitetin e kufizuar» dhe mbi «vendet e paangazhuara» e «vendet në zhvillim» — 127, 148-149, 180-185, 197-198, 278.

*Tregtia e jashtme* — eksporti, importi — 208-209, 271.

*Tregu i Përashkët Evropian* — 57, 60, 115, 116, 117, 164-168, 188, 202-203, 284.

### U

*Uskëria Populllore* — roli udhëheqës i Partisë Komandat, shqabet. Roli dhe detyrat e ushtrisë për mbrojtjen e at-

*dheut* — 343, 344-347, 388-389,  
390-391, 394, 395, 396-397.  
398-399:

- kuadrot politikë e ushtarakë, ushtarët. Marrëdhëniet kuadër-ushtarë. Lufta kundër arrogancës, prepotencës dhe burokratizmit — 342-343, 347, 390, 392-394, 396-397;
- stërvitja ushtarake; njohja e terrenit. Njohja e armikut, e strategjisë dhe e taktikës së tij — 391-392, 394-395;.
- prapavija e ushtrisë. Ndërlidhja, Urdhri, vendimi luftarak — 343, 347, 392-393, 397;
- masat dhe detyrat për shëndoshjen e gjendjes në ushtri pas shpartallimit të grupit komplotist të B. Ballukut, P. Dumes, H. Çakos etj. — 35-36, 44, 51, 347-348, 399.

**V**

*Vendet e porsaqllruara nga zgjedha koloniale* — 128, 172-174.

*Vendet popujt arabë* — 71, 171-172, 211-212, 243-244.

*Vendet revizioniste. Përpjekjet për t'u shkëputur nga hegemonizmi sovjetik dhe për t'u lidhur me imperializmin* — 58, 135-136, 138-139, 143-144, 147-148, 149-150, 153, 158, 163-169, 191, 195-196, 199, 200.

*Vendet socialiste* — 122, 124, 136-137, 187-188, 204.

*Vigjilanca revolucionare* — 35-36, 370, 396, 399-400.

**ZII**

*Zhvillimi dialektik: në shoqëri* — 309-310.

## TREGUESI I EMRAVE

### A

Alia, Ramiz — 323-324, 325,  
327, 329-330, 332, 333, 334,  
336, 338.

Asllani, Muho — 254-257.

Adenauer, Konrad — 166.

Aleksandri I, Karagjorgjeviç  
— 231.

Alende, Salvador — 54.

Anjeli, Xhovani — 280.

Arra, Shaban — 334-335.

Ataturku, Mustafa Qemal —  
242.

### B

Bakunin, Mihail — 182.

Balluku, Beqir — 32, 33, 34,  
37, 44, 50, 65, 66, 259, 399.

Bauer, Oto — 276.

Berlinguer, Enriko — 199, 200,  
203, 260-281, 283, 284.

Bernshtajn, Eduard — 74, 199,  
273, 276.

Bluher, Vasili — 8.

Bozo, Miti — 289, 292, 340,  
387.

Brauder, Erl — 276.

Brežnjev, Leonid — 70, 145,  
148.

Brunetier, Ferdinand — 326.

### C

Caldaris, Kostandin — 239.

Cami, Testa — 298-299, 312,  
336-337.

Cani, Nimet — 380, 381.

### Ç

Çuko, Lenka — 88-89, 93, 96,  
97-98, 100, 103, 107, 109, 111,  
113, 118, 264.

Çako, Hito — 32, 50.

Çan Kai Shi — 7, 9, 10.

Çen Po Ta — 81, 82.

Çerçill, Uinston — 161.

Çian Çin — 15, 21, 82, 83.

Çipi, Pëllumb — 285-286.

Çomo, Maço — 108, 260.

Çu De — 6.

Çu En Lai — 5, 6-7, 10, 12, 14-  
-15, 16, 17, 18, 19, 21, 66, 67-  
-68, 81-83, 84, 85, 86, 114.

### D

Dalila (figurë mitologjike) —  
173.

- Dalles, Xhon Foster — 131.  
 Deliana, Thoma — 298, 353.  
 Dë Gol, Sharl — 162, 164, 166.  
 Dodbiba, Pirro — 107, 255,  
     260, 262-263, 265, 269, 270,  
     291, 382.  
 Dode, Petro — 373-374, 377  
 Dubcek, Aleksandör — 148,  
     149.  
 Dume, Petrit — 32, 50, 393.

**DII**

Dhrami, Muntaz — 30.

**E**

Etli, Klement — 161.

**F**

Faruk, al - Aual — 54.  
 Ford, Xherald — 31, 191.  
 Franko, Françisko — 17, 167,  
     186.  
 Frashëri, Naim — 328.

**G**

Gallaj, Sulejman — 265.  
 Gamlën, Moris — 395.  
 Gandi, Indira — 174, 175, 185.  
 Gën Biao — 186.  
 Gramshi, Antonio — 273.  
 Gusho, Pirro — 380.

**GJ**

Gjikondi, Vangjel (Lele) —  
     334.

**H**

Hoxha, Nexhmije — 25.  
 Hitler, Adolf — 62, 63, 137,  
     190.  
 Hrushov, Nikita — 11-12, 13,  
     14, 20, 48, 90, 141, 142-143,  
     144, 145, 278, 279.  
 Ilua Kuo Fen — 85.  
 Hygo, Viktor — 329.

**I**

Isai, Hekuran — 324, 333, 338,  
     343-344.

**J**

Jakova, Tuk — 34.  
 Jakubovski, Ivan — 149, 236.  
 Jao Ven Juan — 16.  
 Jehovahu — 243.  
 Judin, Pavël — 5.

**K**

Kapo, Hysni — 23, 24, 26, 32,  
     254, 289, 290, 332, 333, 325,  
     339, 340-341, 342, 343, 318.  
 Kadaf, Mohamer — 172.  
 Kadare, Ismail — 327.  
 Kan Shen — 9.  
 Kao Gan — 4.  
 Karlos, Huan — 73.  
 Karriljo, Santiago — 73, 199,  
     200.  
 Kautski, Karl — 74, 115, 276.  
 Köllezi, Abdyl — 33-34, 37,

44, 66, 108, 259, 264, 377.  
 Kissinger, Henri — 17, 81, 191,  
 280.  
 Konfuci — 2, 4, 5.  
 Konica, Faik — 327, 328.  
 Krishti — 243.  
 Kule, Kristaq — 254-257.  
 Kunjal, Alvaro — 152.  
 Kyri, Mari — 92-93.  
 Kyri, Pjer — 92-93.

## L

Lanson, Gustav — 326.  
 Lengo, Spiro — 254-257, 266,  
 268.  
 Leone, Khovani — 283.  
 Libknecht, Karl — 115.  
 Li Hsien Nien — 16, 85, 86.  
 Li Li San — 8.  
 Lin Biao — 4, 15, 19, 81, 82,  
 83, 84, 85.  
 Liu Shao Ci — 4, 5, 12, 13, 14,  
 15, 65, 81, 82, 83, 114.  
 Lui Filip — 329.

## M

Marko, Rita — 265.  
 Miska, Pali — 94, 337, 369.  
 Mao Ce Dun — 2, 3, 5, 6-7, 8,  
 9, 10-13, 14, 15-16, 17, 18,  
 19, 20, 21, 79, 80, 82-83, 84,  
 85, 86-87, 114, 192.  
 Markos, Ferdinand — 81.  
 Marshall, Xhorxh — 10.  
 Marshie, Zhorzh — 73, 199, 200,  
 203, 280.

Mejer, Golda — 186.  
 Metaksa, Joanis — 230.  
 Miho, Jani — 349-350, 351-  
 352, 354.  
 Mikojan, Anastas — 15, 90.  
 Minic, Millosh — 234.  
 Molotov, Vjaçeslav — 11.  
 Mosko, Sokrat — 249-250, 252.  
 Muhammedi — 243.  
 Musolini, Benito — 271.

## N

Napoleoni I (Bonaparti) —  
 329.  
 Napoleoni III (Sharl Lui Bonaparti) — 329.  
 Naser, Gamal Abdel — 54,  
 130.  
 Ndroqi, Shefqet — 337-338.  
 Nehru, Khavaharlal — 174.  
 Nesho, Gago — 24, 26, 27, 31.  
 Ngjela, Kico — 262-263.  
 Nikson, Ricard — 17, 72, 81.  
 Noll, Fan — 327-328.

## P

Façrami, Fadil — 103.  
 Pen Çen — 81, 113, 114.  
 Peristeri, Pillo — 354.  
 Pin De Hua — 4.  
 Pinoçat, August — 17, 54, 72,  
 185, 186.  
 Polo, Marko — 1.  
 Prifti, Illo — 351.  
 Prudon, Pier — 74, 182.

**R**

Rankoviç, Aleksandër — 235.  
 Romel, Ervin — 54.  
 Rusvelt, Franklin — 161, 162.

**RR**

Rrokaj, Zihni — 26, 27, 28, 29.

**S**

Spahiu, Xhafer — 261.  
 Sadat, Anvar — 54-55, 71.  
 Samsoni (figurë mitologjike) — 178.  
 Saragat, Xhuzepe — 283.  
 Skëndi, Taqi — 337-338.  
 Snou, Edgar — 10.  
 Sonerfield — 191.  
 Suharto, I. — 15.  
 Sun Jat Sen — 7.

**SH**

Shastri, Lal Bahadur — 174.  
 Shlezinger, Xhejms — 192.

**T**

Toska, Haki — 254, 261, 335, 340.  
 Ten Hsiao Pin — 4, 5, 12, 13, 14, 15, 21, 64, 65-66, 67, 81,

82, 83, 84, 85, 86, 113, 114, 135.

Tito, Josip Broz — 13, 33, 127, 145, 183, 185, 186, 199, 236.  
 Toliati, Palmiro — 272, 273, 278, 279, 281.  
 Torez, Moris — 279.  
 Trocki, Lev — 273, 276.

**TH**

Theodhosi, Koço — 33, 103, 353, 370.  
 Thomai, Thermije — 254-257, 266-267, 269, 295, 298-299, 311, 337, 339, 340-341, 372, 373, 374, 375, 376, 377, 383, 387.

**V**

Vandemejer — 10.  
 Venizellos, Sofokli — 239.  
 Vrangel, Pjetër — 231.

**Z**

Zografo, Jorgo — 239.  
 Zogu, Ahmet — 94, 231.

**ZH**

Zhiro, Henri — 162.

## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

- Afganistan — 156, 174.  
Aigjer — 162.  
Algieri — 131, 156, 172.  
Alpet e Veriut — 365.  
Ambasada e RP të Shqipërisë në Itali — 240.  
Ambasada e RP të Shqipërisë në RP të Kinës — 86.  
Amerika Latine — 17, 127, 158, 170, 231.  
„Anglo-Persian Oil Kompani” (shoqëria ~) — 94.  
Anglosaksonët — 271.  
Angola — 70, 172.  
Arabin Saudite — 71, 94, 171.  
Austri — 62, 163, 190.

### B

- Ballkan — 63.  
Banka e Shtetit Shqiptar — 103, 288.  
Belgjikë — 163, 164, 271, 395.  
Beneluks (vendet ~) — 163.  
Bengaz (gjiri ~) — 172.  
Berat — 382.  
Berlini Perëndimor — 163.

Boerët — 123.

Bosnjë — 232.

Brahmanizmi — 243.

Brigadat „Garibaldi“ (Spanjë) — 273.

Budizmi — 1-3, 243.

Bulevardi „Dëshmorët e Kombit“, Tiranë — 250, 252.

Bulevardi „Stalin“, Tiranë — 250.

Bullgarë — 241-242.

Byroja Informative e Partive Komuniste e Punëtore (Informbyroja) — 233.

### C

Çad — 132.

Çekosllovaki — 148, 149, 154, 229, 236, 310.

### D

Dardanele (ngushtica ~) — 242.

Derven (vendburimi mineral ~) — 363.

Deti i Kuq — 156.

Dinarike (alpet ~) — 94.

Dropull (Gjirokastër) — 255,  
265-266.

## E

Egjipti i Lashtë — 1.  
Elbasan — 285.

## F

Fabrika e Plastmasit, Lushnjë — 111.  
Fabrika e Uresë (Uzina e prodhimeve të azotuara «Gogo Nushi»), Fier — 311.  
Fier — 300-331.  
Filipine — 174.  
Francë — 57, 59, 62, 128, 129,  
197, 210, 271, 278, 326.  
Fusha (zona) naftëmbajtëse e Lushnjës — 91, 93-94.  
Fusha (zona) naftëmbajtëse Lushnjë—Vlorë — 89.

## G

Gadishulli Iberik — 152.  
Greqi — 94, 151, 168, 237, 242.  
Guomindan (Partia Nacionaliste) — 7, 8, 10.

## GJ

Gjermani — 62, 128, 190.  
Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 57, 59, 162-  
-163, 197-198.  
Gjiri Persik — 171.  
Gjirokastër — 382, 389-390.

## H

Haskovë (Gjirokastër) — 40.  
Hidrocentrali i Smokthinës,  
Vlorë — 235-236.  
«Historia e letërsisë shqipe»  
(teksti ~) — 328.  
«Historia e Partisë së Punës  
të Shqipërisë» (teksti ~) —  
333.  
Hititët — 307.  
Holandë — 163.  
HSINHUA (Agjencia Kina e Re) — 84-85.

## I

Indi — 154, 156, 174-175, 185.  
Indianët [e Amerikës] — 123.  
Indokinë — 174.  
Indonezi — 15, 185.  
Instituti Gjeologjik i Naftës  
[Instituti i Studimeve dhe i  
Projektimeve Gjeologjike të  
Naftës e të Gazit], Fier — 91.  
Instituti i Gjeologjisë [Instituti i Studimeve dhe i Projektimeve  
të Gjeologjisë] — 367-  
-368.

Instituti i Kërkimeve Bujqë-  
sore, Lushnjë — 98.  
Intelixhens Servisi — 94.  
Internacionalja e Dytë — 196,  
220.  
Izrael — 131, 155, 171, 185,  
243, 244.

**J**

Japoni — 8, 9, 128, 156.

**K**

Kamboxhin — 174.

«Kapitali» (K. Marks, veprat ~) — 321.

Kolona e pestë — 154.

Komiteti i Partisë Komuniste i Pekinit — 84.

Komonuelthi — 130.

Kongresi i 8-të i Partisë Komuniste (revizioniste) të Kinës — 4-5.

Kongresi i 9-të i Partisë Komuniste (revizioniste) të Kinës — 4-5, 19.

Kongresi i 10-të i Partisë Komuniste (revizioniste) të Kinës — 4-5, 19.

Kongresi i 22-të i Partisë Komuniste (revizioniste) Franceze — 72-73.

Kongresi i 23-të i Partisë Komuniste (revizioniste) të Bashkimit Sovjetik — 72.

Kili — 17, 54, 72.

KNER (Këshilli i Ndilimës Ekonomike Reciproke) — 60, 115, 143-144, 149, 188.

Kodi i Punës i RP të Shqipërisë — 359.

Kolonjë (Lushnjë) — 91-92.

Kombinati Metalurgjik [Kombinati metalurgjik «Çeliku i

Partisë], Elbasan — 76, 305-311, 312-313.

Konferenca e Jaltës (Krime, BRSS, shkurt 1945) — 190-191.

Konfucizmi — 1-3, 4.

Kooperativa Bujqësore e Babicës, Vlorë — 45.

Kooperativa Bujqësore e Cakranit, Fier — 381.

Kooperativa Bujqësore e Drashoviqës, Vlorë — 25, 45.

Kooperativa Bujqësore e Gorrës, Lushnjë — 376.

Kooperativa Bujqësore e Këmishtajt, Lushnjë — 257, 265, 266, 295, 376.

Kooperativa Bujqësore e Peshkëpisë, Vlorë — 25, 45.

Kooperativa Bujqësore e Semanit, Fier — 381.

Kooperativa Bujqësore e Tipit të Lartë e Dropullit, Gjirrokastër — 265, 266.

Kooperativa Bujqësore e Tipit të Larië e Plasës, Korçë — 262.

Korçë — 33, 266, 337, 355-356.

Kubë — 70.

**L**

Laos — 174.

Leskovik — 33.

Letra e PPSH drejtuar PK të Kinës lidhur me vizitën e Niksonit në Kinë — 18.

- Libi — 156.  
 «Libri i kuq» (Mao Ce Dun) — 15.  
 Liceu i Korçës — 326.  
 Lipari (ishujt ~, Itali) — 273.  
 Londër — 162.  
 Lufta e Parë Botërore (1914-1918) — 125.  
 Luksemburg — 163.  
 Lushnjë — 93-94, 99, 103-104, 107, 118, 255, 304.

**M**

- Malezi — 156.  
 Mali i Zi — 232, 234, 236.  
 Mallakastër (Fier) — 383.  
 «Manifesti i Partisë Komuniste» (K. Marks, F. Engels, vepra ~) — 57.  
 Maqedoni — 232, 234, 236.  
 Marrëveshja (traktati) e mos-sulmimit ndërmjet Bashkimit Sovjetik e Gjermanisë (1939) — 61-63.  
 Mbledhja e partive komuniste e punëtore në Moskë (nëntor 1957) — 10-11.  
 Megaloide — 236, 239.  
 Mesdhe (zona ~) — 156.  
 Miniera e Bakrit e Rubikut, Mirditë — 367-368.  
 Miniera e kromit «Todo Mançor» e Bulqizës, Dibër — 363, 367-368.  
 Mongoli — 19, 82, 83.

- Monumenti i Lirisë — 250, 252.  
 Monumenti i Pavarësisë, Vlorë — 253.  
 Monumenti skulpturor «Drašovica 1920—1943», Vlorë — 29-30.  
 Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë — 250.

**N**

- NATO (Pakti i Atlantikut Verior) — 60, 115, 116, 147, 151, 154, 162, 164, 166, 167, 181, 188, 191, 280, 281.  
 Ndërmarrja bujqësore «29 Nënëtori», Lushnjë — 108.  
 Ndërmarrja Bujqësore e Teplenës — 265.  
 Ndërmarrja bujqësore «8 Nënëtori», Sukth — 265.  
 Ndërmarrja e Rritjes së Gjedhiit, Maliq — 355.  
 Normandi (Francë) — 395.

**P**

- Pakistan Lindor — 185.  
 Palestinë — 244.  
 Pallati i Kongreseve, Tiranë — 250-252.  
 Partia Demokristiane e Italisë — 275, 280, 283.  
 «Plani Marshall» — 132, 160.  
 Plenumi i KQ të PK të Kinës (prill 1976) — 84-85.  
 Portugali — 152, 168.

**Q**

Qipro — 151.

**R**

- Racizëm — 244.  
 Revolucioni i Madh Socialist  
 i Tetorit — 124.  
 Rilindja Kombëtare Shqipta-  
 re — 242.  
 Rumani — 158.

**S**

- Sarandë — 94, 205.  
 SEATO (Pakti i Organizatës  
 për Azinë Juglindore) — 181.  
 Selanik (Greqi) — 242.  
 Senegal — 132.  
 SENTO (Pakti i Organizatës  
 Qendrore) — 181.  
 «Sëmundja foshnjore e «maj-  
 tizmit» në komunizëm» (V. I.  
 Lenin, Vëll. 31) — 273.  
 Siri — 156.  
 Skandal i «Lokhid» — 239, 283.  
 Spanjë — 17, 59, 273.  
 Suez (kanali ~) — 120-131.  
 Sumerët — 1.

**SH**

- Shangai (Kinë) — 86.  
 Sheshi «Skënderbej», Tiranë  
 — 252.  
 Shkolla e Lartë e Partisë «V.I.  
 Lenin», Tiranë — 316-317, 318.  
 Shkolla e mesme «Ali Demi»,  
 Vlorë — 25.

Shkolla 8-vjeçare «Selam Mu-  
 sin» e Babicës, Vlorë — 25.

**T**

- Tajlandë — 156, 174.  
 Tajvan — 17.  
 Teatri i Operës dhe i Bale-  
 tit, Tiranë — 251.  
 «Tien An Men» (sheshi ~) —  
 6, 84, 86, 113, 190.  
 Tiranë — 285, 286, 289.  
 Traktati egjipto-sovjetik (1976)  
 — 171.  
 Traktati i Brest-Litovskit  
 (mars 1918) — 191.  
 Traktati i Shën-Stefanit (mars  
 1878) — 242.  
 Traktati i Varshavës — 115,  
 143, 147, 148, 181, 183, 279.  
 Traktati (marrëveshja) i Mu-  
 nihut (shtator 1938) — 62, 190.  
 Traktati ndërmjet Bashkimit  
 Sovjetik dhe Çekoslovakisë  
 (para 1939) — 62.  
 Traktati ndërmjet Francës dhe  
 Çekoslovakisë (para 1939) ...  
 62.  
 Tripoli (Liban) — 172.  
 Tunizi — 131, 172.  
 Turqi — 151, 154, 168, 210,  
 241, 242.

**U**

Universiteti «Enver Hoxha» i  
 Tiranës — 335-336.

- Ural (malet ~) — 94. XH  
Ushtria Sovjetike — 153.
- V**
- Vatikan — 271. Z  
«Vepra të zgjedhura» (katër vëllimet ~, Mao Ce Dun) — 5, 6.
- Vietnam — 131.
- Vishi (Francë) — 161. ZH
- Vlorë — 24.
- «Vorio-Epir» — 238.
- Xhamia e Ethem Beut (e Sahatit), Tiranë — 253.
- «Zëri i popullit» (gazeta ~) — 73.
- «Zhenminzhobao» (gazeta ~) — 17, 64.

## LËNDA

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 57-TË

V—VIII

1976

KU KA QENË E KU PO SHKON KINA — Shënime (1 prill 1976) .....	1—22
TE PUNOJMË PA U LODHUR PËR TE ECUR GJITH- NJE MË PËRPARA — Nga biseda me kuadro të Partisë, të pushqitit dhe të organizatave të masave të rrëthit të Vlorës (2 prill 1976) .....	23—73
KAOS NË KINË — Shënime (9 prill 1976) .....	79—87
ORGANIZIMI I PUNËS — NJË NGA ARMËT MË TE FUQISIIME PËR ZBATIMIN E DIREKTIVAVE TE PARTISË — Nga biseda me shqoen Lenka Çuko (17 prill 1976) .....	88—118
PËR PROBLEME TË GJENDJES NDERKOMBETARE — Shënime (Prill-maj 1976) .....	119—244
KËTO MASA SYNOJNE PËRMIRESIMIN E JETE- SËS NË FSHAT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 prill 1976) .....	245—248

NDERTIMET QË BËJMË TANI, DO T'I TRASHËGOJNË DHE BREZAT E ARDHSHËM — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 prill 1976)	249—253
EKSPERIENCA E FITUAR NË BAZË TË RREZATHET NË TË GJITË VENDIN — Nga biseda me kundrot kryesorë të Ministrisë së Bujqësisë (27 prill 1976)	254—269
MBI GJENDJEN SHUMË SHQETËSUESE NË ITALI — Shënimë (27 prill 1976)	270—281
PA NJË KTHESË NË KOKEN E NJERËZVE NUK BEHET DOT KTHESA NË PRODHIMIN E ULLIRIT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (28 prill 1976)	285—301
TE PUNOJME, TE PRODHOJME E TE FORCOJME MBROJTJEN QË KUFIJTE TANË TË JENË GJITHMONË TË PAKAPERCYESHËM — Nga biseda në takimin me një grup punonjësish e specialistësh të kombinalit metalurgjik «Çeliku i Partisë» në Elbasan (29 prill 1976)	305—313
TE NDJEKIM ME KUJDIES GJENDJEN NDËRKOMBETARE — Shënimë (19 maj 1976)	314—322
TEKSTET TË HARTOJHEN NË PRIZMIN MARKSIST-LENINIST — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (21 maj 1976)	323—341
MELEDIJET TË JENË TË ORGANIZUARA MIRE DIHE LUFTARAKE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (24 maj 1976)	342—348

DREJTUESIT E RRETHIIT TI SHOHIN PROBLEMET SA MË KONKRETISIIT DHE TI ZGJIDHIN DREJT E NË KOHË — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (25 maj 1976)	349—356
TE MOS KRIJOJMË HALLKA TË TEPËRTA, BUROKRATIKE — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (25 maj 1976)	357—361
TI JAPIM RËNDËSI MË TË MADHE ZBULIMIT TË MINERALEVE TË DOBISHME — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (27 maj 1976)	362—371
KUADROT E AFTE NJIHEN NË PUNË E SIPËR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (27 maj 1976)	372—378
NË PARTI E KANË VENDIN NJERËZIT MË TË ZOTE, MË TË NGRITUR E MË REVOLUCIONARE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (29 maj 1976)	379—387
NË USHTRI TË MOS VEPROHET KURRË FORMALISIIT — Diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (29 maj 1976)	388—400
Treguesi i lëndës	403
Treguesi i enirave	417
Treguesi gjeografik që i emërlimeve të tjera	421